



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 21 NËNTOR 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 21. NOVEMBRA 2013. GODINE**

**NËNTOR - NOVEMBAR  
2013**

## **Rendi i ditës**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014,
5. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2014,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për fshatin Zym i Hasit,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sistemin e lejeve dhe licencave.

## **Dnevni red**

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o budžetu Republike Kosova za 2014. godinu,
5. Preporuka Komisije za budžet i financije o zahtevu Fonda za penzijsku štednju Kosova za usvajanje godišnje takse za 2014. godinu,
6. Drugo razmatranje Nacrta zakona o selu Zym i Hasit,
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona o sistemu dozvola i licenci.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,  
I nderuari zëvendëskryeministër,  
Ministra të Kabinetit qeveritar,  
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Para se të fillojmë me pikat e rendit të ditës, me rastin e humbjes tragjike të jetës së deputetit Olldashi, kërkoj ta nderojmë me një minutë heshtje.

*(Një minutë heshtje)*

Nderimi qoftë me të!

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

### **1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Kjo pikë është e kufizuar në 30 minuta, diskutimet në emër të grupeve parlamentare 5 minuta, kurse në emër të deputetëve 3 minuta.

Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: I nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Gjatë fushatës për zgjedhjet lokale, duke qenë i koncentruar me angazhime në Malishevën time, më është imponuar një parim imi i mëhershëm në këto përplasje konceptuale, herë edhe pseudo-politike - ruajtja e vlerave tona tradicionale, e vëllazërisë, e fqinjësisë dhe e miqësisë.

Duke e parë fushatën në pjesët tjera të Kosovës, më është imponuar të meditoj se çka i mungon Prishtinës dhe çka ka për obligim brezi ynë të sjellë në imazhin e kryeqytetit dhe ta jetësojë në kujtesën e brezave.

Një konkludim logjik është për Ministrinë e Ambientit dhe për Komunën e Prishtinës.

Në bashkëpunim duhet të përgatisim lokacione dhe të shpallim konkurs publik për projektet e njëmbëdhjetë monumenteve në lapidarë të lartë nëpër pjesë të ndryshme më të frekuentuara në Prishtinë si kryeqytet i vendit, i cili vizitohet më së shumti edhe nga të huajt kureshtarë për identitetin tonë dhe historinë e këtij vendi:

- duhet të përjetësohet akti i luftës dhe i flijimit familjar të Familjes Jashari, akti i heroizmit me identitet - figura ushtarake e Adem Jasharit;

- akti heroik i gatishmërisë për flijimet e emërtuara “Ushtari i UÇK-së”, i cili do të simbolizojë heroizmin me identitet të dhjetëra mijëra ushtarëve dhe gjithë atyre që kanë ndihmuar dhe mbështetur luftën e UÇK-së;
- akti i martirizimit të mbi 15 mijë qytetarëve të Kosovës gjatë viteve ‘98-‘99;
- akti i persekutimit dhe qëndresës nëpër breza të gjysmë shekulli të dhjetëra mijëra të burgosurish, të cilët edhe më vështirë se Laokonti janë sfiduar, por kanë mbijetuar duke udhëhequr dhe motivuar nga një qëllim i lartë, i cili edhe triumfoi në fundshekullin e kaluar;
- akti i dëbimit me dhunë në vitin 1999 të qindra mijëra qytetarëve të Kosovës në tri shtete fqinje, njësoj si eksodi biblik;
- akti i shpërnguljes së dhunshme të afërsisht 650 vendbanimeve etnikisht të pastra si epitaf mbi vrasjet e banorëve e djegiet e pasurive familjare, duke i renditur emrat e të gjitha vendbanimeve dhe dëmet e tjera të njohura me relevancë shkencore dhe që duhet të përjetësohen në kujdesën tonë kolektive për shumë arsye. Emërtimet e një pjese të këtyre vendbanimeve ende ruhen në mbiemra;
- monument mbi vrasjen e pamëshirë të fëmijëve, që gjithkund dhe gjithkush i percepton si krijesa të pafajshme;
- monument mbi masakrimin e pleqve, që gjithkund perceptohen të parrezikshëm;
- monument përjetësimi të gruas, nënë dhe femër, e atakuar për faktin se është priprodhuese e jetës. Artistikisht paraqitet në dy akte, me dy fakte: në shënjestër të masakrimit dhe të poshtërimit me qëndrim stoik;
- harta e njohur e shtrirjes e paraardhësve tanë - ilirëve, dhe tkurrja e tyre nëpër etapa deri në kufijtë e tashëm, ku jetojnë dhe identifikohemi si pasardhës të tyre.

Këto monumente në lapidarë duhet të rrezatojnë cilësi arti dhe veti dëshmie, pa u thelluar në shfletimin e historisë për të kaluarën e për të sotmen. Duke i soditur, ne rrimë gatitur para atyre dhe për të ardhmen tonë tregojmë se në kohë të tilla qëndresa individuale vlerësohet gjithnjë, devotshmëria kolektive...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Në emër të Grupit, Sabri Hamiti, nënkryetari, e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit,

Zotërinj ministra të Kabinetit qeveritar,

Kolegë të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emrin tim personal dhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës të shpreh dhimbjen dhe hidhërimin e madh për vdekjen tragjike të deputetit të Parlamentit shqiptar, zotit Sokol Olldashi.

Po ashtu, në emrin tim personal e të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike i shprehim ngushëllim Parlamentit të Shqipërisë, kryetarit të këtij Parlamenti, zotit Ilir Meta, dhe Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Shqipërisë.

Sokol Olldashi ka qenë njëri nga protagonistët e djelmërisë së demokracisë shqiptare të viteve të ‘90-ta, më parë si gazetar e publicist i ri i njohur, më vonë deputetë në katër

legjislatura dhe deputet aktual i Parlamentit të Shqipërisë dhe njëri nga ministrat më dinamik të Qeverisë Shqiptare. Pra, njëri nga protagonistët e ndryshimeve demokratike në Shqipërinë e dytë të decenieve të fundit.

Ngushëllimet tona i shkojnë edhe familjes Olldashi që e ka humbur më të dashurin e vet në moshën e plotë për shërbimin ndaj familjes dhe shtetit shqiptar. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, kryetari i Grupit, deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Unë e kam shumë shkurt në emër si deputet, jo në emër të grupit.

Desha që edhe unë ta shfrytëzoj këtë foltore të Kuvendit që t’i shpreh ngushëllimet më të sinqerta edhe familjes Olldashi, por edhe të gjithë përfaqësuesve politikë të Republikës së Shqipërisë, edhe kryeparlamentarit të Republikës së Shqipërisë për humbjen e deputetit Sokol Olldashi.

Kjo humbje tragjike natyrisht që e ka goditur politikën në Shqipëri dhe gjithandej politikën shqiptare dhe ngushëllimet tona u shkojnë edhe tërë qytetarëve të Shqipërisë, përfaqësuesve të Partisë Demokratike dhe kryetarit të Partisë Demokratike, Lulzim Basha. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Fjalët që duhet të thuheshin i tha profesor Hamiti. Njëjtë edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e shfrytëzon këtë rast dhe i shpreh ngushëllime familjes Olldashi, Kuvendit të Shqipërisë, Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe kryetarit të saj. Mendoj se të gjitha çka duhet të thuhet u thanë: është një humbje e madhe, jo vetëm për Shqipërinë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetarja e Grupit Parlamentar të KKR-së, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Edhe unë do të flas në emër të Grupit Parlamentar.

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar dhe për deputetët,

Koalicioni për Kosovë të Re shpreh ngushëllimet më të mëdha familjes së deputetit nga Shqipëria dhe Shqipërisë për humbjen e një deputeti shumë të zellshëm.

Ndërkohë do ta shtroj edhe një çështje, pasi e kam fjalën, për arsye se ministri i Zhvillimit Ekonomik gjendet sot brenda kësaj seanca, kisha dashur që edhe kryeministri të jetë këtu.

Siç e dimë, Kuvendi i Kosovës e ka autorizuar Qeverinë që ta hartojë Projektligjin për “Trepçën”, ndërsa Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka dalë me dy projekt-propozime për

“Trepçën” dhe njëri nga ato është dashur të sillet në Kuvendin e Kosovës. Mirëpo, tash pritët që Projektligji për “Trepçën” të vijë në Kuvendin e Kosovës.

Në të njëjtën kohë, Agjencia Kosovare e Privatizimit, e cila i përgjigjet Kuvendit të Kosovës, e ka filluar procesin e tenderimit për angazhimin e ofertuesve të shërbimeve profesionale, projekt-tender ky që kushton hiq më pak se 10 milionë euro.

Meqenëse Agjencia Kosovare e Privatizimit është nën menaxhimin e Kuvendit, apo më mirë të themi i raporton Kuvendit të Kosovës, është e rrugës që AKP-ja të mos i vazhdojë procedurat e veta, mirëpo të presë deri në ardhjen e Projektligjit për “Trepçën”. Ministër, të na njoftosh çfarë është duke ndodhur në këtë rast me këto shërbime profesionale për “Trepçën” dhe ligjin të cilën je i obliguar ta sjellësh në Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Grupi Parlamentar “6+”, deputetja Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

U ime Parlamentarne grupe “6+” izražavamo saučešće porodici Olldashi za preminuo poslanika, kao i svim građanima Republike Albanije.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit “Zajednička Budućnost”, kryetari Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala gospodine predsedniče!

Pozdrav ministri i Vladinom kabinetu,

I Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” izdržava svoje najdublje saučešće porodici Olldashi.

Ali moram da sve osvrnem i na rad Agencije za privatizaciju i za privatizaciju hladnjače u Šilovu, i za ostale privatizacije koje su u zadnje vreme desile u srpskim opštinama i na ovaj način izražujem svoju nezadovoljstvo. O tome moramo što više i razgovarati, jer mislimo da na taj način sugrožavaju srpski interesi u sredinama gde su Srbi većinske stanovništvo. Hvala!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe në emër të Partisë Demokratike i shpreh ngushëllime së pari familjes Olldashi për humbjen e më të dashurit të tyre. I shpreh ngushëllime Parlamentit të Shqipërisë, Partisë Demokratike dhe gjithë qytetarëve të Shqipërisë për këtë humbje të një njeriu shumë meritë, të një njeriu që ka merita të jashtëzakonshme për kontributin që ka dhënë gjatë procesit nëpër të cilin ka kaluar shteti shqiptar dhe populli shqiptar.

Por, ne besojmë që këtë dhimbje të përbashkët do ta kalojmë së bashku. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: I nderuar kryetar!

Qeveri,

Të respektuar deputetë,

Në shkurt të vitit 2013, Kuvendi i Kosovës e pati debatin për pensionet e papaguara nga Serbia.

Si rezultat i këtij debati u formua Komisioni Qeveritar, i cili e ka pasur për detyrë trajtimin e kësaj çështjeje.

Nga puna e vet, shihet që ky Komision ka trajtuar komplet çështje tjera, e jo atë për të cilën është krijuar.

Komisioni ka pasur për detyrë që t'i ndihmojë pensionistët me dokumentacion dhe mbështetje për t'i marrë pensionet që u takojnë. Kësaj i shtohet edhe vendimi i Gjykatës së Strasburgut, i cili u ka dhënë udhëzime të sakta, jo vetëm pensionistëve për të drejtën e tyre legjitime, por edhe shtetit të Serbisë që ta kryejnë punën e kthimit të pensioneve të mbetura.

Deri në tetor të këtij viti, deri në muajin e kaluar, vetëm 37 pensione u kanë ardhur pensionistëve të Kosovës, ndërsa e dimë që 90 mijë pensionistë janë ata të cilët kanë dhënë kontribute dhe kanë të drejtë legjitime që të kenë pensione, të cilat u takojnë.

Në qoftë se i analizojmë në anën tjetër zgjedhjet në Kosovë, ndonëse është çështje individuale, shteti i Serbisë i ka ndihmuar votuesit e vet për të mbledhur dokumentacione dhe për të ardhur dhe votuar në Kosovë, gjë e cila nuk ka ndodhur në shtetin e Kosovës, kur është dashur që Komisioni dhe Qeveria t'i ndihmojnë pensionistët tanë që ta marrin të drejtën e tyre legjitime për të cilën kanë paguar.

Do ta lexoj vetëm një pjesë të deklaratës së ministrit Nenad Rashiq, nga deklarata e tij për media, kur thotë se, organizatat sindikale të pensionistëve nuk janë të autorizuar për të pranuar kurrfarë dokumentacioni për pensionet që i kanë paguar kontributet deri në të '99-ën dhe organi i vetëm kompetent në Kosovë për t'u marrë me këtë çështje është Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale.

Unë mendoj që nuk është këtu vetëm mungesa e kujdesit të ministrit, por mendoj që është mungesa e vullnetit të kryeministrit dhe të Qeverisë për rregullimin e çështjes së pensioneve, apo për kujdesin për pensionistët, përveç atëherë kur është fushata dhe atëherë ku u nevojiten votat e tyre.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi, në emër të Grupit.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja e zotërinj deputetë,

Se çfarë sollën bisedimet dhe marrëveshjet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë tregon edhe produkti i këtyre marrëveshjeve, siç është situata e krijuar në komunat veriore të Republikës së Kosovës.

Situata e krijuar para dhe gjatë zgjedhjeve në pjesën përtej Ibrit, në Mitrovicë, Leposaviq, Zubin-Potok dhe Zvečan është drejtpërdrejt produkt i marrëveshjeve Thaçi-Daçiq. Madje, këtë situatë protagonistët dhe partnerët në bisedime e quajnë sukses. Zaten ky është edhe sukses i tyre, por jo edhe i qytetarëve dhe i Republikës së Kosovës.

Duke iu referuar si sukses, madje u deklaruan se është e rëndësishme që serbët morën pjesë në këto zgjedhje.

Atje ka pasur zgjedhje, apo këso zgjedhjesh edhe në kohërat e Jugosllavive të vjetra dhe të reja; atje ka pasur zgjedhje edhe nën organizimin dhe kontrollin e hekurit të Milosheviqit; atje ka pasur zgjedhje edhe nën organizimin dhe kontrollin e Koshtunicës dhe Tadiqit; atje pati zgjedhje edhe tani, por nën organizimin dhe kontrollin e Daçiqit. Por, kurrë nuk pati zgjedhje të lira të Kosovës. As tani!

Rrjedha e zgjedhjeve lokale të 3 dhe 17 nëntorit në komunat veriore të Kosovës ishte jo thjesht rrjedhë normale, por skenar i bisedimeve dhe i marrëveshjeve Thaçi-Daçiq, duke filluar që nga caktimi i datës së zgjedhjeve për 3 nëntor sipas kërkesës dhe vendimit të Qeverisë së Serbisë, heqja e simboleve shtetërore të Kosovës nga fletëvotimet, sipas kërkesës së Qeverisë së Serbisë, pjesëmarrja e udhëheqësve shtetërorë të Serbisë në fushatë dhe thirrjet e tyre për kthimin e Serbisë në Kosovë, lojërat me fletarreste ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë, mbajtja e zgjedhjeve në komunat veriore të Kosovës nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e institucioneve të sigurisë së Serbisë, si ato të MUP-it, BIA-s, Mbrojtjes Civile Serbe dhe të tjera, lojaliteti i Policisë së Kosovës në veri ndaj udhëheqësve të Republikës së Serbisë, sulmi i organizuar me maska dhe shkatërrimi i tri qendrave të votimit në Mitrovicë, si dhe në fund balotazhi, si ai ndërmjet Oliver Ivanoviqit dhe Kërstimir Pantiqit, të dy këta kandidatë me precedent kriminal kundër popullatës civile shqiptare në Kosovë.

I gjithë ky skenar është i përgatitur dhe i pritur, madje edhe i mirëpritur nga Qeveria e Republikës së Kosovës, skenar që interpretohet edhe si sukses drejt integritetit të serbëve në Kosovë.

Në gjithë këtë rrjedhë, kur nuk shkonte ashtu siç ishte paraparë, u ndërhy dhunshëm për ta korrigjuar skenarin, ashtu siç edhe ndodhi në ndërhyrjen në tri qendra të votimit në Mitrovicë.

Zgjedhjet në ato tri qendra u prishën, jo për faktin se kishte probleme, por kur u kuptua se nuk po fitonte kandidati i Daçiqit. Pra, çfarë ndodhi në gjithë këtë skenar?

Pas implementimit të pikave të Marrëveshjes Thaçi-Daçiq, pas formimit të Komunës së Mitrovicës së Veriut, pas formimit të regjionit policor të veriut, pas emërimit të Nenad Gjuriqit në krye të Policisë së Kosovës në veri, bashkë me Asociacionin e Komunave



Serbe në Kosovë, këto komuna po vihen nën kontrollin e çetnikëve serbë dhe po kriminalizohen edhe më tutje, duke ua mundësuar kriminelëve të udhëheqin me to dhe me institucionet e sigurisë atje.

Zotërinj qeveritarë të Kosovës,

Mos të ju vijë rëndë kur them se këto komuna do të udhëhiqen nga kriminelë sikur Oliver Ivanoviq apo Kërstimir Pantiq, sepse po u referohem pikërisht deklaratave tuaja të dikurshme.

Më 9 shkurt të vitit 2000, ku ndodhi spastrimi etnik ndaj shqiptarëve nga pjesa veriore e qytetit të Mitrovicës dhe u vranë 11 shqiptarë e u shpërngulën 11 mijë të tjerë, pikërisht ministri i tanishëm i Brendshëm pati deklaruar në media: “Oliver Ivanoviqi u prin paramilitarëve serbë në veri”, siç, në fakt, dëshmojnë edhe qindra shqiptarë të tjerë të pjesës veriore që e kanë parë me sy këtë masakër të vitit 2000.

Po ashtu, edhe Kërstimir Pantiq është përgjegjësi kryesor i organizimit të ngjarjeve të vitit 2011 dhe barrikadave e terrorit të organizuar në pjesën veriore të Mitrovicës. Pantiq ishte njëri nga katër të hetuarit fillestarë në rastin e aksionit kur e gjeti vdekjen Enver Zymbëri.

Pra, ku është tani Qeveria e Kosovës që po hesht për ata që dikur i quajti kriminelë? Ku është Qeveria dhe kryeministri që po heshtin para deklaratave të Daçiqit për kthimin e Kosovës nën sovranitetin serb dhe për largimin e KFOR-it nga Kosova? Ku është ministri i Brendshëm, i cili kur bëhet fjalë për protestat e “Vetëvendosjes”, i uzurpon në ekranet televizive, e tani kur bëhet fjalë për ata që i quajti dikur kriminelë, e ka futur kokën në zall?

Ja, pra, çfarë zgjedhjesh dhe çfarë suksesi na e sollën bisedimet me Serbinë. Ja, pra, suksesi i Qeverisë së Kosovës!

Bisedimet me Serbinë e çetnizuan dhe e legjitimuan krimin në pjesën veriore të Kosovës, gjë që Qeveria e quan sukses.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Unë do të ngre një shqetësim të qytetarëve të Kosovës, tani kur, sipas KEK-ut, ka filluar sezoni dimëror, edhe pse me kalendar jo. Ka fillua një shtrenjtim enorm i rrymës elektrike dhe fryrje e pagesave nga KEK-u, e më çudit fakti që zëdhënësi i KEK-ut thotë se tarifa dimërore fillon nga 1 tetori deri më 31 mars, duke e ditur se prej shkollës fillore mësohet se Kosova i ka katër stinë, e nuk i ka vetëm dy. Pra, dimri fillon dhe i ka tre muaj, prandaj jo të llogaritet tarifa dimërore gjashtë muaj dhe të fryhen pagesat ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve.

Për KEK-un, do të ishte shumë me rëndësi dhe për ministrin e Zhvillimit Ekonomik që të kërkojë nga KEK-u të bëjë kthimin e kredisë, meqë ka marrë vite me radhë kredi nga taksat e qytetarëve të Kosovës, ka marrë kredi nga Buxheti i Kosovës dhe nuk ka filluar ta kthejë. Prandaj, ata duhet të jenë të saktë, të fillojnë ta kthejnë kredinë që e kanë marrë prej qytetarëve, prej Buxhetit të Kosovës, e jo ta llogaritin dimrin gjashtë muaj. I them KEK-ut se dimri është tre muaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sasha Gjokiq.

SAŠA ĐOKIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!

Ja se javim u ime Socijaldemokratije i želim da istaknem problem koji se dešava na prostoru opštine Gračanice.

S obzirom da se u delu kadarske opštine Gračanica permanentno dešava zauzeće srpske i ostale imovine, gde od strane KAP-a se vrši privatizacija, iako su građani opštine Gračanice i deo je pod opštinu Prištinu podneli zahtev za povraćaj u Posebno veće komore u zadnjim mesecima je od strane NN lica privatizovano 135 hektara, i pre godinu dana 29 hektara zemljište.

Želim da prozovem instituciju KAP-a, gde i mi kao srpska zajednica imamo člana borda, koji je imenovan od strane Samostalne liberalne strane, iako smo gospođicu kao “Zajednička Budućnost” pozvali na razgovor, ona se već mesec dana nije odostojila. Zato smatram da ona ne štiti interese Zakona koje ova Skupština donela, ne štiti interese posebnog veća, iako u Zakonu svaki predmet koji je procesirano od oštećene strane u posebnom veću, posebno veće daje zabranu KAP-on za raspolaganju do okončanje procesa, nezavisno da li će proces biti rešen pozitivno ili negativno.

Zato želim da iskoristim, kao poslanik i predsednik Socijaldemokratije i tražim odgovor od člana Srpske zajednice, ne znam kako se zove, da ako ne želi da dođe u Poslaničku grupu “Zajedničku Budućnost”, da dođe da izveštaj ispred Skupštine. Hvala!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Të gjithë jemi dëshmitarë që sa herë publikohet Raporti i Progresit për Kosovën poenët pothuajse më negativë dalin në fushën që ka të bëjë me lirinë e fjalës dhe me ndërhyrjen apo kërcënimin e medieve të lira në Kosovë.

Duke e bërë këtë presion, neve na është cenuar e drejta për mbrojtjen e integritetit tonë nga shpifjet dhe denigrimet, kurse në të njëjtën kohë disa gazetarëve u jepet hapësirë 100% e manipulimeve. Për këtë ne jemi dëshmitarë të publikimeve të përditshme, të cilat shpeshherë nuk e përmbajnë as edhe një të vërtetë. Kjo është shprehja e mendimit të lirë, thuhet në zyrat e atyre që e përgatisin Raportin e Progresit për Kosovën.

Mirëpo, para pak ditësh, ne të gjithë u bëmë dëshmitarë të ndërhyrjes spektakulare në punën e një gazetari, i cili e kishte bërë punën e vet hulumtuese në mënyrën më të mirë. Dhjetëra e dhjetëra policë të EULEX-it i vërsjuan zyrat dhe banesën e gazetarit Milaim Zeka, duke ia konfiskuar materialet e ndryshme, deri edhe telefonin celular. Shtrohet pyetja: A nuk vlen shprehja e mendimit të lirë edhe për gazetarin Milaim Zeka, apo kjo formë e trajtimit vlen vetëm atëherë kur nuk preken pashallarët e EULEX-it? Pyes përgjegjësit e BE-së: Në çfarë adrese do të drejtohen kritikët në raportin e ardhshëm? Kur do të kërkohet përgjegjësi nga zyrtarët e tyre, të cilët me veprimet e veta për çdo ditë e më tepër po e dëmtojnë besimin në drejtësi?

Sepse, një gjë që shihet qartë është se po nëpërkëmbët drejtësia, duke synuar qetësimin e atyre që deri dje ushtruan gjenocid në mes të Evropës.

Drejtësia, pa dyshim, do të triumfojë, mirëpo shtroj pyetjen a është e nevojshme që personat e caktuar të maltretohen me vite të tëra, t'u shqiptohen dënime marramendëse, të linçohen publikisht dhe, në fund, të shpallen të pafajshëm?

A nuk do të ishte më e drejtë që kjo kohë të shfrytëzohet në kërkim të kriminelëve të vërtetë. Krimi i vetëm dhe më i madh që është duke ndodhur në Kosovë është duke u bërë nga ata të cilët, para syve të BE-së po ushtrojnë presion mbi dëshmitarët, për të thurur akuza, të cilat, përveç fantazisë së momentit, nuk përmbajnë asnjë indicie më të vogël.

Ne kemi mësuar se Justicia është e verbër, po Justicija e Salustros me shokë na del me katër sy dhe e qullur në subjektivitet, urrejtje e paragjykime.

Prandaj, duhet t'i bëjmë thirrje Bashkimit Evropian, Amnesty International, të gjitha organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Avokatit të Popullit, dhe në veçanti ministrit të Drejtësisë të Republikës së Kosovës, që të angazhohen për ndërprerjen e menjëhershme të arrestimeve dhe burgosjeve politike.

Kjo nuk është zgjidhje që guxon të ndodhë në Evropën e shekullit XXI. Drejtësia e të fortit nuk guxon të servohet si standard evropian në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Çështja ime ka të bëjë në lidhje me Ligjin për sigurime shëndetësore dhe këtu dua të lidhem me premtimin e ministrit Agani, të cilin e ka bërë më 22 korrik të këtij viti për miratimin e Ligjit për sigurime shëndetësore, duke thënë që deri në fundin e shtatorit ky ligj do të vijë në Parlament dhe do të miratohet.

Pra, del se kjo është një gënjeshtër e radhës së kësaj Qeverie, e cila ende nuk po e miraton Ligjin për sigurime shëndetësore, e kjo shihet shumë qartë në buxhetin e vitit 2014, i cili sot do të shqyrtohet.

Në këtë buxhet, përveç asfaltit, pagave dhe mëditjeve, duke i zvogëluar kështu edhe investimet kapitale, rezulton se në Kosovë nuk do të ketë zhvillim ekonomik edhe në vitin e ardhshëm, duke shtuar edhe mungesën e këtij ligji.

Pra, mungesa e Ligjit për sigurime shëndetësore e vështirëson më shumë gjendjen e pacientëve, punën e stafit mjekësor të QKUK-së, por edhe në spitalet rajonale.

Mjekët tregojnë se vetëm në Institutin Onkologjik brenda një dite trajtohen mbi 130 pacientë, të cilët duhet të shpenzojnë rreth 300 mijë euro brenda muajit. Ndërsa Ministria e Shëndetësisë e ka për obligim dhe e ka buxhetin e ndarë që këto barëra t'ua sigurojë pacientëve në fjalë.

Deri më tani kemi parë që në QKUK ka vetëm mungesë të barërave esenciale, po ashtu edhe në Institutin Onkologjik. Ju po i shihni çdo ditë intervistat me pacientët tanë, të cilët po bredhin rrugëve, e të cilët nuk po kanë para që të shërohen nga sëmundjet, e të cilat duhet t'ua sigurojë shteti, konkretisht Ministria e Shëndetësisë.

Ne e kuptojmë që është një buxhet jashtëzakonisht i vogël për Ministrinë e Shëndetësisë, mirëpo për këto barëra dhe për këto çështje buxheti ndahet çdo vit dhe lë të kuptojmë se ky buxhet nuk po shpenzohet mirëfilli nga Ministria e Shëndetësisë.

**KRYETARI:** I fundit për sot, nënkryetari Xhavit Haliti e ka fjalën.

**XHAVIT HALITI:** Të nderuar deputetë,

Zoti kryetar,

Të nderuar ministra,

Unë dola që të shpreh ose t'i bashkangjitem shqetësimit të qytetarëve të Rugovës dhe të zonave të Bjeshkëve që po i quajmë të Nemuna lidhur me situatën e krijuar, pas miratimit të Ligjit për park nacional të tyre.

Dua të them hapur që kullosat po degradohen, po degradohen pyjet, sepse po priten, duke u konsideruar si mall i huaj, ose si mall i shtetit. Prandaj, unë mendoj që në përputhje me kërkesën që kanë bërë dhe e kanë dorëzuar sot në Parlamentin e Kosovës disa mijëra qytetarë të Rugovës, ne duhet që me procedurë të rregullt dhe sa më të shpejtë të mundshme ta amendamentojmë ligjin e miratuar në Kuvendin e Kosovës për t'i përcaktuar saktë të drejtat e rugovasve mbi pronën e tyre, qoftë edhe atë të uzurpuar më herët nga pushtuesit, dhe të shndërruar në pronë të shtetit.

Përcaktimin e zonave të banimit, të cilat mund të jenë edhe zona turistike dhe për caktimin e zonave të kullosave, në të cilat do të operojnë blegtorët e ndryshëm.

Kjo nuk do të thotë vetëm për zonën e Rugovës, sepse ata e kanë shprehur këtë shqetësim më shumë, por unë them që situatë e ngjashme është në krejt Bjeshkët e Nemuna, të cilat janë duke u degraduar dhe duke u konsideruar si mall i huaj, ose mall i shtetit, siç e kanë quajtur dikur.

Prandaj, besoj që pas marrjes së petitionit, që është dorëzuar sot, Qeveria, përkatësisht Ministria e Ambientit do ta ketë parasysh këtë dhe do t'i fillojë takimet me qytetarët, të cilët i kanë shprehur këto shqetësime dhe do ta amendamentojmë ligjin, i cili nuk e dëmton realisht ligjin e miratuar, ose parkun nacional, përkundrazi qytetarëve ua jep të drejtën mbi pronat e veta që i kanë dhe do të bëhen, do të thosha, gardian i mbrojtjes së pyjeve, të cilat janë pronë e tyre dhe do të operojnë pastaj me lejet përkatëse, të dhëna sipas ligjeve në fuqi.

Në qoftë se ndodh e kundërta, sipas trendëve që janë sot, ose që kanë filluar shumë më herët, po dyshoj që mund të quhet park nacional. Dhe, dua të shprehë shqetësimin që emrat e caktuar ende vazhdojnë degradimin e këtij parku nacional nëpërmjet miniminimit të një ta quajmë ashtu monumenti, që do të duhej të jetë i mbrojtur nga shteti - Kalaja e Lipës, siç e quajmë në mes të dy fshatrave, ku kalaja ekzistuese është e rrezikuar nga gurthyesit, që të rrënohet dhe t'i humbë gjurmët e vjetërsisë së kësaj zone banimi. Faleminderit!

KRYETARI: Është harxhuar koha për pikën jashtë rendit të ditës. 30 minuta është kjo pikë e rendit të ditës, prandaj ju lutem respektojeni orarin. Fjalën e ka ministri Agani.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

E nderuara zonja deputete,

Nuk bëhet fjalë për kurrfarë gënjeshtre, më vjen keq që e përdorni këtë terminologji pa asnjë fakt, pa asnjë argument dhe pa menduar mirë.

Unë kam thënë se Ligji i sigurimeve shëndetësore do të miratohet në Kuvendin e Kosovës. Ky ligj është kah tentohet të miratohet tash e 14 vjet në periudhën e pasluftës dhe e dimë mirë se është rezultat i një bashkëveprimi ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve relevante ndërkombëtare, në radhë të parë me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore.

Ministria e Shëndetësisë e ka pasur projektligjin e gatshëm qysh në muajin gusht. Kemi punuar edhe në muajin shtator. Ka qenë kërkesë e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe e Bankës Botërore që ky projektligj të përcillet në Qeverinë e Kosovës pas përfundimit të ciklit të përpunimit të Buxhetit të vitit 2014, në mënyrë që të gjitha implikimet fiskale për buxhetin e vitit 2014, 2015 dhe 2016 të jenë të qarta dhe të mos ketë kurrfarë paqartësie në këtë aspekt.

Mund të ju them me kënaqësi se ky projektligj është dakorduar në tërësi me Bankën Botërore. Ata sot e kanë takimin e fundit me mua dhe menjëherë pas elaborimit të deklaratës financiare, që do të bëhet gjatë javës që vjen ,projektligji do të përcillet në Qeveri për miratim, dhe pastaj në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Ke të drejtë në replikë, se ministri nuk ka pasur të drejtë ta marrë fjalën për replikë me deputetët që diskutojnë në pikën e parë të rendit të ditës, jashtë rendit të ditës.

Dhe, le ta lexojë Rregulloren, ajo e përcakton nëse duhet të polemizojë në këto raste ministri, apo jo. Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Zoti ministër, tash e tre vjet, prej kur je në mandatin si ministër i Shëndetësisë, jemi duke dëgjuar teori të tilla.

Sa i përket Ligjit për sigurime shëndetësore, pasi veç qenke dakorduar, para dy-tri mbledhjeve të Qeverisë është deklaruar që Qeveria dhe kryeministri, konkretisht Kabineti nuk ju ka përkrahur për kalimin e këtij projektligji.

Po ashtu, nëse e shihni, sot do të debatohet Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2014, e nuk parashihet asnjë cent për këtë ligj. Ju pavarësisht pse e paskëshit tek sot takimin me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe me Bankën Botërore, kjo prapë po tregon me fakte, në bazë të ligjit, i cili sot do të shqyrtohet, dhe në bazë të fakteve të tjera, të cilat kanë dalë në media, tregohet që ju nuk jeni të gatshëm ta sillni Ligjin për sigurime shëndetësore dhe ky ligj nuk do të miratohet.

Unë nuk di me çfarë gjuhe tjetër duhet të thuhet nëse është gënjeshtër apo është premtim i rremë, apo çfarë është, por kur tri herë një ministër premton që në këtë vit do të miratohet gjithsesi Ligji për sigurime shëndetësore dhe nuk miratohet. Unë po ua lë qytetarëve ta definojnë se si quhet kjo. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, me Rregullore nuk ke pasur të drejtë t'i përgjigjesh me replikë deputetit në pikën e rendit të ditës - deklarime jashtë rendit të ditës. Ke të drejtë për informatë, por pa polemizuar me këtë çështje. Ti e di që deputetëve u përgjigjesh në pyetjet parlamentare dhe do t'u përgjigjesh atyre, meqë t'i kanë bërë hiç më pak se katër pyetje. Ke kohë sot të përgjigjesh për të gjitha këto çështje.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Për këtë seancë janë të parashtruara tetë pyetje parlamentare. Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Besim Beqaj.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Pasi disa herë e kam parashtruar të njëjtën pyetje, mendova se veç është hequr nga rendi i parashtrimit.

Prapë, po e pyes ministrin Beqaj: Sipas Ligjit për lojërat e fatit parashihet që licencimi i objekteve për lojërat e fatit të jetë 500 metra larg objekteve shkollore. Deri më tani jemi duke vërejtur që ky ligj nuk është duke u respektuar dhe ndërtimi apo licencimi i këtyre objekteve për lojërat e fatit është duke u bërë edhe në afërsi të objekteve shkollore, gjë që është shqetësuese.

Bile disa nga këto lojëra të fatit apo lojëra bixhozi janë mu para dymëve të shkollave.

Prandaj, më intereson: Çfarë kanë bërë Administrata Tatimore dhe Ministria e Financave që të zbatohet ky ligj dhe që të mos lejohet licencimi i këtyre lojërave të fatit para objekteve shkollore? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Haxhiu,

Sigurisht që kemi dy momente, që e ndajnë funksionimin e ligjit edhe funksionimin e lojërave të fatit në Republikën e Kosovës.

Deri në momentin kur ligji i ri është adaptuar dhe është kjo që po thoni ju tash me shumë të drejtë, pse po e them ndahet në dy momente, sepse deri në atë kohë ka funksionuar dhe ka qenë obligim edhe i dhënies së lejeve të punës dhe pastaj licenca. Pra, ka qenë dhe është parakusht leja e punës dhe pastaj jepet licenca. Ehe atëherë ATK-ja ka qenë përgjegjëse për lëshimin e licencës, por lejen e punës e kanë lëshuar autoritetet komunale.

Normalisht që ndërkohë pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri, Administrata e ka vizituar shumicën prej tyre, disa janë të mbyllura, por gjithsesi duhet të harmonizohet me autoritetet, të cilat japin licenca, japin leje të punës dhe pastaj të harmonizohen me licenca. Pra, është një aktivitet i përbashkët i autoriteteve komunale dhe i tyre, dhe licenca lëshohet mbi bazën e lejes së punës. Faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem, e dini rendin e fjalës. Deputet, ke pyetje shtesë?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit ministër për përgjigjen!

Numri i objekteve të lojërave të fatit, të cilat ndodhen mu pranë shkollave dhe në afërsi të objekteve shkollore, në veçanti në komunën e Prishtinës është tejet i madh.

Prandaj, mua më intereson, ministër, në aspektin juridik dhe të përgjegjësisë profesionale, e kujt është përgjegjësia për dhënien e lejeve të punës dhe lejimin dhe licencimin e këtyre lojërave të fatit mu përpara objekteve shkollore? Tek e fundit, ne e kemi miratuar një ligj dhe ai ligj duhet të respektohet dhe që këto lojëra të fatit të funksionojnë, duhet të largohen nga afërsia prej 500 metrave afër objekteve shkollore.

Ky ka qenë edhe qëllimi ynë, i përkrahur në atë kohë kur kemi debatuar, edhe nga vetë kryetari i Kuvendit, dhe nga shumica e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, prandaj kërkojmë që kjo të zbatohet dhe ato të largohen. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari edhe sot e përkrah atë. Ministër, ke përgjigje?

MINISTRI BESIM BEQAJ: I nderuar deputet,

Plotësisht pajtohem me konstatimin tuaj, sepse ligji, i cili është i aprovuar dhe është funksional, duhet të zbatohet në tërësi. Kjo është detyrë e të gjithë neve së bashku, prandaj në këtë drejtim dua të them se duhet një harmonizim më i mirë.

Lejet të punës në nivele komunale i jep organi komunal, jo vetëm në Prishtinë, por në të gjitha komunat tjera, prandaj duhet të harmonizohen këto qëndrime. Unë po them që Administrata Tatimore e Kosovës është e gatshme që të bashkëpunojë me institucionet të cilat japin leje të punës dhe të veprojë konform ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Suzan Novobërdaliu, pyetje për ministrin Hajredin Kuçi. Deputetja nuk është e pranishme. Deputetja Aurora Bakalli, pyetje për ministrin Ferid Agani.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti ministër Agani, Ligji për kontrollin e duhanit tanimë ka hyrë në fuqi dhe është në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës që nga maji i këtij viti.

Ky ligj është shumë më rigoroz sesa ligji paraprak për kontrollin e duhanit. Unë personalisht jam përkrahëse e një ligji të tillë rigoroz dhe e kam përkrahur edhe gjatë shqyrtimit në Kuvend, megjithatë jam përkrahëse se përpos një ligji rigoroze, të jetë edhe i aplikueshëm.

Më intereson, zoti ministër, sa jeni ju i kënaqur me aplikimin e deritanishëm të Ligjit aktual për kontrollin e duhanit?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

E nderuara zonja deputete,

Të përgjigjem shkurt menjëherë: jam mjaft i kënaqur me zbatimin e këtij ligji dhe ndonëse është më rigoroz se ligji paraprak, me siguri e keni edhe ju të qartë dhe pajtoheni me mua dhe është një konkludim i përgjithshëm se ai është në pajtueshmëri të plotë me standardet evropiane, që zbatohen sa i përket kontrollit të duhanit dhe në shumë aspekte është më i butë krahasuar me masat e reja që po ndërmerren në vendet e Bashkimit Evropian për kontrollin e duhanit, dhe natyrisht është në pajtueshmëri të plotë me konventën kornizë për kontrollin e duhanit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Ky ligji, i cili ka hyrë në fuqi më 22 maj të këtij viti, është mirëpritur nga qytetarët e vendit tonë, të cilët kanë treguar respekt për këtë, duke e zbatuar atë në masë mjaft të mirë. Ata në këtë mënyrë e kanë demonstruar edhe një gatishmëri për një ndryshim kulturor, që nuk është parë më herët në Kosovë, në raport me shëndetin publik.

Gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, sukseset në zbatimin e tij nuk kanë munguar. Ato madje janë raportuar edhe në Raportin e Progresit për Kosovën, ku kontrolli i duhanit



raportohet si një e arritur. Gjithsesi ligji është sfiduar nga shkelës të ndryshëm, në veçanti në komunat më të vogla të vendit, përderisa Prishtina si kryeqytet dhe disa komuna më të mëdha mbeten shembuj të mirë të respektimit të ligjit.

Në bazë të raportimeve të deritanishme në Këshillin Ndërmintor për Kontrollin e Duhanit, i cili është formuar dhe ka mbajtur 2 takime deri tash, në vendin tonë inspektoratet përgjegjëse, në veçanti Inspektorati Sanitar, që është pjesë e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës dhe Inspektorati Shëndetësor kanë kryer me mijëra inspektime, gjatë të cilave fillimisht është shkuar në vetëdijesimin e subjekteve afariste, bizneseve të ndryshme, kafe-bareve dhe institucioneve të tjera për respektimin e ndalimit të pirjes së duhanit në hapësirat e mbyllura.

Konkretisht, Inspektorati Shëndetësor ka kryer mbi 200 inspektime të institucioneve shëndetësore dhe ka shqiptuar dy dënime për dy spitale nga 3 000 euro dhe ka rekomanduar menaxherët në katër raste për dënime individuale nga 50 euro.

Inspektorati Sanitar ka kryer mbi 3 000 inspektime prej majit të vitit 2013. Vetëm prej shtatorit janë kryer 400 inspektime, janë dërguar në gjykata 30 raste për shkelje të Ligjit për dënime me nga 3 000 euro. Inspektorati i Tregut ka kryer shumë inspektime dhe ndalimi i ekspozimit në supermarkete dhe dyqane respektohet mjaft mirë.

Mbetet të bëhet më shumë përkritazi me çështjen e shitjes së duhanit në rrugë nga Inspektorati i Punës, Inspektorati i Tregut dhe Inspektorati i Arsimit.

Jemi dëshmitarë që neni që në këtë Kuvend është debatuar më së shumti gjatë shqyrtimit dhe amendamentimit të ligjit, neni 9.2, që ka të bëjë me ndalimin e ekspozimit të duhanit, me përjashtim në momentin e shitjes, sot respektohet më së miri, falë edhe...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

AURORA BAKALLI: Faleminderit, zoti ministër për përgjigjen. Edhe prej informacioneve që kam unë, kuptoj se në komunat më të vogla është duke u zbatuar më pak, sidomos në lokalet hoteliere dhe në kafene, ndërkaq nga informacionet që kam edhe në kryeqytet, në orët vona të mbrëmjes nëpër kafene nuk respektohet Ligji i duhanit dhe gjithashtu kam informacione se në disa vende publike, madje edhe në zyrat qeveritare, ka raste kur nuk respektohet Ligji për kontrollin e duhanit.

Gjithashtu, ju pret një sfidë e re tash gjatë sezonit të dimrit, sepse ka qenë më i lehtë respektimi për shkak të mundësisë së pirjes së duhanit nga duhanxhinjtë në ambientet e hapura të kafeneve dhe lokaleve tjera hoteliere. A e keni shtuar numrin e inspektorëve dhe si mendoni të ballafaqoheni me sfidën që ju pret tani në sezonin e dimrit?

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit për këtë pyetje plotësuese. Pajtohem me ju se periudha e ardhshme është një sfidë e veçantë dhe është fakt se jemi dëshmitarë që në disa komuna të vendit shkeljet e ligjit janë më të theksuara, por Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me inspektoratet përgjegjëse për zbatimin e ligjit, shoqërinë civile dhe autoritetet lokale, po ndërton ekipe multisektoriale në komuna të ndryshme me qëllim që zbatimi i ligjit të fuqizohet nëpër komunat jashtë Prishtinës, veçanërisht.

Deri më tani, mekanizma të tillë janë ndërtuar në Mitrovicë, Gjakovë, Prizren dhe Ferizaj, e do të vazhdohet edhe në komunat e tjera.

Një dimension i rëndësishëm në zbatimin e mëtejshëm të ligjit është inkuadrimi i Policisë së Kosovës, e cila u ka asistuar inspektorëve sanitarë në disa inspektime të kryera gjatë orëve të mbrëmjes në Prishtinë dhe ka shprehur gatishmërinë që të njëjtën gjë ta bëjë edhe në komunat tjera, në bashkëpunim me inspektoratet përgjegjëse. Ne si ministri jemi duke i nxjerrë edhe disa akte nënligjore në bazë të këtij ligji, konkretisht njërin akt edhe e kemi nxjerrë, që ka të bëjë me shenjat e ndalimit të pirjes së duhanit dhe vendosjes së tyre.

Janë edhe tri udhëzime tjera administrative, që do ta operacionalizojnë tërë çështjen e mbikëqyrjes të zbatimit të ligjit. Shpresojmë që do të kemi sukses çdo herë e më tepër.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Liburn Aliu, pyetje për ministrin Besim Beqaj.

LIBURN ALIU: Nuk e kam pyetjen për Besim Beqajn, por për ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Në Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2013 thuhet se Ligji i punës ka mungesë të politikave sociale dhe se është e nevojshme që të bëhet amendamenti i tij dhe zbatimi duhet të mbështetet nga burimet e mjaftueshme financiare.

Po ashtu, ky raport thekson se në muajin maj të këtij viti është miratuar Ligji mbi shëndetin dhe sigurinë në punë.

Viti 2012 është karakterizuar nga 62 aksidente në punë, 17 me fatalitet dhe 45 me lëndime të rënda trupore. Po ashtu, është edhe raporti me rekomandime i Komisionit që ka të bëjë me monitorimin e Ligjit të punës, dhe ndër ato rekomandime është edhe rekomandimi i njëjtë, që ka të bëjë me rritjen e inspektorëve në Inspektoratin e Punës. Prandaj, zotëri ministër, pyetja është se raporti tregon se Inspektorati i Punës ka vetëm 49 inspektorë dhe se kjo është e pamjaftueshme për të bërë punë efikase.

Çka është bërë në këtë drejtim, ngase e dimë që nga muaji maj, tani edhe nga rekomandimet nga Kuvendi, që përputhen me këtë Raport të Progresit, Kuvendi ka rekomanduar që të shtohet numri i inspektorëve nëpër inspektorate, prandaj a është punuar në këtë drejtim diçka?

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsedniče!

Poštovani kolege ministri,

Narodni poslanici,

Gospodine Aljiu,

Tačno je da od početka se javio taj neki nedostatak inspektora za rad i mi smo računajući od početka godine zaposlili dodatno 5 inspektora, koji su naravno stali sa svojim radom, a sada ono se naglašava kao 49 inspektora, odnosno generalno bi trebalo da imamo 50. Kada kažem 50, ne volim da odvajam tako, ali to je južno od Ibra, jer mi smo imali dodatnih 5, koje smo zaposlili na ovoj teritoriji ovde, a 5 onih na severu smo anulirali, odnosno poslali smo druge ljude da apliciraju, jer smo hteli da napravimo jednu bolju strukturu gde inspektori za rad na severu mogu da naprave više doprinosa, pa smo objavili jedan novi konkurs, i posle tog novog konkursa nažalost nije bilo dovoljna aplikacija koja bi mogle da budu interesantne za nas, odnosno aplikacije koje bi mogli da uposli dodatnih novih 5 inspektora za rad, zato što oni stari nisu bili na adekvatnom nivou performance.

Tako da možda broj naših inspektora nije onoliko koliko nam bio potreban, koliko mi procenjujemo sada da nam treba, ali opet moram da naglasim da je to u skladu sa iskustvima koja postoje već u regionu, a takođe i u Evropi. Ne možemo insistirati sa konstantnim povećanjem broja inspektora zbog toga što jednostavno u modernom svetu to nije praksa, a podsećam još jednom mi smo za 10% praktički povećali broj inspektora u početku godine, znači od 50, mi smo dodali dodatnih 55, što znači da na teritoriji, opet naglašavam južno od Ibra, mi imamo negde svih 50 inspektora koji bi trebali da rade svoj posao, tačnije da budem korektan u ovom slučaju do je 49, jer je skoro jedan od naših inspektora otišao u penziju.

Pošto ste pomenuli takođe da li je u vezi ostalih ovih nesreća, nažalost koje su se desila, ja imam i drugo pitanje o kojoj se pominje 'Bechtel&Enka' kao jedan od najvećih poslodavaca, i tačno da mi redovno vršimo inspekcije kod njih. Ove godine ih je bilo 8 inspekcija, 5 kod same 'Bechtel&Enka', i tri kod njihovih podizrača. Moram da naglasim da broj inspektora koji idu u poseti 'Bechtel&Enka', zbog toga što je toliko obiman teren na kome oni rade, da nikada nije ispod 10 inspektora, što znači da mi na svim lokacijama gde oni rade obavljamo svoje redovne kontrole i moram da kažem da smo najpreciznije i najadekvatnije...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shitesë?

LKIBURN ALIU: Sa i përket 'Bechtel&Enka', e keni pyetjen e radhës. Unë jam dakord që shtimi i numrit të inspektorëve nuk e sjell domosdo rritjen e cilësisë dhe inspektimin cilësor, por a ka ndryshim të sistemit të punës në terren? Pra, a ka shtim të inspektimeve dhe a ka kategorizim të subjekteve që inspektohen, pasi edhe kjo ka qenë po ashtu vërejtje nga raporti me rekomandime, që ne i kemi pasur.

Pas monitorimit që ne kemi bërë, edhe në diskutimet që i kemi pasur, përpos që duhet të shtohen inspektimet, jo domosdoshmërisht ndoshta edhe të shtohen sa më shumë, është më mirë, por natyrisht mundësitë do të jenë të ndërlidhura me buxhetin, por çështja është që të bëhet kategorizimi i ndërmarrjeve, në mënyrë që të jetë sa më sistematik inspektimi për ndërmarrjet përkatëse. Mua më intereson, pra, a është punuar pra edhe në sistemin e inspektimit, a është ndryshuar apo po vazhdon në mënyrën e njëjtë, se në mënyrën e njëjtë, edhe nëse shtohet numri i inspektorëve, nuk do ta kemi ndonjë përmirësim të dukshëm. Pra, 10% është pakrahasueshëm larg nga nevojat, se e dimë sa janë subjektet që duhet të inspektohen dhe në...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Ministër, vazhdoje përgjigjen.

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Da, slažem sa vama da treba kvalitet poseta da bude mnogo bolji, nego što jeste zbog toga što verovatno ta svesnost pre svega tih poslodavaca je najbitnija, Jer ukoliko poslodavci ne shvate koliko je to važno za njihove radnike, koliko je važno za njih sami, mi možemo da pravimo kontrole koliko god hoćemo, opet neće biti rezultata.

Inače što se tiče Inspektorata, mi svake godine imamo povećanje broja kontrola. Evo rećiću vam, prošle godine smo imali 6 hiljada i šesto, ove godine imamo 7 hiljada. Znači mi svake godine radimo na tome i s tim što sada je zakonodavstvo mnogo organizovanije nego što je bilo. Podsećam da smo od ove godine aprila, imali stupan je na snagu Zakona o zdravlju i sigurnost na radu, što je vrlo jasno opisalo šta svaki poslodavac treba da ima u svom toj kompaniji da bi zaštitio svoje radnike, što znači da mi sa tehničke strane napredujemo, ali ponekad nam treba mnogo više napora i uticaja na generalnom nivou prema poslodavcima da oni shvate da su radnici ipak oni ljudski resursi najbitnije.

Zbog toga neće to biti da kažem lak proces, ali mislim da je mnogo lakše od aprila kada smok mi utvrdili šta je ono tačno što mora da imaju poslodavci da bih zaštitili svoje radnike. Ja naravno ne mogu da dam sve podatke o tome dali smo kategorizovali vrste poslodavaca, ali evo pozivam vas, ja ću da vam pošaljem i u pisanoj formi tačan izveštaj, pošto sada kod mene sada nemam tačan izveštaj koliko je sve vrste i kategorije poslodavaca bilo kontrolisano, ali kada vam budem poslao, naravno možete da dobijete sve informacije koje budu potrebne. Hvala!

KRYETARI: Deputetja Nazane Breca, pyetje për ministrin Ferid Agani.

NAZANE BRECA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër Agani,

Pyetja ime njëjtë ka të bëjë me Ligjin e sigurimeve shëndetësore dhe po më vjen mirë që kolegja nga subjekti Rita Hajzeri-Beqaj e ngriti këtë çështje, sepse është shumë e rëndësishme.

Më 29.11.2011, ne anëtarët e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale kemi marrë informatë nga Ministria se dy projektligje shumë të rëndësishme janë në fazën finale dhe ka kohë që prej atëherë ky projektligj nuk ka ardhur në Kuvend. Është një projekt shumë i rëndësishëm dhe e kërkon një punë shumë të madhe, andaj pyetja ime është: Edhe pse e dhatë informatën që sot do të mbahet një mbledhje në lidhje me këtë projektligj, mua më intereson se kur përafërsisht do të vijë në Kuvend Projektligji për sigurime shëndetësore, që të fillohet sa më shpejt të punohet.

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, e nderuar zonja deputete!

E thashë edhe pak më herët. Projektligji i sigurimeve shëndetësore është krahas Ligjit të shëndetësisë projektligji më i rëndësishëm për sektorin e shëndetësisë. Është projektligj që është tentuar të sillet dhe të miratohet në këtë Kuvend tanimë 14 vjet. Madje e dini në vitin 2006 edhe është miratuar nga Kuvendi i Kosovës, por mandej është shfuqizuar dhe asnjëherë nuk ka hyrë në fuqi. Është projektligj tejet kompleks, i cili ka kërkuar një kohë të gjatë të punës, fillimisht me vendimmarrësit vendorë, e pastaj me partnerët ndërkombëtarë.

Ajo që është e mira e tërë këtij procesi është se ne e kemi dakorduar në tërësi këtë projektligj. Kjo mbledhje sot është fundi i vizitës dyjavore të ekipit të Bankës Botërore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe me këtë projektligj, i cili do të miratohet në Qeveri, siç thashë brenda dy javëve të ardhshme, ne e rrumbullakojmë reformën legjislative dhe krijojmë kushte për ndryshimin substancial të gjendjes në sektorin e shëndetësisë.

Kjo reformë është mirë e menduar, është e bazuar në të dhëna shkencore, në përvojën e përditshme të profesionistëve tanë, në nevojat e qytetarëve. Si e tillë e ka marrë mbështetjen e plotë të Bankës Botërore, e cila para dy muajsh ka vendosur që Qeverisë të Kosovës t'ia ofrojë një fond për mbështetjen e reformës në vlerë prej 25,6 milionë dollarë dhe me këtë unë mendojnë se në mënyrën më serioze ka dëshmuar se dëshirojnë të jenë me Kosovën në procesin e implementimit të sistemit të sigurimeve shëndetësore në vend dhe kjo mendoj se do të jetë e arritura më e madhe e kësaj ministrie në këtë mandat. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

NAZANE BRECA: Faleminderit, kryetar!

I nderuari zoti ministër, sipas kësaj, së shpejti do ta kemi këtë projektligj në Kuvend dhe shpresoj që do të punojmë shumë që ky ligj sa më shpejt të miratohet në Kuvend dhe, sipas kësaj, sa po e shoh, ju veç planifikoni vitin e ardhshëm ta bëni implementimin e këtij ligji.

Ju veç e thatë se e keni një ndihmesë nga Banka Botërore për arsye e se në projektligjin e Buxhetit për vitin 2014 ju e keni një ngritje shumë të vogël të buxhetit, i cili nuk është i mjaftueshëm aspak për t'i implementuar disa projektligje që kanë kaluar në këtë Kuvend.

Por, pyetja ime është dashur të jetë se kah do t'i merrni, por ju veç e dhatë sqarimin se e keni një mbështetje nga Banka Botërore. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni ministër, edhe pse pyetje nuk pati.

MINISTRI FERID AGANI: Vetëm për ta plotësuar edhe përgjigjen, të jetë informata më komplete sa i përket financimit të këtij projektligj. Ne paralelisht me nxjerrjen e këtij projektligji, elaborimin e tij, konsultimet me Bankën Botërore, FMN-në gjatë këtyre dy vjetëve, kemi punuar edhe me komunitetin e donatorëve dhe t'ju them të drejtën mbështetja nga Banka Botërore ka ardhur në masë mjaft të papritur dhe nuk ka qenë e paralajmëruar, por ka qenë reagim i tyre në cilësinë e projektligjit dhe reformës në tërësi. Me aktivitetet paraprake, ne kemi arritur që ta sigurojmë një donacion prej 8 milionë euro nga Qeveria e Luksemburgut, që kryesisht do të shpenzohet në sistemin e informimit shëndetësor dhe në sistemin e informimit shëndetësor të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, dhe një donacion nga Qeveria zvicerane prej 8 milionë frangave zvicerane si grand për mbështetjen e reformës të sistemit shëndetësor, në radhë të parë të financimit të shëndetësisë.

Njëkohësisht, në Buxhetin 2014, ju nuk keni mundur të shihni në pozita të caktuara buxhetore qartë se Projektligji i sigurimeve shërbimeve shëndetësore mbështetet edhe në Buxhetin 2014, konkretisht në pozitat që kanë të bëjnë në sistemin e informimit shëndetësor dhe në pozitat që ka mbrojtur në punësimin e kuadrit të domosdoshëm në Agjencinë e Financimit Shëndetësor, që është paraardhëse e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

Prandaj, janë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që fillimi i zbatimit të këtij projektligjit në vitin 2014 të jetë sa më efektiv dhe sa më efikas, edhe në aspektin financiar.

KRYETARI: Deputetja Nazane Breca, sërish pyetje për ministrin Ferid Agani.

NAZANE BRECA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër Agani,

Ka kohë që Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit të shëndetësisë ka kaluar në këtë Kuvend, është miratuar, dhe më intereson ta dijë se a keni filluar implementimin e ndryshimeve të Ligjit të shëndetësisë dhe çfarë keni implementuar deri më tash?

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zonja deputete!

Po, keni të drejtë se ky projektligj ka filluar të zbatohet, pra implementimi i Ligjit për shëndetësi ka filluar dhe, siç ju jeni të njoftuar, Ligji për shëndetësi nr. 04/L-125 është miratuar me 13 dhjetor 2012, dhe pas përfundimit të procesit në Gjykatën Kushtetuese ka hyrë në fuqi në maj të këtij viti.

Neni 100 i këtij ligji e obligon Qeverinë dhe Ministrinë e Shëndetësisë që brenda një viti, nga dita e hyrjes në fuqi të tij, të nxjerrë akte nënligjore të parapara me këtë ligj. Ministria e Shëndetësisë e ka përpiluar planin e punës për përmbushjen e kësaj detyre me dinamikën e përcaktuar kohore dhe jemi në linjë me realizimin e tij. Angazhimet kryesore në funksion të zbatimit të Ligjit për shëndetësi janë përqendruar në fushat, si në vijim: funksionalizimi i plot i Shërbimit Civil të Ministrisë të Shëndetësisë për zbatimin e Ligjit për shëndetësi, i cili në esencë e ka decentralizimin e institucioneve shëndetësore, menaxhimin të institucioneve shëndetësore nga Ministria e Shëndetësisë në vetë institucionet shëndetësore dhe integrimin e shërbimeve klinike profesionale në nivelin dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor.

Ko është arritur me miratimin e Rregullores për organizimin e brendshëm të Ministrisë të Shëndetësi në Qeverinë e Kosovës.

Nën dy, është bërë përpilimi i draftit të planit strategjik afatmesëm për sektorin e shëndetësisë, i cili është në fazën finale të përgatitjes për miratim në Qeveri. Ky plan strategjik e reflekton legjislacionin dhe reformën legjislative, e cila është duke u zhvilluar, përfshirë edhe Ligjin për sigurime shëndetësore.

Është bërë, siç thashë, përgatitja e draftit final të Projektligjit për sigurime shëndetësore për miratim në Qeveri. Është përgatitur projekt-rregullorja për organizimin e brendshëm të Agjencisë së Financimit të Shëndetësisë në bashkëpunim me Bankën Botërore, në bazë të nenit 86.4 të Ligjit për shëndetësi, dhe kjo do të dorëzohet për Qeverinë gjatë muajit tetor. Është nxjerrë udhëzimi administrativ për skemat stimulative të performansës së profesionistëve shëndetësorë dhe shërbimeve profesionale. Është përgatitur drafti i Rregullores për listën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor dhe ka hyrë në fuqi. Është përgatitur drafti i udhëzimit administrativ për bashkëpagesa. Është bërë përgatitja e draftit të udhëzimit administrativ për kategoritë e dytave dhe të banorëve të liruar nga bashkëpagesat. Është miratuar statuti i shërbimit spitalor klinik universitar të Kosovës në Qeverinë e Kosovës dhe tani jemi në procesin e konstituimit të bordit drejtues të këtij shërbimi dhe të organeve tjera udhëheqëse. Është përgatitur udhëzimi administrativ për shërbimet profesionale të linjës. Është nxjerrë udhëzimi administrativ për frytnimin e asistuar. Është bërë bartja e shërbimit shëndetësor të burgjeve në...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Deputete, keni pyetje shtesë?

NAZANE BRECA: Faleminderit, kryetar!

Faleminderit ministër,

I nderuar ministër,

Unë desha të ndërlidhem edhe me një çështje, se implementimi edhe reformat e Ligjit të shëndetësisë, sa e shoh unë, nuk mund të bëhet ashtu si duhet pa kaluar edhe Ligji i sigurimeve shëndetësore, sepse janë ngushtë lidhur njëri me tjetrën. E përmendët draftin dhe strategjinë afatmesme për 2014, më duket se jeni vonuar shumë për arsye se tash

duhet të filloni ta hartoni strategjinë prej vitit 2014-2017. Është tash koha të hartohet kjo strategji.

Më interesoi nëse keni filluar të bëni diçka në lidhje me kontraktimin e shërbimeve spitalore, sepse edhe kjo parashihet me reformat, të cilat ju i keni planifikuar në Ligjin e shëndetësisë?

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI FERID AGANI: Po, bëhet fjalë për strategjinë 2014-2020. Kjo strategji është duke u elaboruar. Ajo nuk ka mundur të aprovohet para se ta shohim versionin përfundimtar të projektligjit të sigurimeve shëndetësore, në mënyrë që të reflektohet plotësisht në strategji dhe të kemi komplementaritet në këtë aspekt. Keni të drejtë sa u përket kontraktimeve. Kontraktimi me spitalet e përgjithshme dhe Qendrën Klinike Universitare të Kosovës nga Agjenci e Financimit Shëndetësor është bërë qysh në shkurt të vitit 2013, dhe gjatë tërë këtij viti i kemi pilotuar këto kontrata dhe kemi gjetur shumë aspekte pozitive, por edhe vështirësi gjatë implementimit dhe përvojat e fituara gjatë këtij procesi, që e ka përfshirë edhe Ministrinë e Financave në zinxhirin e vendimmarrjes do të na shërbejnë që kontratat e reja, që do të lidhen në janar të viti të ardhshëm, të jenë shumë më efektive dhe më efikase.

KRYETARI: Pyetja e fundit, deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Ferid Agani.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Ministër, më vjen keq që sot ju paskan drejtuar shumë pyetje, e nuk jemi dakorduar që të jenë kaq shumë pyetje për të njëjtën seancë.

Ndërtimi i emergjencës pediatrie në Klinikën e Pediatriisë ka qenë një hap i qëlluar dhe shumë i mirëseardhur për fëmijët që me urgjencë të trajtohen dhe të kurohen brenda ditës.

A do të vazhdojë përkrahja për këtë njësi përbrenda Pediatriisë?

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zonja deputete!

Siç e thatë edhe vetë, themelimi i emergjencës pediatrike ka qenë një veprim shumë i qëlluar dhe me vend sa i takon përkujdesit shëndetësor për fëmijët, të cilët kanë nevojë emergjente për përkujdes shëndetësor. Klinika e Pediatriisë ka reflektuar pozitivisht me shumë kompetencë profesionale në këtë zhvillim. Resurset profesionale janë të mjaftueshme sa i takon kuadrit mjekësor, mirëpo duhet theksuar që hapja e çdo njësie të re i ka reperkusionet e saj organizative dhe buxhetore.

Në këtë sens vlen të ceket se jo vetëm emergjenca, por e tërë Klinika e Pediatriisë dhe shumë klinika tjera në kuadër të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës kanë mungesë të stafit infermierik dhe atij mbështetës. Sido që të jetë, emergjenca pediatrike është duke e kryer funksionin e vet me përkushtim dhe me sukses.



Me këtë rast vlen të ceket se emergjenca pediatrike është e hapur për trajtimin e fëmijëve me nevoja emergjente për gjithë territorin e Kosovës. Në këtë segment po hasim pak në vështirësi, sepse kemi edhe dërgim të rasteve të cilat nuk i plotësojnë indikacionet e duhura mjekësore për t'u kualifikuar si emergjente. Atë që dua ta theksoj, është se si pjesë e këtij projekti mbështetës të Bankës Botërore, që përmenda prej 25,6 milionë dollarësh, është paraparë që njëri prej 4 moduleve të këtij projekti të jetë për shërbimin profesional të nënës dhe fëmijëve dhe në kuadër të këtij moduli do të parashohim që emergjenca pediatrike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës të jetë në fokus të vëmendjes në kuptim të ngritjes së kapaciteteve, edhe profesionale, edhe teknologjike.

KRYETARI: Pyetje shtesë, deputete?

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Ministër, më ka rastisur ta vizitoj këtë njësi në kohë me shi dhe ka qenë çudi se objekti i ri, i saporinovuar, në hyrje është dashur të përdoret ombrella, si të jesh jashtë. Staf i ri, i kompletuar këtë njësi nuk është staf i ri, por është staf që është marrë nga njësitë ose nga repartet tjera të Pediatrikës dhe tani repartet e tjera të Klinikës së Pediatrikës po ballafaqohen me mungesë të stafit shëndetësor, edhe të stafit të mesëm, por edhe të stafit të lartë. A do të shtohet numri i stafit shëndetësor në Klinikën e Pediatrikës, në mënyrë që të funksionalizohet puna ashtu siç duhet?

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: Zonja deputete,

Keni të drejtë. E ceka edhe në fjalën time se mungesa e stafit infermierik dhe mbështetës është problem. Angazhimi i numrit plotësues të punëtorëve shëndetësorë brenda Buxhetit të Kosovës ka qenë shumë i vështirë dhe në këtë aspekt ka pak shpresa se situata do të mund të ndryshojë, por aty ku realisht presim se do të kemi burime të mjaftueshme për ta përmirësuar gjendjen, është aktivizimi i plotë i shërbimit spitalor klinik universitar të Kosovës, i cili prej 1 janarit të viti të ardhshëm nuk do të ketë nevojë që të kërkojë leje nga Ministria e Shëndetësisë për punësimin e stafit infermierik mjekësor, apo të stafit mbështetës, në qoftë se arrijnë që me afarizmin e tyre financiar të rezultojnë me rezultate pozitive dhe të kenë gjendje të tillë, balancë të tillë financiare, që në fund të muajit të mund ta punësojnë stafin e nevojshëm profesional, sipas nevojave që i kanë.

Kjo deri më tani nuk ka qenë e mundur, por Ligji për shëndetësi dhe aktivizimi i shërbimit spitalor klinik universitar të Kosovës e lejon këtë mundësi. Prandaj, shpresoj që në muajt e parë të vitit 2014, ne do ta kemi një situatë në të cilën kjo gjendje gradualisht do të fillojë të tejkalohet.

KRYETARI: Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Pyetja ime ka të bëjë me një çështje që ministri pak e ngriti në përgjigje, që ia dha deputetit Liburn Aliu. Nuk di pse u ngut, por sidoqoftë kompania 'Bechtel&Enka', siç e dimë, ka të punësuar qindra sezonalë në ndërtimin e autostradës dhe gjatë punës në këtë

projekt, siç është raportuar edhe në media, janë lënduar me dhjetëra punëtorë, të cilët kanë mbetur invalidë të përjetshëm, disa prej tyre. Këta punëtorë detyrohen që të zhvillojnë punë të rënda fizike nga 12 orë në ditë, me nga vetëm 1,35 euro për orë, sa është pagesa për ta, ndërkohë në vend të tri shujtave gjatë këtij orarit të punës, atyre u serohet vetëm një, por detyrohen vetëm një herë gjatë orarit 12-orësh të punës. Po ashtu, këta punëtorë, krahasuar me punëtorët tjerë në Kosovë, e kanë vetëm një ditë pushim në muaj, që është drejtpërsëdrejti shkelje e Ligjit të punës në Kosovë, të cilit kjo kompani ishte dashur t'i nënshtrohet.

Të lënduarit që kanë pësuar aksidente në vendin e punës zakonisht janë pushuar nga puna, kurse invalidët janë pushuar pa dëmshpërblim. Pra, kompania nuk kanë marrë kurrfarë përgjegjësie për lëndimin e tyre dhe asnjë punëtor nuk e ka vendin e përhershëm të punës, siç është raportuar në media dhe siç kemi biseduar me disa punëtorë. Shumë herë pra kuzhinieri është shofer, ndërsa ky i fundit edhe pastrues.

Pyetja ime e parë ka qenë nëse Inspektorati i Punës, në kuadër të Ministrisë ka ndërmarrë ndonjë gjë, ndonjë vizitë atje, për ta konstatuar këtë gjendje të punëtorëve, por ministri kësaj pyetjeje ju përgjigj, sepse tha 'po, ka pasur vizita, madje edhe të shpeshta', siç tha ai. Tash po më intereson, cili ka qenë vlerësimi i Inspektoratit të Punës karshi kësaj çështjeje. Pra, çfarë ka ndërmarrë Ministria në këtë drejtim ndaj 'Bechtel&Enka'.

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsedniče!

Kolege ministri,

Dame i gospodo,

Narodni poslanici i gospodine Ymeri,

Ja sam malo pre, kao što ste rekli i vi sami, dao delimičan odgovor što se tiče poseta kojih ove godine bilo 8, kao što sam rekao, ali želim sa tehničke strane da vam informišem u vezi radnika, koji ste vi malo rekli i njihovih prava na njihovom radu. Što se tiče radnog vremena, koje traje 12 sati dnevno u ovom slučaju, ovaj raspored dopušten u stavu 4, člana 23 Zakona o radu i plaćen dodatkom od 30% za radni sat na osnovu člana 56, stav 2,3 istog zakona, znači Zakona o radu, za iznos plate za sat radnog vremena u ugovorenom odnosu između naravno poslodavca i posloprimaoca, sporazumevaju se ugovore i o radu koji se potvrđuje sa obe strane sa svojeručnim potpisom.

Podsećam da ona satnica, koja je preko 40 sati nedeljno, o tome je bilo reči od prvog dana kada je 'Bechtel&Enka' počela da radi, radnici koji su volonterski prihvatili da rade preko 40 sati, i zato zaključe ugovor o radu sa svojim poslodavcem, absolutno imaju pravo zato što je to u njihovom međusobnom dogovoru.

Mi smo stavili klauzulu, gde radnik i poslodavac mogu da se dogovore da rade ukoliko to bude adekvatno nadoknađeno.

Ovaj iznos može biti manji od zarade utvrđene od Vlade Kosova, koji se uzima na predlog Socijalno ekonomskog saveta, u skladu sa članom 57 Zakona 03/Z-212. Dakle

iznos naknade od 1,35 evra po satu prevazilazi minimalnu zaradu. Podsećam još jednom da je odlukom Vlade utvrđena minimalna zarada, koja je došla na osnovu predloga Socijalno ekonomskog Saveta i ta se osnovica po radnom satu uzima kao vrlo merodavna.

Što se tiče realizacije odmora tokom radnog vremena, nismo pronalazili nikakvo kršenje zakona, a onog dela što se tiče obroka koji omogućuje poslodavac, još jednom podsećam da obrok nije nešto što ulazi u zakon, i nije nešto što poslodavac mora da obezbedi i da je utvrđeno zakonom. Prema tome, to je, da nazovem tako, jedna usluga od strane poslodavca, jer zakonskim odredbama on ni na koji način nije obavezan da omogućiti hranu za radnike.

Za svaki slučaj nesreće na radu, koji je izvršen sa bilo telesnim, lakim ili težim povredama, ili posledicama smrta po radniku, inspektori rada odmah nakon dobijanja obaveštenja su reagovali i prozvali mere u skladu sa zakonskim odredbama. Tako da ne stoji da inspektori nisu odgovarali na svojim dužnostima...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Deputet, keni pyetje shtesë?

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Ministër, po më duket që nga pak po e eskivoni përgjigjen në çështjen, të cilën po e ngre, të cilën ju besoj e dini edhe e kuptoni, dhe të gjithë që po e dëgjojnë këtë, dhe të gjithë që e kanë lexuar e kuptojnë se çfarë gjendje e rëndë është. Tash të thuhet që këta punëtorë me vetëdëshirë dhe me vullnet i kanë pranuar këto kushte të punës, unë mendoj që është një lloj naiviteti i skajshëm që nuk duhet të lejohet te asnjë njeri, e veçanërisht e jo te një ministër i Punës, i cili pretendon se i mbron dhe po ashtu e ka për detyrë me ligj që t'i mbrojtë të drejtat e punëtorëve, në këtë rast, e veçanërisht të atyre që paguhën nga paratë e kontraktuara, pra me paratë publike, që janë para të Qeverisë së Kosovës, që ia jep 'Bechtel-Enka' për ndërtimin e autostradës.

Pra, nuk mund të themi që këta punëtorë me vetëdëshirë po e pranojnë që të hanë vetëm një herë në ditë dhe të punojnë nga 12 orë. Ne e dimë të gjithë që këta punëtorë detyrohen ta pranojnë një kontratë të tillë, përndryshe nuk do të ishin fare në vendin e punës.

Ne e dimë të gjithë që këta punëtorë kanë vazhduar nga 2-3 ditë të punojnë me brinjë të thyera, sepse nuk kanë guxuar të tregojnë që i kanë të thyera, përndryshe do ta humbnin vendin e punës...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Ministër, ke të drejtë ta vazhdosh.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala!

Ja samo naglašavam onu stvar koju sam reako malo pre. Sve što radi 'Bechtel&Enka' je absolutno po zakonu. Čak, moram da potenciram to, što je naravno meni logično, kao najveći poslodavac 'Bechtel&Enka' ima absolutno najbolje standarde zaštite na radu.

Na šalost kažem to, zbog toga što naše lokalne kompanije ne poštuju toliko zakone, kao što poštuje 'Bechtel&Enka'. I u svakoj inspekciji, ja sam malo pre rekao, ove godine je bilo 8, bilo je stvarno rigorozne kontrole, zbog toga što znamo, i mi se emotivno možda osećamo isto, da bi trebalo radna snaga da bude veća, da se više plaća, ali jednostavno to je privatna kompanija, koja želi pre svega da zaradi ovde profit.

Prema tome, nikakav zakon nisu prekršili, sva su prava ispoštovali, čak šta više prvi implementiraju zakon o zaštiti i zdravlju na radu. Mi, osim naših redovnih kontrola, kad ove godine bilo 4 povreda na poslu, i onih zahteva koje smo mi svake posete dostavili njima, kao nešto što je obavezno što moraju da urade, oni su to uradili. Prema tome, opet ponavljam 'Bechtel&Enka' je najsavesniji i najodgovorniji poslodavac trenutno na Kosovu. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk kemi pyetje të tjera. Na duhet votimi i procesverbalit. Të pranishëm 54 deputetë. Regjia, bjeri ziles! 54 deputetë kenë, tash erdhën edhe 3-4. Përfaqësuesit e popullit kanë shumë halle!

### **3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme**

Konsideroj që e kemi numrin e mjaftueshëm për miratimin e procesverbalit të seancës së mëparshme. Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 14 dhe 15 nëntor 2013. Të pranishëm tani janë 73 deputetë.

Konstatoj se nuk ka vërejtje dhe Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 14 dhe 15 nëntor 2013.

Në vazhdim ju njoftoj me kërkesën e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të deputetes Suzan Novobërdaliu me deputeten Myzejene Selmani. Lus për një miratim formal me ngritje dore.

Konstatoj që me shumicë votash miratohet kërkesa e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

### **4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014**

Pasi lidhet me buxhetin, të nderuar deputetë, dua t'jua jap një njoftim juve dhe ky njoftim konsideroj që duhet t'u shërbejë edhe medieve lidhur me çështjen e ngritur rreth kërkesës

së Radiotelevizionit të Kosovës për ndarjen e mjeteve në shumë prej 1 milion euro. Jap sqarimin si më poshtë:

1. Buxheti i Radiotelevizionit të Kosovës realizohet në kuadër të buxhetit të Kuvendit në kategorinë subvencione dhe transfere;
2. Rregullat e ndarjes së mjeteve realizohet siç vijon: Radiotelevizioni i Kosovës duhet të procedojë me kërkesë nëpërmjet Komisionit për Buxhet dhe Financa, i cili më pastaj kërkesën e shqyrton dhe e procedon në Qeveri, në Ministrinë e Financave. Qeveria, pasi e shqyrton kërkesën, e njofton Kuvendin, përkatësisht Radiotelevizionin e Kosovës dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa.
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa me rekomandim e autorizon Administratën për alokimin e mjeteve sipas vendimit të Qeverisë.

Në rastin konkret, përkatësisht deklaratimet e Radiotelevizionit të Kosovës se Kuvendi nuk ka proceduar sipas vendimit të Qeverisë për transferim të mjeteve, ju bëj me dije se nuk janë ndjekur procedurat e lartpërmendura.

Kështu, Radiotelevizioni i Kosovës kërkesën prej 1 milion eurosh nuk e ka proceduar nëpërmjet Kuvendit si themelues dhe bartës i buxhetit, por këtë e ka bërë drejtpërdrejt në Ministrinë e Financave.

Përfundim nga kjo procedurë është rasti kur janë ndarë mjetet në shumë prej 550 mijë euro, datë 31 dhjetor 2012, gjatë kohës kur Kuvendi ishte në pushim ndërmjet dy sesioneve të punës.

Pra, vitin e kaluar, duke pasur parasysh se mjetet ishin ndarë më 26 dhjetor, Kuvendi ishte në pushim, ishte çështja e pagave të punëtorëve të Radiotelevizionit, e kam nënshkruar një vendim, por ai nënshkrim nuk mund të përdoret për raste të tjera. Kërkesat tjera buxhetore për Radiotelevizionin e Kosovës janë ndarë sipas rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, datë 30 janar 2013 dhe 10 korrik 2013, në respektim të plotë të procedurave.

Komisioni për Buxhet dhe Financa në përfundimin e vet ka kërkuar që të zbatohen procedurat për ndarjen e mjeteve. Realisht është dashur të jetë një rekomandim. Pra, shihet qartë se kryetari i Kuvendit nuk ka pasur në kohën kur funksionon, kur punon Kuvendi pse ta nënshkruajë një vendim për ato mjete që nuk është çështje e tij.

Ju njoftoj se vendimi i Qeverisë për këto mjete është marrë më 18 shtator, por Kuvendi është njoftuar më 19 tetor, me 1 muaj vonesë. Bile nuk është as kopja me kohë, kur është bërë vendimi nuk është paraparë Kuvendi.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka dhënë rekomandimin e vet, por ju e dini që raporti vjetor i Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012 nuk është miratuar as vitin e kaluar. I është kthyer dhe nuk është rikthyer më dhe një menaxhment që i akuzon të

tjerët, e dy herë nuk i është miratuar raporti, do të duhej ta jepte përgjegjësinë që i takon dhe e meriton. Këtë kisha për të ju njoftuar se nuk është çështje e kryetarit të Kuvendit. Kuvendi nuk e ka bllokuar këtë.

E thashë këtë edhe për një çështje se janë përpjekur t'i japin konotacion politik gjoja se këto mjete qenkan për Televizionin serb dhe se këtë po e bllokon kryetari i Kuvendit. Të gjitha janë të paqëndrueshme. Vazhdojmë me pikën e rendit të ditës.

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Besim Beqaj, që para deputetëve ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kam kënaqësinë që sot para jush të paraqes propozimin për aprovimin në lexim të parë të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014.

Më lejoni të theksoj që konform bazës ligjore në fuqi, hartimi i këtij propozim-buxheti ka filluar në muajin prill të këtij viti me lëshimin e qarkoreve dhe më pas me dëgjimet buxhetore me të gjitha organizatat buxhetore.

Ministria e Financave është e përkushtuar maksimalisht në përmbylljen e suksesshme të këtij procesi të rëndësishëm. Bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ne i kemi shqyrtuar me kujdes të gjitha kërkesat e organizatave buxhetore dhe bazuar në strukturën e financimit për vitin 2014, ju propozojmë këtë projekt-buxhet që ta miratojmë në lexim të parë.

Struktura e propozuar buxhetore bazohet në projeksionet për performansën ekonomisë sonë për vitin e ardhshëm dhe në vitet në vijim, duke marrë për bazë efektet e mundshme të krizës në vendet e Eurozonës dhe në vendet në rajon. Me këtë dëshiroj të ju konfirmoj se propozim-buxheti të cilin po e prezantoj përpara jush është përgatitur në pajtim të plotë me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Gjatë takimeve vjetore të FMN-së dhe Bankës Botërore, ne kemi pasur diskutime intensive me misionin e FMN-së dhe kemi arritur që të pajtohemi lidhur me të gjitha kategoritë e të hyrave dhe shpenzimeve.

Përveç negociatave për strukturën e të hyrave dhe shpenzimeve, kemi zhvilluar diskutime edhe për politikat dhe reformat që Qeveria planifikon të ndërmarrë në periudhën afatmesme, të cilat janë përkrahur edhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Konform obligimeve të Republikës së Kosovës në raport me marrëveshjen 'stand by' të FMN-së, ne kemi arritur t'i përmbushim të gjitha kriteret e performansës dhe ato strukturore.

Më lejoni të ju informoj që tani jemi në fazën finale të rishikimit të këtij programi, rishikim i cili ka përfunduar këtë javë dhe konsiderojmë që Kosova do ta përmbyllë me sukses relacionin dhe marrëveshjen 'stand by' me FMN-në.

Si rezultat i këtij implementimi të suksesshëm të këtij programi, Kosova ka marrë një pjesë të konsiderueshme të mjeteve prej mbi 94 milionë euro nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Të nderuar,

Përgatitja e këtij projekt-buxheti nuk do të duhej të shihej si buxhet i shkëputur vjetor, por më shumë si një buxhet me efekte afatgjate dhe i integruar në kornizën afatmesme ekonomike dhe fiskale të Qeverisë. Në këtë kontekst, më lejoni shkurtimisht të flas për pritjet tona për rritje ekonomike në vitin e ardhshëm dhe në vitet në vijim, të cilat janë reflektuar në detaje në deklaratën e prioriteteve të politikave të Qeverisë dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve 2014-2016, dokumente në të cilat në tërësi përfshihen prioritetet e dala nga plani i veprimit dhe vizioni ekonomik i Republikës së Kosovës.

Ne presim që në vitin 2014 dhe në vitet në vijim, ekonomia e Kosovës të vazhdojë me ritmet e saj pozitive të rritjes. Presim që në vitin 2013, norma e rritjes ekonomike të jetë ndër më të lartat në rajon, në vitin 2014 të jetë 4,9%, ndërsa mesatarja për 3 vjetët e ardhshme 4,6%, duke u bazuar në projeksionet tona për rritje të investimeve, eksportit dhe konsumit.

Investimet private, si një komponentë shumë e rëndësishme rritjes ekonomike pritet që gjatë tre vjetëve të ardhshme të rritet nominalisht me një normë mesatare prej 10%, eksportet e përgjithshme në vitin 2014 pritet të kenë një rritje prej 7%, ndërsa vetëm eksportet e mallrave do të rriten për 10%.

Kjo normë relativisht e lartë e pritjes së rritjes së eksporteve, së bashku me një normë më të ulët të rritjes së importeve, pra diku rreth 4%, pritet që ta përmirësojë bilancin negativ tregtar, që vazhdon të jetë i lartë dhe paraqet sfidë për ekonominë e vendit tonë.

Konsumi agregat për vitin 2014 dhe dy vjetët në vijim pritet të ketë një rritje mesatare prej 6,2% dhe po ashtu të njëjtën rritje pritet ta ketë edhe konsumi privat.

Meqenëse ekonomia jonë është mjaft e hapur ndaj lëvizjeve në tregjet racionale dhe evropiane e më gjerë, ecuria e çmimeve në vend në masë të madhe do të varet nga ecuria e çmimeve të mallrave të nivelit global. Për vitin e ardhshëm, projeksionet tona, që marrin parasysh edhe pritjen për ecurinë e çmimeve të importit tregojnë se do ta kemi një ngritje modeste të çmimeve për rreth 1,5%.

Dërgesat e qytetarëve tanë që punojnë dhe veprojnë në Diasporë vazhdojnë të jenë një financues i rëndësishëm i konsumit dhe investimeve dhe presim që edhe në vitet në vijim niveli i këtyre dërgesave të jetë stabil.

Andaj, sa u përket pritjeve për zhvillimet ekonomike në vitin e ardhshëm dhe në vitet në vijim, vlerësojmë se ekonomia e vendit do të vazhdojë të rezistojë ndaj tronditjeve të jashtme dhe, rrjedhimisht, rritja ekonomike do të jetë ndër më të lartat në regjion dhe më gjerë.

Tani më lejoni, të nderuar deputetë, të theksoj disa aspekte nga propozim-buxheti, i cili del nga korniza makrofiskale e vendit. Për vitin 2014, të hyrat e përgjithshme buxhetore planifikohen të jenë në nivel prej 1 miliard e 458 milionë euro (1 458 000 000), apo një rritje prej 2,5%, krahasuar me vitin 2013. Në kuadër të të hyrave totale, të hyrat nga tatimet e brendshme dhe ato doganore priten të rriten rreth 7%, ndërsa vetëm të hyrat e brendshme priten të rriten për 22%. Kjo reflekton përkushtimin tonë për ta fuqizuar në mënyrë të vazhdueshme Administratën Tatimore dhe për t'i rritur kapacitetet e saj, në mënyrë që të fillohet gradualisht edhe me një zhvendosje më domethënëse të mbledhjes së të hyrave nga kufiri në brendi të vendit.

Rritje planifikohet të ketë edhe te të hyrat tjera buxhetore, duke përfshirë të hyrat jotatimore, të cilat do të rriten për 8,5%, të hyrat vetjake të komunave 6,7%, ndërsa është planifikuar të ketë rënie të të hyrave vetjake të nivelit qendror me 31%, që reflekton pritje të të hyrave të njëhershme këtë vit dhe që nuk do të jenë në vitet e ardhshme.

Rrjedhimisht, duke marrë parasysh këtë nivel të të hyrave, ne kemi bërë propozim-buxhetin për shpenzime, të cilat do të realizohen në vitin e ardhshëm. Shpenzimet e përgjithshme për vitin 2014 priten të jenë në nivelin prej 1 miliard e 590 milionë euro, që paraqet një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2013. Shikuar nga këndvështrimi i kategorive ekonomike, buxheti për paga dhe mëditje pritet të jetë një rritje e konsiderueshme nga 435 milionë euro, në vitin 2013, në 483,4 milionë euro, në vitin 2014.

Ky buxhet reflekton zotimin e Qeverisë për rritje të pagave të të gjithë shërbyesve civilë, duke marrë parasysh performansën dhe efektivitetin e punës së tyre.

Rritje është planifikuar edhe në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Nga 225 milionë euro, në vitin 2013, në 252 milionë në vitin 2014, apo një rritje prej 12%. Kjo bëhet me qëllim të reflektimit të nevojës për përkrahje të reformave në sektorin e sigurisë, drejtësisë, shëndetësisë, arsimit, si dhe në mirëmbajtjen e infrastrukturës së zgjeruar rrugore, shkollave, objekteve të Administratës Publike etj.

Gjithashtu, edhe kategoria e subvencione dhe transfereve është planifikuar të rritet nga 299, në 316 milionë euro, me një rritje prej 5,7%. Kjo rritje shkon për krah me rritjen natyrale të skemave ekzistuese dhe skemave të reja sociale, siç janë Ligji për ish të ndjekurit politikë dhe Ligji për skemat e veteranëve të luftës.

Sa u përket shpenzimeve kapitale, ato priten të jenë në vlerë prej 531 milionë euro. Me këtë buxhet të planifikuar, pjesëmarrja e shpenzimeve kapitale në shpenzimet e përgjithshme buxhetore mbetet edhe më tutje e lartë, me rreth 33%. Edhe me buxhetin e planifikuar ne do t'i vazhdojmë investimet tona në të gjitha fushat me prioritet, që janë shumë të rëndësishme, do të vazhdohet me infrastrukturën rrugore, përfshirë këtu edhe



autostradën në drejtim të Maqedonisë, si dhe ndërtimin e shumë projekteve tjera të rëndësishme, në mesin e tyre edhe ndërtimin e rrugës M2 dhe M9, respektivisht rrugët për Mitrovicë dhe Pejë.

Më lejoni të theksoj se Kosova në strukturën e vet të shpenzimeve e ka përqindjen më të lartë të ndarjet për investime e kapitale në regjion dhe qëndron shumë më lart, krahasuar edhe me vendet dhe standardet e shteteve të Bashkimit Evropian.

Për njoftimin tuaj, Mali i Zi, Serbia, Shqipëria dhe pothuajse të gjitha vendet e rajonit kanë më pak investime kapitale në përbërje të përqindjes nga buxheti total. Gjithashtu, ky buxhet parasheh financimin e reformave të Qeverisë në sektorin e arsimit, shëndetësisë, administratës publike, sigurisë, bujqësisë, ambientit, e kështu e me radhë.

Në këtë drejtim, ju njoftoj më konkretisht rreth buxhetit të planifikuar sipas prioriteteve dhe sektorëve:

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka një rritje në vitin 2014 për rreth 4 milionë euro. Kjo rritje i mbulon obligimet nga huamarrja që ka kjo ministri dhe kryesisht reflekton rritjen e subvencioneve për sektorin e bujqësisë.

Ministria e Shëndetësisë ka rritje prej 7,5 milionë, që reflekton reformën e sektorit të shëndetësisë, por njëkohësisht për këtë ministri është akomoduar edhe huaja nga Banka Botërore, që është 25 milionë dollarë, dhe që parasheh reformën e 4 vjetëve të ardhshme.

Ministria re Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka rritje për 5 milionë për të vazhduar me reformën në fushën e arsimit dhe mbulimin e nevojave të universiteteve të reja.

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale ka rritje prej 23 milionë, prej të cilave 15 milionë shkojnë për skemat e reja, pra për Ligjin për veteranët e luftës dhe Ligjin e ish të burgosurve politikë, dhe pjesa tjetër është planifikuar për rritje natyrale të përfituesve të skemave sociale dhe pensionistëve.

Është rritur buxheti për sektorin e drejtësisë dhe sigurisë, kryesisht për forcimin dhe përkrahjen e reformave të këtij sektori, procesin e liberalizimit të vizave dhe implementimin e Marrëveshjes Kosovë-Serbi. Për Agjencinë Kosovare të Privatizimit janë ndarë 4 milionë euro, për ristrukturimin e kompleksit “Trepça”.

Ministria e Diasporës ka rritje në vitin 2014 prej 2,2 milionë, e cila do të shkojë në përkrahjen e regjistrimit të Diasporës.

Është me rëndësi të theksohet se ky propozim-buxhet parasheh edhe financimin e projekteve sipas prioritet të të gjitha komunave. Kur flasim për nivelin lokal, dua të ju informoj që Qeveria ka vazhduar me...

*(Ndërprerje nga regjia)*

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: T'i vazhdohet fjala, derisa ta kryejë ministri.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit!

Pra, kur flasim për nivelin lokal, dua të ju informoj që Qeveria ka vazhduar me fleksibilitetin e mëtutjeshëm të kriterëve të shpërndarjes së buxhetit. Për Buxhetin 2014, komunat kanë bërë shpërndarjen e të hyrave vetjake në kategoritë e shpenzimeve kapitale, mallrave dhe shërbimeve, apo transfereve, në mënyrë që prioritetet e tyre t'i adresojnë nevojat e qytetarëve tanë.

Nga materialet që keni para jush pasqyrohet buxheti i Komunës së Rahovecit dhe Hani i Elezit, të cilat nuk kanë arritur ta aprovojnë buxhetin në kuvendet komunale. Si rrjedhojë, duke u bazuar në nenin 62 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, është marrë për bazë niveli i Buxhetit 2013 për këto dy komuna.

Në fakt, tabela shtesë specifikon ndarjet buxhetore të aprovuara me Dokumentin... 2014-2016 nëpërmjet qarkoreve 2014/01 dhe 02 për komuna, ndërsa diferenca e granteve qeveritare, të hyrat, është prezantuar në pjesën e bilancit të kësaj tablele.

Të nderuar,

Më lejoni të ju informoj se projekti i Qeverisë që ka filluar në janar 2012 për emetimin e letrave me vlerë deri më tani ka qenë shumë i suksesshëm dhe ne presim që edhe në vitin e ardhshëm të vazhdojë me emetimin e këtyre instrumenteve.

Kostoja e këtij burimi të financimit ka qenë shumë e ulët sesa kostoja e vendeve në rajon dhe presim që edhe në vitin e ardhshëm ta kemi një kosto përafërsisht të njëjtë me atë të këtij viti. Kjo reflekton stabilitetin e sektorit financiar dhe bankar, si dhe sigurinë dhe perceptimin pozitiv të investitorëve për vendin tonë.

Me anë të këtij propozim-buxheti mundësohet respektimi në tërësi i rregullës fiskale, e cila kufizon deficitin e përgjithshëm buxhetor në 2% të bruto-produktit vendor, i cili është paraparë me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.

Në të njëjtën kohë, nëpërmjet implementimit të kësaj rregullore sigurohet qëndrueshmëri afatgjate e financave publike të vendit. Dhe, më lejoni të theksoj këtu edhe një herë se është hera e parë që ne para Kuvendit e prezantojmë ligjin me rregullën fiskale dhe rregulla fiskale thamë kufizon deficitin 2%, ndërsa në raport me atë çfarë ka qenë në vitin 2013, kjo ka qenë 3,5%.

Të nderuar,

Më lejoni të theksoj edhe një herë se ky buxhet i prezantuar para jush është në linjë të plotë me objektivat e Qeverisë për rritje të qëndrueshme ekonomike, për stabilitet makrofiskal. Besojmë se me këtë propozim kemi arritur t'i financojmë kërkesat me prioritet të secilës organizatë buxhetore dhe njëkohësisht ta ruajmë stabilitetin buxhetor, që është parakusht për rritje të qëndrueshme ekonomike.

Në mungesë të politikës monetare, propozim-buxheti, të cilin po e prezantoj sot para jush, është dokumenti kryesor i zhvillimit të politikave të vendit, i cili si i tillë do të sigurojë vazhdim të rritjes ekonomike dhe rrjedhimisht rritje dhe përmirësim të mirëqenies të qytetarëve dhe standardit tonë dhe njëkohësisht premtan edhe rritje ekonomike, edhe një herë po e përsëris, më të madhe, gjë që na bën të ndihemi mirë.

Prandaj, të nderuar deputetë,

Ne do t'i shohim me vëmendje të gjitha diskutimet dhe besojmë që pas aprovimit të leximit të parë ndërmjet dy leximeve ne do ta përmirësojmë edhe aty ku konsiderohen prioritetet, të cilat duhet të trajtohen nga deputetët.

Ju bëj thirrje që ta votojmë në leximin e parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Radha është e kryetares së Komisionit për Buxhet dhe Financa, zonjës Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin për vitin 2014 më 13 nëntor dhe ka vlerësuar se Projektligji teknikisht është i përgatitur mirë, brenda afateve kohore dhe kornizës ligjore.

Projektligji për Buxhetin përfshin të gjitha të dhënat që parasheh Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, pjesën tekstuale, pjesën tabelare, treguesit makroekonomikë dhe të dhënat tjera që e pasurojnë materialin që na është ofruar.

Të nderuar deputetë,

Në draft-dokumentin e Buxhetit vërehet se Qeveria i ka respektuar parimet kryesore që kanë të bëjnë me ruajtjen e qëndrueshmërisë fiskale, sigurimin e financimit të plotë, ruajtjen e rezervës fiskale në nivel të mjaftueshëm, ka adresuar barrierat për avancimin e konkurrencës në sektorin privat, ka arritur ta ruajë trendin e investimeve kapitale, e ka rritur fondin e mjeteve për paga dhe mëditje, ka rritur subvencionet dhe transferet.

Vlen të theksohet se në adresimin e të gjitha këtyre çështjeve me interes, Qeveria ka arritur ta ruajë nivelin e ulët të borxhit publik, në mënyrë që veprimet që janë duke u ndërmarrë sot të mos bëhen ngarkesë për gjeneratat e ardhshme, çka do të thotë se ky buxhet e reflekton fuqinë e shtetit të Kosovës.

Projekt-buxheti është vlerësuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, se është buxhet i harmonizuar sipas marrëveshjes me të. Fondi Monetar Ndërkombëtar ka vlerësuar se Projektbuxheti për vitin 2014 siguron implementimin e reformave, të cilat janë paraparë në kuadër të Qeverisë, parasheh rritjen e pagave, mundëson realizimin e prioritetëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ka vlerësuar se menaxhimi i disiplinuar fiskal ka bërë që buxheti të jetë i mjaftueshëm për financimin e projektit të madh të infrastrukturës,

autostradën në drejtim të Maqedonisë nga resurset e Kosovës, pa pasur nevojë për privatizimin e Postës dhe pa pasur nevojë për financim shtesë.

Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, Buxheti i vitit të ardhshëm mundëson rritjen ekonomike më të lartë në rajon, prej 4%, dhe se Kosova vazhdon të mbetet një vend me stabilitet makrofiskal.

Të nderuar deputetë,

Gjatë këtij viti ne kemi miratuar plotësim-ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ku kemi paraparë edhe rregullën fiskale, ku buxheti nuk mund të planifikohet nëse duhet të respektojë 2%-shin e deficitit buxhetor me rastin e planifikimit, domethënë 2% të bruto-produktit vendor.

Me këtë propozim-buxhet mundësohet respektimi në tërësi i rregullës fiskale, e cila kufizon deficitin e përgjithshëm buxhetor në 2% të bruto-produktit vendor. Në të njëjtën kohë, nëpërmjet implementimit të kësaj rregulle sigurohet një qëndrueshmëri afatgjate e financave publike të vendit. Me këtë propozim-buxhet është arritur të financohen kërkesat me prioritet të secilës organizatë buxhetore dhe njëkohësisht të ruhet stabiliteti buxhetor që është parakusht për rritje të qëndrueshme ekonomike.

Prandaj, Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka përkrahur me shumicë vota në parim Projektligjin për Buxhetin dhe ka rekomanduar të miratohet dhe t'i jepet mundësia komisionit që ta shqyrtojë dhe ta amendamentojë atë.

Të nderuar deputetë,

Projektligji që na është ofruar për miratim vazhdon me ritme pozitive të rritjes. Të hyrat e përgjithshme buxhetore për vitin 2014 parashihen të jenë 1 miliard e 458 milionë, që do të thotë 2,3% më shumë krahasuar me vitin 2013, me një pjesëmarrje prej 26,5 në bruto-produktin vendor.

Nga Doganat parashihet të mblidhen të hyra prej 934 milionë euro, apo 21,4 milionë euro më shumë, krahasuar me vitin 2013, që parasheh një rritje prej 2% krahasuar me vitin që po e lëmë pas. Të ardhurat nga Administrata Tatimore e Kosovës parashihen të jenë 367 milionë euro, krahasuar me 301 milionë euro të parapara për vitin 2013, dhe kemi një rritje prej 66,3 milionë euro, çka do të thotë që ka rritje prej 22%, në krahasim me vitin që po e lëmë pas.

Të hyrat jotatimore janë planifikuar të jenë 192,5 milionë euro, kurse të hyrat nga tantiemat janë planifikuar të arrijnë në vlerën 22 milionë, ndërsa grantet e projekteve pritjet të arrijnë vlerën 1,3 milion, ndërsa të dalat e përgjithshme janë planifikuar 1 miliard e 590 milionë euro, me një rritje prej 11% për paga dhe mëditje, krahasuar me vitin e kaluar, kur është paraparë rritja e pagave për stafin civil dhe të tjerët, 12% ka rritje për mallra dhe shërbime, ku janë paraparë reforma në drejtësi, në sektorin e shëndetësisë, në sektorin e sigurisë dhe në arsim, kurse 6% janë rritur subvencionet dhe transferet, ku është përfshirë përkrahja e skemave sociale ekzistuese, e skemave të reja sociale, ku janë paraparë mjete edhe për ish të përndjekurit politikë dhe skema e veteranëve të luftës.

Shpenzimet kapitale janë paraparë të jenë 530 milionë euro, që përfaqëson 33% të buxhetit të përgjithshëm, apo 10% të bruto-produktit vendor, ku parashihet ndërtimi i rrugëve me interes nacional, autostrada për Shkup, për Mitrovicë, për Pejë, përmirësimi i infrastrukturës lokale rrugore, infrastruktura sportive-arsimore, investimet në sektorin e bujqësisë, në ujësjellës e kanalizime, investime këto nga të cilat përfitojnë edhe komunat tona.

Investimet e tilla janë bazë e zhvillimit ekonomik, e krijimit të ambientit më të favorshëm për rritjen e investimeve të brendshme dhe të jashtme, si dhe reflektojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Për Ministrinë e Shëndetësisë është bërë rritje prej 7 milionë e 911 mijë euro, krahasuar me vitin 2013, nga të cilat 42 milionë e 463 mijë euro janë për mallra dhe shërbime dhe 18 milionë euro investime kapitale, çka do të thotë që 5 milionë euro janë më shumë krahasuar me vitin 2013 për përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore, të kujdesit dytësor, tretësor. Janë përkrahur programet për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor, është përkrahur programi për përkrahjen e shëndetit të nënës dhe fëmijës.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka rritje të buxhetit për 4 milionë e 531 mijë euro, krahasuar me vitin 2013. Vazhdohet edhe më tutje me ndërtimin e shkollave, janë të ndara 24 milionë e 750 mijë euro, si dhe janë ndarë mjete për përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe krijimin e kushteve për funksionimin e universiteteve të reja.

Kurse për përmirësimin e infrastrukturës në bujqësi janë ndarë 4 milionë euro më shumë se në vitin 2013, kurse janë ndarë edhe 11 milionë e 810 mijë euro për mbështetje të fermerëve, me qëllim të rritjes së prodhimtarisë vendore, që janë 3 milionë euro më shumë se në vitin 2013.

Rritje e Buxhetit është paraparë edhe në sektorin e sigurisë, ku janë ndarë 6 milionë e 978 mijë euro për Ministrinë e Punëve të Brendshme. Është bërë rritje edhe e buxhetit të Ministrisë së Forcës së Sigurisë, Ministrisë së Integriteteve Evropiane dhe Ministrisë së Diasporës.

Komunat e Kosovës do të përfitojnë nga Buxheti shtetëror 388 milionë euro gjatë vitit 2014, që shënon një rritje prej 20 milionë eurove, krahasuar me vitin 2013.

Komunat kanë planifikuar 51,19%, apo 198 milionë e 706 mijë euro t'i shpenzojnë për paga dhe mëditje; 10,78% për mallra dhe shpenzime, dhe 48% kanë paraparë për subvencione dhe transfere, kurse 32,96% të shpenzimeve të tyre i kanë paraparë për shpenzime kapitale, që kap shifrën prej 127 milionë e 938 mijë e 154 euro.

Pjesë e Buxhetit janë edhe 29 institucione të pavarura, të cilat i kanë të punësuar 634 njerëz dhe e ka një buxhet prej 95 milionë 615 mijë euro. E theksoj këtë, sepse Komisioni për Buxhet dhe Financa në vazhdimësi është në vështirësi në përcaktimin e pagave dhe mëditjeve të bordeve ekzistuese, mbikëqyrëse, këshillëdhënëse dhe pagave të stafit të

këtyre institucioneve, në mungesë të bazës ligjore, që i përcakton pagat e funksionarëve të lartë publikë.

Është shqetësuese se si nuk po mund të gjendet mundësia e miratimit të Ligjit për pagat e funksionarëve të lartë publikë, që po shkakton konfuzion sa u përket pagave të stafit politik dhe stafit civil.

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka bërë një debat konstruktiv në mbledhjen që e ka mbajtur. Janë ngrehur disa çështje që kanë të bëjnë me pjesën tekstuale dhe me pjesën tabelare. Janë ngrehur shqetësimet për disa nene të projektligjit, ku janë kërkuar sqarime për rritjen ekonomike. Është kërkuar informatë shtesë nga ministri i Financave, që ishte i pranishëm në takim, për disa shifra që kanë të bëjnë me treguesit makroekonomikë. Është kërkuar që të ndërhyhet në pjesën tekstuale të projektligjit, që të ashpërsohen kriteret dhe...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Edhe një minutë!

SAFETE HADËRGJONAJ: ...të mos lejohen kryetarët e komunave të investojnë në kohë fushate jashtë procedurave të parapara me investime kapitale. Është kërkuar sqarim se çfarë po ndodh me kthimin e huas nga e KEK-u.

Të gjitha këto vërejtje konstruktive të anëtarëve të komisionit dhe vërejtjet dhe sugjerimet tuaja, të nderuar deputetë, ne do të angazhohemi që t'i shqyrtojmë me kujdes dhe nëpërmjet amendamentimit të bëhen pjesë e Ligjit për Buxhetin e vitit 2014.

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka përkrahur me shumicë votash Projektligjin për Buxhetin dhe ka rekomanduar që seanca plenare ta miratojë. Prandaj, unë sot ju ftoj të gjithë juve, të nderuar deputetë, që ta votojmë Projektligjin për Buxhetin për vitin 2014 dhe të na jepet mundësia në Komisionin për Buxhet dhe Financa t'i marrim parasysh të gjitha vërejtjet dhe shqetësimet tuaja dhe të anëtarëve të Komisionit...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Mocion?! Veç nëse e ke në emër të grupit, jo personal? Zoti Haxhiu e ka fjalën për mocion.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Pasi janë afro 30 deputetë të paraqitur për diskutim, propozoj që diskutimet e shefave të grupeve parlamentare, apo në emër të grupeve parlamentare të zgjasin nga 10 minuta, ndërsa diskutimet e deputetëve 7 minuta.

KRYESUESI: Për ju mund të jetë e papranueshme, por për mua mocioni është i pranueshëm dhe e hedhim në votim.

*(Debat në sallë)*

Të lutem, është një rregull, e zbatojmë për të gjithë njësoj!

*(Debat në sallë)*

Po, është një rregull. Është një rregullore. Unë atë detyrë e kam.

Është propozimi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, që diskutimet të shkurtohen nga 10 në 7 minuta, ndërsa përfaqësuesve të grupeve parlamentare t'u lihen 10 minuta.

Ne jemi këtu të gjithë. Jam i obliguar që të marr vendimin e Grupit Parlamentar të LDK-së, sipas radhës lidhur me propozimin. Është apo s' është dakord?

Kush e do fjalën? Zoti Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë mendoj që nuk duhet të bëhet kurrfarë shkurtimi, aq më tepër në këtë fillim ende asnjë artikullim të deputetëve s'e pamë dhe po ndërhyjmë. Mendoj që le t'i japin argumentet e nevojshme, jam shumë i bindur që s'do ta kalojnë as atë shifër që po kërkohet, sepse do të shteren argumentet, kështu që më duket që është herët të bisedohet në këtë formë.

Shkurt po i bie, nuk është koha dhe mendoj se s'duhet ta votojmë këtë kërkesë.

KRYESUESI: Unë s'mund ta ndryshoj.

*(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)*

Fjalën e ka zoti VisarYmeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Edhe ne jemi kundër që të shkurtohet koha sa kanë të drejtë deputetët të flasin. Natyrisht, që do të jetë e deputetëve të vlerësojnë a ka nevojë t'i përsërisin argumentet, siç tashmë filluan, për shembull me kryetaren e Komisionit e cila e përsëriti fjalimin e ministrit, po sidoqoftë ne si seancë nuk duhet t'ua shkurtujmë të drejtën deputetëve të flasin për buxhetin, meqenëse është një çështje shumë e rëndësishme, t'i thonë ato që kanë për t'i thënë për këto çështje.

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zoti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Edhe unë pajtohem që t'i dëgjojmë deputetët, kanë të drejtë të shprehen. Nuk ka nevojë për ta ndërprerë minutazhën.

KRYESUESI: Në rregull. E ka fjalën zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Duke marrë parasysh se projekt-buxheti është ligji më i rëndësishëm, i cili vjen në Kuvend të Kosovës dhe njëkohësisht është projekt-buxhet i qytetarëve të Kosovës, atëherë kisha pasur dëshirë të gjithë të prononcohem, mirëpo me argumente.

KRYESUESI: Faleminderit! Sasha Milosavljeviq, SLS-ja.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedavajući!

Mi se slažemo sa predlogom da se razgovor poslanika skrati od 10 na 7 minuta.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bale, nga “6+”.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Ja mislim da je vreme potrebno da se donese ovakav zakon je vrlo bitno i mislim da se treba se dati pravo da svakom poslaniku kaže ono što ima vezano za budžet.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga “Zajednička Budućnost”, dëshiron dikush ta marrë fjalën. Zoti Gjokiq, s'është. Në rregull.

Unë duhet ta hedh në një votim formal, por nga diskutimet shihet që nuk ka vullnet që të shkurtohen diskutimet. Atëherë, zoti Haxhiu, a dëshiron ta tërheqësh mocionin, apo? Zoti Haxhiu e dëshiron fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Qëllimi im ishte që të racionalizojmë kohën, asnjë qëllim nuk kam pasur që të zvogëlojmë mundësinë e dikujt për të shprehur mendimin apo qëndrimin e tij për buxhetin, por pasi që edhe opozita, domethënë kryesisht është që diskutimet të jenë 10 minuta, në asnjë mënyrë nuk dëshiroj që të ndikojmë që shprehjet e tyre për buxhetin të zvogëlohen. Nëse këta nuk janë të pajtimit, atëherë unë gjithsesi e tërheq mocionin tim dhe t'i dëgjojmë, sigurisht që do të na jepet mundësia që të debatojmë edhe më tutje, mirëpo krejt propozimi ishte në kuptimin e racionalizimit të kohës dhe jo në zvogëlimin e argumenteve, që e di që edhe për dy minuta s'kanë çka të thonë tjetër, veçse kanë si t'i përsëritin vërejtjet e viteve të kaluara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, i shpëtuam votimit. Miratohet tërheqja e mocionit. Sipas radhës e hap diskutimin lidhur me projektbuxhetin. Në emër të grupit parlamentar, fjalën e ka kërkuar zonja Hasime Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Projektligji i buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2014 është shqyrtuar dhe analizuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, si projektligj me rëndësi të veçantë për shtetin e Kosovës, i cili është i përgatitur mirë në aspektin teknik



dhe përmbajtjesor, ku ofron të dhëna të detajuara në pjesën tabelore, si dhe në pjesën tekstuale të projektbuxhetit, sipas të cilit është rregulluar mënyra e ndarjes dhe menaxhimit të mjeteve.

Me këtë projektbuxhet, në bazë të parashikimeve makroekonomike grumbullimi i të hyrave gjatë vitit 2014 është paraparë të jetë 1miliard e 458 milionë euro, ku të hyrat e mbledhura nga doganat, parashihihen të jenë 934 milionë euro, ndërsa të hyrat në vend pritet të jenë 367 milionë euro.

Kthimet nga tatimet në vlerën e shtuar gjatë vitit 2014 pritet të jenë 37 milionë euro, që krahasuar me vitin 2013, që ishin 35 milionë euro. Struktura e të hyrave të grumbulluara në kufi vazhdon të dominohet nga TVSH-ja me 46,5% e përcjellë nga akciza me 42,6% dhe nga të hyrat nga taksat doganore me 11%.

Të hyrat jotatimore parashihihen rreth 193 milionë euro, të hyra këto që kryesisht përbëhen nga të hyra vetjake që mblidhen nga niveli qendror dhe niveli lokal, ndërsa të hyrat nga tantienat vlerësohen të arrijnë vlerën rreth 22 milionë euro, si dhe grantet e projekteve pritet të arrijnë vlerën rreth 1 milion euro.

Struktura e të hyrave të përgjithshme vazhdon të mbetet e njëjtë. Tatimet direkte dhe indirekte marrin pjesë me mbi 90% në të hyrat e përgjithshme.

Arkëtimet në vend parashihihet të kenë rritje të pjesëmarrjes në të hyra të përgjithshme për 22% për vitin 2014. Edhe përkundër lirimeve të shumta doganore, rritja e të hyrave buxhetore, krahas faktorëve të tjerë ekonomikë, është edhe rezultat i ngritjes së efikasitetit nga institucionet arkëtuese drejt uljes së hendekut tatimor.

Shpenzimet buxhetore për vitin 2014 janë hartuar mbi bazën e mbarëvajtjes së qëndrueshmërisë makrofiskale nëpërmjet aplikimit të rregullës fiskale, e cila limiton deficitin e përgjithshëm buxhetor në kufirin prej 2% të brutoproductit vendor, e cila është përcaktuar me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Shpenzimet e përgjithshme për vitin 2014 janë paraparë të jenë në vlerë prej 1 miliard e 590 milionë euro, duke përfshirë edhe AKP-në, që përafërsisht janë të njëjta me shpenzimet e planifikuara për vitin 2013.

Për vitin 2014 po ashtu janë përfshirë edhe projektet që financohen nëpërmjet kredive nga partnerët ndërkombëtarë, që arrijnë vlerën prej 38 milionë eurosh, kryesisht investime këto që kanë të bëjnë me përmirësimin e infrastrukturës.

Shpenzimet buxhetore sipas kategorive për vitin 2014-2016 janë bërë në harmoni me planifikimin e të hyrave buxhetore për vitet përkatëse, për të siguruar financim të qëndrueshëm të shpenzimeve të planifikuara.

Nga ky projektbuxhet i planifikuar mund të themi se Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdon me realizimin e projekteve madhore në interes të vendit, në ndërtimin e autostradave të njëpasnjëshme; duke mos lënë anash dhe ndërtimin e rrugëve rajonale dhe

lokale; investimet në infrastrukturën arsimore dhe sportive; mbështetjen e sektorit të bujqësisë; mbështetjen e reformave në sektorin e shëndetësisë; si dhe investimet në të gjithë sektorët e tjerë, që drejtpërdrejt ndikojnë në përmirësimin e kushteve për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Shpenzimet për paga dhe mëditje, parashihet një ngritje për vitin 2014, që do të thotë se kjo qeveri vazhdon me ngritjen e pagave nëpër sektorë të ndryshëm me qëllim të përmirësimit të kushteve për një jetë më të mirë për të gjithë.

Me këtë projektbuxhet të planifikuar nga Ministria e Financave, Qeveria e Republikës së Kosovës me politikat e saj shtetformuese vazhdon ta ruajë qëndrueshmërinë makrofiskale dhe stabilitetin makrofiskal, duke ofruar mbulesë të plotë buxhetore për të gjitha projektet dhe shërbimet e parapara për vitin 2014, që janë në interes të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Dhe, në fund, grupi ynë parlamentar do të jetë pro këtij projektbuxheti dhe gjithë kontributin tonë do ta japim në Komisionin Funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kush e ka fjalën? Zoti Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër i Financave,

Është për keqardhje që sot në shqyrtim të aktit më të lartë ligjor- buxhetit nuk është prezent kryeministri, asnjë zëvendëskryeministër, asnjë ministër i sektorëve përkatës, përjashtuar dy të tjerë. Me të vërtetë është një keqardhje, për një devalvim të institucioneve apo shpërfillje të institucioneve të Kosovës.

Sidoqoftë, buxheti i shtetit si një akt përshkrues dhe politik përbën instrumentin kryesor të aksionit ekonomik të Qeverisë duke reflektuar mënyrën më të plotë dhe domethënëse në politikat ekonomike të një vendi, në parametrat e ekonomisë së vendit tonë, buxhet ky i cili do të duhej të përcaktonte të gjitha linjat e të ardhurave, shpenzimeve dhe investimeve të Qeverisë në një vit.

Aplikimi i rregullave teknike, tradicionale, të nevojshme për një menaxhim më të mirë të financave publike do të lehtësojë kontrollin e Parlamentit mbi shpenzimet dhe të ardhurat e institucioneve publike.

Projketligji për buxhetin i cili është sot para deputetëve të Kuvendit për shqyrtim, kërkon vëmendjen tonë me kujdes të analizojmë prioritetet dhe joprioritetet, sidomos në ato segmente ku Qeveria nuk ka qenë mjaft e vëmendshme, ose ka tentuar që të marrë disa ingerenca të Kuvendit.

Neni 4, paragrafi 5 i ligjit në mes, ku thuhet “dhe përfaqësuesit e popullatës së zonave kadastrale”. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12, nenit 123 dhe nenit

124, komuna ka përfaqësuesit e saj legjitimë, që dalin nga vota e lirë e qytetarëve dhe nuk njih asnjë përfaqësues tjetër kadastral.

Neni 9, paragrafi 3, fondi i përfolur dhe i diskutueshëm për veriun nuk figuron fare në të hyra dhe të dala në buxhet.

Neni 13, paragrafi 2, çdo ndërhyrje e Qeverisë në ligj për shkurtime apo shpenzime të organizatave buxhetore, duhet të bëhet ekskluzivisht vetëm nëpërmjet Kuvendit dhe në asnjë mënyrë vetëm me vendime të Qeverisë.

Pavarësisht lëshimeve të pjesës tekstuale, ky buxhet që i është propozuar Kuvendit të Republikës së Kosovës edhe më tutje vazhdon të jetë buxhet shpenzues, pa perspektivë dhe shpresë për një jetë më të mirë të qytetarëve, buxhet i cili sjell ekonominë e Kosovës në depresion duke kthyer atë në formën primitive të këmbimit mall me mall, sepse bizneset nuk do të kenë mjete për afarizëm të domosdoshëm e kështu do të rritej papunësia e me të varfëria më e madhe në Kosovë.

Projektbuxheti i vitit 2014 vazhdon të jetë i ndërtuar në të njëjtën bazë dhe ka të njëjtat orientime, pa elemente zhvillimore që nuk mbështesin objektivat makroekonomike reale. Buxheti bazohet kryesisht në të hyrat që qytetarët e Kosovës do të vazhdojnë t'i konsumojnë mallrat nga importi, prej të cilave Qeveria do të mbledhë mbi 64% të hyrave buxhetore në kufi. Qeveria nuk ka bërë asnjë përgatitje se si do të kalohet nga mbledhja e të hyrave në kufi, në mbledhjen e të hyrave brenda vendit. Sikur kjo të mundësohej, atëherë TVSH-ja do të mblidhej pasi të shitej malli dhe kështu do të qarkullonin mbi 430 milionë euro apo 46,5% që janë të hyra nga TVSH-ja e që nënkupton se bizneset do të mund të qarkullonin këto para në investimet biznesore deri në momentin e shitjes së mallit.

Në aspektin makroekonomik Kosova ka ekonomi konsumuese me perspektivë të zymtë, ka bilanc tregtar tejet negativ, me rritjen e vazhdueshme të deficitit tregtar, me rritje të eksporteve dhe rënie të importeve të mallrave dhe shërbimeve. Rënia e investimeve në ekonomi po vazhdon për shkak të politikave jo të mira fiskale, mungesa e masave lehtësuese doganore dhe tatimore për bizneset, që ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe në hapjen e vendeve të reja të punës.

Nga analiza del që ky buxhet është shpenzues, për arsye se 68,5 e buxhetit është për paga, subvencione dhe transfere sociale.

Varfëria e thellë bën që 28% e shpenzimeve rrjedhëse që është për 9% më shumë se në vitin e kaluar, të shkojë për mirëqenie sociale, që tregon qartë se është ky buxhet, në fakt buxhet për t'u menaxhuar varfëria e madhe që ka kapluar Kosovën.

Qytetarët e Kosovës nuk shohin perspektivë nga kjo qeveri, sepse segmentet më vitale të shoqërisë sonë nuk kanë qenë asnjëherë prioritet. Si mund të pritët zhvillim kur për arsim ndahen vetëm 4,7% në krahasim me mjetet investive kapitale. Vetëm 4,4% arsimit merr pjesë në kategorinë mallra dhe shërbime. Unë e di që ministri i Arsimit do të reagonte për arsye se do ta tërhiqte vërejtjen se këto nuk janë universitete, për mjetet për universitet,

duke përfshirë edhe mensën, që është shpenzuesi më i madh i shërbimeve publike, bën pjesë vetëm me 2%.

Pra, nuk ka një ngritje të shpenzimeve esenciale, që të bëjnë arsimin prioritet për të krijuar kushte më të mira për ngritje të cilësisë arsimore, që nuk mund të thuhet se nuk do të ketë shpenzime më të mëdha në kategorinë e pagave në këtë lëmi.

Paga është keqpërdorur nga Qeveria sikurse në çdo vit elektorale, sepse ajo nuk rritet për të gjithë shërbyesit civilë, që padyshim do të duhej të ishte një rritje permanente nga viti në vit, prej 7 deri 7,6%, për t'u mbrojtur nga inflacioni dhe për të ngritur sadopak mirëqenien e shërbyesve civilë në përgjithësi.

Nga ky buxhet nuk mund të presim që të kemi një shoqëri të shëndoshë, kur Qeveria investon vetëm 3,4% në mjete investive, apo 8% të cilave janë investime në mallra dhe shërbime, ku përfshihet normalisht edhe lista esenciale e barnave, që do të thotë se edhe më tutje pacientët kosovarë do të kërkojnë shërim jashtë vendit, pasi që spitalet tona do të jenë ngushtëllimi më i padëshiruar në rajon.

Kosova me një popullsi shumë të re dhe vitale, të etshme për dije, aktivitete sportive kulturore dhe aktivitete të tjera rinore, është totalisht e shpërfillur. Me këtë buxhet, për rini janë ndarë vetëm 0,08% shpenzime buxhetore.

Të nderuar deputetë,

Kjo qasje e shkujdesur dhe injorante ndaj rinisë, e cila po na hakmerret me ikjen jashtë vendit, por edhe me sukseset e tyre individuale, por që përkrahen nga shtetet tjera, në fakt një fakt i tillë kërkon një vëmendje drejt një qasjeje më të ndërgjegjshme se sa ajo që ofruar në buxhet nga kjo qeveri.

Rritja për 24 milionë e 300 mijë euro e ndihmave sociale, që marrin familjet e varfra tregon se gjendja reale ekonomike e qytetarëve të Kosovës në këtë rritje nuk do të ketë rritje esenciale për familjarë, për ata që marrin asistencë, por me këtë rritje do të zgjerohet vetëm gama e atyre që do të kenë nevojë nga kjo asistencë. Ndërsa, edhe më tutje nuk do të trajtohen kategoritë e ndjeshme, për të cilat kemi folur edhe në buxhetin e kaluar, në vitin e kaluar, që ka të bëjë me ish të burgosurit politikë dhe veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Që ky buxhet nuk është zhvillimor e tregon edhe zvogëlimi i shpenzimeve kapitale. Prej 90 milionë eurove, nga 621 milionë sa kishte për vitin që jemi 2013 dhe 531 milionë për vitin 2014. Fokusi i investimeve kapitale mbetet në rrugët. Ajo në drejtimin e Shkupit me 130 milionë me shpronësim dhe investime të tjera sipas politikave lokaliste apo partiake, që prishin rënd kriterin e grantit për komuna.

Si ilustrim më banal mund të merren investimet që janë bërë në Skenderaj dhe Prishtinë, si kryeqytet. Në shumën e investimeve kapitale të këtyre dy komunave për arsim janë ndarë 97,4% për Skenderaj, vetëm 2,6% për Prishtinë, apo thënë ndryshe 38 herë më shumë është investuar për kokë nxënësi në Skenderaj se sa në Prishtinë.

Ndërsa, për investime të rrugëve 19 herë është investuar më tepër në Skenderaj se sa në Prishtinë.

Të nderuar deputetë,

LDK-ja nuk mund të mbështesë këtë buxhet, pasi nuk është bërë ndonjë shpërndarje proporcionale e investimeve kapitale. Nuk jepet prioritet investimeve të domosdoshme në arsim, për funksionalizimin dhe ngritjen e cilësisë, si një investim që siguron një të ardhme më të mirë të vendit. Nuk ka investime të mjaftueshme dhe të domosdoshme në shëndetësi, që ne do të vazhdojmë edhe më tutje të trajtohem në vende të tjera.

Bujqësia, nuk merr ndonjë vend të rëndësishëm, si sektor ekonomik shumë i rëndësishëm. Edhe më tutje do të importojmë mallra të konsumit me prejardhje bujqësore.

Nuk do të ketë një rritje të pensioneve dhe pensionistët edhe më tutje do të përballen me probleme të përditshme.

Ne nuk mund të mbështesim, deputetë të nderuar, këtë buxhet, sepse në bilancin bankar janë futur përsëri mjetet nga shitja e PTK-së, pa bazë ligjore për privatizim.

Thjeshtë, LDK-ja nuk do ta votojë këtë buxhet, për këto arsye që u përmendën dhe për shumë arsye të tjera, që do t'i përmendin kolegët e mi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Natyrisht që nuk mund të filloj të flas tash, pa e konstatuar edhe njëherë faktin ose mos seriozitetin e Qeverisë, ministrave të caktuar, të them ashtu, përfshirë kryeministrin me mospjesëmarrjen e tyre në këtë seancë parlamentare ku po diskutohet buxheti. Pra, kjo na flet ose për një mos seriozitet, ose thjesht se këta persona që nuk janë këtu, nuk kanë çfarë të thonë. Pra, e kanë pranuar buxhetin si të tillë, i kanë të ndara paratë për resorët e tyre dhe tash nuk dinë se si t'i arsyetojnë ato, apo nuk dinë se çfarë ka në të, që është e çuditshme për një qeveri të mos dijë t'i arsyetojë shpenzimet që do t'i bëjë të parasë publike.

Çështja tjetër, që u dëgjua këtu, para se të hyj te fjala e ministrit, mendoj që nga persona që i thonë lavde buxhetit, që folën edhe në emër të grupit parlamentar, po edhe në emër të Komisionit, e dëgjova një fjalë që unë nuk e kuptoj. Pra, do t'i isha lutur apologjetët e buxhetit që të na shpjegojnë çka është ky lavdi i përgatitjes mirë teknike të buxhetit, se s'po kuptoj çka është ajo “përgatitje e mirë e buxhetit”. A është për shkak se vijat janë në vend, apo për shkak se kanë arritur saktësisht për t'i mbledhur numrat, gjë që natyrisht, ne e dimë që e bën një program kompjuterik i quajtur EXEL, pra s'ka nevojë për t'i thurë lavdi kujtdo? Apo, ndoshta edhe diçka tjetër, që unë vërtet s'po e kuptoj, por do të ishte mirë të na shpjegohet çka është “përgatitja e mirë teknike e buxhetit”, që ta dimë edhe ne në të ardhmen, ta çmojmë këtë punë të madhe të Qeverisë, që e ka bërë.

Është natyrisht që buxheti si tërësi e veçanërisht tabela 1, po edhe pjesa tekstuale paraqesin shumë probleme, që barten nga viti në vit, sa herë që kjo qeveri prezanton buxhet para Kuvendit të Republikës së Kosovës, sepse është avazi i vjetër. Pra, është mënyra e njëjtë e të buxhetuarit, asgjë nuk ndryshon, pavarësisht zhvillimeve ekonomike, që ndodhin në Kosovë dhe pavarësisht zhvillimeve ekonomike, që ndodhin gjithandej nëpër Evropë dhe nëpër glob, Qeveria jonë buxheton në mënyrën e njëjtë.

Pra, nuk po them me shuma të njëjta, po them në mënyrën e njëjtë, me logjikën e njëjtë të të buxhetuarit, gjë që po e dëmton vazhdimisht edhe potencialin zhvillimor të Kosovës, sepse po kemi buxhete të cilat aspak nuk janë zhvillimore, por janë buxhete, si të them para-apokaliptike.

Pra e kemi dëgjuar shpeshherë edhe ministrin e Financave, por edhe kryeministrin dhe ministrin e mëhershëm të Financave, kur i kemi diskutuar buxhetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, se vazhdimisht këta e kanë çmuar faktin se si ky buxhet do ta shpëtojë vendin nga kolapsi financiar. Pra, po e mbrojmë kolapsin financiar dhe në këtë mënyrë, kjo vetvetiu është zhvillim.

Pra, në njëfarë mënyre përparimi, progresi, prosperiteti po zëvendësohet me shpëtimin, ose shpëtimi po na shitet si progres. Pra, meqenëse nuk po kolapsojmë fare si shtet, atëherë i kemi punët mirë ekonomisht.

Përparimi e progresi janë dy gjëra të ndryshme, krahasuar me shpëtimin nga humnera. Dhe, këtu shpëtimi nga humnera po na servohet si progres, pra si përparim, si ecje përpara.

Edhe ministri e tha që gjatë vitit 2014 rritja ekonomike do të jetë 4,1%, pra ky është projeksion i Qeverisë. Po, natyrisht se ne e dimë dhe ju kisha ftuar edhe njëherë, që të mos e marrim këtë shifër shumë seriozisht, sepse e kemi parë edhe në të kaluarën, që projeksionet e Qeverisë janë diametralisht të kundërta me zhvillimet në ekonominë reale. Pra, disa herë Qeveria në fillim të vitit ka projektuar rritje prej 5% të ekonomisë dhe pastaj kemi përfunduar në 3,1 apo 2,7%, varësisht se kush e ka vlerësuar në fund, FMN-ja apo Banka Botërore apo vetë Qeveria e Kosovës.

Pra, edhe kjo rritje ekonomike, unë do të kisha shpresuar të jetë ashtu, por duke pasur parasysh historikun, natyrisht se kam shumë pak besim se kjo do të ndodhë.

Dhe, në këtë drejtim pastaj këto shifra të projektuara për vitin 2014, po ashtu paraqiten si problematike, po flas për tabelën, ose pjesën e tabelës që i rendit të hyrat në buxhetin e vitit 2014. Pra, këtu e shohim një rritje veçanërisht të madhe të të hyrave vendore prej 301 milionë sa janë projektuar të jenë në vitin 2013, kemi rritje në 367,3 milionë për vitin 2013. Dhe, kjo rritje është një rritje goxha e madhe e të hyrave vendore, gjë që logjikisht do të kishte nënkuptuar se ka, do të ketë, ose projektohet të ketë rritje enorme të edhe aktivitetit të brendshëm ekonomik, i cili do të prodhonte pastaj tatime të brendshme, ose edhe të rritjes së kapaciteteve, efikasitetit të Administratës Tatimore në mbledhjen e këtyre tatimeve. Pra, ose rritje e bazës, ose rritje e mbledhjes së tatimeve.

Mirëpo, këtë ministri nuk e përmendi, që këtu në fakt, në pjesë e konsiderueshme e kësaj rritjeje është falë një marrëveshjeje, siç e ka shpjeguar dje në një takim ministri, të Marrëveshjes ndërmjet ATK-së dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit, prej të cilit do t'i marrin një pjesë të parave të privatizimit, për ta futur dhe shndërruar në para publike, në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Pra, nuk është as efikasiteti i ATK-së e as rritje e zhvillimit ekonomik ose aktivitetit ekonomik brenda vendit, por thjeshtë do të jetë një marrëveshje për disa para të privatizimit, që do të futen në buxhetin e Republikës së Kosovës, që i garantohet me Ligjin për AKP-në, ose me ndryshimin e Ligjit për AKP-në.

Natyrisht, që kjo shifër nuk është thënë publikisht, me sa kam parë unë, nuk është thënë publikisht se sa do të jetë ajo shifër, pra sa do të jetë kjo shifra e rritjes, ose sa për qind të kësaj rritjeje do të jenë, i atribuohen kësaj marrëveshjeje, sa % të tjera do të jenë rritje e efikasitetit të Administratës Tatimore, e kështu me radhë.

Mirëpo, kur e shohim projeksionin pastaj për vitin 2015, vërtet dekurajohemi me këtë entuziazëm të Qeverisë, sepse në vitin 2015 pastaj rritja ose dallimi ndërmjet 2014-ës dhe 2015-ës është vetëm 2,7 milionë. Pra, kthehemi në avazin e vjetër të rritjes minimale të përqindjes apo shumës, që do të mbledhen si tatim i brendshëm.

Ndërkohë që e kemi po ashtu një, edhe pse ka rritje të hyrave doganore, është një dhënie si përqindje, krahasuar me vitet tjera. Pra, për vitin 2014 projektohen që të hyrat doganore të jenë si përqindje më pak se sa në vitin 2013. Dhe, këtu e kemi, siç e shohim të gjithë, e kemi një ndryshim të raportit ndërmjet të hyrave vendore dhe të hyrave doganore, që automatikisht, pra siç e tha edhe ministri, kjo e dërgon një sinjal se do të kemi ndryshim të raportit tregtar të Kosovës dhe natyrisht që kjo do të ishte diçka që do të duhej ta çmonim.

Mirëpo, a është vërtetë kështu? Unë mendoj që jo. Sepse kjo rënie e përqindjes krahasuar me vitin 2013, për vitin 2014 të të hyrat doganore, në fakt nuk i atribuohet rënies së importit, por më shumë i atribuohet Marrëveshjes për Tregti të Lirë, që e ka nënshkruar Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës me Turqinë, e cila siç është raportuar në media, do ta dëmtojë buxhetin e Kosovës për diku 20 milionë euro në vit, duke pasur parasysh që importi nga Turqia zakonisht është 200 milionë euro. Pra, ky 10%-shi, siç e kanë kalkuluar ata të taksës doganore, që do të jetë 20 milionë euro, e kjo natyrisht që do të jetë edhe më shumë, sepse nuk është vetëm taksa doganore që e humbim këtu dhe, natyrisht që importi shkon duke u rritur, pra nuk është se do t'i importojmë vetëm 200 milionë uro në vitin e ardhshëm.

Dhe, në këtë lojë numrash, konsideroj që këtu ministri është bërë jashtëzakonisht i pasinqertë edhe me qytetarët e Kosovës edhe me Kuvendin e Republikës së Kosovës, pra deputetët, sepse po do ta inskenojë një situatë të zhvillimit ekonomik, ku realisht nuk do të kemi zhvillim ekonomik fare, ose do të kemi rritje ekonomike duke iu falënderuar edhe investimeve publike e kështu me radhë, siç i kemi pasur deri tash, ndoshta 2%, ndoshta 3%, ndoshta 4, por nuk do të kemi rritje të aktivitetit ekonomik prodhues vendor, i cili

vërtet është gjëja që do ta shpëtonte ekonominë e Kosovës nga ky kolaps, në të cilin është futur.

Unë e di që do ta kem kohën e kufizuar, por dua ta ngre vetëm edhe një çështje tjetër për sa i përket kësaj tabelës së parë, që mendoj që është e rëndësishme, sepse e përmendi ministri disa herë, që është buxheti i parë në Kosovë, që po draftohet duke, ose në përshtatje, në përputhje me rregullën fiskale, që nuk lejon më shumë se 2% të bruto produktit vendor, si deficit buxhetor.

Mirëpo, ministri nuk e përmendi edhe një numër tjetër, që është nën të e që është rritja e borxhit si përqindje e bruto prodhimit vendor. Pra, një numër pas kësaj, pas minus 2%-shit, që është sipas rregullës fiskale, e kemi borxhin publik që projektohet për vitin 2014, të jetë 12% e bruto prodhimit vendor, krahasuar me 9,6%, sa e kemi pasur në vitin 2013.

Pra, çfarë po bëjmë ne është, po e zëvendësojmë deficitin buxhetor me rritje të borxhit publik, asgjë tjetër. Nuk është se po rriten të hyrat, nuk është se kemi ndonjë ndryshim në strukturën e buxhetit, por thjesht po e zëvendësojmë njëloj borxhi me njëloj borxhi tjetër. Pra, nuk po i marrim në bankë, por po i marrim te fajdexhinjtë, po nuk është kjo kurrfarë ndryshimi, për sa i përket qëndrueshmërisë ekonomike të Kosovës.

Mirëpo, gjithsesi ky buxhet, natyrisht se do ta shpëtojë vendin nga kolapsi, gjë që po duket se është qëllim primar i kësaj qeverie vazhdimisht në mënyrën se si e shpenzon, ose si e projektton shpenzimin e buxhetit ose të parasë publike të Kosovës.

Po ashtu, këtu u përmend disa herë që në vitin 2014 do t'i kemi tantimat 22 milionë, që në tabelën numër 1, thuhet që nuk do të ndryshojnë fare nga viti 2013. Unë nuk po e kuptoj se si ndodh kjo për shembull, si projektton Qeveria që nuk do të ketë rritje të prodhimit të energjisë ta zëmë, ose më falni, prodhimit të thëngjillit, ta zëmë për vitin 2014, kur e dimë që konsumi i energjisë do të rritet, domosdoshmërisht rritet për çdo vit. Pra, nëse rritet konsumi i energjisë, atëherë ne projektojmë që nuk do ta rrisim fare gjenerimin e energjisë elektrike, sepse nuk do t'i rrisim tantimat, nuk do të ketë ndikim në rritje të tantimave, pra do të shfrytëzojmë të njëjtën sasi të thëngjillit ta zëmë, mos të hyjmë te të tjerat, te feronikeli e kështu me radhë. Pra, ose nuk do t'i mbledhim të gjitha tantimat për resurset tona të shfrytëzuara, ose thjesht ne projektojmë që ta mbajmë tërë sektorin e xehetarisë në Kosovë në nivel të njëjtë të nxjerrjes, pra që të mos kemi fare zhvillim në këtë drejtim.

Dhe, po ashtu te taksa koncesionare, këtu mendoj që shifrat që janë të përmendura këtu duken sikur të jenë të hedhura ashtu kuturu, për vitet e ardhshme... se kemi 6,3 milionë në 2013-ën, 5,5 pastaj në 2014-ën, një rënie në taksën konsesionare...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Edhe dy minuta, ju lutem, zotit Ymeri.



VISAR YMERI: ...dhe pastaj e kemi një rritje në 10 milionë në vitin 2015 dhe 12 milionë në vitin 2016, gjë që shihet që nuk ka fare projektim, pra thuhet se është projektim, por nuk ka fare bazim në realitet apo në ndonjë trend, që do ta përcillte të njëjtin aktivitet.

Dhe, për fund, për sa i përket tabelës 1, është një gjë e çuditshme këtu. U përmend edhe nga deputeti Osmani, që Posta dhe Telekom i Kosovës, pra privatizimi i saj nuk projektohet për vitin 2014, sepse supozohet që do t'i marrim paratë këtë vit. Kështu planifikon Qeveria do ta fusin atë në bilancin bankar, por pastaj te financimi i njëhershëm e kemi një 20 milionësh, i cili nuk shpjegohet se çfarë është, pra ku do t'i marrim ato 20 milionë, çka do të shesin tjetër, çka ka mbetur pa shitur dhe çka është ajo që planifikoni ta shitni për 20 milionë në vitin e ardhshëm, nëse kjo është e hyrë nga privatizimi?

Përfundimisht, natyrisht që Lëvizja “Vetëvendosje” nuk do ta votojë këtë buxhet, për shkak të këtyre që i përmenda unë dhe për shkak të shumë vërejtjeve që do t'i kemi deputetët e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Ky është edhe një herë, pra përveçse është buxhet që e pamundëson, jo që nuk e ndihmon, po e pamundëson zhvillimin ekonomik të Kosovës, përveç që është buxhet që bazohet vetëm në ata sektorë të cilët po prodhojnë në njëfarë mënyre alokim të resurseve, parave tona në projekte që kanë zero përfitim ekonomik, është edhe buxhet i cili e vazhdon këtë ndarje të parasë publike nëpërmjet Fondit të veriut, pra i cili po duket se do të jetë pjesë e secilit buxhet në Kosovë, derisa të ndryshojë kjo qeveri.

Dhe, këtu as nuk tregohet se si do të reflektojë ky fond, ose si ka reflektuar deri tash në buxhetin e gjithëmbarshtëm, në të hyrat e gjithëmbarshtme e as sa do të jetë ky fond. Pra, kërkohet nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës ta votojmë një fond, i cili do të kontrollohet nga Vulini, madje- madje as pa u treguar deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, a do të jetë 10 milionë, 15, 20, 50, 100, pra sa do të jetë buxheti i Asociacionit, të cilin kërkohet nga ju që ta miratoni?

Ne do ta votojmë kundër këtë buxhet dhe mendojmë që edhe në amendamentimin e tij, përveç nëse ndryshohet tërësisht, ky buxhet prapë do të mbetet në nivelin e njëjtë, pra një buxhet...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka zoti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Zoti ministër i Financave,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ajo që shihet është se politikat sektoriale të ndjekura me vite e kanë sjell Kosovën në një gjendje në të cilën praktikisht është e vërtetë që duhet gjetur zgjidhje për të mbijetuar. Kjo është e vërtetë. Domethënë, nuk ka diçka që nuk bën të thuhet këtu.

Grupi Parlamentar i Aleancës e ka treguar se do ta votojë kundër buxhetin dhe unë do të provoj të ju tregoj pse, cilat janë arsyet. Sigurisht që edhe kolegët tjerë deputetë nga grupi do të flasin dhe do të lëshohen në aspekte sektoriale.

Fillimisht, duhet të themi se edhe ajo përgatitja teknike, për të cilën u fol dhe ndoshta kjo ka të bëjë ekskluzivisht me ministrin e Financave, jo aspektet tjera, tabelat nuk përputhen. Shifrat në tabela, zoti ministër, nuk përputhen në shumë vende dhe, të paktën ato shifra, çfarëdo që janë, sido që i keni paraparë ju, me politikat tuaja si Qeveri, të paktën shifrat duhet të përputhen në tabela.

Mendoj se deputetët që e kanë lexuar buxhetin e shohin se nuk përputhen as shifrat në tabela, domethënë është një problem ky në vetvete.

Një pyetje tjetër për ne që është tepër interesante është si mund të parashihet, ose si mund të proklamohet një rritje e madhe, kur e dimë se ju vetë e parashihni një rritje të GDP-së ose rritje ekonomike prej 4,1%, ndërsa mesatarja e rritjes së vendeve në zhvillim është 5,1%. Ata që i ndjekin këto çështje e dinë që është 5,1%, do të thotë kjo rritje te ne nuk është për mburrje, për shkak se është nën mesataren e rritjes së vendeve në zhvillim, nuk po flasim për ato që kanë rritje më të shpejtë.

Shihet që raporti i rritjes së investimeve, në krahasim me rritjen e GDP-së po bie, domethënë këto shifra po bien, po flasim në aspekte relative, edhe pse mund të rriten investimet eventualisht, edhe pse këtë vit nuk janë rritur, prapë ky relacion, ky raport ndërmjet rritjes së GDP-së dhe shpenzimeve po bie.

E kemi edhe një aspekt tjetër për të cilin me siguri se duhen shpjegime, për shembull, të hyrat rriten për 2,5%, ndërsa inflacioni parashihet 2,8%, që do të thotë vlera reale e parasë në buxhet bie për 0,3%, do të thotë nuk kemi rritje. Domethënë, vlera e buxhetit nëse vetëm këtë shifër e shohim, është për 0,3% më e vogël si vlerë. Ai mund të rritet vlera monetare, po ju vetë e keni paraparë, vetë e keni paraparë inflacionin e ne e dimë, e kemi të qartë që Qeveria ka pak leva në dorë për ta kontrolluar inflacionin, për shkak se nuk kemi monedhë tonën, e tjera, e tjera, mirëpo, prapëseprapë shifrat po e tregojnë këtë.

Çështje tjetër është se është paraparë një shumë e rritjes së pagave për shërbyesit civilë dhe për ne është krejt në rregull. Ne mendojmë se duhet të rriten pagat, duhet të rriten përtej inflacionit, njerëzit duhet të paguhet më mirë, mirëpo është paraparë po ashtu edhe shtimi i numrit të punësuarve me 1 399 persona, që do të thotë ajo rritje e shumës totale për paga në buxhet nuk reflekton drejtpërdrejt rritje të pagave për ata që janë të punësuar aktualisht, për shkak se ky 1400-sh ose 1 399 persona të rinj do ta marrin një pjesë të asaj shume që është ndarë për paga.

Çështje tjera, të cilat janë interesante për t'i parë në buxhet dhe po provoj të jem i shkurtër janë se tek tabela 3.2 për shembull, kemi 7 milionë euro shpenzime kapitale të paparashikuara, do të thotë të paspecifikuara. Kjo bie ndesh me Ligjin për menaxhimin e financave publike. Ne mund të kemi fonde ose mund të kemi vija buxhetore për shpenzime të paparashikuara, ne e kemi të qartë, por te shpenzimet kapitale duhet të dihet

cilat janë ato. Nuk mund të ketë shpenzim kapital të paparashikuar. Kjo është një problem i madh. Ose te AKP, për shembull, e kemi një 7 milionë uro ekstra, të cilin nuk e dimë se çka është.

Këto dhe arsyet tjera e kanë bërë Grupin Parlamentar të Aleancës, që të jetë kundër këtij projektbuxhet, mirëpo unë, tani jo në emër të grupit parlamentar, por si deputet, do ta ngre edhe një çështje tepër interesante për Kuvendin e Kosovës, për Qeverinë e Kosovës dhe për popullin e Kosovës, në fund të fundit.

Ne e dimë cili është procesi i buxhetimit në Kosovë. Diku në shkurt ose në mars organizatat buxhetore, që janë komunat dhe ministritë i dërgojnë kërkesat dhe Ministria e Financave i kërkon ato. Kushdo që ka qenë ndonjëherë në ekzekutiv e di, qoftë në nivel lokal, qoftë në nivel qendror, lëshohen qarkoret, debatohet, llobohet, që është krejt në rregull, se në gjithë botën ndodh kështu, dikush e kërkon një projekt, dikush një projekt tjetër, dhe ky proces zgjat diku deri në tetor.

Tani duke pasur parasysh këtë proces të buxhetimit, ne vetëm mund të themi se një problem i madh ekziston në paraqitje të prioritetëve, ose me vendosje të prioritetëve këtu.

Ju e dini që diku herët në pranverë të këtij viti është shembur ura në Rakovinë. Është shembur ura në një rrugë nacionale, që lidh diku 200 mijë banorë me Prishtinën drejtpërdrejt dhe kurrkund nuk figuron riparimi i kësaj rruge në buxhetin e vitit 2014, po lëre që nuk figuron 2014, por edhe nëse futet për buxhetin 2015 do të thotë që ajo anë e Kosovës, një anë shumë e madhe, shumë e rëndësishme qoftë sa u përket njerëzve që jetojnë, qoftë sa u përket të hyrave që i sjell Kosovës, mbetet e izoluar për shkak se sidomos dimrit, nuk mbetet rrugë tjetër për të qarkulluar mallrat.

Ju e dini që në atë rrugë e në momentin që fillon ngrica nuk mund të qarkullojnë mallrat edhe njerëzit me vetura të vogla do të kenë problem të qarkullojnë.

Dhe, pyetja ime është kjo, zoti ministër për ju drejtpërdrejt: A ju ka kërkuar ndokush, a ka kërkuar prej jush ndonjë organizatë buxhetore qendrore që ajo urë të riparohet?

Unë e di që ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nuk i bie rruga kurrë andej, pra nuk e sheh atë urë që është rrëzuar se nuk i bie rruga çka ka të bëjë ky?!

Po ka disa njerëz në Qeverinë tuaj që po qesin lot krokodili për Gjakovën, e kanë qenë aty, dy zëvendëskryeministra i ke, po më intereson shumë ta di a kanë kërkuar të hyjë në buxhet riparimi i urës së Rakovinës, për shkak se është problem tepër i madh për ata njerëz.

Shihni, është hera e tretë që unë po e ngre këtë çështje. Janë bërë 12 vjet në institucione të Kosovës, se tash po flas si deputet, nuk kam kërkuar kështu gjëra drejtpërdrejt për shkak se e di se ne jemi Kuvendi i gjithë Kosovës, mirëpo po ju them është njëfarë turpi. Unë po ju them kështu, po të ishte shembur një urë e vogël kah u bie rruga juve, t'u shkurttohej për 200 metra, nuk e kishit lënë pa e futur në buxhet.

E shembet një urë që e lidh qytetin e tretë më të madhin në Kosovë, i cili s'ka kah të vijë më në Prishtinë dhe kurrkush nuk merret me këtë temë. A po ju duket që është në rregull?

Seriozisht, pyetja ime është shumë serioze, a ka kërkuar dikush prej jush, qoftë dikush prej zëvendëskryeministrave, qoftë ministri i Infrastrukturës që kjo urë të rregullohet? Unë kam kërkuar tri herë në Kuvendin e Kosovës.

Çështje tjetër e cila duhet të përmendet është rruga për Pejë. E dimë që e keni futur në buxhet vazhdimin e rrugës, mirëpo mendoj se Kuvendi i Kosovës duhet të mendojë dhe Qeveria e Kosovës ka pasur mundësi ta fusë të gjithë rrugën Prishtinë-Pejë, atë vazhdim që shkon prej Gjurgjicës. Nuk është ndonjë shpjegim i madh, jeni duke ditur për çka jemi kah flasim edhe rruga deri në Pejë duhet të kryhet. Nuk ka nevojë të mbetet copa – copa dhe të na zgjat 10 vjet të përfundojë një rrugë e cila prapë e lidh njërën prej qyteteve më të mëdha të Kosovës me Prishtinën dhe jo vetëm atë qytet, e lidh një zonë të tërë.

Këto ishin ato që i thashë si deputet në fund, shpresoj që zoti ministër i Financave, sinqerisht do të më tregoj a ka kërkuar ndokush prej jush, se këtë e di që nuk e bëni ju, të rregullohet ura në Rakovinë? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hadërgjonaj e ka fjalën për replikë me zotin Ymeri, se s'ia dhashë fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

E ndjeva të nevojshme të bëj një ndërhyrje të vogël këtu. Unë përpiqem në emër të Komisionit për Buxhet e Financa t'i paraqes të gjitha ato të cilat ngritën në Komisionin për Buxhet, edhe të arriturat, por edhe vërejtjet të cilat bëhen në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Dua të sqaroj një çështje se kur kam theksuar që projektligji është teknikisht i përgatitur mirë dhe brenda afateve dhe kornizës ligjore, atëherë dua ta sqaroj këtë që ne në Komision e shqyrtojmë edhe këtë çështje, sepse projektligji përgatitet në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësisë dhe një theksim i tillë do të thotë se janë respektuar nenet 20 dhe 21 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, domethënë përmbahen të gjitha të dhënat që i parasheh neni 21 dhe është përgatitur në afatin kohor sipas procedurave të parapara me nenin 20.

Të gjitha diskutimet të cilat ne si deputetë të pozitës i bëjmë, dikujt i duken që janë të njëjta. Të gjitha të arriturat e Qeverisë kur ne i theksojmë, dikujt i duken se janë të njëjta, mirëpo unë dua të them që në vazhdimësi derisa të jemi në pushtet ne do t'i theksojmë, do t'i përsërisim në vazhdimësi të arriturat të cilat i ka bërë Qeveria gjatë kësaj periudhe kohore, pavarësisht nëse dikujt i vjen mirë apo i vjen keq.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, e ka fjalën kryetarja e Grupit, zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për ministrat dhe deputetët,

Duke marrë parasysh se sot diskutohet për Projektbuxhetin e vitit 2014 dhe është projekt apo më mirë të themi projektligji më i rëndësishëm i cili duhet të kalojë nëpër Kuvend të Kosovës, mund të themi se Projektbuxheti i vitit 2014 është projektbuxhet i qytetarëve të Kosovës, të cilët participojnë me taksat e tyre për mbushjen e këtij buxheti dhe njëkohësisht Qeveria si ekzekutiv është e obliguar që në mënyrë proporcionale në bazë të projekteve t'iu kthejë apo t'iu realizojë një jetë më të mirë ekonomike dhe sociale qytetarëve të Kosovës.

Në rast se shohim projektbuxhetin nuk mund të themi se është projektbuxhet i Qeverisë Thaçi, por duhet të cekim të gjithë si deputetë të këtij Kuvendi të Kosovës, është projektbuxhet i qytetarëve dhe ky projektbuxhet realizohet po nga taksat e qytetarëve që i shohim nëpërmjet të hyrave në dogana dhe nëpërmjet të hyrave në Administratën Tatimore të Kosovës.

Në rast se i shohim të hyrat nga Dogana për vitin 2014, siç është projektuar, pritet një rritje e mirë, por prapëseprapë edhe unë si deputetë, si qytetare dhe si grup parlamentar nuk mund të jemi të kënaqur për arsye se të gjithë ekonomistët janë në njohuri se një shtet i cili e mbledh projektbuxhetin nga Doganat nuk është një shtet shumë i fortë dhe këtë e dimë të gjithë.

Mirëpo kjo është fatkeqësia jonë, ndërsa nga Administrata Tatimore, fatbardhësisht ministri i Financave është këtu, duhet të kërkohet që të kryejë një punë shumë më efikase për arsye se ne jemi në procesin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ku pritet që Doganat të bien dhe çka do të ndodhë pastaj me shtetin e Kosovës dhe çka do të ndodhë me projektbuxhetin, i cili duhet të realizohet për çdo vit?

Këtu thuhet se në aspektin makroekonomik kemi një pasqyrë ku paraqet bruto produktin vendor, po prapëseprapë nuk duhet të jemi të kënaqur. Ju them shumë sinjerisht, pavarësisht pozitë-opozitë se ky buxhet, e thashë edhe në fillim, është buxhet i qytetarëve të Kosovës ku rritja reale e bruto produktit vendor shihet që është nga konsumi, investimet në gjendje shumë të ulët nga eksporti, importi në rritje, mirëpo shpresojmë se politikat e ardhshme ekonomike të cilat duhet t'i ndërmarrë Qeveria, duhet të shkojnë në zhvillimin ekonomik të vendit, për arsye se zhvillimi ekonomik i vendit nuk mund të realizohet nga rritja e shpenzimeve kapitale, ku dihet se vetëm shtetet e varfra ndërtojnë nga buxheti, ndërsa shtetet e pasura ndërtojnë nga investimet të cilat duhet të hyjnë në atë vend.

Dhe, shpresoj dhe besoj shumë që Qeveria në të ardhmen do të marrë në dorë hartimin e politikave ku këtu janë paraqitur në tabelë të hyrat e shpenzimet e Qeverisë së përgjithshme si tabelë rrjedhëse që në këto politika të caktojë cilat ligje u mundësojnë ardhjen e investimeve më të lehta, cilat do të jenë ligjet për taksat për investitorë dhe cilat do të jenë ndoshta lehtësirat më të lehta nëpërmjet ligjeve, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, e cila atakon shumë investitorë me lejet e tyre.

Nëse e shohim çështjen e pagave dhe mëditjeve mund të themi se këtu është një rritje e mirë, por në esencë Qeveria duhet të përballet me reformimin e administratës.

Dhe në çështjen e reformimit të administratës, Qeveria për këtë arsye me sa më duket vetë në Ministrinë e Financave është ndarë një buxhet më i madh kësaj radhe dhe në tabelën në të cilën shihet buxheti është ndarë edhe për Zyrën e Kryeministrit, ka një rritje edhe te Zyra e Presidentes.

Njëkohësisht mund të themi se ne duhet të kemi rritje në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, sepse e ardhmja e këtij vendi janë fëmijët të cilët duhet të shkollohen, studentët të cilët duhet të marrin dije dhe jo vetëm të kemi kuantitet dhe jo kualitet dhe shpresoj që ministri i Arsimit që është këtu do të bëjë një reformë të madhe, që nga niveli i ulët deri në nivelin superior, për arsye se Kosovës i duhen kuadro më shumë se kurdoherë.

Në përgjithësi mund të themi se i gjithë projektbuxheti është ky që është, nuk është një buxhet, unë thashë në fillim një buxhet me të cilin duhet të jemi të kënaqur, mirëpo duke marrë parasysh se gjithë qytetarët presin nga ne që të ketë një jetë më të mirë në zhvillimin e tyre social - ekonomik, shpresoj që në të ardhmen gjatë projektimit të buxhetit mos të vihet syri vetëm të hyrat nga Dogana, mirëpo të kemi kujdes edhe te Administrata Tatimore, se ka një hendek të madh të mbledhjes së tatimeve dhe jo të atakohen vetëm bizneset e vogla.

Bizneset e mëdha, ministër, duhet të shihen sa janë duke paguar për arkën e shtetit dhe të kemi kujdes me çështjen e ardhjes së investimeve.

Koalicioni për Kosovë të Re do ta përkrahë projektbuxhetin, thashë edhe në fillim se ky është projektbuxhet i qytetarëve dhe jo i kryeministrit as i partnerit të koalicionit. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Në emër të SLS, zonja Bontiq e ka kërkuar fjalën.

**JELENA BONTIĆ:** Hvala predsedavajući!

Poštovani kolege i kolegice,

Uvaženi članovi Vlade,

Razmatrajući strukturu budžeta koja se predviđa Nacrtom zakona budžeta za 2014. godinu vidimo iznos od 1 458 000 000 evra.

Poslanička grupa Samostalna liberalna stranka ocenila je da je ovaj iznos nedovoljan za razvoj Kosova. Ovo iz razloga da je potrebno investirati u segment proizvodnje, mnogo više kako bi ekonomski efekat bio bolji.

S toga smatramo da ovaj nedostatak u iznosu budžeta nadomestimo dovođenjem stranih investitora koji bi svojim kapitalom potpomogli razvoj privrede.

Zato, kao Poslanička grupa upućujemo zahtev Vladi da sprovede sve zakone iz ove oblasti kako bi nadomestili nedostatak iznosa. Podržavamo takođe davanje iz budžeta predviđena za razvoj infrastrukture. Takođe dajemo podršku za sredstva koja su izdvojena za socijalna davanja jer je to u ovom trenutku razvoja neminovno.

Pozitivna strana je da je budžet usklađen sa MMF. Takođe pozitivno je i to da su prihodi od carina u stalnom porastu. Za prošlu godinu porast od 2% ukazuje na tu činjenicu.

Poslanička grupa Samostalna liberalna stranka veruje da će se ovim predlogom budžeta uspešno realizovati finansijski zahtevi za sve budžetske organizacije ali istovremeno da se očuva i budžetska stabilnost kao preduslov za održivi ekonomski rast i Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke glasaće za ovaj nacrt budžeta. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar 6+, zonja Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem predsedavajući!

Poštovani ministri,

Poštovane kolege,

Budžetska planiranja Nacrta budžeta za 2014. godinu od iznosa od 1 405 000 000 evra pripremljena su potpuno u skladu sa odredbama MMF. Očekivanja koje se odnose na ovaj nacrt budžeta, vezani su za opšti budžetski prihod na nivou od milijardu evra odnosno povećanju od 2,5% u odnosu na prošlu godinu.

Što se tiče totalnog uvoza budžet za 2014. godine očekuje se rast od 7% dok će samo izvoz robe imati rast od 10%.

Ovaj budžet reflektira obavezu Vlade za povećanje plate svih civilnih zvaničnika, nastaviće se investiranje na putnu infrastrukturu uključujući i autoput u pravcu Makedonije kao i izgradnje puteva za Mitrovicu i Peć.

Ovaj predlog budžeta predviđa finansiranje projekata prema prioritetima opština i u Nacrtu su uključeni i takvi projekti u opštinama gde žive Bošnjaci i druge nacionalne zajednice i do perioda finalizovanja budžeta za 2014. godinu planiramo mogućnost u saradnju sa ministrom i komisijom za budžet da ubacimo po neki projekat i infrastrukturu u sredinama u kojima mi živimo.

Parlamentarna Grupa 6+ podržaće ovaj nacrt zakona i svoj dalji doprinos daće kroz rad u parlamentarnoj komisiji.

KRYESUESI: Faleminderit! “Zajednička Budućnost”, zoti Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala gospodine predsedavajući!

Poštovani ministri,

Poštovane kolege,

Na osnovu dobijenog budžetskog cirkulara od 2014. godine izdatog od strane Ministarstva financija u kome smo dobili iznos budžeta za 2014. godinu kao iznose za opšti grant, specifični grant za obrazovanje, specifični grant za primarno zdravstvo, grant za sektorijsko zdravstvo, kao rezultat proširenih nadležnosti opštine prema rezidencijalnih usluga Ministarstva rada socijalne zaštite u opštini i projekciju sopstvenih prihoda vidi se da je ukupan budžet za opštinu Gračanica za 2013. godinu 5 miliona 557 376 evra od čega 4 miliona 101 699 evra vladini grantovi a 1 455 067 evra su sopstveni prihodi.

U poređenju sa budžetom iz 2013. godine, vidi se da budžet za 2014. godinu manji za 151 hiljadu i 91 evra ili za 2,65 procenata.

Ovaj iznos bi bio još veći da vam nije dodeljen budžet za prenos rezidencijalnih usluga od strane Ministarstva rada i socijalne zaštite ili u brojkama 261 091 evra ili 4,58%. U poređenju sa vladinim grantovima to smanjenje je mnogo drastičnije, iznosi 456 768 evra ili 10,03%, dok su sopstveni prihodi povećani za 305 677 evra ili za 26,58 procenata pa smatramo da su planirani sopstveni prihodi precenjeni i da su teško ostvarljivi za 2014. godinu.

Imajući u vidu trenutni trend prikupljanja sopstvenih prihoda, naime, opština Gračanica je Ministarstvu finansija dostavila svoj predlog socijalnih prihoda od 905 000 evra koji Ministarstvo finansija nije usvojila iz nama nepoznatih razloga i samo dala projekciju sopstvenih prihoda za 2014. godinu.

Po formuli za dobijanja grantova 89% budžeta se dobija na osnovu broja stanovnika kako popis stanovnika koji je bio sproveden 2011. godine nije u potpunosti uspeo u opštini Gračanica to je rezultiralo i smanjenjem broja stanovnika sa 18.642 na 10 675, a samim tim i smanjenje budžeta.

Za predstojeće lokalne izbore koje su bile zakazane za 3. novembra u opštini Gračanica u biračke spiskove je upisano 19 077 birača sa pravom glasa pa tako dolazimo do jednog velikog paradoksa da u opštini ima više glasača nego stanovnika, a znamo da pravo glasanja imaju samo punoletne osobe.

Najdrastičnije smanjenje budžeta se oslikava u sekundarnom zdravstvu obrazovanju i primarnom zdravstvu. U sekundarnom zdravstvu budžet je smanjen za 288 970 evra ili 26,5% sa odobrenim budžetom a imajući u vidu trenutni broj zaposlenih kao i trend povećanja radnika imaće sredstvo samo za ekonomske kategorije plata i dnevnica što bi u mnogome ugrozilo pružanje kvaliteta zdravstvenih usluga stanovništvu.

U primarnom zdravstvu budžet je smanjen za 88 294 evra ili za 27,21%. U obrazovanju budžet je smanjen za 189 504 evra ili za 12,14%.

Uzimajući sve gore navedena smanjenja koje su predviđena budžetom opštine Gračanica biće umanjen za 966 768 evra ili 16,93% u poređenju sa budžetom iz 2013. godine.



Total opštinskog finansiranja za 2014. godine iz budžetskog cirkulara 2014. primenjivaće se u nekim opštinama Priština, Uroševac i Gnjilane koji su takođe došlo do smanjenja broja stanovnika na osnovu popisa, Priština sa 388 561 stanovnika na 196 697 ili za 50,62% manje, Uroševac sa 111 000 na 108 000 ili 2,16% manje, Gnjilane sa 100 348 stanovnika na 90.188 ili za 11,4% manje došlo je do povećanja budžeta. Priština sa 63 371 na 63 443 ili za 0,11% više. Uroševac za 12,08 procenata više, Gnjilane za 9,26% procenata više, pa se s pravom pitamo kako je moguće da se kod nekih opština do kojih je došlo do smanjenja broja stanovnika po popisa došlo je do smanjenja budžeta Gračanica, Parteš, Klokot, Zvečan, Zubin Potok, Štrpce, Leposavić.

Po formuli za dodelu budžeta u nekim opštinama gde je došlo do smanjenja broja stanovnika po popisu a došlo je do povećanja budžeta, kao što je Priština, Uroševac i Gnjilane, da li je u pitanju neka čarobna formula koja ima dva aršina da se u zavisnosti od opština za koje se dodeljuje grant po potrebi smanjuje ili povećava ili je u pitanju nešto drugo.

Zato se ovim putem obraćamo Vladi za dodelu opštih grantova da nam ukoliko je to moguće objasni kako se došlo do ovih budžeta za 2014. godinu uzimajući u obzir gore navedene činjenice za pojedine opštine i revidira već dodeljeni grantovi čime bi se ispravila nepravda za one opštine koje su u poređenju sa budžetom iz 2013. godinu dobile manje iznose.

Poslanička grupa Zajednička budućnost podržaće u načelu usvajanje Budžeta za 2014. godinu ali će amandmanima u radu komisija tražiti da sve nepravilnosti isprave. Hvala!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.)*

KRYETARI: Radha është e deputetëve. Fjalën e ka deputeti Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektbuxheti të cilin duhet ta aprovojë sot ky Kuvend është tepër i rëndësishëm për Kosovën që të vazhdojë suksesshëm me financimin publik.

Kuvendi duhet ta aprovojë Projektbuxhetin për faktin se ky projektbuxhet paraqet planin e Qeverisë për financimin e projekteve mbi bazën e prioriteteve dhe në funksion të qëndrueshmërisë së financimit publik, zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale në Kosovë.

Buxheti për vitin e ardhshëm planifikon një rritje ekonomike rreth 4%.

Ky projektbuxhet është hartuar në bashkëpunim me ekspertët e ekonomisë si dhe mbi bazën e rekomandimeve të përfaqësuesve të FMN për një politikë dhe menaxhim të disiplinuar fiskal.

Në këtë kuadër dua të citoj shefin e delegacionit të FMN, Johanes Uajgend i cili ditë më parë ka deklaruar e buxheti i vitit 2014 është i fuqishëm për të përballuar rritjen e pagave dhe investimet kapitale. Sipas tij në dy vjetët e fundit Kosova ka bërë progres të dukshëm në forcimin e menaxhimit mikrofinanciar duke shtuar më tutje se politikat makroekonomike dhe financiare janë në binarë të sigurt.

Në veçanti buxheti i vitit 2014 i sjell në Kuvendin e Kosovës, në fund të tetorit është i qëndrueshëm. Ndër të tjera ky buxhet përfshin një alokim të mjeteve për fillimin e autostradës për Shkup si dhe rritjen e pagave në sektorin publik.

Projektbuxheti për vitin 2014 në dimensionet e të hyrave parashihet të jetë 1 458 000 000 euro. Pra, në dimensionin e të hyrave është bërë një projektbuxhet i kujdesshëm dhe konservativ.

Ky parashikim bazohet në vlerësimet afatmesme të indikatorëve kryesorë makroekonomikë dhe në vlerësimet e rritjes së performansës së institucioneve përgjegjëse për mbledhjen e të hyrave siç janë: Dogana dhe Administrata Tatimore e Kosovës, të cilat i përgëzoj për punën dhe rezultatet e arritura.

Parashikimi i të hyrave të përgjithshme është bërë po ashtu mbi trendin e të dhënave historike nga të cilat janë nxjerr edhe supozimet mbi efektin se kanë financime të projekteve publike në të hyrat buxhetore. Krejt kjo është bërë edhe me sugjerimet respektive të FMN-së.

Mbledhja e të hyrave nga tatimet është paraparë të jetë 1.264.1 milionë euro, në këtë kuadër nga tatimet indirekte kufitare si TVSH, akcizë dhe Doganë, është paraparë që të jetë 934.1 milionë euro, ndërsa nga tatimet e brendshme është paraparë që të mblidhen 367.3 milionë euro.

Edhe pse struktura e të hyrave të përgjithshme vazhdon të mbetet e njëjtë, tatimet direkte dhe indirekte kontribuojnë me mbi 90% të hyrat e përgjithshme.

Të hyrat e përgjithshme buxhetore për vitin 2014 janë parashikuar të rriten në 3%, ndërsa të hyrat e grumbulluara në vend dhe ato në kufi pritet të rriten me një mesatare prej mbi 6%.

Në dimensionin e shpenzimeve buxhetore projektbuxheti në pjesën më të madhe të tij është produkt i projeksioneve dhe politikave të filluara në vitet e mëparshme, respektivisht shpenzimet do të jenë 1 590 000 000 euro.

Shpenzimet publike në Kosovë nga viti në vit janë rritur, sepse janë rritur funksionet shtetërore të Kosovës, përkatësisht nevojat publike të saj.

Vlerësimi dhe ndarja e shpenzimeve buxhetore për vitin 2014 është përpiluar në funksion të qëndrueshmërisë makro-financiare fiskale nëpërmjet aplikimit të rregullës fiskale, e cila limiton deficitin e përgjithshëm buxhetor në kufirin prej 2% të GDP-së.

Struktura e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit 2014 dominohet nga shpenzimet e rrjedhës, pjesëmarrja e të cilave në shpenzimet e përgjithshme buxhetore ka arritur në 66%, ndërsa shpenzimet kapitale në shpenzimet e përgjithshme buxhetore edhe më tej do të mbeten të larta rreth 33%.

Shpenzimet për paga dhe mëditje për vitin 2014 janë paraparë të jenë 483.4 milionë, shifër kjo që paraqet një ngritje prej rreth 11% në krahasim me shpenzimet e planifikuara për vitin 2013.

Në lidhje me ndarjen buxhetore ne kemi mundësinë e mirë që në funksion të implementimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm të bëjmë rivlerësimin dhe zvogëlimin e të hyrave për ato agjenci buxhetore të cilat nuk kanë përmbushur rekomandimet respektive të Auditorit të Përgjithshëm.

Nga aspekti i prioriteteve dhe analizimi i përmbajtjes së këtyre shpenzimeve del se ato janë paraparë mbi bazën e kriterit të nevojës dhe kriterit të dobisë së financimit të një shpenzimi publik.

Në fund, mendoj se Projektbuxheti i Qeverisë duhet të aprovohet, sepse do të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik të Kosovës duke e bërë të mundur që nëpërmjet shpenzimeve kapitale të ndikohet në rritjen ekonomike. Do të jetë në funksion të stabilitetit financiar duke bërë të mundur një financim publik të qëndrueshëm të shpenzimeve shtetërore dhe nën tre, do të jetë në funksion të zhvillimit social duke bërë të mundur financimin e nevojave sociale të shtresave të caktuara të popullsisë për aq sa mjetet buxhetore në dispozicion e mundësojnë këtë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Falën e ka deputetja Hykmete Bajrami.

**HYKMETE BAJRAMI:** Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Shumë të nderuar ministra që po keni durimin të rrini këtu.

Unë fjalimin tim po e filloj me indinjatën e thellë për mos prezencën e kryeministrit të Kosovës, në rastin kur në Kuvendin e Kosovës diskutohet për ligjin më të rëndësishëm që ka të bëjë me shpenzimin dhe shpërndarjen komplet politike të 1.6 miliard taksave të qytetarëve të Kosovës.

Unë kisha dashur shumë që sot të jetë kryeministri i Kosovës jo nga se kam mall për të, por kisha dashur shumë, sepse gjatë muajit të fushatës ai tha se premtimet e tij janë vendime. Dhe, unë i them sot kryeministrit ose vartësve të tij se sigurisht ia përcjellin se ai ka premtuar për komunën e Prizrenit 200 milionë dhe në dokumentin e buxhetit i keni vetëm 12,5. Ka premtuar për Mitrovicën 150 milionë dhe në dokument të buxhetit janë vetëm 4,8. Ka premtuar për Gjilanin 120, ndërkohë që i ka ndarë 5,9. Ka premtuar për Vushtrrinë 80 dhe i ka ndarë 4,6. Ka premtuar për Suharekën 80 milionë ka ndarë 4,2 milionë, ka premtuar për Podujevën 70 milionë dhe ka ndarë 6,6 milionë.

Për komplet gjashtë komunat e Kosovës, kryeministri ka premtuar 700 milionë, mirëpo për projeksionet buxhetore 2014-2016 për tre vjetët e ardhshme për 38 komuna të Kosovës janë të ndara vetëm 405 milionë.

Kryeministri gjithashtu ka premtuar që gjatë mandatit të tij të ardhshëm do të rriten pagat për 100%, por unë ju them se është rritur fondi i pagave, shumë e vërtetë, për 48 milionë.

Por të nderuar deputetë, a nuk e patëm ne rritjen e Fondit të pagave për 28 milionë, vitin e kaluar dhe më thoni se kujt i është rritur paga vitin e kaluar? Kjo rritje e Fondit të pagave për 48 milionë lejon rritjen maksimale 7% të pagave në këtë vit, projeksionet për 2015 lejojnë rritjen maksimale për 7.6%, për vitin 2016 lejojnë një rritje për 1% dhe komplet për tri vjetët e ardhshme pagat mund të rriten jo më shumë se 15%, ndërkohë që normat e inflacionit kalojnë vlerat e kësaj rritje.

Më vjen keq se më duhet t'i përsëris disa nga sukseset nëse pozita dhe partitë e koalicionit dhe Qeveria dëshirojnë që t'i quajnë suksese. Projektbuxheti i vitit 2014 nuk dallon aspak as në strukturë as në shpërndarje. Vetëm duhet të bëj një krahasim, nëse rritja prej 0,3% e buxhetit të Kosovës në krahasim me këtë vit quhet sukses, atëherë kjo le të përmendet, le të përmendet nga të gjithë nga pozitë dhe opozitë. Unë vetëm dua t'ju përkujtoj që buxheti i vitit 2010 në krahasim me atë të vitit 2009 është rritur me 13,4%. Tash kemi ra në normat e rritjes 0,3% dhe nëse ky është sukses kjo duhet të potencohet.

Nëse borxhi publik është rritur nga 9,6% e GDP, në 12%, nëse është sukses, si sukses le të potencohet, por këto gjëra nuk janë sukses, sepse qytetarët e Kosovës i kuptojnë shumë mirë, ata kuptojnë jetën dhe mirëqenien në të cilën gjenden sot.

Projektbuxheti ka probleme strukturore. Pas tre vjetëve me radhë ku Qeveria Thaçi ka futur 300 milionë të hyra të njëhershme duke aluduar në shitjen e 75% të aksioneve, këtë vit ato nuk janë si të hyra të njëhershme, por aq më keq, sepse na paraqiten si të realizuara në bilancin bankar të Kosovës.

Imagjinoni, 303 milionë. Edhe sikur të kishte ndodhur, kjo shumë është dashur të korrigjohet për 32 milionë, sepse të hyrat nga PTK-ja nëse do të ndodhte, janë 242 milionë, të hyrat nga Distribucioni janë 26 milionë dhe këtu nuk bëjnë 303 milionë, por bëjnë 268 milionë, andaj është pafytyrësi që para deputetëve të sillen dokumente të tilla.

934 milionë parashihen që të jenë të hyrat nga Dogana. Kjo tregon që vendi ynë prapë do të vazhdojë me import dhe do të varet komplet nga importi. Investimet kapitale kanë ra për 15% apo 19 milionë dhe unë i pyes të gjithë këtu se a është ky sukses apo është dështim?

Qeveria kreket shumë me aplikimin e rregullës fiskale, por u tha më herët, asgjë nuk është bërë, sepse është zbritur deficitin primar për 30 milionë dhe është rritur borxhi publik për 40 milionë.

Ky buxhet nuk derivon nga objektivat zhvillimore që vërehet lehtësisht nga analiza e shpenzimeve në institucione.

Derisa rreth 32% e investimeve kapitale shkojnë për infrastrukturë rrugore, krahasuar me vetëm 4,1% në arsim, 3% në shëndetësi, 1,8% zhvillim ekonomik dhe 1,6% në bujqësi.

Të nderuar deputetë,

Në vitin 2014 rreth 73% të hyrave tatimore do të mblidhen në kufi. Kjo është një rritje shumë e vogël, mirëpo megjithatë duke parë raportin e shpenzimeve që Qeveria e ka sjellë në Kuvend kohët e fundit, ne vërejmë që kjo është një pritje ambicioze, sepse për nëntëmujorin e këtij viti Qeveria, do të thotë Doganat e Kosovës ngelen me 76% prapa planit. Kemi 76 milionë, 12% prapa planit, më pak se ato që janë të planifikuara.

Me këto ngecje dhe planifikime është vështirë që të parashikohen rritjet e buxhetit.

Të hyrat vendore të planifikuara nga Administrata Tatimore janë 367 milionë. Edhe këtu kemi një rritje, mirëpo sa është e realizueshme kjo rritje kur shohim performansën e këtij viti të Administratës Tatimore, ku kemi 10% ngecje të planit.

Sfidë sa u përket të hyrave në kufi mbetet funksionalizimi i pikave doganore 1 dhe 31. Fondi zhvillimor duhet patjetër që të jetë pjesë e tabelave të buxhetit. Kuvendi i Kosovës duhet patjetër që të ketë Fondin zhvillimor në tabelat e buxhetit. Nëse Fondi zhvillimor nuk është pjesë e të hyrave dhe e të dalave në tabelat e buxhetit, ky është një buxhet i ndarë nga buxheti i Kosovës dhe kjo nuk është aspak në rregull.

Kur jemi te shpenzimet rrjedhëse sa u përket pagave, thashë maksimumi që mund të rriten është 15% për tre vjetët e ardhshme.

Lidhja Demokratike e Kosovës nuk është kundër rritjes së pagave, jemi për rritje sistematike, mirëpo rritja duhet të ndodhë konform rritjes ekonomike, sepse një rritje e pagave pa rritje ekonomike s'po na shkakton asgjë tjetër vetëm inflacion.

Shpenzimet për transfere janë rritur për 24 milionë. Kur jemi te investimet kapitale që janë zbritur me 15% apo 90 milionë, kjo duhet të themi se me një kalkulim të thjeshtë kemi një rënie të aktivitetit ekonomik për 200 milionë dhe të gjithë ne e dimë se çka do të thotë kjo.

Është e vërtetë se janë ndarë 132 milionë për autostradën Shkup-Prishtinë, mirëpo me çfarë kostoje, duke i harruar: shkollat, spitalet, rrugët, furnizimin me ujë, trajtimin e mbeturinave dhe ujërave të zeza, bujqësinë dhe sektorë tjerë të cilët janë krucial për zhvillimin e vendit.

Bujqësia, të nderuar deputetë, ka një buxhet shumë të vogël. Derisa në vitin 2009, pjesëmarrja e buxhetit të bujqësisë në buxhetin e tërësishëm ka qenë 1,08, në vitin 2014 ne kemi një rritje në 1,7, që është shumë larg rritjes së normave të inflacionit.

Ne kemi problem me shpërndarjen politike të investimeve, kemi 7,5 milionë të cilat janë shpenzime të paparashikuara kapitale që u tha më herët që nuk dihet ku do të shkojnë dhe kemi gjithashtu 11.4 milionë që janë për bashkëfinancim me komuna. Edhe ky është problem.

Ne nuk kemi investime në infrastrukturën rrugore, nuk kemi investime në furnizimin me ujë edhe pse 1/3 e popullsisë gjendet jashtë rrjetit të ujësjellësit, nuk kemi investime të mjaftueshme në trajtimin e mbeturinave dhe ujërave të zeza.

Investimet në arsim jo vetëm që janë të pakta, po ka edhe probleme strukturore, të nderuar deputetë.

Po përmend vetëm një fakt, në buxhetin e vitit 2014 ne i kemi 53 shkolla që janë në ndërtim e sipër dhe a e dini çfarë, 47 shkolla janë në buxhet prej vitit 2012 e më herët, 7 janë që kanë filluar në vitin 2013, kinse kanë filluar dhe vetëm 3 i kemi të reja si projekte të reja në vitin 2014. Tash imagjinoni, Qeveria e cila është në gjendje t'i paguajë 'Bechtel-Enka'-s 250 milionë në vit, do të thotë të paguajë 1 kilometër autostradë 10 milionë euro, nuk është në gjendje të ndërtojë një shkollë për 1 a 2 vjet, por i zgjasin ato ndërtime deri në pesë vjet.

Problem tjetër, kur jemi te Ministria e Arsimit e kemi edhe problemin e furnizimit me libra. Për libra janë ndarë në kuadër të shpenzimeve kapitale 3,2 milionë. Dhe a dini çfarë, ky është tenderi më jo transparent që po ndodh me këtë Qeveri, sepse kemi furnizim joburimor, çmimet asnjëherë nuk bëhen transparente, i keni parë të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm ku kemi libra të cilat janë paguar nga Ministria e Arsimit dhe nuk përdoren, sepse nuk është matur mirë as numri i nxënësve dhe gjithashtu 3,2 milionë janë ndarë në buxhet e librat dhe gjithmonë na kushtojnë 7, 8 dhe 10 milionë. Edhe kjo aspak nuk është në rregull.

Kemi shumë pak investime në shëndetësi, kemi një buxhet të mbijetesës në sektorin e rendit dhe të sigurisë dhe me këto vërejtje assesi ne nuk mund të votojmë një...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Albulena.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Në bazë të parimit të ndarjes së pushteteve, pushteti gjyqësor paraqet njërën nga degët e pushtetit me rëndësi më jetike brenda një organizimi shtetëror. Si i tillë, sistemi gjyqësor paraqet garantin kryesor për stabilitetin juridik në drejtim të mbrojtjes së ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë së shtetit. Në këtë drejtim financimi i tij dhe strukturimi i tij është tejet i rëndësishëm në aspektin funksional.

Në anën tjetër, buxheti i Republikës së Kosovës në cilësinë e një akti ligjor paraqet bazën kryesore juridike për financimin e mbarëvajtjes së sistemit shtetëror, në përgjithësi, e në veçanti edhe të sistemit gjyqësor.

Në strukturën buxhetore të Republikës së Kosovës që përfshin një shumë prej 1 589 000 000 euro ndarja buxhetore për sektorin e drejtësisë përfshin një numër prej 29 milionë euro. Kjo shumë në mënyrë nominale paraqet shumën prej 1,87% të totalit buxhetor për vitin 2014, ndërsa për vitin 2013 ishte 1,97%. Pra këtu kemi të bëjmë me ndarjen buxhetore për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, Gjykatën Kushtetuese, Prokurorinë e Shtetit, Institutin Gjyqësor dhe Këshillin Gjyqësor.

Pra, nëse e krahasojmë ndarjen sipas përqindjes nga totali i buxhetit të Kosovës, shohim se ekzekutivi ka ndarë për këtë vit 0.10% më pak për sektorin e drejtësisë në krahasim me vitin e kaluar. Edhe pse shuma totale në mjete figuron më shumë, por vetë ndarja më e vogël për sektorin e drejtësisë tregon se kjo Qeveri nuk është e interesuar që të forcojë sektorin e drejtësisë në mënyrë që të luftohet korrupsioni për të cilin këta qeveritarë e kanë përplot gojën e mbushur me frazeologji boshe.

Në krahasim me degën e ekzekutivit që përfshin një shumë prej më se 60% të buxhetit, paraqet një denigrim që i bëhet degës së gjyqësorit. Ngritja në aspektin e sasisë së mjeteve financiare figuron që të jenë jo më shumë se 1 milion për sektorin e drejtësisë.

Nëse vazhdohet me këtë trend, ne jo vetëm se nuk do të arrijmë t'i zëmë trendët e vendeve të rajonit, por jemi duke shkuar në regres të qartë dhe të qëllimshëm.

Kushtet subjektive të gjyqtarëve dhe prokurorëve janë të mjerueshme dhe në vend që të ngritët niveli dhe cilësia e punës së tyre nëpërmjet përmirësimit të kushteve subjektive të punës, sigurisë së tyre personale, ruajtjen e dinjitetit të tyre në shoqëri, sot investohen milionat në lukse qeveritare.

Problemin tjetër që e ka sot sektori i drejtësisë është numri i madh i lëndëve të pazgjidhura, andaj është dashur që të investohet në rritjen e kapaciteteve profesionale në sistemin e gjyqësisë për të cilin vazhdimisht bëjnë thirrje sot prokurorët dhe gjyqtarët.

Gjyqësia e fortë, gjyqësia efikase, gjyqësia e pavarur është shtyllë e ndërtimit të demokracisë së mirëfilltë dhe njëkohësisht është forcë pozitive për zhvillimin ekonomik dhe social, duke e përfshirë edhe rritjen e besimit të investitorëve të huaj. Mirëpo, me 1,87% të totalit buxhetor që ndahet për sistemin e drejtësisë, kjo asnjëherë nuk do të arrihet. Faleminderit!

**KRYETARI:** U morëm vesh për pauzë. Në orën 15:00 do ta vazhdojmë seancën.

\* \* \*

*Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës*  
*Mbledhjen e drejtuar kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi*

KRYETARI: Vazhdojmë me seancën. Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Unë do të ndalem shumë shkurt në disa dikastere nëpër ministri të caktuara. Po, çdo qeveri e ka obligim që të qeverisë mirë me mjetet publike, duke e mbrojtur interesin publik.

Për mua është shqetësuese se në vitin 2014 investimet kapitale janë në zvogëlim, që është një e keqe e këtij buxheti, për arsye se do të kemi më pak investime në investimet kapitale se sa vitin që shkoi, për arsye se investimet kapitale sjellin edhe rritje ekonomike, sjellin edhe zhvillim ekonomik dhe ulje të papunësisë dhe shpresoj që këto zvogëlime të investimeve kapitale të mos shkojnë në shpenzime për mallra dhe shërbime, do të thotë në shpenzime joproduktive.

Do të ndalem konkretisht në disa ministri të veçanta, për shembull, Ministria për Integritet, e cila ka marrë përgjegjësi që t'i kryejë disa obligime rreth liberalizimit të vizave. E shoh se në kodet e saja kurrkund nuk parasheh që të ndihmojë shumë që të propozojë strategjinë e tri komuniteteve, të cilat nuk janë të zhvilluara shumë mirë ekonomikisht dhe e shoh që nuk ka ndarë asnjë buxhet dhe asnjë cent në këtë pjesë dhe të arrijë që këto komunitete të kenë një perspektivë ekonomike.

Prandaj, vetëm me strategji në letër pa buxhet nuk mund të zvogëlohet papunësia, nuk mund të zhvillohet integriteti i komunitetit egjiptian dhe komuniteteve tjera, të cilat paraprakisht thuhet në atë strategji, që kanë ngecur pas në punësim, në arsim dhe në shumë lëmenj tjerë.

Unë dua të besoj që edhe shpërndarja rajonale duhet të jetë më e mirë dhe ndoshta në të ardhmen duhet të mendohet në fond për vendet më të pazhvilluara në Kosovë, por edhe për komunitetet më të pazhvilluara. S'po kërkoj fond ashtu siç është bërë për komunitetin serb dhe për tri komunat, por kërkoj që ky fond të përdoret në vendet ku janë pjesë më të pazhvilluara dhe në pjesët ku gravitojnë disa pjesëtarë të komuniteteve, të cilat kanë nevojë më tepër për infrastrukturë edhe rrugore, infrastrukturë në arsim dhe në lëmenjtë tjerë.

E meta e këtij buxheti mund të them është mungesa dhe ulja e investimeve. Kisha pasur dëshirë që të kishte ndodhur një trend i rritjes të investimeve kapitale. Besoj që edhe për Ministrinë e Infrastrukturës do të kishte qenë mirë që të vazhdohej rruga Prishtinë - Pejë edhe mos të bëhet pjesë-pjesë, për arsye se na mundëson qarkullim, zhvillim ekonomik më të hovshëm, kur dihet që është një rrugë e cila graviton dhe shumë qytete të rëndësishme të Kosovës, bile edhe ministri i Ekonomisë vjen shpesh asaj rruge dhe unë



udhëtoj për çdo ditë. Dhe, po dua t'i them një gazete ditore, që para do ditësh më qiti që nuk udhëtoj, po dua t'i tregoj që 11 vjet udhëtoj për çdo ditë Pejë - Prishtinë.

Dhe, jam shumë i interesuar që kjo rrugë shumë më shpejt të rregullohet dhe të mos lihet pjesë-pjesë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Saygıdeğer Başkan, Değerli Milletvekiller

Bu gün 2014 yılı Kosova Bütçesini incelemiş bulunmaktayız.

Aslında normalde olması gerektiği gibi, her devlette bir önceki yıla göre bir artış, bir ekonomik büyüme göstermesi normal olarak görmekteyiz. Tabi bizim aldığımız ve incelediğimiz bütçede geçen yıla kıyasen gelirlerde bir artış olduğunu görmekteyiz ve bu artış yaklaşık olarak 35 milyon olarak görülmektedir, yani ortalama olarak ekonomik büyümenin yüzde 3 olarak öngörülmesi.

Yine Kosova bütçesine baktığımızda gelirler ve giderler arasında bir dengesizliğin olduğu, daha doğrusu gelir ve giderler arasında yaklaşık olarak 130 milyonluk bir açık görülmektedir, gelirlerimizin toplamı 1 milyar 458 milyon öngörülmüş, harcamalarımız ise 1 milyar 590 milyon olarak öngörülmektedir.

Yine gelirlerimizin en büyük kısmını doğal olarak vergiler oluşturmaktadır, ama vergilerden gümrük vergisinin yine yüksek olması ülkemizin hala ithalata dayalı bir ekonomik kalkınma sürdürdüğü, ki bu doğru olmadığını ifade etmek istiyorum. Her ne kadar iç vergilerde bir artış gösterebilir bu yetersizdir, yani iç vergilerden gereken artışı sağlayamadığımız ve bunu takip etmekte Hükümetin yetersiz kaldığını görmekteyiz. Katma değer vergisine ve gelir vergisinde düzeni oturtmamızda Hükümet politikalarını gözden geçirmelidir.

Geçen yıla oranla vergi dışı gelirlerimizde bir düşüşün yaşandığını görmekteyiz, bunu telafi edecek de mekanizmanın olmadığını görmekteyiz, bu da Hükümetin artık bu tür gelirlerden yoksun kaldığı bir gerçek.

Bütçeyi analiz ettiğimizde, belki ekonominin daralmasına sebebiyet verecek yatırım kalemlerinde ciddi bir düşüşün tespit etmemizdir, bu rakam hiç de küçümsenecek miktar değil, yaklaşık olarak 90 milyon, bu da yerli şirketlerimizin gelişmesine, yani özel sektörün kalkınmasına olumsuz etkileyecektir, dolayısıyla işsizliğin artmasına sebebiyet verecektir.

Kamu sektöründe maaşlardaki kalemlerde artışın olacağı açık olarak göstermektedir ve bu rakam da 50 milyon olarak belirlenmiş, fakat artışın hangi oranda maaşlara yansıtılacağı ancak ocak ayında belirlenecektir.

Bütçede belki büyük bir kalemi sosyal transferler oluşturmaktadır, geçen yıla nazaran artış olmasına karşın, özellikle emekli maaşlarda bir artışı görmek mümkün değil.

Bütçe açık vereceği kesin ve bu açığı kapatmak için Kosova yaklaşık olarak 100 milyon bir borçlanma yapacağı kesin, tabi bu borçlanma transfer harcamasına gitmesi Kosovanın geleceği açısından olumlu bir durum değil, buna Hükümet dikkat etmeli, çünkü gelecek nesillerimizi borç yükü ile bırakmamalıyız.

Bakanlıklardaki bütçe dağılımına baktığımızda dikkatimizi çeken en önemli hususlardan biri Sağlık Bakanlığına veya bu Alana ayrılan payın yine düşük olmasıdır, bu bütçe çerçevesinde yine sağlık Hükümetin öncelikleri arasında değil, bu sektör belki en fazla yatırıma ve reforma ihtiyacı olan alandır. Kosova dışına gidecek hastaların her geçen gün artması ve ayrılan bütçenin yine yetersiz olduğunu görmekteyiz, buna alternatif üretmek için de yatırımlarda bir atışı da bütçede göremedik.

Her yıl Topluluklar Bakanlığının bütçesinde geri dönüş ve topluluklara bütçe ayrılmaktadır, fakat bu bütçeden her nedense sadece Sırp topluluğu faydalanmaktadır, teklifimiz bu subvansiyon kategorisinde her topluluğun miktarının belirlenmesidir, her topluluğun ayrı ayrı talepleri olmaktadır, bu güne kadar Türk topluluğunun bu bütçeden aldığı miktar çok düşüktür, o yüzden önerimizi komisyona sunacağız, her topluluğun ayrı bir kodu olması şarttır.

Prizren belediyesindeki yatırım kalemlerini incelediğimizde, birçok yatırım öngörülmüş, özellikle Prizren şehrini bağlayan otobana olan yolun yapımı isabetli, ayrıca Kurila semtindeki Aile Sağlık Merkezine 120 bin yuro ayrılmış olması ve yine Kurila semtinde yol yapımı için 70 bin avro ayrılması çabalarımızın bir sonucudur, ama öngördüğümüz proje şekli için yeterli bir miktar olmadığının da dikkatini çekmek isteriz. Yine taleplerimiz arasında fakat Bütçede yer almadığını gördüğümüz Türk Kültür Merkezinin yapımı, bu talebimizi her seferinde dile getirdik, yine komisyona teklifimizi sunacağız.

Prizren nehrinin temizlenmesi, arasta minaresi ve etrafının yapımı gibi projeler Prizrenin tarihi dokusunu korumaya yönelik projeleri de takdir etmek ve geliştirmek şarttır.

Mamuşa belediyesi bütçesine baktığımızda geçen yıla oranla elle tutulacak herhangi bir proje görmek mümkün değil. Mamuşa tarım bölgesi, ama tarımı kalkındıracak ve geliştirecek somut projelerin eksikliğini bütçede görmekteyiz.

Merkezi düzeyden, özellikle Kültür ve Spor Bakanlığının Mamuşada kapalı bir spor stadının projesinin olmayışı, ayrıca kültür merkezinin yapımının da öngörülmemiş olması tabi ki kabul edilebilir bir durum değildir. Umut ediyoruz ki 2014 yılının ikinci yarısında projelendirilip bütçede yerinin alması sağlanır.

Hükümetin hazırlamış olduğu Bütçe önerisini Kosova yarınlarının her geçen gün daha güzel olacağına Türk toplumu olarak inanmaktayız. Önerilerimizi komisyona sunacağımızı bildirirken, Bütçe taslağını desteklediğimizi ifade etmek isterim. Teşekkür ederim.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Behar Selimi.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Unë do ta mbështes buxhetin për së paku tri arsye. Arsyeja e parë është se ky buxhet konsiderohet buxhet i zhvillimit; buxhet që mbështet rritjen ekonomike; buxhet që i ka respektuar maksimalisht kërkesat e organizatave buxhetore. Këtë vlerësim e japin institucionet kompetente vendore dhe sidomos ato ndërkombëtare, prandaj kjo është një nga arsyet që do ta mbështes buxhetin.

Arsyeja e dytë është se në këtë buxhet pjesëmarrja në buxhet e sektorit të sigurisë nacionale, e sektorit të sigurisë publike dhe e sektorit të sundimit të ligjit merr pjesë me 15%, përkatësisht 230 milionë.

Pra, 15% pjesëmarrje në sektorin e sundimit të ligjit mendoj që është pjesëmarrje relativisht e mirë, të cilës kur t'ia shtojmë edhe menaxhimin mbi bazën e parimit të efikasitetit, pra jo veç të efektivitetit, atëherë mendoj se mjafton, plus mbështetja që na vjen nga sektori ndërkombëtar i sundimit të ligjit dhe të sigurisë, që po ashtu flasim për qindra miliona. Mendoj se ia vlen dhe duhet ta mbështesim si buxhet, qoftë edhe për këtë arsye.

Dhe, arsyeja e tretë, më josh posaçërisht Fondi për rritje të pagave dhe dua të besoj se hisja e sektorit të sigurisë, pra e Policisë, e shërbyesve korrektues, e zjarrfikësve, e oficerëve të ushtrisë, përkatësisht të Forcës së Sigurisë, do të jetë pjesëmarrje domethënëse në atë rritje të rrogave, meqë nuk e dimë përqindjen. Prandaj, qysh tash i bëj thirrje Qeverisë që me rastin e rritjes së pagave në vitin e ardhshëm të ketë rritje domethënëse për sektorin e sundimit të ligjit dhe të sigurisë kombëtare dhe publike, edhe për arsye se prioritetet e Qeverisë janë të lidhura me sundimin e ligjit, përkatësisht nëpërmjet sundimit të ligjit po synojmë integrimin edhe euroatlantik.

Prandaj, unë do ta votoj buxhetin për këto tri arsye që i përmenda. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: I nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Zhvillimi ekonomik i Kosovës i referohet përparimit shoqëror dhe teknologjik, respektivisht investimeve kapitale në aplikimin e metodave bashkëkohore për prodhim. Pra, investimet duhet orientuar në prodhim për t'i rritur kapacitetet prodhuese, sidomos duhet rritur investimet në bujqësi, ku ky sektor mundëson hapje të shpejta të vendeve të reja të punës.

Duhet investuar në energji, industri, pastaj duhet rritur investimet në sektorin e arsimit, për t'i kualifikuar në mënyrë sa më të mirë gjeneratat e reja dhe për t'i përgatitur për tregun e punës. Duhet rritur investimet në shëndetësi për të krijuar një popullatë të shëndoshë dhe për të përmirësuar efektshëm jetën e qytetarëve.

Shtrohet pyetja: a është ky buxhet zhvillimor dhe a i përmbush këto kërkesa?

Unë në diskutimin tim do të fokusohem tek buxheti për sektorin e bujqësisë. Edhe buxheti i vitit 2014 i ndarë për bujqësi nuk ka ndonjë ndryshim të madh krahasuar me buxhetin e vitit të kaluar, edhe pse vazhdimisht është thënë se do të krijohen mundësi më të mëdha për zhvillimin e sektorit të bujqësisë në Kosovë.

Me fjalë të tjera, rreth 1,7% e buxhetit të tërësishëm e ndarë për bujqësinë, është e pamjaftueshme. Investimet kapitale prej 9,9 milionë euro dhe subvencionet 11,8 milionë euro janë akoma të ulëta. Edhe pse shihet një rritje në krahasim me vitin e kaluar, gjendja në këtë sektor përsëri nuk është e dëshiruar, sepse ky buxhet sërish mbetet më i ulëti në rajon.

Maqedonia ka ndarë 150 milionë euro vitin e kaluar, Serbia ka ndarë 3,7% të buxhetit të tërësishëm për bujqësi. Pra, duke bërë këto krahasime shihet që bujqit e rajonit kanë dukshëm përparësi konkurruese nga bujqit tanë. Pra, ne mendojmë që me këtë buxhet neglizhohet bujqësia.

Ky buxhet siguron që do të vazhdojmë të importojmë 600 milionë euro produkte bujqësore nga jashtë. Me këto investime në bujqësi nuk mund të sigurohet që Kosova të arrijë t'i zëvendësojë produktet bujqësore të importuara me produktet vendore, ekonomia e Kosovës do të vazhdojë të jetë një ekonomi konsumuese e varur nga importet.

Disa ekspertë të politikave bujqësore konsiderojnë se Kosovës i mungon një strategji afatgjate e zhvillimit të bujqësisë, ku do të vendoseshin prioritetet që mund të realizojnë një rritje të prodhimit në përgjithësi, prodhimit, sidomos atij të ushqimit, që duhet të jetë së paku në të ardhmen një ndër përparësitë konkurruese në Kosovë. Sigurimi i ushqimit duhet të bëhet jo vetëm për nevojat e vendit, por edhe për eksport, bujqësia duhet të jetë resurs i cili duhet të favorizohet shumë më tepër, se sa që është favorizuar deri më tani.

Toka pjellore dhe kushtet e volitshme atmosferike në Kosovë, sipas ekspertëve të bujqësisë mundësojnë rimëkëmbjen e shpejtë të këtij sektori. Sipas të dhënave të Doganave të Kosovës, misri dhe gruri janë produktet ushqimore të cilat më së shumti importohen nga shtetet e ndryshme të botës dhe hyjnë në Kosovë. Importi i prodhimeve bujqësore ndodh pikërisht për shkak të investimeve të vogla që bëhen nga Qeveria e Kosovës për bujqësinë. Maksimum në bujqësi Kosova investon këtë vit është 1,7% nga buxheti i tërësishëm, ndërsa në rajon investohet 5-7% nga buxheti i shteteve. Shembull, Maqedonia investimet në bujqësi i ka 4,5% nga buxheti i tërësishëm.

Kosova i ka të gjitha resurset natyrore dhe njerëzore për t'u marrë me bujqësi, por prapë po e theksoj, sipas ekspertëve të politikave bujqësore, mungon kombinimi i këtyre dy resurseve. Ne jemi vend agrar, por importojmë produkte bujqësore nga jashtë. Këtë nuk kemi se si ta quajmë tjetër vetëm paradoks.

Problemi kryesor është se ne nuk jemi në gjendje që t'i kombinojmë kushtet natyrore dhe njerëzore dhe të prodhojmë së paku për nevoja tona. Ne nuk jemi në gjendje që t'i

shfrytëzojmë dhe menaxhojmë efektshëm ato pasuri që kemi për ta rritur zhvillimin, për të ulur përqindjen e madhe të të papunëve, duke orientuar investimet në sektorë dhe projekte zhvillimore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti dhe nënkryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: I nderuar kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Është më se e qartë që strukturimi i buxhetit shtetëror është pasqyrë e mënyrës së prioritizimit të nevojave shoqërore. Varësisht se si ekzekutivi e ndërton buxhetin, kjo i shpjegon edhe orientimet e përgjithshme ekonomike të politikës qeveritare. Prandaj, nuk është e rastësishme ajo thënia e mirënjohur “më trego se çfarë ndarje të buxhetit aplikon, të tregoj se çfarë politike ke”.

Nëse e shohim dhe analizojmë mënyrën e ndarjes së buxhetit nga ana e Qeverisë, vërehet fare qartë se pjesën më të madhe të parave tona po e merr asfalti, kurse pjesën më të vogël bujqësia, arsimi e shkenca, shëndetësia, mbrojtja sociale e kështu me radhë.

Këtu, në Kosovë kur konstruktohet buxheti i fushave të caktuara në formë të përqindjes, krijohet lajthitja se ne nuk qëndrojmë shumë prapa vendeve të rajonit. Por, mendoj se pasqyrë reale, shumë më reale, do të ishte po të konstruktohej buxheti i fushave të caktuara në formë të përqindjes, si mbështetje përtej sistemit të pagave. Pra, se sa merr pjesë investimi i Qeverisë, i shtetit të Kosovës si përqindje në fusha të caktuara përtej pagave, që i marrin njerëzit, të cilat janë të domosdoshme, sepse po të shikohet raporti ndërmjet përqindjes së pagave dhe investimeve shtesë përtej pagave, atëherë shihet se përqindjen dërmuese e marrin pagat.

Kjo do të thotë se nuk mund të mburremi se po investojmë në arsim dhe se kemi një arsim të fortë vetëm pse arsimtarët dhe mësuesit po i marrin pagat e tyre rregullisht, ndërkohë që kur i shohim investimet në shkencë, në hulumtime apo në institutet e kërkimeve, këto janë pothuajse zero dhe të papërfillshme e këto janë ato që e forcojnë arsimin, shkencën e një vendi e kështu me radhë.

Kjo do të thotë se fushat tona të jetës shoqërore janë kryesisht të reduktuara në paga, kurse investimet tjera shtetërore përtej këtij domeni janë pothuajse simbolike dhe të cilat nuk i përmbushin aspak nevojat e qytetarëve për një arsim të duhur, për një shëndet normal, si dhe për një mirëqenie të dinjitetshme.

Indeksi zhvillimor i shteteve gjithnjë e më shumë po matet me përqindjen e investimeve shtetërore përtej domenit të pagave të domosdoshme për administratën dhe për të punësuarit e sektorit publik.

Një sektor plotësisht i anashkaluar nga prioritetet dhe projeksionet buxhetore qeveritare, për të cilin desha të flas sot, është procesi i industrializimit të Kosovës. Prej fundit të viteve 60 në Kosovë pat filluar një proces i hovshëm i industrializimit që pati vazhduar

për rreth dy dekada nëpërmjet hapjes së qindra fabrikave të profileve të ndryshme, Kosova hyri në një fazë të industrializimit, të zhvillimit ekonomik dhe të punësimit masiv. Me rikthimin e okupimit klasik serb të viteve të '90-ta kjo tendencë u shkatërrua plotësisht. Shprehja që e përdorin me plot të drejtë ekspertët e kësaj fushe, për ta përshkruar efektin rrënues ekonomik të këtij okupimi është “deindustrializimi i Kosovës”. Por, pas çlirimit dhe vendosjes së vendit tonë nën administrimin ndërkombëtar, shumë njerëz pritën që tash Kosova do t'i nënshtrohej një procesi të riindustrializimit dhe shumëkush e priti një politikë qeveritare e cila do t'i kombinonte si duhet tre faktorë, lidhjen produktive ndërmjet arsimit dhe në ndërmjet nevojave të ekonomisë; orientimin e politikave në prodhimtari; si dhe sigurimin aktiv të prodhuesve për tregjet e tyre.

Dështimi më i madh i Qeverisë së tanishme duhet të gjendet, sidomos përbrenda këtyre tre faktorëve, të cilët janë kyç për zhvillimin e një vendi.

Është me të vërtetë e turpshme dhe e pafalshme që të konstatohet fakti se në vitin 2013 shumë prej fushave të industrisë në Kosovë janë më të dobëta se ato që kanë qenë 30 apo 40 vjet më parë. Nëse merren industria e tekstilit, industria minerare, industria e përpunimit të prodhimeve bujqësore, industria e prodhimeve metalike, industria e prodhimeve të gomës e plot degë të tjera të industrisë e sidomos fusha e industrisë përpunuese, që mallrave ua jep vlerën e tyre të shtuar të vërtetë, të gjitha këto janë larg nivelit prodhimtar të para katër dekadave në Kosovë.

Kjo ka bërë që edhe biznesi në Kosovë të marrë një strukturë të caktuar. Nëse merret masa e përgjithshme e bizneseve në Kosovë, atëherë shihet shumë qartë se mbi 80% e bizneseve në Kosovë e kanë vetëm një aktivitet që është tregtia, kurse aktivitetet prodhuese janë fare simbolike, në masën e përqindjes me të cilën ato marrin pjesë në bruto-prodhimin e Kosovës.

Prandaj, kjo është arsyeja kryesore pse Kosova karakterizohet nga një bilanc kaq i pafavorshëm në kurriz të eksporteve tona. Kjo politikë e gabueshme ka krijuar një gjendje ekonomike që shquhet nga mbizotërimi i importeve; dalja e vazhdueshme e parave të qytetarëve jashtë Kosovës; mungesa e masave subvencionuese dhe dështimi për garantimin e tregjeve për prodhimet tona.

Në kursin aktual që ndodhet kjo politikë, e vetmja gjë që është e garantuar mbetet ngulfatja dhe lodhja e vazhdueshme e ekonomisë me performansës të dobët dhe larg impulseve të zhvillimit çfarë i nevojiten Republikës së Kosovës.

Këto janë vetëm disa prej pak arsyeve, përpos atyre tjerave që u përmendën, pse ne mendojmë se ky buxhet i konstruktuar nga Qeveria nuk duhet ta marrë votën tonë në Kuvendin e Kosovës.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Shtrohet pyetja: a është ky buxhet i zhvillimit ekonomik apo është biznes i mbijetesës së institucioneve publike, sepse nëse analizohet buxheti me vitin e kaluar nuk ka ndryshime esenciale?

Në këtë vit buxheti është rritur, ka një rritje të vogël, po kjo rritje a është ndarë në mënyrë proporcionale nëpër institucione, a është shpërndarë sipas prioriteteve dhe sipas nevojave, a është shpërndarë nëpër komuna?

Vitin e kaluar shëndetësia është ballafaquar me probleme të shumta, qoftë në mungesë të buxhetit apo buxheti jo i mjaftueshëm, po edhe më shumë edhe nga keq menaxhimi i këtij buxheti dhe keq menaxhimi i resurseve njerëzore e që po shihet se prapë nuk ka buxhet të mjaftueshëm, që qytetarëve t'u ofrojmë shërbime shëndetësore kualitative, ashtu siç e meritojnë.

Ky buxhet a mundëson të kryhen të gjitha prioritetet e Qeverisë, të proklamuar gjatë këtij viti? Rritja e kategorisë së pagave për 50 milionë, por të pa definuara se cila kategori do të fitojë në rritje të pagave, në arsim, shëndetësi, pensionistët, rastet sociale, familjet e dëshmorëve, familjet e të pagjeturve apo familjet e viktimave civile, e cila kategori nuk ka përfituar nga rritja e fundit në paga. Dhe, çka do të bëhet me veteranët e luftës, të cilët nuk janë të paktë e të cilët nuk kanë asnjë burim ekzistence?

Sa i përket Deçanit janë përfshirë disa projekte që janë sjell nga komuna, por jo të gjitha projektet, andaj kishim kërkesë që gjatë amendamentimit të përfshihen edhe projektet tjera. Një lajm i mirë është se në këtë buxhet është përfshirë rruga për Plavë.

Një kërkesë, zoti ministër, e kemi, shkolla në Rastavicë, e cila është përfshirë në buxhet në komunën e Junikut, kishte qenë mirë që të rregullohet statusi i saj, sepse Rastavica si njësi administrative është pjesë e Deçanit e jo e Junikut dhe është mirë që edhe shkolla të kalojë në këtë kategori. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputetja Valbona Dibra.

**VALBONA DIBRA:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2014 vlerësoj se është i përgatitur në mënyrë shumë profesionale. Për vitin 2014 është planifikuar buxheti prej 1 miliard e 590 milionë euro dhe është shpërndarë në mënyrë të drejtë dhe racionale duke pasur parasysh se ky është buxhet i mundësive dhe jo i nevojave që ka Kosova.

Edhe në këtë projektbuxhet shihet se Qeveria e Kosovës prioritet ka zhvillimin e të gjitha rajoneve të Kosovës, pra zhvillimin e Kosovës në tërësi duke bërë ndarje të drejtë buxhetore për të gjitha rajonet e vendit.

Është shumë e rëndësishme të ceket se në këtë projektbuxhet është e përfshirë edhe rritja e pagave për mësimdhënësit, familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës, për policinë e Kosovës, për shërbyesit civilë, Shërbimin korrektues, Sektorin e shëndetësisë dhe zjarrfikësit. Kjo rritje e pagave është një motivim për punëtorët dhe padyshim do të ndikojë në ngritjen e performansës dhe po ashtu ndikon në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve. Kjo rritje e pagave për të gjitha kategoritë është në përputhje të plotë me Fondin Monetar Ndërkombëtar, ashtu si edhe i gjithë buxheti që është përgatitur në pajtim të plotë me FMN-në.

Çështje tjetër shumë e rëndësishme, pas përfundimit të projektit kombëtar Autostradës Morinë - Merdar, është ndarja e 200 milionë eurove për autostradën Prishtinë - Hani i Elezit, përkatësisht Shkupit. Financimi i projekteve madhore tregon qartë përkushtimin dhe guximin e marrjes së vendimeve të rëndësishme dhe të drejta të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatësisht kryeministrit Thaçi. Po ashtu, në këtë projektbuxhet është paraparë Fondi për veteranët e luftës, si dhe për ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë, kategori këto të cilat meritojnë përkrahjen nga shteti i Kosovës.

Është shumë e rëndësishme të ceket dhe vlen të përsëritet se projektbuxheti i shtetit është përgatitur në përputhshmëri me rregullat fiskale dhe se të gjitha projektet e planifikuara në këtë projektbuxhet nuk mbështeten në mjetet nga shitja e PTK-së. Ky projektbuxhet garanton zhvillim ekonomik të vendit dhe stabilitet financiar, ku rritja ekonomike vlerësohet të jetë 4,1%, që është rritja ekonomike më e lartë në rajon.

Tash dua t'ia bëj një replikë deputetit, kolegut Osmani, që diskutoi më herët, vendosja e korrelacioneve ndërmjet Prishtinës dhe Skenderajt është me të vërtetë tendencioze dhe e padrejtë, kur dihet se në Skenderaj ka pasur mungesë kronike të investimeve. Nuk e di pse po ju pengon zhvillimi i Skenderajt, koleg i nderuar, edhe pse nuk qenka këtui. Ka kaluar koha e lënies anash të rajoneve të caktuara të Kosovës, siç ka ndodhur në kohërat okupuese që ka pasur Kosova. Ne duhet t'i gëzohemi të gjithë çdo investimi në Kosovë e pse jo edhe në Skenderaj.

Unë tash dua t'i paraqes disa statistika meqenëse nuk desha t'u hyj këtyre statistikave, por mu imponua. Dua t'ua rikujtoj, të nderuar deputetë dhe të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, se Prishtina për vitin 2012 për investime kapitale ka pasur në dispozicion 46,5 milionë euro dhe ka shpenzuar 25 milionë euro, apo 55% apo thënë shkurt ka lënë të pashpenzuara 21 milionë euro, ndërsa, deputetë të nderuar, Skenderaj evropian ka pasur vetëm 3,5 milionë euro për investime kapitale, por ka shpenzuar 2,9 milionë euro, apo 81% të buxhetit kapital.

Po ashtu, dua të marr edhe statistikën për këtë nëntëmuor për shpenzimet kapitale në Prishtinë, ku janë shpenzuar 51% në tërësi, ndërsa 42% vetëm për investime kapitale, ndërsa për nëntëmuorin e këtij viti, pra vitit 2013, Skenderaj ka shpenzuar 54% të investimeve kapitale.

Unë, të nderuar deputetë, ju ftoj që ta votoni këtë projektbuxhet. Faleminderit!



KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra të Kabinetit Qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Që në fillim të fjalës sime lidhur me projektbuxhetin e vitit 2014, dua të theksoj se në parim unë do të votoj kundër këtij projektbuxheti. Në vazhdim do t'i potencoj disa prej arsyeve që më kanë shtyrë të jap votën kundër këtij projektbuxheti.

Një prej arsyeve është se sipas vlerësimit tim, ky projektbuxhet nuk është projektbuxhet që garanton prosperitet ekonomik, që ofron mirëqenie dhe zbutje të papunësisë për qytetarët e Kosovës, por, thjeshtë është një buxhet që një pjesë e madhe të tij do të shpenzohet për pagat dhe mëditjet e zyrtarëve dhe shërbyesve civilë, të cilët jo rrallë krijojnë vende të punës mbi bazat e përkatësisë partiake dhe atë kuptohet, të partisë që është në pushtet.

Të jem më konkret, sipas këtij projekt-buxheti për vitin 2014 është planifikuar që 483 milionë apo 28,5% e buxhetit do të shpenzohen për paga dhe mëditje, që paraqet përqindjen më të lartë në regjion, të paraparë për këtë destinim.

Mirëpo, pavarësisht kësaj përqindjeje kaq të lartë, të paraparë për paga dhe mëditje, unë dua t'ia bëj me dije opinionit të gjerë, por edhe të punësuarve kosovarë se kjo qeveri nuk do t'ua rrisë pagat në vitin 2014 ashtu siç u ka premtuar gjatë fushatës elektorale, duke premtuar në disa sektore rritje 30-50% e në disa edhe më shumë, për shkak se rritja e buxhetit në kolonën e pagave dhe mëditjeve në krahasim me vitin 2013, është për 47,4 milionë euro apo për afro 10,8%, që do të thotë se kur të kemi parasysh rritjen e numrit të punësuarve në sektorin publik, si dhe shkallën e lartë të inflacionit në vendin tonë, atëherë jam i bindur se jo që nuk do të ketë rritje reale të pagave, por do të ketë një rënie të caktuar të vlerës reale të pagave të të punësuarve në sektorin publik.

Arsyeja tjetër për mos votimin e këtij projektligji është planifikimi i fondeve jo të mjaftueshme për njërin prej sektorëve më me perspektivë për ekonominë e Kosovës, konkretisht për degën e bujqësisë, për të cilën për vitin 2014 janë planifikuar 11,8 milionë euro për subvencione dhe 9,9 milionë euro për investime kapitale. Shuma prej 21,7 milionë eurove paraqet vetëm 1,28% të buxhetit të tërësishëm, që është përqindje më e vogël se ajo për vitin 2013, kur ishte 1,4% dhe që është përqindja e tillë më e ulët në regjion e që duke pasur parasysh strukturën e popullatës kosovare, pjesa e madhe e të cilës është popullatë rurale, sipas ekspertëve përkatës do të duhej të rritej edhe për disa herë dhe ashtu të krijohen kushtet për zhvillimin e kësaj dege të ekonomisë sonë, në të cilën janë të përfshirë afro 140 mijë familje kosovare, respektivisht afro 170 mijë persona.

Investimet e pamjaftueshme në bujqësi dhe trajtimi joserioz i bujqësisë nga ana e kësaj qeverie, ka bërë që për nevoja të konsumit të gjerë të importohen produkte bujqësore në vlerë deri në 600 milionë euro në vit e që paraqet një përqindje të lartë të importit total.

Kështu, falë politikave të gabuara buxhetore, në vend se të stimulohet bujku kosovar për të prodhuar atë që di dhe mundet më së miri, konkretisht produktet bujqësore, qytetari ynë detyrohet t'i nxjerrë eurot e veta jashtë vendit, për të blerë pemë dhe perime.

Vërejtja ime tjetër ka të bëjë me shpërndarjen e buxhetit nëpër komuna për vitin 2014. Pas analizës së tabelës me titull “Buxheti i komunave për vitin 2014”, shihet se komunat e Kosovës Lindore janë lënë pas dore nga kjo qeveri, për të mos thënë janë diskriminuar në mënyrë evidente. Kështu, nga kjo tabelë shihet se për vitin 2014, konkretisht për komunën e Kamenicës, si grand qeveritar janë paraparë vetëm 180 mijë euro, shumë e cila për mua shkakton një habi, sepse është grand më i vogël se sa i shumë komunave të tjera në Kosovë, si për shembull, të Kaçanikut, Shtimes, Shtërpçës, Zveçanit, Graçanicës dhe komunave të tjera dhe thua se është i nivelit të njëjtë me komunat që janë themeluar para disa vjetësh në fshatrat e ndryshme të Kosovës, si për shembull, me fshatin Ranillug, Junik, Kllokot. Por, as komunat tjera, si ajo e Artanës, e Gjilanit, e Vitisë, nuk kanë kaluar më mirë në ndarjen e grandeve qeveritare për investime kapitale, kuptohet, kur krahasohen me komunat tjera, që janë të përafërta me to, qoftë për nga numri i banorëve dhe qoftë për nga madhësia e territorit.

Të jemi të qartë, unë nuk po kërkoj që komunave tjera t'u zvogëlohet buxheti, por po kërkoj që edhe komuna e Kamenicës, por edhe ajo e Artanës dhe komunat tjera të Kosovës Lindore të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim, sepse një ndarje e këtillë e propozuar më bën të dyshoj që kjo qeveri synon të ndëshkojë qytetarin e Kosovës Lindore, për shkak të bindjeve dhe votës politike të tij.

Këtij projektbuxheti mund t'i bëhet vërejtje edhe sa i përket sektorit të drejtësisë, ku bëjnë pjesë Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Prokurori i Shtetit, Gjykata Kushtetuese, Instituti Gjyqësor i Kosovës dhe Komisioni për Ndihmë Juridike Falas, në të cilat institucione janë të punësuar 2 mijë e 866 persona e për të cilat, sipas këtij projekti, janë planifikuar afro 30 milionë euro, që paraqesin 1,77% të buxhetit.

Duke pasur parasysh gjendjen në të cilën ndodhet drejtësia kosovare, organet e të cilës janë të stërngarkuara me lëndë, zgjedhja e lëndëve të caktuara stërzgjatet me vite të tëra, andaj imazhi i gjyqësisë kosovare dita-ditës po zbehet, kurse qytetari ynë e ka humbur jo vetëm besimin në drejtësinë kosovare, por edhe shpresën se Kosova do të bëhet një vend ku sundon rendi dhe ligji, mendoj se Qeveria jonë duhet të investojë më shumë në këtë sektor, që ndikon në jetesën dhe sigurinë, si fizike ashtu edhe juridike të qytetarit tonë.

Vlerësoj se ngritja e përqindjes prej 1,77% në 4, respektivisht 5%, sa është mesatarisht në vendet e rajonit, do të ndikonte në përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e pagave të gjykatësve dhe prokurorëve tonë, të cilët nuk do të kishin nevojë të kërkonin punësim sekondar nëpër kolegje private dhe kështu do të mund të fokusoheshin 100% në zgjidhjen e lëndëve gjyqësore, duke plotësuar në një nivel shumë më të lartë nevojat dhe kërkesat e qytetarëve tanë, për një të mirë elementare njerëzore, që quhet drejtësi.

Vërejtja ime e radhës për këtë projektbuxhet ka të bëjë me financimin e universiteteve të reja publike, si atë të Pejës, Gjilanit, Gjakovës dhe Mitrovicës, për të cilat kjo qeveri

propozon që për vitin 2014, në emër të investimeve kapitale t'u ndahen nga 200 mijë euro për secilin veç e veç.

Duke pasur parasysh gjendjen e infrastrukturës, me të cilën disponojnë këto universitete, pastaj hapësirat e punës, numrin e madh të regjistruarve, si dhe kërkesat e studentëve dhe nevojat për një punë dhe cilësi të kënaqshme të studimeve, mendoj se 200 mijë euro nuk janë të mjaftueshme, as për universitetet që janë themeluar shumë vite më parë e që i kanë të zgjidhura probleme të shumta materiale e lëre më për universitetet të sapo themeluara.

Trajtimi i këtillë i këtyre universiteteve, tregon se kjo qeveri e ka iniciuar themelimin e tyre vetëm sa për nevojat e veta elektorale e jo për të themeluar institucione cilësor të arsimit të lartë.

Andaj, duke pasur parasysh këto dhe vërejtjet e lëshimet tjera që i ka dhe mund t'i bëhen këtij projektbuxheti, unë do të votoj kundër aprovimit të tij. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Qëndrimet tona rrjedhimisht janë të njëjta për shkak se edhe gabimet në këtë projektbuxhet janë të njëjta sikur viteve paraprake.

Unë do të flas pak për sektorin e sigurisë apo për projektbuxhetin për sektorin e sigurisë, i fokusuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në Policinë e Kosovës, në Ministrinë e FSK-së, respektivisht në Forcën e Sigurisë së Kosovës, por jo vetëm në këtë.

Për Ministrinë e Punëve të Brendshme ka ardhur sërish e njëjta qasje, i njëjti trajtim, me të njëjtit parametra ndaj kësaj strukture, e cila do të duhej të trajtohej krejtësisht ndryshe, krejtësisht në mënyrë më dinjitoze edhe me këtë projektbuxhet.

Njëkohësisht edhe për Forcën e Sigurisë së Kosovës nuk ka ndryshime, madje ky projektbuxhet megjithëse kemi përsëritur, ne do të duhet ta përsërisim prapë, nuk siguron as mirëmbajtjen dinjitoze të gjendjes shumë të vështirë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, pa lëre më të pretendohej për një zhvillim më shumë të kësaj force, për shkak se edhe qasja e Qeverisë së Kosovës ndaj Forcës së Sigurisë së Kosovës po vazhdon të mbetet e njëjtë, pra edhe në aspektin buxhetor.

Por, kësaj radhe do të fokusohem në një çështje, të cilën do të duhej që Qeveria e Kosovës ta zgjidhte dhe Qeveria e Kosovës nuk e ka zgjidhur duke e shkelur edhe ligjin, të cilin kjo legjislaturë e ka aprovuar. Pra, do të flas pak për sektorin e zjarrfikësve në Republikën e Kosovës.

Ky problem i zjarrfikësve po vazhdon të mbetet problem nëpër shumë vite. Të kujtojmë edhe njëherë se që nga viti 2003 deri në vitin 2011 zjarrfikësit ka qenë komponentë nën menaxhimin e komunave. Më 22 shtator të vitit 2012 është miratuar Ligji i ri për

zjarrfikës dhe shpëtim dhe po ashtu, është dekretuar brenda këtij viti më 7 tetor 2011 nga presidentja e Republikës së Kosovës.

Sipas dispozitave të këtij ligji ish-shërbimet zjarrfikëse dhe të shpëtimit, deri atëherë kompetencë e komunave, tani Njësi profesionale të zjarrfikjes dhe të shpëtimit, pra kalojnë në kompetencë të menaxhimit të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, respektivisht nën kompetencat e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Konform ligjit të cituar më lart, Ministria e Punëve të Brendshme ka nxjerrë edhe një numër të konsiderueshëm të udhëzimeve administrative me qëllim të qartësimit dhe rregullimit për më së afërmi të normave ligjore. Pra, janë nxjerrë më shumë apo rreth katër udhëzime të tjera administrative, por jo vetëm dhe, konform dispozitave ligjore të formës së prerë dhe shpjegimeve të mëvonshme, me udhëzime administrative, me vendim të ministrit të Punëve të Brendshme, është formuar edhe Komisioni për Realizimin e Transfereve Përkatëse.

Transferi formal është kryer në periudhën gusht-shtator 2012, nëse ju kujtohet. Përkundër kësaj, transferi real i buxhetit nuk është bërë asnjëherë, as me planifikimin e rregullt e as me rishikimet e buxheteve, as të vitit 2011 dhe as të vitit 2012 dhe po ashtu edhe të viteve pasuese.

Për më tepër, vetë kryeministri më datën 2.5.2013 mori vendim për transferimin e Njësisë profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit nga niveli komunal në nivelin qendror, pra nën kompetencat e Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave, respektivisht të Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke përfshirë edhe ndryshimet buxhetore, ndryshime këto të cilat nuk janë përfshirë as në projektbuxhetin të cilin ne sot po e diskutojmë dhe të cilin rrjedhimisht edhe do ta kundërshtojmë.

Si pasojë, shumë njësi nuk kanë mundësi t'i realizojnë as nevojat elementare të operimit, e jo më të investojnë në veshmbathje, pajisje të reja, furnizim me karburante për dimër, pagesë të energjisë elektrike dhe shpenzime të tjera.

Paramendojeni, shumë makineri të zjarrfikjes nuk kanë as sigurime, nuk kanë as karburante për të intervenuar, rrjedhimisht nuk kanë as regjistrime të makinave të tyre të intervenimit. Por, kjo qeveri nuk i ka dhënë një udhëzgjdhje as në këtë projektbuxhet këtij problemi shumë të madh, me të cilin po ballafaqohen zjarrfikësit dhe rrjedhimisht edhe qytetarët, si pasojë e mos efikasitetit të zjarrfikjes kudo nëpër komunat e Kosovës.

Pra, ky buxhet nuk garanton tashmë as mirëmbajtje dinjitoze, lëre më një investim serioz në institucionet e sigurisë. Si të tillë s'kemi se si ta përkrahim këtë projektbuxhet dhe do ta votojmë kundër.

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

**DONIKA KADAJ-BUJUPI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!  
Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe pse po na bie ta përsërisim, duhet të theksojmë se buxheti është instrumenti i vetëm për realizimin e politikave të Qeverisë në Kosovë, për shkak të specifikave që kemi. Mirëpo, ky buxhet i cili në rrethana normale do të duhej t'i adresonte prioritetet e vendit, të cilat rrjedhimisht do të pasonin me një zhvillim, realisht është një arnim. Dhe ky projektbuxhet i prezantuar mund të emërohet si projektbuxhet i cili do të arnojë në vitin e ardhshëm disa nga projektet e nisura, do të mbulojë disa nga projektet e përfunduara në këtë vit e që janë të parapara në këtë projektbuxhet, por nuk e ka asnjë element zhvillimor.

Duke i ditur problematikat e vendit, për shembull, unë e shtroj një pyetje: Si është e mundur, që në shëndetësi, në grandet për komuna e kemi një zvogëlim të buxhetit për 29 milionë euro duke e ditur se cila është gjendja e shëndetësisë sot, cilat janë prioritetet e këtij buxheti, këtu nuk po shihet?

Të mos pyes ku janë premtimet milionëshe, për shembull, për pagat dhe pensionet e rritura? Në këtë projektbuxhet nuk janë. Po i bie që ato premtime megalomane nuk kanë mundur t'i paguajnë qytetarët me taksat e tyre.

Jashtë kësaj, do të ndalem te disa defekte teknike, të cilat megjithëse jemi shtet i ri, me të vërtetë nuk guxojmë t'i kalojmë dhe nuk guxojmë t'i aprovojmë si të tilla. Për shembull, te tabela 1, të hyrat dhe shpenzimet kemi një shpërputhje prej 700 mijë eurosh me tabelën 2.

Te organizata buxhetore është niveli qendror, pagat, shërbimet, me tabelën 2 ka një shpërputhje prej 3 milionë e 321 euro. Pastaj te projektet kapitale, po dua ta theksoj edhe njëherë, edhe pse u tha, janë 7, 5 milionë euro mjete, të cilat thotë “pozicion i padefinuar”. Pozicion i padefinuar tek investimet kapitale, ku duhet projekti të ketë emrin, të ketë kodin, numrin dhe parallogarinë, si i tillë është në kundërshtim me çdo parim të buxhetit.

Mos definimi i mjeteve do të lejojë që gjatë vitit Qeveria të vendosë vetë, pa i dhënë llogari Kuvendit dhe askujt tjetër se ku do t'i dërgojë këto mjete.

Pastaj kemi përsëritje të projekteve, të cilat janë përfunduar. Për shembull, unë do t'i përmend tri rrugë për të cilat e di, sepse i kam parë vetë që janë të përfunduara në këtë vit. Bëhet fjalë për rrugën Tomoc, për të cilën janë ndarë 350 mijë euro, është shtruar në tetor, është përfunduar në tetor të këtij viti.

Njëjtë është edhe me një rrugë në fshatin Prekallë, të dyja në komunën e Istogut, pastaj rruga në Stapanicë, që është përfunduar shkel e shko gjatë fushatës, pa kurrfarë baze paraprake, e ka një gjerësi rreth 3,5m, do të thotë nuk përmbush asnjë standard dhe figuron si projekt i ri për vitin 2014. Tash qysh po i bie? Njëherë ne po i shtrojmë rrugët, pastaj po i alokojmë mjetet, pastaj po fillojmë me procedurat e tenderimit dhe të prokurimit. Kjo është shkelje dhe është e papranueshme.

Po kthehem në fillim, projekti thash është një projekt i arnesës, sepse vetë nga Qeveria janë dhënë të dhëna, 2,5% kemi të hyra, ndërkaq inflacioni është 2,8%, domethënë që jemi në rënie të vazhdueshme. Vendi nuk po zhvillohet ashtu si dëgjua sot këtu nga ministri. Janë indikacionet makroekonomike që tregojnë që kursimet po bien, po zvogëlohen, kemi mungesë të zhvillimit ekonomik dhe kjo është përditshmëri të cilën ne e përjetojmë si qytetarë. Mirëpo kjo jo veç pse përjetohej, dihet, thuhet nga të gjithë, po konstatohet edhe në të gjitha raportet që flasin për Kosovën. Do t'i referohem edhe Raportit të Progresit, i cili e thotë të kundërtën e asaj se çfarë u tha sot këtu nga ministri. Për shembull, në faqen 22 përshkruhet gjendja ekonomike në Kosovë, rritja ekonomike, thotë, është dobësuar dhe mbetet e brishtë, eksporti i mallrave është përkeqësuar, pabarazitë tregtare janë thelluar, investimet e huaja kanë rënë në nivelin e tyre më të ulët që nga viti 2005.

Tash, kjo është në kundërshtim me atë që po thuhet që ka zhvillim. Po, kjo gjendje e përshkruar mund të konstatohet përditë edhe në rrugë, edhe në bisedë me cilindo qytetar të Kosovës, i cili pavarësisht a është i kualifikuar, sepse kemi të dhëna edhe mbi individë që janë me arsimim të lartë, po të cilët çdo ditë e më shumë po i bashkohen karvanit të të papunëve, ose janë të pakualifikuar, kanë statusin e njëjtë, do të thotë janë të gjithë të papunë. Vazhdojmë të jemi do të thotë vendi me papunësinë më të lartë jo veç në rajon, por edhe në nivel global, në tabelat për varfëri dhe papunësi po vazhdojmë të prijme.

Prandaj, me një fjalë, kryeministri në fillim e tha: “ po ndihemi mirë si qeveri me këtë buxhet”, unë dua t'i them, se qytetarët e Kosovës nuk do të ndjehen mirë, asnjë kategori, duke filluar nga studentë e deri tek pensionistë. Po e theksoj edhe njëherë, ata të cilët u mashtruan që sa herë, edhe kësaj herë nuk janë të paraparë në këtë buxhet, për të pasur një rritje të pensioneve, ashtu siç iu tha.

Prandaj, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe unë si deputete nuk do ta votojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: I nderuar kryetar,

I nderuari Kabinet qeveritar,

Edhe unë i bashkohem vërejtjes së disa kolegëve deputetë që e apostrofun mungesën e një pjese të Kabinetit, pikërisht në një pikë dhe në një çështje kaq të rëndësishme. Por, unë për vete tash në këtë kohë edhe në këto momente jam i detyruar edhe me kërkesën e shumë kolegëve që ta sintetizoj fjalën time të paraparë dhe do të mundohem telegrafikisht t'i përmbledh shumicën e atyre ideve dhe koncepteve që i kam dhe vlerësimeve që i kam përmbledhur gjatë leximit të këtyre 300-400 faqeve që i ka buxheti, i cili nuk është edhe lehtë të trajtohet, pa një informim dhe pa një nivel edukativ.

Secili prej nesh do të dëshironim që ta kishim një buxhet me një shumë më të madhe. Kjo shifër që është konceptuar dhe paraparë në këtë buxhet, të gjithë pajtohemi se është më e vogël se e dhjetëra klubeve të futbollit në Evropë. Dhe, natyrisht që unë në këtë moment, ndoshta në cilësitë e ministrit do ta dëshiroja veten në secilin dikaster, vetëm ministër i

Financave, do ta kisha vështirë dhe të sikletshme që ta shpërndaj këtë buxhet dhe këtë shumë me prioritetet që i kërkon vendi. Megjithatë, ne dëgjuam këtu mjaft patetikë, mjaft retorikë në temën e numrave, një oqean i tabelave nuk përkojnë me zhargonin që dëgjuam. Ky buxhet nuk është për ditirambe, natyrisht, por edhe nuk është për ta atakuar në këtë nivel, pa ndonjë analizë të gjithëmbarshme profesionale.

Secili prej nesh do të ishte shumë i vlerësuar sikur të jepte ide dhe të na shpaloste nga përgatitja e tij ndonjë koncept se si ta rrisim këtë buxhet, pastaj, për shpërndarje të prioritetëve edhe mund të pajtoheshim me të nëse do të jepte prioritete, një vendi, një komune, apo një kategorie sociale apo çfarëdo qoftë, në shoqërinë tonë aq të nevojshme, për një buxhet edhe më të madh...

Pastaj, këtu edhe do të mund të pajtohesh edhe unë vetë, sepse në këtë Kuvend, në këtë foltore unë për veten time kam ngritur një nevojë të komunitetit të Malishevës, edhe jo për gjëra që natyrisht janë shumë të nevojshme, por për një artikull shumë jetik që i mungon një pjese të madhe të Malishevës, siç është uji i pijshëm. Këtu, kam bërë madje edhe një amendament për buxhetin e vitit të kaluar që të merret në konsideratë nga hartuesit e buxhetit, përkatësisht edhe nga ministri i Financave, për një popullsi e cila përfshin diku nga një burim i fshatit Senik, që do të furnizoheshin afërsisht 15 – 16 fshatra, ku numërojnë diku rreth 30 mijë banorë dhe do të zgjidhej një problem jashtëzakonisht jetik.

Unë për veten time e kam vënë këtu këtë propozim kur kam ngritur për dy vota. Unë tashti deri në aprovimin e këtij buxheti do të lloboj, do të bëj përpjekje ndërmjet këtyre leximeve, sepse këtë lexim do ta përkrah, do ta mbështes, por deri në leximin e dytë do të lloboj që gjithsesi ministri i Financave, për ta marrë edhe votën time dhe të miqve të mi që do të më mbështesin, duhet ta parasheh doemos edhe këtë projekt për ujësjellësin e shumë fshatrave të Malishevës, i cili ujësjellës krijohet nga një burim me rënie krejt të lirë, me një cilësi të jashtëzakonshme dhe mjaft të vlerësuar.

Kështu që unë për fshatrat Balincë, Llozicë, Vërmicë, Tërpezë, Carallukë, Drenoc, Buhavec, Kijevë, Mleçan, Plloçicë, Shkarashnik, të cilët nuk kanë fare ujë të pijshëm dhe për përforcim të fshatrave Senik, Bardh, Bellanicë, Ngucat, Temeçinë dhe fshatrat e tjerë, kërkoj që ministri i Financave t'i gjejë mundësi buxhetore edhe ta përfshijë këtë projekt, me të cilin ne do të vlerësoheshim nga komuniteti, nga banorët e Malishevës.

Unë edhe tani përpiqem që ta përmbyll fjalimin tim duke pasur mirëkuptimin e komunitetit të Malishevës për fshatrat tjera që jemi në hulumtim të burimeve të ujit, sepse është edhe pjesa tjetër që ka nevojë, por që ende nuk e kemi gjetur burimin e ujit. Dhe, natyrisht duke pasur edhe mirëkuptimin, duke shpresuar që kam mirëkuptimin e ministrit të Financave që në analiza të mëtutjeshme për leximin e dytë ta inkorporojë këtë projekt dhe projektet tjera që i sheh të arsyeshme, edhe pse kam mirëkuptimin për këtë buxhet, të cilin vërtet se është vështirë ta shpërndash në këtë numër, në këto shifra.

Megjithatë, për veten time po përpiqem që me shkrim ta dorëzoj gjithë fjalën, të cilën e kam përmbledhur në disa faqe dhe pastaj ju i lexoni dalëngadalë ato dhe do t'i vlerësoni e

do t'i vendosni në mundësitë buxhetore që i ka ky buxhet i kufizuar, natyrisht do ta quaja edhe me mundësi këtu që i kemi tani. Faleminderit!

KRYETARI: Armend Zemaj e ke fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegë deputetë,

Ministra të pranishëm,

Pa dashur ti përsëris ato që u thanë nga kolegët e mi nga Grupi Parlamentar i LDK-së, vlen të theksohet po ashtu, se ky buxhet ashtu siç kanë rrjedhur edhe shpenzimet për vitin 2013, si dhe niveli i të hyrave të akorduara, tregon qartë se kjo qeveri dhe ky dikaster i financave ka humbur kontrollin mbi hartimin adekuat të një buxheti që do të siguronte së paku një stabilitet financiar e lëre që ajo do të ishte më e mira si një shpresë për qytetarët e vendit që të jetë buxhet zhvillimor.

Këto janë të pakta, minimale dhe për mua është tregues i qartë që duhet votuar jo kundër, por duhet rishikuar në tërësi, në shumë aspekte, të cilat edhe u theksuan më parë.

Si mund të quhet buxhet zhvillimor një buxhet i cili nuk siguron një mirëqenie më të mirë për qytetarët e vendit? Si mund të kemi stabilitet financiar ku me këtë buxhet nuk krijohen kushte që nëpërmjet ngritjes së infrastrukturave dhe kapaciteteve, të luftohet informaliteti financiar, shpëlarja e parave si dhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit?

Andaj me këtë rast të shqyrtimit të këtij buxheti për vitin 2014, do të mundohem të trajtoj në pika të shkurta opinionin tim të financimit të sektorit të sigurisë se çka ofron ky buxhet.

Nga tabelat e paraqitura duket se ky segment për Qeverinë është më shumë periferik sesa element kyç që duhet përkrahur dhe zhvilluar, që dukuritë negative që po dëmtojnë vendin tonë, të minimizohen apo edhe të luftohen nga organet e sigurisë.

Kjo tregon qartë se strukturat e organizuara të Qeverisë janë të zhytura në afera korruptive dhe mospërkrahja për dikasterë të sigurisë nuk është interes i tyre, por interes i tyre është të krijojnë institucione të dobëta të sigurisë dhe që jetëgjatësia e krimit dhe korrupsionit të jetë favor për ta dhe përkrahësit e tyre parapolitikë.

Edhe këtë vit pagat për Policinë e Kosovës nuk janë prioritet i Ministrisë së Punëve të Brendshme. Kushtet e punës nuk janë të parapara të avancohen apo edhe infrastruktura për luftimin e krimit akoma është simbolike dhe e varur nga donacionet e jashtme, se sa investimet direkte në pajisje, makineri apo edhe mjete speciale të hetuesisë, të cilat janë më se të nevojshme që të kemi një polici të përgatitur, të pavarur, si dhe me kushte të përafërta me vendet e rajonit.

Policët e Kosovës sot i sheh të angazhuar në punë dytësore, që nga shitës, biznes e deri edhe bodiguardë të lokalet e natës, për të siguruar një pagë shtesë, për ta siguruar



mbijetesën familjare, jo të jenë imunë ndaj korrupsionit. Kjo është dashur që të jetë pjesë e prioriteteve të kësaj Qeverie, por shihet qartë se krijimi i vartësisë financiare është interes grupor se si do të operonin kazinotë, fajdetë, bastoret, tenderët, po të kemi polici efikase dhe mirë të financuar, apo ndoshta Qeveria edhe në vitin 2014 parasheh që të “vetëfinancohet” policia duke e vjedhur drogën në zyrat e sigurisë, duke e vjedhur arin e grumbulluar po ashtu në zyrat e sigurisë, si dhe duke keqpërdorur dosjet e krimeve për interesa të grupeve kriminale.

Kjo tregon, kolegë të nderuar deputetë, se prioritet në investime mbetet edhe për vitin e ardhshëm vetëm asfalti. E kjo më nuk ka shpjegim tjetër përpos që tregon qartë se kjo tani është dëshmuar se pikërisht aty është korrupsioni më i theksuar për qeveritarët e deri te manipulimet për tërheqjen e votave në lagje, rrethe të ndryshme për interesa provinciale e grupe.

Pothuaj se çdo vit në çdo dikaster qeveritar ndahen mjete për blerje të veturave, të cilat më shumë janë bërë luks se sa nevojë, e kjo tregohet me shpenzimet për karburante të cilat kanë shënuar rritje të theksuar duke bërë keqpërdorimin më të madh. Pothuaj se nuk ka zyrtar qeveritar i cili është pjesë e militantizmit partiak që nuk i shfrytëzon automjetet zyrtare për çdo ditë të javës, bile-bile edhe fundjavë për çështje private dhe të piknikut familjar.

Ndërsa, për vitin 2014 Ministria e Punëve të Brendshme ka paraparë që për autoblanda, limuzina të blinduara, automjete speciale të ndajë vetëm 1,2 milion euro, e kjo tregon më së miri se sa është kjo shumë minimale e cila jo që nuk siguron kushte më të mira pune dhe efikasitet të luftimit të krimit por zhvesh nga siguria dhe demotivon Policinë vendore që të përballlet me grupet kriminale anembanë Kosovës. Shembulli më i keq i mbrojtjes së jetës së policit është aksioni i 25 korrikut në veri dhe rezultati i saj për shkak të kushteve të këqija infrastrukturore të pajisjeve që është dashur të jenë të siguruara nga Qeveria ishin edhe fatale me humbjen e jetës së policit të Njësisë Speciale.

Në kuadër të kësaj shihet qartë se edhe Departamenti i Hetuesisë, për të cilin tash thuhet se është politizuar skajshmërisht për vitin 2014, parashihet blerja e pajisjeve në vlerë prej 150 000 eurove e kjo nuk do koment tjetër se kjo më shumë është ikje nga përgjegjësia dhe lënia e zhvillimit të hetimeve të fshehta në rrugë të dobëta dhe jo institucionale e ky segment është dashur që të jetë më i përgatitur si dhe më i pajisur me mjete të sofistikuara për luftimin e krimit dhe korrupsionit në vendin tonë.

Unë propozoj që të rishikohet në tërësi buxheti për institucionin e ofrimit të sigurisë, sepse me një buxhet në tërësi për të gjitha departamentet: polici, forenzikë, polici kufitare, inspektorat policor, Ministri të Punëve të Brendshme të jenë vetëm 18 milionë investime e që në përqindje është pothuaj se më pak se 1% e buxhetit të përgjithshëm vjetor, jo që do të kemi avancim, po do të kemi degradim total të këtij sektori.

Institucionet e sigurisë janë mbajtur po ashtu me premtime te kuota për rritje pagash, po edhe këtu shihet qartë se i ashtuquajturi fondi për rritje të pagave nuk do të ndahet as në këtë vit vijues për policinë, prokurorinë, gjykatat dhe institucionet tjera të sigurisë. Kjo

do të qartësohet si, ku dhe si do të dedikohet ky fond e jo të jetë pjesë e manipulimit kolektiv si dhe të përdoret në mënyrë selektive nga Qeveria nëpërmjet Ministrisë së Financave.

Kolegë të nderuar deputetë,

Rritja e shpenzimeve në mallra dhe shërbime e ulja e investimeve kapitale është tregues i qartë i vazhdimit të keqpërdorimit të Buxhetit të Kosovës, e gjitha sipas preferencave të ngushta politike. Si rezultat i kësaj politike, po e marr një shembull të fundit që ka ndodhur në shpërndarjen e këtij buxheti në një pjesë të infrastrukturës lokale ku Ministria e Infrastrukturës, përpos që parasheh të mbajë 11,4 milionë euro buxhet për rrugë lokale që me ligj do të duhej t'u takonte komunave, duhet shpalosur një fakt që unë e njoh, u potencua edhe nga kolegët tjerë deputetë që këto mjete po shfrytëzohen për të krijuar avantazhe të caktuara politike nëpër komuna.

Mund të shihni tabelën bashkëfinancimet komunale 16, 17, 18, tregon qartë manipulimet që bëhen nga kjo Qeveri në bashkëpunim me udhëheqësit e pandershëm e mashtrues në disa komuna të Kosovës e kjo ka ndodhur si pjesë edhe e kësaj fushate të fundit ku po theksoj vetëm disa shembuj në komunën e Deçanit.

Rrugët që tash janë të ndërtuara dhe të përfunduara dhe që parashihen që janë pjesë e vitit 2014 dhe disa prej tyre të cilat janë ndërtuar gjatë kohës së fushatës. Ndërtimi i rrugës Llukë e Epërm - Deçan, ndërtimi i rrugës Kodrali - Deçan, Lumbardh - Boliq - Deçan, ndërtimi i rrugës në fshatin Drenovc të cilat pothuaj se janë të përfunduara dhe kjo tregon qartë se çka është manipuluar në fushatë zgjedhore dhe si do të tenderohen këto rrugë.

Dhe, për fund, kolegë deputetë, projekti me interes nacional, rruga Deçan - Plavë, ky është mashtrimi i radhës elektorale, sepse me 400 mijë euro buxhet është vetëm hedhje sy gjëja po fillon ky investim i shumëpritur dhe i shumëpërfolur. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë. Mirë, thuaj dy-tri fjalë dhe shkurt, 2 minuta.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Si ministër i Infrastrukturës e ndjej për obligim që të sqaroj disa shqetësime të deputetëve, po më mirë të them edhe disa lansimeve të pavërteta rreth investimeve në Republikën e Kosovës, sidomos kur sulmohet investimi kapital i cili është interes jetik për qytetarët e vendit dhe ka prekur pothuajse secilin fshat të Republikës së Kosovës me investime kapitale.

Unë dua t'i sjell disa fakte të cilat flasin ndryshe prej kolegëve të mi deputetë, për atë që folën, por me një rast të caktuar do të pajtohem pjesërisht me një shqetësim që e ka ngritur një deputet, por edhe do të jap shpjegime se cila është gjendja reale për rastin e urës së Rakovinës.

Buxheti i propozuar i Ministrisë së Infrastrukturës për investime kapitale, i nderuar deputet, për vitin 2014 është 188 975 000 euro, prej tyre 153 884 000 euro ose 81,43% janë projekte të reja të propozuara nga Ministria e Infrastrukturës, ndërsa 35 000 000 ose 18,57% janë obligime të kontraktuara në vitin 2013 dhe që mbarojnë në vitin 2014.

Ky është demanti më i mirë për zotin Zemaj që tani flet për projekte të bashkëfinancimit me komunat ose edhe projektet të cilat kanë afat dyvjeçar të realizimit se është shumë normale që një pjesë e projekteve barten edhe për vitin pasues me buxhetin që është paraparë saktësisht nga Ministria e Infrastrukturës.

Të nderuar deputetë,

Dua të heq një shqetësim tuajin dhe të publikut, nëse ekziston, se është një fat shumë i mirë që ne nuk ngelim mbrapa...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Vazhdoje, por realisht debati është për deputetët që ju t'i dëgjoni vërejtjet e tyre. Atëherë, ia vazhdoni edhe pesë minuta.

FEHMI MUJOTA: Kryetar kërkoj falje, nëse ju keni menduar për çështje replike, por ndoshta si ministër i Dikasterit kam nevojë të jap ca sqarime dhe ju kisha kërkuar mirëkuptim që ta kem fjalën.

Atëherë, buxheti i vitit të ardhshëm kryesisht është i koncentruar në projekte kapitale të cilat janë prioritet i Qeverisë dhe janë këto: ndërtimi i autostradës Prishtinë-Hani i Elezit me 100 000 000 eurove, zgjerimi i rrugës nacionale Prishtinë-Mitrovicë, 20 000 000 euro, zgjerimi i rrugës nacionale Prishtinë-Pejë, 10 000 000 euro, rehabilitimi i linjës hekurudhore, për herët të parë kemi paraparë një buxhet të tillë, për rehabilitim të hekurudhës Leshak-Hani i Elezit në vlerë prej 10 000 000 dhe shtresimin e rrugëve magjistrale dhe regjionale që është prioritet i Ministrisë së Infrastrukturës për vitin 2014 që planifikojmë 6 000 000 euro të shpenzojmë për shtresimin e rreth 55 kilometrave të rrugëve magjistrale.

Dhe, po të shihet realizimi i buxhetit në këto projekte kapitale del se 77% e buxhetit në investime kapitale të propozuara nga Ministria e Infrastrukturës janë nga projektet me interes nacional, ndërsa pjesa tjetër është pjesë e buxhetit e cila prek të gjitha rrugët magjistrale regjionale dhe rrugët lokale.

Të nderuar deputetë,

Meqë diskutuat shumë për anësi politike në investime ose edhe anashkalim të projekteve të caktuara, atëherë më lejoni që unë para jush të prezantoj listën e gjerë të projekteve të komunave në të cilat ka investuar Ministria e Infrastrukturës dhe të cilat projekte sot e kësaj dite janë shumë të mirëpritura nga banorët e secilit lokalitet në të cilin është investuar.

Prandaj, tek bashkëfinancimi me komunat, të nderuar deputetë, dua t'i precizoj këto gjëra. Gjithsej nga viti i kaluar dhe një pjesë e buxhetit që është bartur në vitin e ardhshëm janë të parapara 11 401 000 euro. Për vitin e ardhshëm do të kemi 2 190 000.

Cilat janë rrugët në të cilat kemi pasur bashkëfinancim? Është financimi i rrugës Gllarevë-Rixhevë-Stepanicë-Klinë, zgjerimi ose asfaltimi i rrugës së fshatit Carralevë-Rancë, rruga Petrovë-Vranisht, rruga Dremjak-Mollopojç-Jezerc, rruga në fshatin Dubravë të Kaçanikut, asfaltimi i rrugës Gelancë, segmenti në drejtim të fshatit Novadë në Suharekë, rruga e fshatit Llukavc-Frigodë-Vrellë-Istog, rruga "Brahim Ademi" dhe "Driton Islami" Ferizaj, rruga Viçkë-Kashtanjevë-Shterpcë, rruga Berishë-Qendër-Moronicë-Junik, rruga Novosellë-Lipë, faza e dytë Pejë, rruga Karaçë-Gumnishtë-Vushtri, renovimi i rrugës Drenovc-Bajincë dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Nekoc-Drenas, asfaltimi i rrugës në fshatrat Klinë dhe Prekaz, ndërtimi i rrugës lokale në Klinë të Ulët, asfaltimi i rrugës në fshatrat Llapçevë-Astrazub-Berishë-Dragobi dhe Bubavec, Malishevë, Asfaltimi i rrugës në fshatrat Zhegër-Lladovë-...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Urdhëro ministër, një sqarim...

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, kryetar, e di që ndoshta nuk ka nevojë t'i arsyetoj 100 e më tepër projekte të realizuara që janë në gjithë Republikën e Kosovës. Çështja e urës së Rakovinës, i kisha mbetur borxh nëse nuk i kisha thënë këto fjali.

I nderuar Gjini, e di që keni ngritur pak më tepër se duhet nëse është shqetësim ose realisht ashtu qysh është shqetësimi, por unë ju them një gjë, Ministria e Infrastrukturës ka paraparë buxhetin për urën prej 2 117 000 euro dhe prioriteti i Ministrisë është ura e Rakovinës. Problemi është ky. Në tri konkurse asnjë operator i Kosovës për kontraktim s' ka konkurruar dhe është dashur të shtyhet deri tani dhe jemi të detyruar që për herën e katërt të përzgjedhim një kompani ndërkombëtare që të bëjë projektin. Pa projekt nuk e bëjmë këtë urë, megjithatë ura është tash në funksion, qarkullon komunikacioni, jo në mënyrën më të mirë por pa projekt, pa procedura nuk e bëj këtë urë. Në pranverën e vitit të ardhshëm do ta kemi urën e re. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Kryetar, pa dashur se ikja nga përgjegjësia është model tashmë i kësaj Qeverie dhe mua më vjen keq edhe pse ministri Mujota që ndoshta është i rralli këtu që është më i respektuari hyn në këto ujëra, por demanti më i mirë qëndron vetëm të shikohet ueb-faqja e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe të shihen a iu ka nënshtruar këtyre procedurave këto rrugë që unë i përmenda. Domethënë rrugë që janë të asfaltuara, janë të kryera dhe parashihen ndarje e buxhetit për vitin 2014. Dhe ky është shqetësimi im.

Dhe si është e mundur zoti ministër që të gjitha këto, shumica e këtyre rrugëve, pikërisht kanë filluar, janë shtruar, janë rregulluar në muajin tetor dhe në fillim do të thotë të

muajit shtator? Kjo është dilema ime dhe e qytetarëve të Deçanit për keqpërdorime dhe manipulimet e nivelit nga Qeveria, njerëzit tuaj, deputetët tuaj me kryetarin e komunës aktual.

KRYETARI: Sqaroje ministër, veç kjo nuk është lehtë të sqarohet.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: I nderuar deputet Zemaj, Ju mungon edhe një informacion, Ministria e Infrastrukturës për këto dy vjet ka bërë decentralizimin e shumicës së buxhetit për bashkëfinancim, me buxhetin, me procedurat dhe me të gjitha elementet që i takon ndërtimit të një rruge kanë ndodhur në komuna. Ne e përcjellim shpenzimin e buxhetit, realizimin e punimeve dhe paguajmë për punët e kryera. Të gjitha ato procedura janë të udhëhequra nga komunat.

KRYETARI: Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar, Mua më duhet t' i them ministrit vetëm kështu. Nuk e kam për qëllim ta fyej kurrkënd dhe do të isha i lumtur sikur kjo urë të kishte qenë në buxhet për t'u riparuar, por ne nuk e dimë çka ka në kokë ministri, çka ka në mend.

Ne jemi duke e aprovuar një ligj dhe këtu shkruhen sendet. Te ndërtimi i urave dhe mirëmbajtja e urave, zoti ministër shkruan vetëm ndërtimi i urës në fshatin Zallq. Kurrkund nuk shkruan riparimi i urës së Rakovinës. Unë nuk mund të di çfarë ju keni në mend e çka planifikoni të bëni nëse nuk e shkruani në buxhet, por në këtë projektbuxhet që e keni sjell ju nuk po shkruan çka po thua ti tash.

Ky është problemi im dhe unë do të isha mirënjohës nëse kishte shkruar këtu, por s'po shkruan. Çka të bëj unë tash, kujt t'i besoj a ligjit që e aprovon Kuvendi apo çka po thoni ju?

KRYETARI: Urdhëro ministër, një minutë e ke.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Deputet Gjini, keni të drejtë në specifikimin që nuk ekziston si ura e Rakovinës, por derisa mos ta kemi projektin në detaj, nuk kemi pasur ndonjë para masë - parallogari se cili është çmimi i urës, prandaj në kuadër të 2 milionë e më tepër euro është ura e Rakovinës në prioritetin numër 1 dhe kjo do të jetë, pa asnjë shqetësim për të.

Ndërsa, ka edhe buxhet tjetër i cili është sulmuar pak më herët, se nuk është i precizuar tek investimet te shtresimet e rrugëve për magjistralet, rreth 6 milionë janë paraparë në 55 kilometra në gjitha rrugët magjistrale, prandaj ne duhet të specifikojmë secilën pjesë dhe këto do të ndodhin brenda vitit 2014.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Qeveria e Kosovës nuk ka vizion për zhvillim ekonomik, e lëre më plan konkret. Qeverisë i intereson vetëm që Fondi Monetar Ndërkombëtar të mos hidhërohet e dihet se FMN është kollaj të mbahet e kënaqur përderisa asaj i interesojnë vetëm numrat përfundimtar të barazuar dhe jo proceset ekonomike dhe struktura e ekonomisë së vendit tonë.

Me këtë buxhet që e kemi para vetes nuk plotësohen nevojat e qytetarëve, nuk rriten mundësitë për qytetarët dhe imponohet shkelja e të drejtave të tyre për jetë të dinjitetshme.

Edhe kur flasim për buxhetin, edhe kur e shpenzojmë atë, kjo Qeveri me këtë kryeministër e këta ministra, nuk flasin si për një pasuri të shtetit që u shërben qytetarëve, ndërkaj këta e menaxhojnë përkohësisht, por flasin si për një pronë të tyre që të gjithë qytetarët e Republikës i kthen në shërbëtorë, argatë ose klientë.

Në këto gati 3 vjet të mandatit të saj, duket qartë se Qeveria e Kosovës në fakt parqet veçe administratën e dy çifteve të korporatave të mëdha - 'Bechtel-Enka' dhe 'Limak-Çalik'.

Pas njërës autostradë që synojnë ta vazhdojnë me tjetrën në drejtim të Shkupit dhe pas shitjes së Distribucionit dhe Furnizimit të KEK-ut e me orvatje të vazhdueshme për ta privatizuar PTK-në, këta duan të zgjerohen si administratë e korporatave që po e pronësojnë Kosovën dhe po e shpronësojnë publikun.

I kotë paska qenë edhe Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për vitin 2013, pasi që të gjeturat dhe vërejtjet e tij nuk i adreson Projektbuxheti për vitin 2014.

Investimet e huaja direkte kanë rënë në nivelin më të ulët prej vitit 2005, në 4,3% të bruto-produktit vendor dhe gjysma e tij shkon në patundshmëri dhe sektorin e ndërtimit, 12% në shërbimet financiare dhe vetëm 13% kanalizohen në prodhim.

Deficiti tregtar i Kosovës është 35,1% të bruto produktit vendor, pra më i lartë se 1/3 e bruto produktit vendor.

Bruto produkti vendor për kokë banori në Kosovë është sa 1/9 e mesatares të vendeve të Bashkimit Evropian.

Mjetet e grumbulluara nga TVSH-ja janë mbi dyfishin e atyre nga tatimi mbi korporatat, 47% kundrejt 22%.

Edhe me këtë projektbuxhetin e vitit 2014 të hyrat vendore nuk përbëjnë as 40% të të hyrave doganore.

Raporti i Progresit 2013 thekson që buxheti për gjyqësorin për vitin 2012 në Kosovë ishte 0,47% të bruto produktit vendor.

Numri i lëndëve të grumbulluara u rrit nga 218 mijë e 740 lëndë në pritje në vitin 2012, në 235 000 sosh në vitin 2013. Ndërkohë, shprehja më e përdorur në deklaratimet verbale dhe ligjërimin publik të kësaj Qeverie është sundimi i ligjit.

Krahasuar me buxhetin e vitit 2013, tani që e kemi para vetes, është edhe më ultë në përqindje sa i përket drejtësisë.

Në njërin anë, papunësia në Kosovë është edhe enorme edhe po rritet, ndërkaj në anën tjetër, sipas Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2013, më shumë se 800 zyrtarë publikë në Kosovë kanë më shumë se dy vende pune e disa prej tyre deri në pesë vende pune.

Agjencia kundër Korrupsionit ka sugjeruar që zyrtarët të mos lejohen që të kenë më shumë se një vend pune. Jo vetëm që kjo nuk u përfill, por ka aq shumë zyrtarë që vazhdojnë të kenë biznese private ose nuk bëjnë deklaratimin të AKK-ja kur marrin postin publik.

Gjithnjë sipas Raportit të Progresit, gjatë vitit 2012, 2 261 biznese të reja janë regjistruar, kjo rritje është prej 20% krahasuar me vitin paraprak.

Në anën tjetër 334 biznese janë mbyllur ose 16,7% më shumë se sa në vitin 2011. Pra, më kollaj se përpara njëmend hapen bizneset, por më vështirë se përpara ato arrijnë të rriten dhe mandej rritet numri e përqindja e tyre që falimentojnë.

Doktrina e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme është përqendruar te lindja e bizneseve dhe jo te rritja e tyre, prandaj edhe jeta e këtyre bizneseve është edhe e vështirë edhe e shkurtër.

Biznesi në Kosovë konsideron mungesën e qasjes në financa, ndërprerje të energjisë elektrike, konkurrencën jo fer ndërmjet ndërmarrjeve lokaleve dhe korrupsionin si pengesat kryesore të të bërit biznes.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Gjendja socio-ekonomike e një shteti nuk ka të bëjë me historinë e popullit, nuk ka të bëjë me kulturën e shoqërisë, nuk ka të bëjë me gjeologjinë e territorit, por mbi të gjitha e para se gjithash ka të bëjë me modelin ekonomik.

Se nuk e kanë ndërmend ta zhvillojnë Kosovën tregojnë aq shumë elemente. Buxheti për Ministrinë e Infrastrukturës është shtatëfish më i lartë se sa buxheti për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Tri ministritë që mund ta bëjnë dhe përbëjnë shtetin tonë zhvillimor, pra Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, marrë së bashku u ndahen vetëm 4,3% të buxhetit.

Rriten pagat dhe mëditjet, rriten shpenzimet për mallra dhe shërbime, rritet për 50% huazimi i brendshëm, bie për më shumë se 30% subvencionimi i ndërmarrjeve publike,

gjersa për autostrada ndahen 59 herë më shumë se sa për “Trepçën”, së cilës nuk i dedikohen as 2 milionë euro.

Në këtë projektligj për buxhetin 2014, Kosova është mall që duhet harxhuar dhe jo vetëm ekonomi që duhet zhvilluar.

Më tutje, krahasuar me buxhetin e vitit paraprak, në këtë buxhet për vitin 2014 i rritet buxheti Zyrës së kryeministrit për gati 1 milion euro dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit për mbi 3 milionë euro, kurse i zvogëlohet buxheti Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për më shumë se 1 milion euro, ndërkaq Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për më shumë se 11 milionë euro.

Se nuk është në fokus as demokracia dhe as të drejtat e qytetarëve e dëshmon privilegjimi sërish i Zyrës së Kryeministrit, buxheti për të cilin është mbi 12 milionë euro, ndërsa buxheti për Kuvendin e Kosovës është 90 milionë euro kur t’i hiqet RTK-ja.

Njëkohësisht vetëm buxheti i Kabinetit të kryeministrit, pra jo i zyrës së tij, është sa dyfishi i buxhetit për institucionin e Avokatit të Popullit.

Për fund, te buxheti i paraparë për Ministrinë e Punëve të Jashtme, pagat dhe mëditjet rriten për 32,3% përderisa numri i të punësuarve aty mbetet i pandryshuar, 272.

Shpenzimet për vetura më shumë se dyfishohen për administratë nga 100 000 euro në 210 000 euro, kurse për ambasada nga 120 000 në 250 000 euro.

Pas 88 000 eurove në këtë vit janë paraparë edhe 50 000 të tjera për makina fotokopjuese në administratë, si dhe 60 000 të tjera nëpër ambasada. Makinat fotokopjuese këtu ngjajnë si bimë njëvjeçare.

Nuk sqarohet se çka nënkuptohet me pajisje të tjera, furnizimi me të cilat në ambasada do të dhjetëfishohet nga 15 000 në 150 000 euro, e të tjera, e të tjera.

Me kesi buxheti, Qeveria sërish rreshtohet në regjistrin e problemeve të Kosovës e jo të zgjidhjeve për Kosovën.

Kur kemi qeveri të padrejtë dhe të padobishëm, atëherë gjithsesi kundërshtimi i saj nga Kuvendi është edhe i drejtë edhe i dobishëm. Prandaj ju bëj thirrje që ky buxhet i propozuar për vitin 2014, të mos votohet dhe të mos kalojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti)*

KRYESUESI: Fjalën e ka kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,  
Kabinet qeveritar,



Nuk kisha ndërmend të marr fjalën, por megjithatë janë disa çështje e ndoshta kryesorja është mosrespektimi i ligjeve në hartimin e buxhetit.

Ne të gjithë do të kishim dëshiruar që vërtet buxheti i Kosovës, i shtetit të Kosovës, të jetë buxhet zhvillimor, por me 1 590 000 000 euro, realisht s'mund të jetë buxhet zhvillimor, është një buxhet i konsumit.

Po a ka mundësi Kosova ta ketë një buxhet më të mirë? Unë e kam një bindje që do të mund ta kishte buxhetin diku rreth 2 miliardë euro dhe pastaj mund të flisnim për një zhvillim.

Po ia shtroj një dy-tri pyetje ministrit të Financave. Qeveria dhe Ministria e Financave - a kanë ndonjë studim të planifikuar për rritjen e buxhetit të Kosovës në vitet e ardhshme?

A ka Administrata Tatimore e Kosovës kapacitete që mbledh më shumë tatime të brendshme në Kosovë?

Çështja tjetër - Sa do t'i shërbejë buxhetit, cila do të ishte shuma që mund të hynte në Buxhetin e Kosovës sikur të mos e kishim ekonominë informale në nivelin që e kemi? Dhe, unë mendoj që në Kosovë ka shumë ekonomi informale.

Njërën nga degët më të zhvilluara në Kosovë e kemi degën e ndërtimtarisë. Sa nga kjo degë e zhvilluar në Kosovë hyn buxhetin e Kosovës.

Dhe, sa do të mund të shtohet shuma në buxhetin e Kosovës nëse do të ishte një kontroll më i mirë në kufi të Kosovës, e kam fjalën për Doganat e Kosovës?

Kurse çështja për të cilën dola të flas, është për një ligj që e kemi miratuar dhe për një agjenci që e kemi formuar në këtë vit.

Me qëllim të planifikimit, të ndërtimit, administrimit dhe menaxhimit të komplekseve memorialë, Kuvendi i Kosovës me datë 19.3.2013 ka aprovuar Ligjin numër 04-L/146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

Kuvendi i Kosovës, në përputhje me nenin 6 të këtij ligji, me 12.7.2013 e ka zgjedhur drejtorin e Agjencisë.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, me rishqyrtimet e buxhetit për vitin 2013, në përputhshmëri me nenin 6 të këtij ligji për Agjencinë ka ndarë për paga dhe mëditje 13 000 euro, për mallra dhe shërbime 10 000 euro, ndërsa për projekte kapitale 750 000 euro të destinuar për memorialin "Adem Jashari".

Fillimisht në dëgjimet buxhetore për vitin 2014, Ministria e Financave nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të gjitha projektet e komplekseve memoriale ashtu siç janë të dhënat në shtojcën 1 të Ligjit numër 04-L/146 i ka bartur në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për mirëmbajtje të komplekseve 75

000 euro, për paga dhe mëditje 63 000 euro, për mallra dhe shërbime 50 000 euro dhe shërbime komunale 10 000 euro.

Menjëherë pas kësaj, me intervenimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji që u cek më lart, të gjitha projektet janë kthyer në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përveç projektit të Prekazit, me arsyetimin se kanë punë të kontraktuara edhe për vitet e ardhshme. Këto pretendime nuk qëndrojnë ngase kontrata të tilla kanë vetëm për projektin e Krushës dhe atë të Zahir Pajazitit.

Lidhur me këtë propozoj që Komisioni për Buxhet dhe Financa, gjatë shqyrtimit dhe amendamentimit të këtij ligji t'i përfshijë dakordimet buxhetore të aprovuara sipas aneksit 1, Qarkorja e tretë buxhetore, kufijtë final për buxhetin e vitit 2014 dhe vlerësimet për vitet 2015 - 2016 dhe Agjencisë t'i mundësohet menaxhimi me projektet e sipërcituara dhe t'i kthehet funksionimit normal në bazë të ligjit që e kemi miratuar.

Është edhe një çështje që dua ta them, pasi jemi te kompleksi memorial. Ka vite që është një kërkesë për ta restauruar dhe mbrojtur kompleksin. Dhe, me këtë shumë që është dhënë në buxhet nuk mund të restaurohet kompleksi. Ajo është një histori dhe ajo histori do konservuar. Dhe konsideroj se Qeveria e Kosovës, Ministria, por edhe komisionet përkatëse nuk kanë qenë në përgjegjësinë e duhur për ta mbrojtur këtë vepër historike që nuk i duhet këtij brezi, por që u duhet brezave të ardhshme për ta njohur historinë e vërtetë se çka ka ndodhur në atë vend. Kjo mendoj që është papërgjegjësi e gjithë neve.

Një çështje tjetër që dua ta diskutoj është çështja e komunës së Drenasit, pasi këtu po flitet dhe bëhen krahasime dhe unë pata rastin këtë vit të njihem më për së afërmi me gjendjen në atë komunë dhe të gjithë e dini pse janë krijuar barsoleta të ndryshme për Drenicën e Drenasin dhe ato barsoleta tregojnë se aty gjithçka, do të thotë mirëqenia është në kulm. Unë po ju them që në Drenas nuk ka asnjë rrugë që mund të quhet rrugë e kualitetit, në Drenas nuk ka asnjë ujësjellës të përfunduar. Edhe për rrugët, edhe për ujësjellësin, edhe për kanalizimin komuna e Drenasit është komuna më e prapambetur në Republikën e Kosovës dhe unë jam i bindur që nuk e meriton.

Unë nuk them që krejt kjo çështje është e buxhetit, sigurisht që është edhe mosdija në qeverisje, por unë ju them që kushdo mund ta vërtetojë këtë, asnjë projekt, asnjë rrugë, asnjë kanalizim dhe asnjë ujësjellës në komunën e Drenasit nuk është i përfunduar. Dhe edhe aty ku është punuar diçka, është punuar keq, prandaj konsideroj që buxheti që afrohet për këtë komunë nuk i plotëson kushtet për ta ndryshuar dhe për të ngritur kualitetin e jetës së qytetarëve të Drenasit. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka zonja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë dhe ju ministra që jeni të pranishëm,

Ashtu siç u tha nga shumë kolegë buxheti 2014 është buxhet i varfërisë dhe nuk siguron zhvillim ekonomik që do të rezultonte me krijimin e vendeve të punës.

Qytetarët e Kosovës disa herë, por në veçanti gjatë fushatës së fundit u manipuluan me premtime për rritje pagash, që në fakt është një rritje e rreme. Fondi për paga siç dëshmohet nga buxheti që po e shqyrtojmë është rritur vetëm me 48 000 000 euro dhe nuk siguron rritje më të madhe se 7%, që nuk do të thotë asgjë duke pasur parasysh nivelin e inflacionit në Kosovë.

Në anën tjetër, pjesa dërmuese e këtij fondi do të shkojë për t'i mbuluar pagat e stafit të ri që është punësuar në universitetet e reja të themeluara duke dëshmuar kështu se nuk ka rritje për institucionet e ndryshme publike siç kishte premtuar kryeministri vazhdimisht.

Një mashtrim tjetër elektoral ishte ai për rritje të pensioneve, por buxheti që është sot para nesh e dëshmon të kundërtën, pra edhe mbi 120 000 pensionistë nuk do të mund të presin rritje të pensioneve nga ky buxhet.

Një shqetësim tjetër esencial është se në këtë projektligj për buxhetin e vitit 2014, është po shpërfillen një sërë ligjesh të tjera në fuqi, edhe pse kjo nuk po ndodh për herë të parë natyrisht meqë Qeveria kishte praktikuar diçka të tillë edhe gjatë miratimit të buxhetit të vitit të kaluar. Fjala është për shkelje të Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe të Ligjit për arsim komunal.

Neni 17 i Ligjit për vetëqeverisje lokale përcakton kompetencat e komunave si në fushën e arsimit fillor e të mesëm, ashtu edhe sa i përket rrugëve lokale. Ligji për arsimin komunal në anën tjetër, përkatësisht nenet 5 dhe 8 të këtij ligji përcaktojnë se është përgjegjësi dhe kompetencë e komunave që të ndërtojnë shkolla të këtyre niveleve nga buxheti i tyre, që nënkupton se këto mjete duhet t'u ndahen nëpërmjet buxhetit të miratuar në Kuvend.

Ndërkaq, neni 7 i po të njëjtit ligj sqaron se sa i përket kompetencave të Ministrisë së Arsimit në ndërtimin e shkollave, kjo përfshin ofrimin e asistencës teknike për komunat, nëse një gjë e tillë kërkohet nga ato.

Pra të dyja këto ligje qartë potencojnë se për arsimin fillor dhe të mesëm përgjegjëse janë komunat dhe këtu përfshihet edhe buxheti për ndërtimin e shkollave të këtyre dy niveleve arsimore. Megjithatë, në vend se buxheti për ndërtimin e këtyre shkollave t'i alokohet komunave, pra fondet të barten te këto, ai në fakt në kundërshtim me ligjin po i alokohet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Në rastin konkret, fjala është për mbi 20 000 000 që i janë ndarë kësaj Ministrie edhe për ndërtimin e shkollave të këtyre niveleve, gjë të cilën vazhdimisht e kanë bërë pastaj sipas preferencave politike, siç e dëshmon edhe praktika.

Shkelja e ligjeve që i përmenda ndodh edhe te buxheti për infrastrukturën lokale, sepse në vend që buxheti prej 1,4 milion për ndërtimin e rrugëve lokale t'i bartet komunave, meqë me ligj është kompetencë e tyre, ky buxhet i është ndarë Ministrisë së Infrastrukturës.

Shkelje të tilla përfundimisht, përveç që bëhen për qëllime politike e dëmtojnë baraspeshën e funksionimit të pushtetit lokal në Kosovë, si dhe bazën ligjore për funksionimin e qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

1 miliard e 589 milionë në total është buxheti i shtetit për vitin 2014. Në vitin e kaluar kam thënë se është buxhet i harmonizuar në tërësi me Fondin Monetar Ndërkombëtar, ndërsa në këtë vit jo vetëm që është i harmonizuar me FMN, por është buxhet i lavdëruar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, sepse është një buxhet zhvillimor, ruan stabilitetin financiar, parasheh investime kapitale dhe gjithsesi është shumë me rëndësi parasheh rritje të pagave dhe rritjen ekonomike, nuk ka shkurtime buxhetore e një trend i vendeve të rajonit, por edhe disa vende të Evropës.

Para se të hy në disa plotësime të nevojshme që duhet t'i bëhet buxhetit të vitit 2014 duhet theksuar se si asnjëherë më parë ky buxhet është mbështetur dhe lavdëruar nga mekanizmat makro financiarë botëror, Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ashtu si edhe viteve të kaluara, edhe buxheti i vitit 2014 është buxhet që është përcjell më shumë debate brenda dhe jashtë kësaj sale, gjë që është normale kur debatohet për një buxhet të shtetit, por të paktë ishin ata ekspertë që vlerësuan realisht buxhetin e shtetit. Më shumë u është dhënë hapësirë kritikave në bllok të analistëve, të cilët edhe në të kaluarën kanë kritikuar ashpër projektbuxhetet e Qeverisë, por që asnjë nga supozimet e tyre nuk kanë dalë të sakta.

Ky buxhet jo vetëm se është zhvillimor, por ofron edhe rritje ekonomike, por është edhe një ndër buxhetet më të balancuara që ka ardhur ndonjëherë në këtë Kuvend. Bile, pas një analize më të detajuar mund të vërehet se një disbalancë e vogël e buxhetit është në favor të opozitës e cila, edhe pse po e kundërshton këtë buxhet, në asnjë rrethanë, në asnjë mënyrë deri më tani nuk do të kishte mund as vetë më mirë të planifikonte investimet në komunat të cilat i udhëheq ajo.

Prandaj, partitë opozitare do të duhej që edhe ta mbështetnin këtë projektbuxhet për arsye se Qeveria ka treguar një profesionalizëm të lartë në hartimin e këtij projektbuxheti.

Shpresoj që kryetarët e komunave nga Partia Demokratike e Kosovës të mos bëjnë vërejtje për shkak të ndarjes politike të buxhetit, që shkon në favor të komunave që nuk udhëhiqen nga Partia Demokratike. Prandaj për këtë profesionalizëm të lartë të Qeverisë së Kosovës, opozita do të duhej ta mbështeste dhe jo ta kritikonte apo në tentativë që ta

shantazhonte kryekëput me arsyetime jo të qëlluara, por kryekëput me arsyetime elektorale.

Se Qeveria ka planifikuar me anë të këtij buxheti të investojë më tepër se në komunat të cilat nuk i udhëheq, po e bëj vetëm një analizë të shkurtër, të nxjerra nga disa investime për grandet komunale në komunat të cilat i udhëheq Partia Demokratike dhe në ato të cilat nuk i udhëheq Partia Demokratike. Për shembull, në Prizren janë planifikuar 15 milionë e 500 mijë euro investime, ndërsa në Prishtinë janë të parapara 27 milionë e 568 mijë euro, që i bie dyfishi i investimeve të parapara në Prizren, e që në fakt numri i banorëve dhe numri i zhvillimit të qyteteve nuk është i tillë.

Në Mitrovicë janë paraparë 3 700 000 euro, ndërsa në Gjakovë 5 500 000 euro. Në Skenderaj 2 920 000 euro, ndërsa në Podujevë 5 830 000 euro. Në Klinë, që udhëhiqet nga Partia Demokratike, janë 2 240 000 euro ndërsa në Suharekë janë 5 000 000. Në Shtime janë 1 500 000, ndërsa në Fushë-Kosovë 2 700 000. Në Kaçanik janë 1 500 000, ndërsa në Istog janë 2 300 000. Në Gjiilan janë 3 800 000 euro, ndërsa në Pejë 5 100 000. Përafërsisht analizën e kam nxjerrë te numri i barabartë i banorëve për qytete.

Pra, kur i analizon këto në detaje, atëherë del se nuk ka ndonjë disbalancë në këtë buxhet dhe ky nëse mund të thuhet se është një disbalancë, atëherë ky është në favor të opozitës dhe kjo dëshmon një profesionalizëm të lartë të ekspertëve të Qeverisë së Kosovës për të trajtuar në mënyrë të njëjtë të gjithë qytetarët e vendit që nuk ishte praktikë në të kaluarën e këtyre që po e kundërshtojnë sot këtë projektbuxhet.

Andaj, të nderuar kolegë të opozitës tejkaloni inatet personale, kundërshtimet në bllok, bëhuni pak më realistë, gjykoni për interesa të përgjithshme, jo për ato të ngushta politike dhe pranoni se ky është një buxhet zhvillimor, që garanton rritje ekonomike, rritje të pagave, investime në infrastrukturë që nuk kanë mund në të kaluarën as të ëndërrohen.

Analizat dhe vajtmet që janë bërë buxheteve të viteve paraprake 2011, 2012 dhe 2013 dolën se ishin të paarsyeshme dhe pa vend. Asnjëra prej supozimeve të ashtuquajturave ekspertë nuk dolën të sakta, edhe pse vajtmet u mbështetën nga analistë dhe vajtues gjoja edhe të pavarur. Nuk besoj se ka vend në rajon që është duke lëvizur në aspektin infrastrukturor më shumë se Kosova dhe se e ka ruajtur stabilitetin financiar dhe rritjen e ekonomike. Javën e ardhshme besoj se do të përurojmë autostradën “Ibrahim Rugova” dhe po besoj shumë se shumë shpejt do të fillojmë edhe me ndërtimin e autostradës në drejtim të Shkupit.

Gjithsesi mendoj se ky buxhet do të plotësohet edhe me disa vërejte të vogla dhe ato do t’i paraqes si në vijim.

Te investimet kapitale në kuadër të Ministrisë së Arsimit, te ndërtimi i shkollave në Projektbuxhetin e vitit 2013, është paraparë ndërtimi i shkollës në Qirez, që është një projekt për vitin 2013/2014 në një shumë prej 1 milion euro, ndërsa në tabelat buxhetore të vitit 2014 janë të planifikuara vetëm 10 mijë euro, por besoj se ky është vetëm një lëshim teknik dhe nuk është në aspektin e planifikimit afatgjatë në atë nivel.

Gjithsesi kur jam te komuna e Skenderajt kërkoj që të vazhdohet me projekti e ndërtimit të banesave për familjet e dëshmorëve që nuk është paraparë në këtë projektbuxhet, ndërsa është dashur të jetë projekt në vazhdimësi nga projektbuxhetet e viteve paraprake.

Të nderuar kolegë deputetë,

Në veçanti anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa, kërkoj vëmendjen tuaj dhe do të insistoj me ngulm që të ndahen mjete për ndërtimin e rafteve për nxënësit në të gjitha shkollat e Kosovës për faktin se disa herë në këtë Kuvend kam ngritur shqetësime për peshën e rëndë të çantave shkollore të fëmijëve tanë. Operimi i një fëmije me skoliozë kushton deri në 60 000 euro dhe përveç koston së lartë të operimit kostoja e dëmtimit të shëndetit të këtyre fëmijëve është e pallogaritshme. Andaj, ne kemi mundësi që të parandalojmë deformimet e shtyllës kurrizore te fëmijët nëse investojmë që të zvogëlohet pesha e çantave të fëmijëve shkollore, prandaj do të kërkoj me ngulm që kjo të jetë pjesë e këtij buxheti nga ju deputetë e në veçanti nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Vërejtje tjetër e imja në tabelat buxhetore të Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Sportit të investimet në sport është planifikuar në vitin 2013 investimi në stadiumin “Adem Jashari” dhe ky projekt nuk ka përfunduar, ndërsa nuk është i planifikuar për vitin 2014. Dhe gjithsesi duhet t’ua rikujtoj që Federata e Futbollit të Suedisë i ka dhuruar Federatës së Futbollit të Kosovës reflektorë në vlerë prej 1 500 000 euro, ndërsa për 70 - 80 000 euro deri më tani ka munguar montimi i tyre në stadiumin olimpiq “Adem Jashari”.

Kur jemi te investimet në sport nuk mund pa e përmendur premtimin e kryetarit të LDK-së, Isa Mustafës, në fushatë elektorale për ndërtimi ne stadiumit të ri të futbollit e që askund nuk figuron në tabelat buxhetore të komunës së Prishtinës. Edhe atëherë kur e ka premtuar Isa Mustafa, stadiumin e futbollit në Prishtinë, me 60 000 a 50 000 ulëse nuk e di sa i ka premtuar, e kam quajtur se është një blufë i Isa Mustafës dhe koha dëshmoi që ishte i tillë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Në disa diskutime të mia për gjendjen në shëndetësi kam kërkuar që të ndërtohet Qendra e re klinike universitare dhe disa nga objektet aktuale të Qendrës Klinike Universitare t’i kalojnë Spitalit të Prishtinës. Në atë kohë propozimin tim ministri e pati mbështetur dhe pati deklaruar dhe prezantuar një skicë- projekt dhe duke thënë se ky është projekti i Qendrës së re klinike universitare, ndërsa në tabelat buxhetore të këtij viti shihet se ekziston vetëm ndërtimi i Qendrës Emergjente në kuadër të Qendrës Klinike Universitare dhe nuk është i paraparë askund ndërtimi i Qendrës Klinike Universitare, por shpresoj që në të ardhmen ministri do të vazhdojë të ndërtojë Qendrën e re klinike universitare ashtu si ka premtuar edhe reformimin e sistemit shëndetësor.

U tentua që të manipulohet rreth investimeve kapitale me ato premtimet e kryeministrit dhe duke prezantuar vetëm tabelat apo grantet komunale të parapara me këtë projektbuxhet, gjithsesi duke u paraqitur vetëm grantet komunale pa i paraqitur edhe grantet qeveritare dhe ato nga donatorët do të bëhej një shkelje profesionale dhe asnjë profesionisti të ekonomisë nuk do të lejohen një gjë të tillë.

Të gjithë e dimë ndarjen buxhetore, edhe grantet komunale, por edhe ato grantet qeveritare, po edhe grantet nga donatorët. Shpresoj shumë që ky buxhet të merr përkrahjen e të gjithë deputetëve të këtij Kuvendi për arsye se është në interesin e qytetarëve dhe ofron mirëqenie më të mirë për ta, prandaj ju faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, për çka? A ta ka përmendur emrin, a? Po, sa replika po i doni, vëlla? Tri replika! Një e ka Sabri Hamiti, një Naser Osmani dhe një zoti Ferati. Jeni paraqitur tre për replikë dhe të tretë merreni fjalën. Zoti Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Meqë ma dhe fjalën në këtë formë, unë po lidhem pra me atë që po e quan replikë.

Unë besoj që nuk ka kurrfarë efekti nëse me hall e efekt përmendim emra këtu, qoftë të këtij ose të atij, ose po flasim për një buxhet që është me shifra e me destinime, që është libër, që mund të kontestohet dhe të propozohen alternativa dhe mos t'i fusim këtu e folurat publike në fazat e premtimeve parazgjedhore, të kujtudo qofshin.

Pak përpara përmendej kryeministri dhe fliteshin milionat që ai i shpërndan, po e them figurativisht, nëpërmes mëngëve kur del në fushatë parazgjedhore thotë i jep këto. Ju vetë e thatë që Prizrenit ia ka premtuar 17, më duket. Në buxhet i thonë 17, po ai thotë 200. Pra, unë për vete nuk i kisha analizuar këto premtime sot siç s'e kisha analizuar premtimin e kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës që ka thënë: do ta mbaroj një stadium, do ta mbarojmë, në dëshirore i bie ajo, me premisat, me rregulloret e FIFA-s.

Normalisht, Kosova si shtet që pretendon të hyjë në gara ndërkombëtare duhet ta ketë një stadium të tillë. I bie ta ketë në Prishtinë se është kryeqyteti.

Kolegu e di se e di që e do sportin, e dua edhe unë dhe futbollin e këqyri gjithë, e këqyri edhe në stadium edhe në televizion, ju e dini që Shqipëria s'po mund të bëjë ndeshje të vërteta ndërkombëtare për mungesë të një stadiumi dhe kjo nuk është ndonjëfarë kërkesë e panatyrshme. Por, po ta pyesni edhe Isa Mustafën...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Në asnjë rrethanë, në asnjë mënyrë nuk desha që të provokoj ndonjë replikë apo ndonjë diskutim, qëllimi është që të kemi, dhe dëshira ime po edhe e shumë adhuresve të sportit është që në Prishtinë ta kemi një stadium me përmasa të FIFA-s dhe të UEFA-s ashtu si e ka premtuar Isa Mustafa, që shihet se është një bluf dhe nëse nënkryetari i Kuvendit thotë që të mos i fusim në diskutim premtimet elektorale, unë po pajtohem me të, mirëpo një sugjerim të tillë do të duhej t'ia jepte së pari kolegëve të partisë së tij për arsye se kryeministri i vendit, të gjitha premtimet të cilat i ka bërë në fushatë elektorale duke filluar nga rritja e pagave dhe premtimeve tjera, kanë qenë të realizueshme, dhe besoj se e njëjta gjë nuk do të ndodhë me kryetarin e partisë së tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit!

Unë do të vazhdoj aty ku mbet, që nuk u dëgjua profesori Hamiti, që premtimi i dhënë ka kuptimin e mandatit katërvjeçar, ndërsa Ligji për buxhet është me mandat njëvjeçar dhe këtë duhet ta ketë të qartë.

Ajo çka dua ta bëj një demant para publikut, para qytetarëve që shifra e afuara nga deputeti në fjalë ka të bëjë me investimet vetjake të komunave dhe nëse një deputet nuk e dallon cilat janë investimet kapitale të Qeverisë, të paraqitura në tabelën numër 1 nga investimet vetjake, mua vetëm mund të më vjen keq për atë deputet.

KRYESUESI: Zoti Haxhiu, kundër-replikë.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Unë besoj shumë në profesionalizmin e deputetit në fjalë dhe besoj që edhe ai sikur unë di t'i dallojë grantet komunale dhe grantin qeveritar të investimeve kapitale dhe Qeveria, në këtë rast ministri i Financave, Ministria e Financave e ka përgatitur një buxhet të mirë, me tabela të skicuara, të vizatuara mirë, të prezantuara mirë, që edhe unë si laik i ekonomisë mund t'i kuptoj këto, por po më vjen shumë keq që kolegu nuk e ka kuptuar dhe thirret si profesionist i ekonomisë. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Në realitet në tabelat e paraqitura këtu flitet për grandin e rregullt, e dihet se grandin e rregullt është një formulë dhe nuk është në vullnetin e dikujt se dikujt i ka dhënë më shumë ose më pak. Dhe grandin, është grandin proporcional që i jepet pra secilës komunë në bazë të numrit të banorëve 6%, kriteri gjeografik 3% minoritetet në komunë dhe 2% minoriteti në nivel qendror dhe grandin specifik që i jepet për numër të nxënësve dhe numër të qytetarëve për mjekësi. Kjo është grandin e rregullt, ndërsa grandet nga ministratë nuk i ke të reflektuara në tabelën të cilën e lexove.

Problemi tjetër është te komunat që i lexove, që the kanë më pak. Problemi është një, sepse i harxhojnë, kanë të ardhura të vogla dhe i harxhojnë në paga, sepse i kanë ministrat e njohshëm dhe çdo muaj dhe çdo vit iu lirojnë të punësojnë shumë e më shumë dhe ato komuna të kallëzojnë cilat janë. Prandaj, këtu reflekton te komunat që kanë disiplinë financiare, kanë më shumë investime kapitale.

Dhe në këtë tabelë, cilën komunë ta shihesh se ka më shumë investime kapitale, dihet që aty qeveriset pak më mirë, që i çon në zhvillim dhe nuk i harxhon kot së koti.

Ndërsa, sa i përket çështjes së stadiumit, fole për një komunë që 25 milionë i ka investime kapitale dhe ... që janë në këtë vit, pas 2 vjetëve i ka 50 milionë ta bëjë



stadium me kritere të UEFA-s, po unë po besoj ti nuk i beson një tjetër kryetari që i ka vetëm 2 milionë investime kapitale, e ka premtuar “Uembly” stadiumin, Avni Kastrati i Mitrovicës. Ti po e qan këtë 50-shin e s’po e qanë atë 2-milionëshin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhiu, kundër-replikë!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Kur jemi te grandet dhe te rritja e numrit të tyre si e potencoj deputeti Ferati dhe kur në të kaluarën kanë qenë vërejtjet e tilla në komuna të cilat janë dhe vijnë nga Partia Demokratike, tani e thotë të kundërtën sido që të jetë mbetet në profesionalizmin e tij. Shembullin të cilin e mori për ministra besoj që është nga përvoja e tij kur ka qenë ministër i Pushtetit Lokal, ndërsa unë kërkoja gjithsesi vazhdimin e investimeve në stadiumin “Adem Jashari” dhe po kërkoj me ngulm që të jetë i përfunduar edhe projekti në stadiumin “Adem Jashari” dhe të jetë edhe premtimi i Isa Mustafës. Të mos tentojnë ta mbrojnë Isa Mustafën me premtime blofe që i ka bërë në këtë formë duke i atakuar të tjerët, të cilët nuk kanë premtuar investime të tilla, por që janë duke i realizuar dhe i kanë ato projekte.

Dëshira ime është që të kemi edhe stadiumin “Adem Jashari”, si “Uembly”, por edhe në Prishtinë ta kemi një stadium me standarde të FIFA dhe UEFA-s, prandaj kjo do të duhej t’i gëzonte kolegët deputetë nga Lidhja Demokratike dhe jo në këtë formë, do të thotë, duke tentuar të manipulojnë.

Çështja tjetër e investimeve kapitale, këshillën që tentoi të ma jepte mua...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Shkojmë radhazi, nëse bën. Ia kemi kapërcyer radhën zotit Idrizi. Nijazi Idrizi e ka fjalën.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky buxhet nuk mund të quhet buxhet i rritjes, sepse buxheti i planifikuar për vitin 2014 në shumën prej gjithsej 1 miliard e 590 milionë eurove është për vetëm për 4,5 milionë euro më i madh se i vitit 2013 e që ishte 1 miliard e 585,5 milionë euro, ose 0,3% më shumë.

Ky buxhet nuk mund të quhet as buxhet i zhvillimit, sepse investimet kapitale janë zvogëluar nga 621 milionë euro në 531 milionë euro, ose 90 milionë euro më pak, që i bie për 15% të jetë shkurtuar.

Përderisa shpenzimet kapitale zvogëlohen, rriten ato në mallra dhe shërbime. Tek mallrat dhe shërbimet shpenzimet rriten nga 224,5 milionë euro sa kanë qenë të ndara për vitin 2013, në 251,8 milionë euro ose 27,3 milionë euro që i bie një shumë prej 12%.

Duhet të theksohet fakti se rritja ekonomike të cilës sot po i referohet Qeveria akoma nuk po vjen nga zhvillimi i sektorit privat, por po vjen më shumë nga investimet qeveritare.

Është e çuditshme se si Qeveria planifikon rritje kaq të lartë të hyrave nga Dogana dhe Administrata Tatimore e Kosovës kur zhvillimet aktuale aty nuk po korrespondojnë me planifikimin e të hyrave. Vetë Qeveria flet për një stabilizim të importit, gjegjësisht një rritje shumë të vogël të importit, kurse në anën tjetër ngarkon Doganën që të grumbullojë hiq më pak se 934 milionë euro, të cilat në rrethanat aktuale që i ka Dogana, është shumë e zorshme që të përballohen.

Planifikimi i të hyrave shtesë për vitin 2014 është joreal. Edhe sikur efekti i akcizës të rritur në cigare, të arrihet 100%, gjë që është absolutisht e pamundur pasi konsumi nuk mund të mbetet në nivelin e njëjtë me të ardhura të njëjta dhe me taksë më të lartë. Përsëri kjo shumë e planifikuar nuk do të arrihet që të përmbushet.

Mua nuk më del se në këtë planifikim të jetë futur efekti i mundshëm i nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian, e cila sigurisht do t'i ulë edhe më tutje këto të hyra. Po ashtu, këtu nuk është marrë parasysh as zbatimi i Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë, e cila është lidhur para pak dite me Turqinë dhe e cila po ashtu përcillet me efekte.

Pritja se ATK-ja mund të mbledhë 367,3 milionë euro për vitin 2014 që në krahasuar me vitin 2013 kemi të bëjmë me një rritje prej 66 milionë euro ose 22% duket që do të jetë shumë e zorshme që të arrihet.

ATK-ja nuk ka arritur ndonjë herë një rritje vjetore në një përqindje kaq të lartë, ku pretendohet të arrihet në vitin 2014. Ajo nuk ka bërë deri tash ndonjë ndryshim në normativat tatimore, nuk ka bërë, me sa jemi të informuar as ndonjë reformë të veçantë në administratë, domethënë nuk ka trajnuar njerëz po edhe nuk është plotësuar me ndonjë numër më të madh të njerëzve që të arrijë këtë objektiv. Kam frikë se ky tentim do të mbetet vetëm një dëshirë e parealizuar.

Edhe ky buxhet po krijon diferenca në zhvillimin e komunave dhe regjioneve, duke i stimuluar disa nga ato në kurriz të disave të tjerave. Ky diferencim po i acaron njerëzit dhe mund të shkaktojë ndarje me pasoja afatgjate.

Vendimmarrësit që janë pranë buxhetit për interesa të ngushta po saktësojnë prioritete, por pa standarde profesionale. Nuk është e pranueshme që të marrin dy komuna qendrën regjionale në numër të përafërt të banorëve të diferencohen kaq keq dhe sa për informim dëshiroj ta përmendi faktin që njëra nga këto kanë ndarë për infrastrukturën rrugore 50 milionë e 660 mijë euro, ndërsa për një komunë tjetër janë ndarë vetëm 1 milion e 218 mijë euro. Të dy këto komuna janë qendra regjionale me numër të përafërt të banorëve dhe me komponentë të përafërta, që vlen po thuaj si rregull për të gjitha komunat.

Ose edhe një komunë tjetër më e vogël, të ketë njëra 20 milionë e 94 mijë euro, ndërsa tjetra vetëm 287 mijë euro, kjo është precedent dhe nuk është në rregull të jetë kështu.

Propozoj që ky buxhet pas përfundimit të këtij debati të tërhiqet nga Qeveria me qëllimin e mirë që të shqyrtohet një herë pas gjithë këtyre argumenteve që u dhanë këtu, me qëllim që pastaj të vijë në një të ardhme më i plotësuar dhe më i punuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Siç shprehën qëndrimet e tyre të gjithë kolegët deputetë këtu, edhe unë kam dëshirë që të kontribuoj me disa komente nga ana ime lidhur me këtë projektligj.

Në fillim kam për t'i bërë disa komente të përgjithshme, e më pastaj disa specifike.

Është për t'u përsëritur që buxheti i projektuar për vitin 2014 është në korniza të rregullës fiskale dhe se deficitin për 2014 është në nivelin e 2% të bruto prodhimit vendor.

Edhe këtë vit, buxheti parasheh që deficitin ta mbulojë me anë të huamarrjeve. Huamarrjet janë paraparë që të rriten për 2,4%, për dallim nga viti i kaluar, i cili ka qenë në vlerë prej 9,6% dhe për shkak të kësaj rritjeje unë si deputetë rekomandoj që Qeveria t'i forcojë ekipet negociatore për huamarrje, me qëllim të forcimit të pozitës së saj gjatë negociatave për huamarrje shtetërore në nivel minimal të kamatave dhe kushteve të favorshme për kthim.

Unë kujtoj se edhe Qeveria e ka parasysh këtë se Banka Islamike për Zhvillim i ka kushtet më të mira në tregun ndërkombëtar të financimit.

Blerja e veturave është e pranishme në shumicën e dikastereve qeveritare dhe kjo dukuri nuk ka të ndalur.

Duhet të ketë kontroll të shtuar për këtë kategori shpenzuese, pasi paraqet shpenzim të përsëritur, derisa nuk është provuar përdorimi i drejtë dhe racional i tyre me kufizime vetëm për përdorim zyrtar, derisa ndaj keqpërdoruesve nuk janë marrë masat adekuate.

Në vend të kësaj, këto shpenzime që po përsëriten në çdo projeksion të buxhetit mund të përdoren për qëllime të përmirësimit të situatës në arsim apo në shëndetësinë kosovare, por edhe për projekte me karakter zhvillimor.

Shpenzimet për mëditiye duhet të kenë kontroll më të mirë nga dikasteret, sidomos ato për organizimin e takimeve të punës me karakter të brendshëm shtetëror. Këtu përjashtoj takimet ndërkombëtare, pasi gjykoj se një takim i mbajtur jashtë Kosovës nuk mund të prodhojë efekte më të mira për të mirën e Kosovës sesa një takim i mbajtur në Kosovë. Për më tepër, këto janë para publike dhe duhet të shpenzohen brenda Kosovës.

Kurse sa u përket komenteve specifike, unë mendoj se te Ministria e Financave, Fondi për Kuadro në kuadër të Ministrisë së Financave është paraparë se do të shpenzojnë një

milione euro gjatë vitit 2014 dhe parashihet që ky fond të vazhdojë si i tillë edhe në vitet 2015 dhe 2016.

Ky lloj fondi ka ekzistuar edhe në buxhetet e viteve të kaluara, derisa ne si deputetë nuk kemi marrë ndonjë raport të vlerësimit të efekteve të këtij fondi.

Pra, do të ishte mirë që ta kemi një analizë të kostos ndaj përfitimit nga ky fond, në cilët persona është investuar dhe se si ata persona këtë investim ia kanë kthyer Kosovës. Po ashtu, si është paraparë shpërndarja e këtij fondi nëpërmjet ministrisë përkatëse që të përfitojnë të gjitha dikasteret qeveritare nga ky fond.

Pres që Qeveria në një afat sa më optimal ta përfundojë vlerësimin e përfituesve, si dhe vlerësimin fiskal, që ndarjet kontingjente në Ministrinë e Financave për financimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë dhe veteranëve të luftës të mund të shpenzohen për këta përfitues dhe të transferohen në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Gjithashtu te Ministria e Bujqësisë janë paraparë 4,6 milionë euro për rehabilitimin e sistemit të ujit në Kosovë, të ujitjes dhe a është koordinuar kjo me kompanitë rajonale të ujit në Kosovë se sa kapacitete pra ka Ministria e Bujqësisë t'i shpenzoj këto mjete, në mënyrë që të jetë e drejtë dhe të ketë efikasitet për këtë qëllim.

Alokime të tilla ku ka konflikt të mundshëm të veprimtarisë mes një dikasteri qeveritar dhe një kompanie publike duhet të koordinohen paraprakisht që të mos kemi alokime për shpenzime me karakteristika të njëjta, apo thjesht dyfishim të shpenzimeve për të njëjtin qëllim.

Qeveria pra duhet t'i japë përparësi, respektivisht të ketë prioritet në investimet në Ministrinë e Shëndetësisë, të Bujqësisë dhe të Arsimit.

Gjithashtu, mendoj se Qeveria, konkretisht dikasteret e saj duhet t'i ndihmojnë komunat e lëna më anash, sidomos Kamenicës, por edhe komuna të tjera, duke paraparë projekte dhe duke i implementuar ato. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Emilija Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Hvala predsedavajući!

Poštovani predstavnici Vlade,

Kolege poslanici,

I uvaženi građani,

U ime Bošnjačke zajednice zahvaljujem se određenim ministarstvima Vlade Republike Kosova, Ministarstvu za infrastrukturu, Ministarstvu za rad i socijalnu politiku, kao i Ministarstvu za financije, ali i opštini Prizren odnosno Direktorijatu kulture, Direktorijatu urbanizma i javnih službi na svim kapitalnim investicijama i infrastrukturnim projektima za protekle tri godine, koji su se realizovali u svim ruralnim mjestima, izgradnja puteva, rekonstrukcija vodovodne i električne mreže, razni kulturni objekti, sve to radi poboljšanja uslova života svih naših građana.

Naše projekte smo uvrstili u opštinskom budžetu Prizrena za 2014. godinu. Samo bih zamolila ministra finansija, odnosno gospodina Bećaja da u budžetu ubaci dva velika prioritetna projekta za dva velika bošnjačka sela, Gornje Ljubicine i Grnčare, to su izgradnja vodovoda.

Mi smo već dve godine insistirali i pokušavamo i zahtijevamo od Vlade da se ovi projekti realizuju na terenu, ali do sada nismo naišli na razumijevanje, te koristim priliku da danas za ovom govornicom u Parlamentu Kosova iznesem ovu problematiku i apelujem na Komisiju za budžet i finansije da ove projekte ubaci u svoj prioritet za 2014. godinu.

S obzirom da je Nacrt budžeta i od strane Međunarodnih organizacija ocjenjen pozitivno, ja ga podržavam i glasaću za njega. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka zoti Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Është vonë dhe nuk është e lehtë të marrësh pjesë në një debat që për mua është i mirë, por në një kohë të keqe, në orët e vona dhe në një momentum të papërshtatshme ndërmjet rundeve elektorale. Prandaj, nuk befasohem që ka edhe aq shumë tone politike elektorale, por buxheti do të nënkuptonte nevojën e një qasjeje pak më pak politike.

Është një debat vërtet ‘sui generis’ ndoshta natyrshëm, sepse Kosova është e tillë. Është kulaçi i vogël, ndarja jo aq e mirë. Prandaj, për mendimin tim është krejt e pashmangshme që të ketë edhe vlerësime të ndryshme, madje edhe shumë të dallueshme, varësisht çka kërkon. Ai që i qaset pozitivisht mund të gjejë arsye për të konstatuar pluse dhe ai që i kërkon minuse i gjen edhe ato. Kush kërkon për ta zhvilluar eventualisht qasjen mund të gjejë hapësirë për të shtruar pyetje, dilema e tjera.

Unë, duke pasur parasysh edhe kohën, do të dëshiroja të ndalem vetëm në tri çështje dhe atë mundësisht sa më shkurt.

E vlerësoj pozitivisht në përgjithësi Buxhetin dhe kur e bëj këtë kam parasysh momentin nëpër të cilin po kalon, jo veç Kosova, por edhe në përgjithësi ekonomia regjionale evropiane e më gjerë.

Personalisht kam pritur më shumë vështirësi, më shumë telashe. Më del një buxhet solid, i konsoliduar, dhe ndihem mirë. Uroj që kjo të jetë kështu edhe në të ardhmen, sepse ndodhë ndonjëherë që të jetë një fotamorganë dhe mund të jetë rrezik për procesin e ardhshëm. Megjithatë, uroj që kjo qasje të zhvillohet edhe më tej.

Kosova është ekonomi e rrënuar, vend i plaçkitur, i plagosur. Prandaj, askush s’ka mundur të presë mrekulli. Është një vazhdimësi dhe nëse ka progres, qoftë edhe i kufizuar, mendoj që do përshëndetur.

Po vërejtjet dashamirëse janë të mirëseardhura për mendimin tim. Kanë vend, se ato ndihmojnë.

Unë do të dëshiroja të shtroj vetëm një nga problemet, të cilin, për fat të keq, jam detyruar ta nënvizoj edhe herëve tjera. Kulaçi i vogël, s'jemi gjithmonë ne fajtor, megjithëse një pjesë mund edhe ta diskutojmë. Ndoshta me një menaxhim më të mirë, do të mund të ishte më i madh. Por, ndarja më e mirë është punë që varet në masë të mirë edhe prej nesh dhe këtu përsëri dua ta vë theksin te ndarja asimetrike joproporcionale regjionale, është bërë më sindromë. Dhe, më vjen keq që vijë nga një pjesë që është e dëmtuar në këtë proces dhe mund të kuptohet keq.

Po përmendi për të mos e zgjatur një shembull që e kam theksuar përsëri. Në gjithë pjesën lindore të Kosovës, gjeografikisht lindore, nuk ka asnjë copë rruge në katër korsi, kurse ndërtohen gjithandej autostrada e tjera. Mirë që ndërtohen për Prizren, për Pejë, për Mitrovicë, tash edhe për jug në Han të Elezit, siç po thuhet, por pse nuk bën që së paku një copë rrugë të bëhet edhe në pjesën e Anamoravës e tjerë. Është shtruar kjo në vazhdimësi.

Për më tepër, vini re ju lutem strategjinë e përgjithshme të infrastrukturës, sidomos kësaj me autostrada. Edhe linja për veri, edhe kjo që qe e planifikuar për Merdar, edhe kjo për Leskoc, edhe kjo tjera për Shkup, në të vërtetë lidhen me një horizont, me një korridor. Çka do të prishte punë që në vend se të jenë dy-tri në të njëjtin drejtim të bëhej një në midis, që do të lidhte ta zëmë jo vetëm Anamoravën, por edhe Preshevën e Kumanovën, atë që e quajmë Kosovë Lindore. Dhe, a nuk është një faktor që duhet marrë parasysh?

E theksoj këtë, edhe pse jam i vetishëm se duke folur për buxhetin, nuk e ka ndoshta sa duhet vendin. Por, kur bisedohet edhe për studimin e fizibilitetit, do të duhet të merrej parasysh edhe kjo, dhe me këtë do të korrigjohet së paku njëra nga anomalitë e politikës së vazhdueshme buxhetore.

Ka edhe ndonjë çështje që është me pluse e me minuse. Këtu më lejoni të ndalem te, më në fund, hapi pozitiv që është bërë në trajtimin e padrejtësive së kaluarës, veçanërisht me të burgosurit politikë, dhe formula që është futur në buxhet, për fat të keq e vonuar e stërvonuar, por që krijon shpresën se më në fund po fillon realizimi i saj, por me kërkesën të cilën duhet ta nënvizoj - që të precizohet edhe linja buxhetore, për të mos lejuar mundësinë e ngatërresave.

Dy, që paragrafi në nenin 12, që mendoj është i pazakonshëm, i paprecedent të sqarohet dhe besoj që në procesin e amendamentimit do të rregullohet për ta evituar mundësinë e keqkuptimit të interpretimit me dykuptimësi dhe me mundësi bllokimi e zvarritje, kurse në të vërtetë është një çështje që s'duron më zvarritje.

Megjithatë, uroj që këto të eliminohen rrugës dhe të korrigjohet një padrejtësi e madhe.

Për mos u zgjatur, unë si të tillë e mbështes këtë buxhet. Pres që të mbështetet prej deputetëve edhe nga një arsye. Është buxheti më i mirë që kemi. Po të kishte një alternativë, le ta bëjmë. Nëse mund të korrigjohet diçka, le të korrigjohet gjatë amendamentimit, por nuk është diçka që mund të shtrohet dhe të korrigjohet duke e bllokuar, duke e prishur. Imponohet pastaj buxheti emergjent dhe secili duhet ta

mendojë çka do të thoshte kjo edhe për Kosovën, edhe për proceset e përgjithshme. Mendoj që edhe këtë duhet ta kishim parasysht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër Hashim Thaçi e ka kërkuar fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës të ju përshëndes të gjithëve për debatin tuaj jashtëzakonisht korrekt dhe konstruktiv për buxhetin më të mirë që ndonjëherë e ka pasur Kosova në historinë e vet politike, për buxhetin zhvillimor, për buxhetin e rritjes së mirëqenies sociale të qytetarëve të Kosovës, për buxhetin e investimeve në sektorin privat, në infrastrukturën rrugore, për buxhetin i cili do të hapë një perspektivë më të mirë për shtetin tonë dhe për shoqërinë tonë.

Natyrisht se ju kërkoj ndjesë për angazhimin tim të vonshëm sot në këtë debat, po për shkak të udhëtimeve që kam pasur dhe agjendës së ngjeshur dhe mysafirëve nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kjoka qenë e pamundur. Por, si do që të jetë, në çdo rrethanë dhe moment kam qenë i gatshëm që të bashkëngjitem dhe tani më jam këtu të bashkëbisedojmë për këtë buxhet.

Pra, ne do ta vazhdojmë rritjen ekonomike, do të vazhdojmë me qeverisjen e mirë, integrimet evropiane, shëndetësinë dhe rritjen e mirëqenies sociale.

Gjashtë vjetët e qeverisjes qendrore, por edhe lokale në shumicën e komunave të Kosovës, ne kemi dëshmuar se dimë, kemi vullnet dhe përgjegjësi për investime.

Të nderuar të pranishëm,

Të nderuar ju deputetë,

Dëshiroj të theksoj se ne do të vazhdojmë me përgjegjësitë më të larta që në kuadër të mundësive dhe kapaciteteve që kemi si Qeveri e vendit të vazhdojmë me investime në të gjithë sektorët.

Ndërsa, duke dëgjuar edhe opinionet e deputetëve, dhe pajtohem me zotin Hyseni që është buxheti më i mirë, por ka mundur të jetë edhe ndoshta edhe më i mirë, por jemi këta që jemi dhe jemi këtu ku jemi dhe vendi që jemi. Por, për mundësitë që i kemi si shtet dhe shoqëri, është buxheti më i mirë i mundshëm për kushtet dhe rrethanat në të cilat jemi, duke pasur parasysht edhe faktorët dhe rrethanat tjera, situatat financiare edhe në rajon, por edhe në botë.

Por, dëshiroj të theksoj edhe një herë se totali i investimeve kapitale për t'i sqaruar disa komentues këtu me infrastrukturën rrugore nga viti 2008-2012 nga Qeveria qendrore, përkatësisht ministritë e linjës në komunat e Kosovës ka qenë 215 milionë euro.

Në këto komuna janë ndërtuar rreth 1 200 rrugë dhe janë realizuar 298 projekte.

Projektet tjera nacionale janë realizuar. Tash është në përfundim e sipër projekti Morinë në drejtim të Merdarit dhe më 26 nëntor do të përmbyllet deri në Besi, investim ky jashtëzakonisht i rëndësishëm.

Për të sqaruar për qytetarët e Kosovës, por edhe qytetarët e Podujevës, përkatësisht Llapit, dëshiroj të theksoj se zgjerimi i rrugës do të vazhdojë deri në Merdar, ndërsa ndërtimi dhe zgjerimi i autostradës tjetër do të vazhdojë në drejtim të rrugës evropiane, apo korridorit evropian, që e kemi diskutuar edhe më herët.

Ndërsa dëshiroj të ju theksoj gjithashtu se në javët e ardhshme, nuk po flas për muajt, do të fillojë edhe ndërtimi i autostradës tjetër dhe janë ndarë mjetet, janë të përfshirë edhe në buxhetin e vitit 2014 për fillimin e kësaj autostrade, Prishtinë - Ferizaj - Kaçanik - Hani i Elezit, pra në drejtim të Shkupit. Ndërsa do të vazhdohet me zgjerimin e magjistrave në drejtimin Prishtinë - Vushtri deri në Mitrovicë. Në të njëjtën kohë do të vazhdohet, është duke punuar zgjerimi i magjistrave me katër korsi nga Prishtina, Kijeva, Ura e Klinës deri në Pejë, pra duke mos u ndalur tek Ura e Klinës, por deri në qytetin e Pejës.

Për të sqaruar dhe deputetin e nderuar, zotin Hyseni, dëshiroj të theksoj se është planifikuar dhe është përmbyllur tanimë studimi që do të lidhet menjëherë me autostradën Prishtinë-Shkup, nga Ferizaj në drejtim të Vitisë e Gjilanit dhe Gjilan - Prishtinë.

Gjithashtu është investuar shumë edhe në bujqësi dhe nëse e krahasojmë me vitet e mëhershme janë investime që definitivisht nuk mund të krahasohen në kuptimin më pozitiv të mundshëm.

Sa u përket komunave, pasi dëgjova edhe unë opinione të ndryshme që herë janë të sakta, herë të pasakta, herë me karakter elektoral, herë qëllimshëm, unë dëshiroj për shkak të transparencës së plotë para qytetarëve dhe gjithë spektrit politik kosovar të theksoj se investimet kapitale që kanë ndodhur nëpër komunat e Kosovës kurrë në asnjë rrethanë nuk janë shikuar siç prezantohen ndonjëherë në kuptimin e partive politike, apo se kush e qeveris një komunë.

Unë dua të theksoj se vetëm në Prishtinë, dhe prin Prishtina për investime kapitale, janë investuar 110 milionë euro. Natyrisht, vazhdon Prizreni me mbi 100 milionë euro. Por, unë do ta mbështes fuqishëm edhe kryetarin e Prishtinës, nëse zgjidhet, dhe të tjerët që zgjidhen, nëse zgjidhet tjetërkush, për ndërtimin...

*(Reagime nga salla)*

Ok-ej, e ka fituar rrethinën e Prishtinës, por Prishtinën e ka humbur, i nderuar Sabri! Prishtinën e ka humbur, rrethinën e Prishtinës e ka fituar.

Prandaj, kemi investuar në Prishtinë 110 milionë euro. Do ta mbështetim edhe për ndërtimin e stadiumit, kushdo që të fitojë, sepse kryeqyteti ka nevojë për një stadium të standardeve të UEFA-s, por natyrisht ka nevojë edhe për transparencë, së pari të dihet



kush e menaxhon këtë stadium sot. Ju e dini se nuk menaxhohet prej Komunës, po prej një grupi njerëzve të interesave të ndryshme.

Por, do ta mbështetim fuqimisht edhe kryetarin Ramadan Muja për mandatin e ardhshëm katërvjeçar për ndërtimin edhe të stadiumit të standardeve të UEFA-s, edhe të teleferikut të Kalaja e Prizrenit. Është zgjedhur, ai ka fituar mbi 13 mijë vota herën e parë, kështu që Eqremi veç e di atë punë, sikur edhe ju.

Ndërsa kemi vazhduar në Ferizaj me 60 milionë euro, në Pejë 55 milionë euro, në Mitrovicë, i nderuari zoti Ferati, me 93 milionë euro dhe do ta mbështetim kryetarin e ardhshëm aktual dhe të tashëm zotin Kastrati për ndërtimin e “Vimbëlldonit” në Mitrovicë. Bëhu më optimist për qytetin tuaj, sepse dërgimi i atij mesazhit tuaj pesimist është jo i shëndetshëm edhe për ju personalisht, edhe për politikën tuaj, megjithëse e keni marrë përgjigjen prej vullnetit të qytetarëve. Në Gjilan 92 milionë eurosh, flas me shifra dhe fakte. Në Gjakovë, mbi 40 milionë, në Podujevë 47 milionë, i nderuar Sabri! Në Skenderaj 51 milionë euro, në Vushtrri 35 milionë euro, në Drenas mbi 35 milionë euro, në Suharekë mbi 35 milionë, Lipjan mbi 31 milionë euro, Malishevë 31 milionë euro, Viti 22 milionë euro, Deçan mbi 15 milionë euro, Istog 22 milionë euro, Klinë 20 milionë euro, Kamenicë mbi 17 milionë euro, Fushë-Kosovë 14 milionë euro, Kaçanik mbi 20 milionë euro, Dragash 13 milionë euro, Shtime 15 milionë euro, Obiliq 12 milionë euro, Hani i Elezit 12 milionë euro.

Gjithashtu këtu u diskutua edhe çështja e pagave. Unë dua vetëm të sqaroj diçka. Ne kemi premtuar në vitin 2010 rritjen e pagave për mandatin e dytë 50% për mësimdhënësit, për policët, për mjekët, për shërbyesit civilë, pjesëtarët e FSK-së, pensionistët, sistemin e drejtësisë, veteranët, familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, familjet e dëshmorëve, zjarrfikësit. E përmendi zoti Hyseni edhe çështjen e të burgosurve politikë, që bashkërisht po mundohemi ta vëmë në binar realë, të drejtë e institucionale të marrjes së përgjegjësiive të shtetit për zgjidhjen definitive të kësaj problematike, por po zgjidhet.

Unë dua të theksoj se, ju e dini të gjithë, ne kemi mbajtur premtimin për rritjen 50% të të gjitha këtyre kategorive për mandatin e parë. Por, kam premtuar dhe po realizohet edhe një rritje tjetër për të gjitha këto kategori gjatë këtij mandati. Ndërsa për mandatin e ardhshëm katërvjeçar 2014-2018, i nderuar zoti Hamiti, kam premtuar dhe do ta mbaj atë premtim. Rritjen graduale për të gjitha këto kategori për katër vjetët e ardhshme, pra për mësimdhënësit, punëtorët universitarë, shkollat e mesme, fillore, parafillore, për policët e Kosovës, për mjekët, shërbyesit civilë, pjesëtarët e FSK-së, pensionistët, sistemin e drejtësisë, veteranët, familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës dhe zjarrfikësit.

Pra, një rritje do të ndodhë deri në qershor në vitin 2014. Ndërsa rritja tjetër graduale 2014-2018 do të ndodhë për 100% për të gjitha këto kategori. Ky është premtimi im, ky është vendimi im, natyrisht me vullnetin e qytetarëve të Kosovës dhe kjo do të realizohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti nënkryetar Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Unë dy-tri herë po e kërkoj fjalën të flas për temën që po më intereson, meqë po ma përmendin emrin, po bëjnë referencë. Faleminderit, zoti kryeministër!

Atëherë s'ke dëgjuar ose ata të tjerët, se përkundrazi unë kam thënë që ato janë premtime që s'kanë afate dhe nuk janë për një vit, po unë nuk do të shkoj tutje. E kreu, ka kush të merret me këto.

Unë dola të flas për një temë, e cila kurrë s'është partiake, se po u bë partiake s'vlen gjë. Ka të bëjë me kulturën. Po u lidh me një moment, bëhet ideologjike, prapë e vret veten. Pra, dua të flas për një vlerë shpirtërore të shoqërisë, e cila kur bëhet sublime, e ka detyrë dhe e ka garant që e kalon kohën e vet.

E pra, çështja është sa një shtet i ri si Kosova, që do të konstituohet në të gjithë lëmenjtë, nga ai social e ekonomik, bën për këtë që quhet pjesë shpirtërore.

Mund të themi që me ndodhitë socio-historike që kanë ndodhur në dy deceniet e fundit në Kosovë është e natyrshme që kjo pjesë e botës shpirtërore të Kosovës nuk është stimuluar aq sa duhet dhe nuk është krijuar në kushtet e përshtatshme. Ka ardhur koha që kjo të trajtohet institucionalisht dhe të trajtohet me gjithë vlerën dhe rëndësinë që ka për një shoqëri, aq më tepër për një shoqëri që do të jetë e identifikueshme dhe të ketë kulturë identitare, e cila e bën të tillë çfarë është para të tjerëve në komunikimet universale.

Me pikat e programeve që pretendojnë të artikulohen në këtë buxhet njëvjeçar të Kosovës, ne e dallojmë të paidentifikuar nënformën, qysh do t'i klasifikoj unë. Një që ka të bëjë me trashëgiminë kulturore, që lidhet edhe me kërkime arkeologjike, dhe ka të bëjë me ruajtjen dhe kultivimin, konservimin, mbrojtjen e vlerave kulturore-tradicionale. Në këtë pikë, atje unë e shoh një shifër, edhe pse është e nënvizuar në dy-tri drejtime, pak a shumë është më e madhe.

Problemi sot për Kosovën është që të mos mbetemi vetëm në identifikimin e asaj trashëgimie që është, që ka mbetur, që është e brezave tjera. Por, çka do të bëjmë për kulturën moderne, ose bashkëkohore?

Çka do të bëjmë me krijuesit dhe prodhuesit e kulturës dhe harxhuesit e saj, që e kanë një sensibilitet tjetër dhe kanë sensibilitet të kohës dhe çka do të bëjmë që në këtë lëvizje krijimtare të bashkëkohësisë të identifikohen vlerat, të cilat do të bëhen të trashëgueshme për nesër.

Në këtë pikë ne kemi shumë pak investime. Shumë pak! Bile unë frikohem ta them publikisht sa i përket librit çfarë shifre e vogël është. As nuk dua ta përmend, se jam i bindur që duhet të ndërrohet, dhe ajo bile thotë 'për botimin dhe për blerjen e librit'. Kjo është shifër që nuk bën të përmendet.

Pse po insistoj këtu? Po insistoj, sepse në një shoqëri si Kosova sot, ndonëse me ligjet, të cilat mund të ju them janë gati të kopjuara nga shtetet tjera, kultura dhe krijimtaria janë sjellë në nivelin e mallit të tregut. Kosova me çmime e tregut dhe prodhimet e

domosdoshme të mbijetesës me fuqinë që e ka nuk mund të krijojë profit. Le më me letërsi, le më me kulturë, me çmime tregu. Prandaj është shteti, është Qeveria, e cila ndërhyr për veprat kapitale, ndërhyjnë edhe vendet që janë shumë të mëdha, Franca, Kroacia, për shembull. Unë ju them që Instituti Leksikografik i Zagrebit ka punuar me investime të Qeverisë kroate 10 vjet për ta bërë enciklopedinë kroate dhe është menduar që është botim elit, se është botim elit. A e dini se tri vëllimet e para janë shitur tri herë, pa dalë i katërti dhe është bërë botimi më përfitues, sepse ka qenë elit.

Edhe te ne, menjëherë po them, vlerat klasike të letërsisë, të kulturës, të teatrit duhet të bëhen me një program të ministrisë, me një program të Qeverisë dhe ato të financohen, sepse janë vlera identitare. Nuk po flas për shijet. Për shijet kanë thanë latinët nuk flitet. Dikush e do këtë tip, e harxhon dikush këtë tjetrin. Po flas për vlerat. Kur është puna te vlerat funksionojnë kriteret profesionale dhe këtu duhet të ndërhyhet. Po ashtu, siç duhet ndërhyhet në atë që quhet promovim i kulturës. E thashë, jemi në komunikim global dhe me të tjerët komunikojmë me atë që na bën të krahasueshëm dhe të ndryshueshëm, se kjo është kultura.

Atëherë, nëse gjuha e muzikës dhe e arteve pamore është universale dhe paraqitja jashtë është vetëm teknike, në kulturën identitare, siç është gjuha amtare, në letërsi kjo do edhe investim. Kjo do edhe krijim të nivelit të dytë. Prandaj, duhet të bëhen investime dhe këto investime duhet të bëhen të organizuara, jo veç me vullnetin e individëve. Në botën tonë, në kohën tonë vlerat e rëndësishme nuk bëhen me vullnete, bëhen me profesionalizëm dhe me organizim.

Prandaj, unë po them, do të përpiqem gjatë kohës derisa diskutohet ky program që në këto dy-tri pika të vëmë dy-tri kriteret, të cilat do të shkojnë deri në fund.

Unë nuk po flas për disa autorë, edhe filmash i kemi dëgjuar, që marrin shpërblime, e s'kanë para të shkojnë ta marrin shpërblimin. Nëse është e vërtetë është keq për të gjithë ne, edhe për Kuvendin, edhe për Kosovën. Nëse një njeri individualisht eka marrë një sukses dhe i bëhet problem ta marrë një biletë avioni për ta marrë shpërblimin, përnjëmend është keq!

Dhe, më lejoni edhe një tregim për çantën e fëmijëve. Unë kam dëgjuar gjatë këtyre ditëve edhe në bisedimet publike, edhe intime, edhe nëpër institucione, që flitet për çantën e rëndë të fëmijëve. Është shumë e vërtetë. Por, problemi është diku tjetër. Problemi është në sistem. Nuk çlirohet çanta e fëmijëve pa u ndërruar sistemi shkollor dhe pa ndërruar mënyra e mësimi, a mësohet në shkollë gjithë ditën, apo në shtëpi, se njeriu që veç merr mësim prej mësuesit 6 orë, e vjen 6 orë në shtëpi, i bart librat patjetër, se nuk i ka në shkollë. Kjo me rrafte nuk zgjidhet.

Edhe e dyta, është sistemi me çfarë librash mësohet. Pra, reforma është përtej asaj çante. Çanta është pasojë dhe ne mund të flasim për nipat, dikush ka nipa, dikush ka fëmijë, varet prej moshave, të gjithë e kanë të njëjtin problem. Është e vërtetë që është çantë e rëndë, por ajo bëhet me reforma, nuk bëhet me pakënaqësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Replikë, zoti Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar nënkryetar Hamiti,

Nuk është qëllimi që të replikoj, por vërtet më vjen mirë që e keni kapur shqetësimin tim sa i përket shëndetit të fëmijëve dhe sa i përket reformës në arsim. Besoj që ne deputetët me përvojë dhe një akademik i shquar i Kosovës, keni mundur ta jepni edhe kontributin tuaj në reformimin e sistemit arsimor.

Dhe, meqë unë për herë të parë jam në Kuvendin e Kosovës dhe për mua është një shqetësim. Jam duke bërë përpjekje maksimale që ta mbrojmë, përveç edukimit, të mbrojmë edhe shëndetin e fëmijëve. Prandaj, faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Afrim Hoti.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryesues!

Buxheti që na ka ardhur nga Qeveria si propozim do të ketë në dispozicion një miliard e 590 mijë euro.

Qeveria e Kosovës nuk është duke ndryshuar as këtë vit, jo pse nuk mund, por pse nuk di, me një kryeministër të shantazhuar e të korruptuar, kjo Qeveri është futur në borxhe.

Ata kanë hyrë në borxhe personale, tash dëshirojnë që edhe qytetarët të paguajnë për dështimet e tyre. Muaj e vite më herët shiten disa nga ndërmarrjet publike strategjike dhe ekonomike për ta mbuluar mungesën e fondeve për sektorë të caktuar. Ndërsa tani, kur s'kanë mundur ta shesin PTK-në, po duan ta fusin vendin në borxhe.

Buxheti i propozuar për vitin 2014 është buxheti i kreditit, është buxheti i borxhit.

Qeveria ka planifikuar që për vitin 2014 të marrë borxh të jashtëm deri në 64,9 milionë euro dhe përderisa për vitin 2013 ky borxh ishte 31,6 milionë euro, këtë vit Qeveria e ka rritur borxhin mbi 100%.

Marrja e borxhit të jashtëm parashihet edhe në vitin 2015, çdo herë më shumë deri në 71 milionë euro, e që i bie 39,4 milionë më shumë se në vitin 2013.

Ky buxhet sërish mbetet i borxhit. Sipas asaj që shohim, na del se Qeveria ka planifikuar që për vitin 2014 të marrë borxh të brendshëm deri në 120 milionë euro, dhe përderisa për vitin 2013 ky borxh ishte 80 milionë euro, pra viti i ardhshëm parashihet të ketë një rritje të borxhit deri në 40 milionë më shumë.

Marrja e borxhit të brendshëm parashihet edhe në vitin 2015, çdo herë më shumë, deri në 89 milionë euro më shumë se sa janë marrë për vitin 2013.

Rënia e shpenzimeve kapitale, orientimi i tyre, çfarë ka bërë Qeveria e Kosovës me uljen e shpenzimeve kapitale prej 90 milionë eurove? Është ajo që i ka dërguar në shpenzime rrjedhëse, pra për ta ruajtur dhe mirëmbajtur pakënaqësinë e njerëzve.

Rënia e investimeve kapitale, krahasuar me vitin e kaluar, nuk po thotë që do të jetë garanci e zhvillimit ekonomik.

Mjetet, pra siç e thashë, do të shkojnë në shpenzime rrjedhëse. Kjo do të thotë stagnim. Në vend se këto mjete të përdoren për ngritjen e kapaciteteve për industrializimin e vendit, ato shkojnë në shpenzime rrjedhëse dhe më kot eksportohen jashtë, sepse s'mund të përdoren për diçka tjetër, përveç se për konsum, për të cilin e dimë mirë që më shumë se 80% e blerjes së mallrave të shpenzuesve vjen nga jashtë.

Nëse e shikojmë buxhetin e propozuar, Qeveria e Kosovës nuk i ka shikuar rrethanat, e as nevojat e vendit.

Kjo Qeveri nuk i ka as prioritetet e mira. Buxheti thekson se investimet kapitale janë rreth 90 milionë më të vogla sesa në vitin 2013. Por, asgjë nuk ka ndryshuar substancialisht nga viti 2013. Kryesisht na dalin shpenzime për infrastrukturë rrugore. Pra, buxheti kryesisht thotë që investimet do të jenë të drejtuara nga infrastruktura rrugore dhe nuk ceket asnjë projekt tjetër që do ta ulte papunësinë, që do të ndikonte në zhvillimin ekonomik, apo edhe në përmirësimin e ambientit për biznes. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.)*

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,

Ju të pranishëm,

Është e vërtetë se buxhetin si dokument që e kemi përpara mund ta vlerësojmë në bazë të perceptimit që e kemi, ose në bazë të asaj që mund të nisemi si një gotë gjysmë e mbushur, apo një gotë gjysmë e zbrazur.

Këtu patëm rast të dëgjojmë diskutime prej më të ndryshmeve, duke bërë edhe krahasime ndërmjet ndarjes së buxhetit nëpërmjet komunave dhe ministrive dikastereve përkatëse. Por, ajo që mua më vë në dilemë se nganjëherë njerëzit po zvogëlohen së tepërmi, po tkurren në petkun ndoshta nganjëherë të lokalizmit, e ndoshta nganjëherë të një vlerësimi jo të duhur dhe mbi të gjitha prapë për mua është shqetësuese kur bëhen krahasime ndërmjet buxhetit të ndarë ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe komunave, siç është Skenderaj, apo Drenasi.

Mua më vjen mirë edhe një tjetër gjë, se siç thotë Kadareja, te libri vet "Ra ky mort e u pamë", është mirë që ranë zgjedhjet dhe njerëzit e kanë shumë të reja realitetin se si ndodh

nëpër komuna. Nganjëherë duke ekzagjeruar duke keqkuptuar se diku është zhvillua më shumë e diku është zhvilluar më pak.

Por, mbi të gjitha, mua më vjen mirë që kemi vërejtur se vërtet Drenica dhe Drenasi janë shumë të pazhvilluar, madje Drenasi është komuna më e pazhvilluar në Kosovë dhe edhe Drenasi, edhe komuna tjera Gjilani e gjakova, ku ta di unë, kanë nevojë për mbështetje serioze, e jo vetëm për diskutimet tona në Parlament.

Dhe, më vjen mirë që pas një kohe të gjatë i vërejmë bashkërisht dhe shpresoj që bashkërisht t'u ndihmojmë atyre komunave, t'i bashkojmë forcat dhe të ndikojmë pozitivisht, sepse Drenica e Drenasi, mbi të gjitha, e meritojnë një qasje shumë më pozitive, shumë më serioze, dhe meritojnë një zhvillim më të mirë dhe më hovshëm.

Me vite të tëra është duke vazhduar ndarja e buxhetit e bazuar në kritere unike, me të cilat diskriminohen këto komuna, sepse nuk mund të jetë kriter i njëjtë, siç është numri i banorëve, territori e kështu me radhë, ngase disa komuna, siç është Drenasi, dhe një pjesë tjetër e Dukagjinit kanë përjetuar një shkatërrim të tmerrshëm nga lufta dhe po që se i tërë ky buxhet do t'u dedikohet atyre komunave të shkatërruara nga lufta dhe një qasje mjaft negative që e kanë pasur pushtetet në atë pjesë, ne nuk do të arrinim që t'i nivelizojmë, të bëjnë një jetë tërë normale, siç e bëjnë edhe komunat tjera.

Unë personalisht e mbështes këtë buxhet dhe ju ftoj të gjithëve bashkërisht t'i lëmë anash të gjitha ato inate, partiake e personale, t'i tejkalojmë dhe ta votojmë buxhetin, sepse me mosmiratimin e tij humb Kosova, humbin edhe qytetarët e saj dhe bashkërisht edhe ne, e nuk dëshirojmë të jemi pjesë e humbjes. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Vjollca Krasniqi e ka fjalën.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë të nderuar deputetë,

Do të përqendrohem në planifikimin e buxhetit në fushën e sigurisë, në institucionet dhe agjencitë e sigurisë.

Është e natyrshme se para çdo planifikimi të buxhetit, së pari të jepet përgjigjja në pyetjet elementare, siç janë: Cilat janë zhvillimet e kohëve të fundit në mjedisin e sigurisë? Cilat janë të ashtuquajturat rreziqe aktuale dhe kundërveprimet e reja në këto rreziqe?

Mendoj se planifikimi i buxhetit është bërë pa ndonjë studim të veçantë, pa ekspertizë të mirëfilltë, pa bashkëpunim të mirë ndërqeveritar, duke i mbajtur në terr komisionet mbikëqyrëse, larg interesit të medieve, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë.

Derisa intensiteti i rreziqeve që e kërcënojnë paqen dhe sigurinë, rendin dhe ligjin janë në ngritje e sipër, është absurde që ndaj të njëjtave të kundërveprohet në mënyra jofunksionale, apo në mënyra sa për ta plotësuar formën.

Planifikimi i buxhetit për çështjet e sigurisë në mënyrë të njëjtë si tre vjetët e kaluara është tregues se ky buxhet vetëm e siguron mbijetesën e institucioneve të sigurisë, duke i bërë ato joefikase në përmbushjen e misionëve dhe detyrave esenciale.

Edhe këtë vit nuk është bërë vlerësimi adekuat i rreziqeve politike, ekonomike e shoqërore dhe atyre natyrore.

Prandaj, vonesat e paarsyeshme në rishikimin strategjik të sektorit të sigurisë ndikojnë drejtpërdrejt në planifikimin e dobët të këtij buxheti.

Derisa Republika e Kosovës është vendi më i përfolur në Evropë në raportet e autoriteteve ndërkombëtare për krimin e organizuar, tregtinë e kundërligjshme, kontrabandën e drogës, imigrimin, tregtinë me qenie njerëzore, shpërdorimin me drejtat e njeriut, paqëndrueshmërinë e brendshme politike, varfërinë, degradimin e tokës, keqpërdorimin e burimeve, atëherë është e natyrshme se organet e sigurisë në mungesë të vullnetit politik të Ekzekutivit, ekspertizës, autorizimeve ligjore, mundësive teknike dhe planifikimit të dobët buxhetor janë të kufizuara për të kundërvepruar ndaj këtyre dukurive.

Nga analiza e planifikimit të tillë, shumë lehtë arrihet në përfundime se në vitin 2014, në si shoqëri do të përballemi me kërcënime ndoshta të njëjta në forma më agresive, pa mundësi të lëvizjes së lirë në tërë territorin e Kosovës, me rritjen e keqpërdorimeve të fondeve publike dhe korrupsionit, shpenzime joefektive dhe joefikase.

Mendoj se mënyra e shpërndarjes së mjeteve financiare për institucionet dhe agjencitë e sigurisë nuk plotëson kushtet elementare që ato të jenë në nivelin e kërkuar për përmbushjen e misionëve, përkundrazi i bën joefikase, po ashtu edhe vetë ato të ndikueshme nga dukuritë negative dhe jo rrallë herë edhe vetë të përfshira në veprime korruptive dhe kriminale.

Do të doja t'i them pak fjalë edhe për planifikimin e buxhetit në sektorin e sportit dhe rinisë.

Me këtë buxhet, edhe këtë vit, edhe këtë herë, injorohen të rinjtë, të rejat, klubet, federatat dhe të gjitha organizatat sportive që zhvillojnë aktivitete në mënyrë të organizuar.

Edhe këtë vit, në tabelat buxhetore shihen disa palestra sportive, shumica prej tyre projekte në vazhdim, arnime, e për projekte të reja janë vetëm një milion 950 mijë euro, çka do të thotë se e kemi një shumë tepër të vogël. E kemi një përqindje shumë të vogël, diku 0,5% e buxhetit të gjithmbarshëm shpenzohet në sport.

Në një nga tabelat buxhetore e kemi ndërtimin e një pallati olimpiq. Të ju them të drejtën, bukur marr vesh në segmentin sportiv, por këtë pallat olimpiq, nuk di se çfarë do të thotë, çfarë destinimi do të ketë, ku do të ndërtohet dhe do të ishte mirë që ministri Krasniqi të jetë i pranishëm, mirëpo ai më duket që nja tre-katër muaj ka harruar të vijë në këtë sallë,

dhe nuk besoj që ka punë më të mirë dhe më të rëndësishme se të jetë sot këtu i pranishëm, që të paktën t'i elaboroj edhe ato pak projekte që janë paraparë për këtë projektligj.

Ajo që është edhe më shqetësuese, është buxheti i paraparë për rininë. Për rininë janë paraparë 0,08% shpenzime nga ky buxhet. Andaj, kjo më së miri tregon se si kjo Qeveri përkujdeset ndaj kësaj kategorie, që gjithnjë e më shumë është e zhgënjyer, pa mundësi punësimi, pa mundësi të zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme, andaj kjo përqindje flet vetë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Albana Fetoshi e ka fjalën.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryetar!

Fillimisht do të isha ndalur në atë që e tha kryeministri Thaçi pak më herët, në premtimet që i bëri për rritje të pagave. Më konkretisht, do të isha ndalë te premtimi i kryeministrit që e pati për rritje të pensioneve.

Desha t'ia përkujtoj kryeministrit që kot bën premtime për rritje të pensioneve, nëse kjo nuk është e paraparë në buxhetin e vitit 2014, për shkak se nëse i shikojmë shifrat për pensionet, aty vërehet një rritje prej 9% e kategorisë së pensioneve bazë, që do të përfitojë kjo kategori, e kjo nuk ka të bëjë me rritjen e pensioneve, por kjo ka të bëjë me rritjen e numrit të atyre që përfitojnë. Prandaj, nuk është mirë që këtë lloj kategorie t'i gënjëjë në këtë mënyrë një kryeministër i vendit.

Sa i përket buxhetit për vitin 2014, nuk kemi vërejtur se ka ndonjë ndryshim prej viteve paraprake sa i përket mënyrës së ndërtimit të këtij buxheti.

Investimet kapitale për këtë vit janë 90 milionë më pak se në vitin paraprak. Pra, kemi një rënie prej 15% të investimeve kapitale, ndërkohë që kemi rritje të pagave dhe mëditjeve, të mallrave dhe shërbimeve. Dhe, kjo nënkupton që rritje të pagave dhe mëditjeve, mallrave dhe shërbimeve do të kemi edhe për shumicën e ministrive.

Për shembull, në Ministrinë e Financave kemi rritje të mallrave dhe shërbimeve për 12,6%. Në Ministrinë e Infrastrukturës kemi rritje të pagave dhe mëditjeve për 4,9%. Ndërkohë që numri i të punësuarve mbetet i njëjtë, si dhe rritja në mallra dhe shërbime për 3,3%. Në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik kemi rritje të pagave dhe mëditjeve për 9,4%, ndërkohë që numri i të punësuarve mbetet i njëjtë. Rritje enorme në mallra dhe shërbime gjen në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, ku kemi një rritje prej mbi 100% për mallra dhe shërbime. Nuk mbetet keq në këtë drejtim as Ministria e Punëve të Jashtme, ku ka një rritje në paga dhe mëditje për 32,2%, ndërsa në mallra dhe shërbime për 9,5%.

Sa u përket investimeve kapitale që janë paraparë në këtë projektbuxhet për vitin 2014 vlen të theksohet se këto investime kapitale shumica prej tyre janë të bartura nga vitet paraprake, shumica e atyre nga viti 2012.



Po i marr disa shembuj, për shembull në Ministrinë e Infrastrukturës të projektet e bashkëfinancimit me kuvendet komunale janë 31 projekte të bartura nga vitet paraprake, ndërsa vetëm një projekt është i ri për vitin 2014, ku shumica e këtyre projekteve janë për asfaltim të rrugëve, ndërsa 4 prej tyre janë për ndërtim të rrugëve.

Në total, për Ministrinë e Infrastrukturës, sa u përket projekteve kapitale, shuma është 188 milionë e 975 mijë e 172 euro, ndërsa totali i Ministrisë së Bujqësisë, sa u përket projekteve kapitale, kap shumë jo më shumë se 9 milionë e 989 mijë e 206 euro.

Pra, nëse i krahasojmë këto dy shifra, i bie që pjesa më e madhe e investimeve kapitale është orientuar në ndërtim të rrugëve, e jo në prodhim.

Kur flitet për rritjen ekonomike prej 4%, Qeveria flet pikërisht për këtë investim të projekteve kapitale në sektorin publik, që do ta mundësonte këtë, e që kryesisht është për ndërtim të rrugëve.

Por, nëse e shikojmë, kjo nuk është një rritje ekonomike afatgjate dhe e qëndrueshme, sepse nuk është një rritje ekonomike që bazohet në prodhim.

Në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 39 projekte kapitale janë të bartura nga vitet paraprake. Shumica prej tyre janë të bartura nga viti 2012, ndërsa vetëm 9 projekte të reja për vitin 2014.

Te të gjitha këto projekte, Qeveria është mjaftuar vetëm me ndërtim të shkollave, por jo edhe të investojë në cilësinë e arsimit.

Te Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, 7 projekte janë të bartura nga vitet 2012 dhe 2013, dhe e kemi vetëm një projekt të ri për vitin 2014, e ai projekt ka të bëjë me blerjen e dy veturave të transportit.

Nëse dëshirojmë t'i krahasojmë të gjitha projektet e bartura nga viti 2012, se në cilën fazë të punës janë dhe a janë gati të përfunduara, ta shikojmë transparencën e punës së këtyre projekteve, këtë e kemi të pamundur, sepse nuk janë të parapara te raporti vjetor i buxhetit për vitin 2012, e besa as te raporti vjetor i shpenzimeve të buxhetit për vitin 2013. Është fjala për raportin e shpenzimit të këtyre projekteve, domethënë veç e veç për secilin projekt.

Te të hyrat nga kufiri për vitin 2014 parashihen të jenë 934 milionë euro, që shënon një rritje prej 2% nga viti paraprak.

Si pasojë e mosinvestimit në sektorët që do të sillnin prodhim, kemi rritje të importit, pra eksport të parasë sonë.

Pasi pjesa më e madhe e buxhetit mbledhet në kufij dhe kur e kemi parasysh që pjesa e mallrave të importuara janë mallra të konsumit për mbijetesë, atëherë vijmë në përfundim

se janë qytetarët e varfër ata që e paguajnë shumicën më të madhe të tatimit dhe njëkohësisht janë ata që përfitojnë më së paku nga ky buxhet.

Që të ketë punësim për të gjithë, pastaj rritje të pagave, është e domosdoshme që të mos e kemi këtë Qeveri në pushtet, e cila e ka dobësuar shtetin dhe e ka përdorur pushtetin për pasurim personal, sepse që të kemi mirëqenie për të gjithë duhet që secila pjesë e politikës të funksionojë. Duhet që pasuria e përgjithshme e akumuluar të shpërndahet drejt.

Në Kosovë, asnjë pjesë e politikës nuk është në funksion të qytetarëve dhe duke mos qenë në këtë funksion, ajo është në funksion të pushtetarëve që e kanë mbytur Republikën dhe e kanë drejtuar akumulimin e pasurisë kah vetja e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Një pjesë të fjalimit tim do ta dorëzoj në Administratën e Kuvendit, mirëpo meqë u diskutua edhe për investimet në kulturë, më intrigoi që ta marr fjalën, me gjithë faktin që ministri Krasniqi ndodhet në një vizitë zyrtare në Shqipëri dhe e ka pasur të pamundur të jetë sot këtu.

Ndërkaq këtu u përmendën shpërblimet për projektin e fundit të zotit Sopi dhe unë e di që janë subvencionuar tri bileta për të shkuar dhe për ta marrë shpërblimin dhe këto bileta janë anuluar dhe me vetë vendimin e regjisorit Sopi dhe kjo përkrahje e Ministrisë së Kulturës ka qenë evidente gjatë këtyre dy vjetëve të fundit. Do të thotë, kjo Ministri ka ndarë vazhdimisht fonde për të gjitha artistët, për komunitetin artistik, pastaj komuniteti është përkrahur pothuajse në të gjitha kërkesat, si në udhëtime jashtë vendit, si në marrje të shpërblimeve dhe të çmimeve të ndryshme.

Pastaj u përmend këtu buxheti për kulturë, buxhet ky që është rritur mbi 100% vetëm gjatë këtyre dy vjetëve të fundit. Gjithë performuesit e artit gjatë këtyre dy vjetëve kanë kushte më të mira për punë.

Po i përmend të gjitha institucionet, Teatrin Kombëtar, ansamblin e valleve 'Shota', Filarmoninë e Kosovës, Qendrën Kinematografike të Kosovës, Trupin e Baletit, Galerinë Kombëtare. Të gjitha këto institucione gjatë këtyre dy vjetëve kanë pasur mundësi më të mira, si dhe kanë pasur kushte më të mira për punë dhe rritje të buxhetit.

Po ashtu, gjatë vitit të ardhshëm është paraparë edhe një rritje e buxhetit për 20%, që nuk do të thotë që është e mjaftueshme, mirëpo nuk mund të thuhet se nuk është punuar në këtë drejtim. Faleminderit!

*(Diskutim i dorëzuar me shkrim)*

I nderuari kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në pika të shkurtra të bëj një përmbledhje të Buxhetit të prezantuar para nesh dhe njëkohësisht në mënyrë kritike të jap vlerësimin tim për këtë buxhet.

Mendoj se materiali i dërguar nga Qeveria në mënyrë të detajuar dhe shumë profesionale ofron informata mbi bazën e të cilave është përgatitur Buxheti për vitin 2014.

Nëse i referohemi pjesës tekstuale të propozim-buxhetit, është e qartë se Qeveria ka bërë analizat e nevojshme historike dhe projeksionet e bazuara për vitet në vijim, dhe rrjedhimisht, duke u bazuar në pritjet për performansën e ekonomisë sonë, edhe e ka hartuar Buxhetin për vitin 2014.

Ne jemi të vetëdijshëm se ekonomia e vendit tonë nuk është e izoluar nga trendët dhe ecuritë e ekonomive të vendeve tjera. Megjithatë, duhet të thuhet se si në vitet e kaluara, ashtu edhe në vitet në vijim, pritjet që ekonomia jonë të vazhdojë t'i ketë normat më të larta të rritjes ekonomike, në krahasim me të gjitha vendet regjionale.

Kjo është reflektuar edhe në propozim-buxhetin që ne sot po e shqyrtojmë.

Nëse e shikojmë me kujdes pjesën e të hyrave, mund të konstatojmë se është planifikuar një rritje kualitative e të hyrave buxhetore për vitin 2014, si dhe për vitet vijuese.

Përpos rritjes së planifikuar në total të hyrat, është me rëndësi të veçohet planifikimi për rritje të theksuar në të hyrat vendore tatimore - pra të hyrat nga Administrata Tatimore e Kosovës (AKT).

Përderisa në vitin 2013 pritjet që të hyrat nga ATK-ja në total të hyrat tatimore të marrin pjesë me 25,5%, në vitin 2014 është planifikuar që të hyrat nga ATK-ja në raport me total të hyrat tatimore të rriten në 29%.

Shikuar nga këndvështrimi i rritjes vjetore, të hyrat tatimore në brendi të vendit është planifikuar të rriten me mbi 22%.

Kjo rritje e planifikuar nuk mbështetet në ndonjë ndryshim në normat tatimore - me fjalët të tjera, rritja e planifikuar prej 22% do të bëhet e mundur, duke i mbajtur të pandryshuara normat tatimore për të gjitha llojet e tatimeve.

Kjo zhvendosje nga tatimet e mbledhura në kufi, drejt mbledhjes më të theksuar në brendi të vendit, reflekton përkushtimin e Qeverisë për të formuar edhe më tutje kapacitetet e Administratës Tatimore, për të luftuar informalitetin dhe çka është shumë e rëndësishme, rritja e planifikuar në të hyrat nga ATK-ja reflekton aktivitetin e shtuar ekonomik të vendit.

Sa u përket shpenzimeve, edhe këtu është planifikuar rritje e buxhetit për t'i implementuar reformat dhe projektet me rëndësi për vendin.

Ky buxhet parasheh ndërtimin e autostradës në drejtim të kufirit me Maqedoninë, investime në rrugët që çojnë në drejtim të Mitrovicës dhe Pejës dhe ndërtimin e një numri të madh të rrugëve tjera regjionale dhe lokale.

Ky propozim-buxhet parasheh investime të konsiderueshme edhe në sektorët tjerë, të tillë si arsimi, shëndetësia, bujqësia, sektori i sigurisë, e kështu me radhë.

Ajo çka është me rëndësi të veçantë, duke filluar nga viti i ardhshëm do të ketë rritje të konsiderueshme të pagave për të gjithë shërbyesit civilë.

Tani të nderuar deputetë,

Më lejoni që shkurtimit të flas mbi qëndrueshmërinë buxhetore dhe kredibilitetin e propozim-buxhetit.

Siç e dini, në qershor të këtij viti ne i kemi aprovuar ndryshimet në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe një pjesë e konsiderueshme e këtyre ndryshimeve lidhen me aplikimin e rregullës fiskale.

Ashtu sikur që shumë vende të tjera evropiane që viteve të fundit kanë modifikuar ose kanë dizajnuar rregulla të reja fiskale, tani edhe ne e kemi një rregull të tillë që siguron se Qeveria e tanishme dhe qeveritë e ardhshme të vendit t'i mbajnë nën kontroll nivelet e deficitit buxhetor.

Duke e respektuar këtë rregull fiskale, ne sigurohemi se vendi ynë do të ketë qëndrueshmëri buxhetore dhe financiare në vitet në vijim. Për më tepër, mbajtja nën kontroll e deficiteve buxhetore do të sigurojë një rritje graduale dhe të kontrolluar të borxhit publik.

Buxheti që kemi para nesh në tërësi e respekton këtë rregull fiskale. Për më tepër, buxheti i propozuar gjithashtu ka paraparë mbajtjen e niveleve adekuate të bilancit bankar.

Ju të nderuar deputetë, e dini se Kosova nuk ka politikë monetare dhe rrjedhimisht instrumenti i vetëm nëpërmjet të cilit mund të orientohet ekonomia jonë është buxheti.

Për më tepër, në rastet e jashtëzakonshme është buxheti ai që i bën të mundur Qeverisë të intervenojë në fusha dhe sektorë të caktuar.

Prandaj, mbajtja e niveleve adekuate të bilancit bankar është një domosdoshmëri dhe këto nivele adekuate janë pjesë e këtij propozim-buxheti.

Rrjedhimisht, mund të konstatoj se ky propozim-buxhet është transparent, mirë i integruar dhe mbi të gjitha është buxhet kredibil, që siguron rritje ekonomike dhe qëndrueshmëri makrofiskale.

Këto konstatime, në fakt, nuk janë aspak subjektive. Besoj se ditë më parë keni mund të shikoni dhe lexoni pikëpamjet e Fondit Monetar Ndërkombëtar mbi Buxhetin 2014.

Sipas FMN-së, Buxheti i vitit 2014 është buxhet që mundëson vazhdimin e implementimit të prioritetëve të Qeverisë, implementimin e reformave me rëndësi dhe çka është më e rëndësishmja është buxhet që të gjitha këto projekte i integron brenda një kornize të qëndrueshme fiskale.

Si përfundim, ky buxhet i përgatitur nga Qeveria është buxhet i rritjes ekonomike, buxhet i vazhdimin të reformave me rëndësi për vendin dhe është buxhet i vazhdimin të qëndrueshmërisë fiskale.

Si rrjedhojë, ne e kemi mbështetjen e fuqishme të FMN-së dhe më lejoni të them se gjatë viteve të fundit ne jemi një nga vendet e rralla për të cilën FMN-ja si një institucion me kredibilitet ndërkombëtar sa u përket financave dhe sektorit financiar, vazhdimisht i jep vlerësimet e tij më pozitive të mundshme për Kosovën. Faleminderit!

*(Blerta Deliu-Kodra, d.v.)*

KRYETARI: Deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projekt-buxheti që vjen i propozuar nga Qeveria me përmbajtjen strukturën dhe mënyrën e prezantimit të tij e vijon logjikën e një 'status quo'-je që ishte e pranishme edhe gjatë viteve të kaluara të këtij mandati qeverisës dhe e servison edhe më tutje këtë 'status quo', me një tendencë përkeqësimi në periudhën në vijim.

Ky dokument ka probleme serioze në tri aspekte:

Aspekti i parë është se ka një shprehje logjike, analitike dhe të natyrave tjera midis trendëve ekonomikë, sfondit makroekonomik në Kosovë dhe buxhetit propozuar, pra kemi gati dy botë paralele.

Dy, ka paqartësi në tekst dhe në prezantimet që i kemi sot nga përfaqësuesit e Qeverisë ka paqartësi lidhur me politikën buxhetore, cila është filozofia e tyre politikave, filozofia ekonomike-sociale. Ka paqartësi lidhur me prioritetet dhe lidhur me projektet nacionale.

Dobësia e tretë serioze është se i tërë procesi buxhetor, por edhe ky dokument nuk e siguron një transparencë të domosdoshme që duhet ta përcjellë procesin buxhetor. Pra, ka probleme të transparencës edhe lidhur me mënyrën qysh prezantohet buxheti, edhe me strukturën e buxhetit. Ka defekte serioze edhe në prezantimin teknik të dokumentit.

Këto dobësi serioze i kanë përcjellë edhe dokumentet e buxheteve në vitet paraprake dhe sot me keqardhje mund të konstatohet se asnjë përmirësim nuk është arritur, me gjithë propozimet dhe sugjerimet që janë bërë në këtë Kuvend.

Sa i përket aspektit të parë, sa korrespondon buxheti me situatën makroekonomike, në pjesën shoqëruese të tabelave buxhetore, në pjesën tekstuale, që pretendon të jetë analizë makroekonomike, analiza e trendëve ekonomikë dhe treguesve të sfondit makroekonomik është sipërfaqësore, në disa pjesë kundërthënëse.

Kjo analizë nuk korrespondon me projeksionet buxhetore. E kemi theksuar disa herë se analizat makroekonomike dhe produktet e Agjencisë Statistikore të Kosovës lidhur me llogaritë kombëtare janë larg nevojave për një qeverisje të mirë ekonomike, që në epiqendër do të duhej ta kishte përcaktimin e politikave cilësore ekonomike me të cilat do të shfrytëzoheshin burimet, kompetencat dhe mundësitë e Qeverisë për ta sendërtuar rritjen më të madhe ekonomike, hapjen e vendeve të punës, ngritjen e cilësisë e të jetës së qytetarëve, sidomos të grupeve të marginalizuara, që më së shumti goditen nga varfëria e pranishme në Kosovë.

Fatkeqësisht, prej asaj që shohim dhe dëgjojmë, Qeveria nuk ka pasqyrë lidhur me këtë çështje me rëndësi kruciale dhe nëse nuk ekziston një pasqyrë reale dhe një koshiençë për kundërthënie në matrix-in ekonomik e social në Kosovë, nuk ka se si të prodhohen politika cilësore dhe buxhet i mirë. Prandaj, harrojeni se ky është një buxhet i mirë.

Ne sot patëm fjalime të përfaqësuesve të Qeverisë dhe nga ato fjalime nuk e shohim se prezantohet këtu as më i vogli problem në Kosovë. Prej fjalimeve të tyre del se Kosova është një vend i ëndrrave, në të cilën njerëz duhen të jetojnë, e jo një vend ku njerëzit ikin refugjatë dihet në çfarë gjendje.

Prandaj, ju lutem, të kthjellemi, sepse situata është për një qasje serioze, jo një qasje me premtim se rriten pagat 100%, e në tre vjetët e ardhshme rritja që është në këtë dokument që e ka sjellë Qeveria, që e kryeson kryeministri, është 21%. Ju lutem!

Prandaj, duhet të bëhemi serioz edhe t'i trajtojmë. Këto janë probleme të përbashkëta. Nuk po akuzoj, por pletoj që të bëhemi seriozë, sepse situata është serioze. Dokumenti është serioz, prandaj ju lutem që të mos e shohim këtë punë pozitiv-opozitiv, por ta shohim si një dokument esencial të Kosovës, nga i cili varet cilësia e jetës në Kosovë.

Rritja e projektuar ekonomike, projeksionet dhe komponentët që duhet ta sajojnë këtë rritje ekonomike nuk janë bindëse, as të qëndrueshme. Kjo kryesisht presupozon rritjen e eksportit, të investimeve private, konsumit privat e publik, por e tërë kjo në dokumentin që e shoqëron tabela buxhetore është më tepër deklarative, e jo e arsyetuar.

Rritja e investimeve publike është një problem serioz dhe do ta frenojë rritjen ekonomike. Rritja e projektuar e investimeve private në kushtet e kredive të shtrenjta dhe rënies së ritmit të kredidhënies nga bankat në kushtet e klimës derprimuese biznesore dhe investuese nuk është reale. Fakti se Kosova e ka përmirësuar pozitën në rangimin ndërkombëtar për mjedisin biznesor nuk duhet të mashtrojë, pasi ky përmirësim ka të bëjë me disa ndryshime në ligje dhe kjo nuk duhet të mashtrojë përderisa ligjet nuk zbatohen, përderisa investitorët e ndiejnë veten të kërcënuar nga mosefiçienca e sistemit ligjor dhe gjyqësor dhe përderisa perceptioni mbi rritjen e korrupsionit është në rritje.

Edhe projeksionet lidhur me konsumin nuk janë adekuate dhe të arsyetuara. Mjafton të bisedoni me tregtarë dhe do të ju tregojnë sa ka rënë blerja e mallit të konsumit në Kosovë prej viti në vit. Andaj, projeksionet e paqëndrueshme për rritjen ekonomike janë problem qendror në këtë dokument dhe kështu i bën të paqëndrueshme edhe projeksionet lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit.

Projekti i buxhetit nuk përmban arsyetim për shpenzime. Nuk shihet filozofia, prioritetet dhe politikat që qëndrojnë prapa ndarjes së buxhetit për destinim në sektorë të caktuar. Nuk ka një arsyetim se pse e kemi një rënie të buxhetit në investimet publike prej 15%. Pse kemi një rritje të shpenzimeve për mallra dhe shërbime dhe pse kemi rritje të shpenzimeve për transfere? Pse kemi rritje të shpenzimeve për mallra dhe shërbime për 12%, në kohën kur investimet kapitale zvogëlohen për 90 milionë? Nuk kemi as adresim të ministrit të na arsyetojë, as nuk kemi sqarim në dokument. Ky është problemi.

Duhet seriozisht të bëhet një auditim në sektorin social të shpenzimeve, transfereve dhe subvencioneve për arsye se unë jam i bindur se kjo faturë është mjaft e rëndë për Buxhetin e Kosovës, por ka mundësi të analizohet, të racionalizohet dhe të adresohen çështjet që kanë mbetur nga kjo situatë.

Na shpeshherë kemi biseduar për numrin e përfituesve nëse janë realë, apo nuk janë, por duhet bërë një auditim serioz. Nuk ka kurrfarë arsyetimi për orientimin e mjeteve buxhetore në arsim, shëndetësi dhe çështje të tjera.

Lidhur me këtë kërkoj sqarime. Nuk di a janë këtu ministrat. Kam pyetje konkrete për tre ministrat. Kam pyetje për ministrin e Infrastrukturës, ai qëndroi mjaft gjatë, por shkoi. Unë kërkoj që ai t'i sqarojë Kuvendit se është norma e kthimit të investimeve në projektin e autostradës Prishtinë-Hani i Elezit dhe si mendohet të përmbyllet? Sa përfiton, sa kontribuon? Nga përqindja e kthimit të këtij investimi, ne e shohim nëse është ky projekt i pranueshëm ajo. Asnjëherë nuk është prezantuar.

Dy, kërkoj sqarime nga Ministri i Arsimit lidhur me buxhetin për universitetet e reja në Pejë, në Mitrovicë dhe në Gjilan, sepse i kemi themeluar tash, duhet t'i servisojmë. Sa është buxheti për këto universitete i bazuar në rritjen e buxhetit të Ministrisë, ose sa është bërë? Nuk qenka as ai këtu, ose si është bërë ai ristrukturim brenda, të servisohet. Nuk është lojë të krijohen 4-5 universitete.

Tre, kërkoj sqarime nga ministri i Shëndetësisë, i vetmi është këtu, për arsytet e pakënaqësisë së tij lidhur me buxhetin dhe për atë se si po adresohen këto pakënaqësi dhe çfarë pasojash do të kemi nëse këto pakënaqësi nuk adresohen?

Problemi i tretë i buxhetit është transparenca dhe prezantimi tejet i mjegulluar i këtij buxheti. Është problematik, ka telashe në metodologji. Së pari, ne kemi këtu prezantimin e buxhetit, projeksionet në bazë të buxhetit të vitit 2013, e jo në bazë të gjendjes reale, faktike të realizimit të buxhetit. Ky është defekt metodologjik, defekt esencial.

Në buxhet ne i kemi 300 milionë nga Posta dhe të tjera. Posta nuk është shitur, ne sot na vjen që i kemi 300 milionë. Është shitur? Ndoshta është shitur! Kështu që është problem, ky është problem metodologjik, se nuk e paskam këtu kolegun tim, i cili është profesor i ekonomisë. Nuk mund të bëhet projeksion mbi projeksion. Projektioni bëhet mbi vlerësimin e gjendjes reale. Problemi është shumë i rëndë.

Tjetër problem është, lexojeni arsyetimin...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Ju po e zgjatni shumë! Urdhëro, edhe një minutë.

MUHAMET MUSTAFA: ... E keni, shikojini këto grafikone që na kanë ardhur. Në qoftë se dikush di t'i deshifroj, unë po ia jap çmimin Nobel. Këtu ndoshta kur janë ngjyra në kompjuterët e Ministrisë të Financave deshifrohen, por neve na kanë ardhur kështu dhe kjo është lojë me deputetët, ju lutem.

Prandaj, mendoj se problemi i transparencës është shumë serioz dhe e lëndon seriozisht demokracinë në Kosovë. Në këtë drejtim, unë kërkoj që Qeveria ta marrë këtë dokument seriozisht, ta përmirësojë dhe i duhet një ristrukturim, një përmirësim serioz në përmbajtjen, strukturën, në prezantim, gjithçka para se eventualisht ta konsiderojmë se duhet ta aprovojmë.

Unë do të dëshiroja që ta aprovojmë dhe ta kemi një buxhet të mirë, por nuk është buxhet i mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Në projektbuxhetin e këtij viti nuk ka asgjë të re. Vazhdon e njëjta logjikë logjik - logjika e rezultateve të së cilës shihet në sy dhe nuk ka nevojë për analiza të hollësishme. Projektbuxheti po na tregon se si do të shpenzohen paratë, e jo se si do të investohen ato.

Pra, sindromi i shpenzimit të parave nuk përshkon ndryshe, vetëm se duke u ricikluar dhe pothuaj nuk vërehen përpjekje për ta ndryshuar këtë gjendje. Dallimet janë diku në shifra, e diku as në shifra, pasi pothuaj gati asgjë nuk ndryshon nga logjika e së shkuarës. Por, së pari përse para trajtimit të projektbuxhetit edhe këtë vit, raporti nëntëmujor i shpenzimeve vjen i mangët?

Përse ne si deputetë nuk mund ta dimë se çfarë ka ndodhur me investimet kapitale? Ku ka kuptim që ne të flasim sërish dhe ta ripërthypim vit pas viti tek investimet kapitale në çështje të caktuara, projekte të caktuara, të cilat vetëm përsëriten, përsëriten çdo vit dhe në fund të vitit ato as nuk përfundohen, dhe prapëseprapë në vitin tjetër vjen po i njëjti projekt, por para se të vijë ky projektbuxhet nuk vjen së pari një raport i qartë se a janë shpenzuar paratë për atë projekt në vitin që ka kaluar.



Dhe, këto projekte nuk mund t'i hasësh vetëm në Ministrinë e Bujqësisë, ku mu më tepër më ka rënë që t'i trajtoj, por edhe në ministrinë tjera.

Kot pra tregohen rritje ta zëmë në Ministrinë e Bujqësisë, përderisa nuk raportohen se si janë shpenzuar paratë e buxhetit të shkuar. Nga përvoja e çdo viti deri tash, i bie që sërish investimet kapitale janë një dështim në të gjitha sferat. Po të ishin investimet kapitale të realizuara me sukses, Ministria dhe e tërë Qeveria, jo vetëm që do të jepnin hollësi për këto projekte, por propaganda në media nuk do të kishte pasur të ndalur. Përse po na fyen inteligjencën me të njëjtën logjikë çdo vit? A po llogaritni në harresë, apo si është puna? Si do ta imagjinojmë ne zhvillimin kur investimet në projektet kapitale nuk e dimë sa janë realizuar?

Vitin që shkoj paratë nga investimet kapitale, e që gjatë tërë vitit nuk janë shpenzuar, ta zëmë në Ministrinë e Bujqësisë, në fund të vitit janë bartur subvencione. Janë disa projekte, unë do të doja ta marr shembull projektin e rehabilitimit të sistemit të ujitjes. Prej se unë jam deputet, në çdo trajtim, apo në çdo rishikim të buxhetit ka ekzistuar dhe ka figuruar projekti për rehabilitimin e sistemit të ujitjes.

Dhe, çfarë ndodh? Çdo vit asnjë cent i vetëm nuk shpenzohet në këtë projekt. Ngjashëm ndodh edhe me projektet tjera, ta zëmë projekti i pikave të grumbullimit, apo projektet tjera edhe në çështjet e mjedisit.

Çfarë ndodh me paratë e këtyre projekteve në fund të vitit? Në fund të vitit përherë kemi pastaj transferet, ku të gjitha këto para nga investimet kapitale barten në subvencione. Çfarë po ndodh?

Pra, paratë e buxhetit nuk po bëhet ndryshe, vetëm pse po shpenzohen. Ato nuk po investohen. Nuk po shkojnë paratë në projekte, nga të cilat pastaj do të kemi kthim, por ato para vetëm po shpenzohen, sepse edhe në rastet kur kemi investime kapitale, ato barten prapë në subvencione, e si jepen ato subvencione? A jepen prapë si ndonjë lloj investimi, se natyrisht edhe nga subvencioni mund të llogaritet se ato janë një lloj i investimit, por nëse ato jepen me vonesë dhe jepen në kesh, shumicën e rasteve ato para vetëm që do të shpenzohen.

Nuk shkojnë në bujqësi, nuk shkojnë në farëra, nuk shkojnë në pleh, nuk shkojnë në naftë, sepse janë dhënë pasi është korrur gruri. Pra, edhe nëse duhet të japim subvencione, e që natyrisht se duhet, pra duhet të kemi subvencione, atëherë duhet të jetë e qartë se si duhet të jepen ato. Duhet të jepen me materiale në furnizimet e ndryshme, të cilat drejtpërdrejt investohen dhe drejtpërdrejt sjellin rezultat.

Por, çfarë ndodh këtu tash? E kemi këtë logjikë të përsëritjes, e në anën tjetër kemi vetëm subvencion, pa pasur investim kapital. Kudo nëpër logjikën e vendeve, në mënyrën se si investohet në bujqësi, ta zëmë në vendet tjera, investimet kapitale dhe subvencionet shkojnë në një raport të barabartë njëra me tjetrën. Nuk ka kuptim vetëm njëra, të shpenzohen paratë në njërin, përderisa të mos të ketë një infrastrukturë përcjellëse për ato subvencione.

Këtu me vite të tëra nuk investohet asnjë cent në zhvillim, ndërsa paratë harxhohen shumë thjesht në subvencione.

Pra, logjika e shpenzimit të parasë është shndërruar në logjikë të përgjithshme të buxhetit. Kudo mallra dhe shërbimet rriten, bien projektet kapitale, dhe të cilat projekte kapitale mbijetojnë? Cilat janë ato projekte kapitale të cilave u shpenzohen paratë në fund të vitit? Janë vetëm ato që kanë të bëjnë kryesisht me disa ndërtime, e ku e dimë shumë qartë që përfitimin nga ato ndërtime nuk e ka qytetari, por e kanë ose kompanitë, ose në njëfarë mënyre mund ta kenë edhe politikanët, apo ministritë.

Dhe, nëse fillojmë tash të bëjmë krahasime nga ministria në ministri, atëherë e shohim që qytetari sërish mbetet ai i fundit që përfiton nga këto para të buxhetit. Paratë e buxhetit qarkullojnë në mënyra të ndryshme, pasurohen, rriten diferencat te qytetarët tanë, varfëria e skajshme bëhet edhe më e skajshme për disa, ndërsa për disa të tjerë, për një shtresë të vogël, një pjesë të vogël të qytetarëve, bëhet një pasurim i paimagjinueshëm, rriten diferencat.

Në anën tjetër, shteti na dobësohet përditë e më tepër. Kjo është një logjikë që duhet ndryshuar dhe me këtë logjikë të shpenzimit të parasë publike dhe me këtë logjikë të ndarjes së buxhetit, alokimit të buxhetit, është e qartë që nuk ka ndryshim as për këtë vit dhe nuk pritët të ketë ndryshim as në vitin që vjen.

Prandaj, ndryshimet janë të domosdoshme dhe ndryshimet patjetër se do të lidhen edhe me mënyrën se si do të alokohet buxheti, edhe me mënyrën se si të shpenzohet buxheti i ndarë. Pra, të shpenzohet apo të investohet dhe natyrisht që për këtë projektbuxhet ne do të votojmë kundër.

**KRYETARI:** Ju njoftoj që të gjithë deputetët që tani janë të paraqitur për debat janë nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike. Fjalën e ka deputetja Nazane Breca.

**NAZANE BRECA:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Me analizimin e projektbuxhetit të vitit 2014, me keqardhje pashë se edhe këtë kjo Qeveri nuk e ka prioritet shëndetësinë. Ngritja qesharake e buxhetit të Ministrisë për Shëndetësi për 7,5 milionë nuk mjafton për t'i ofruar shërbime shëndetësore kualitative popullatës tonë, nuk mjafton për t'i përmbushur nevojat e listës ekzistenciale të barërave, nuk mjafton për institucionet për infrastrukturë të objekteve shëndetësore, për pajisjet e duhura, për ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve, për avancimin e shërbimeve shëndetësore dhe të shëndetësisë, e shumë e shumë mangësi të tjera që janë në shëndetësinë tonë, e të mos flasim për pagat e punëtorëve shëndetësorë, të cilat janë shumë të ulëta dhe fyese për punën që kryejnë punëtorët shëndetësorë.

Edhe këtë vit i është dhënë prioritet asfaltit, që pacientët tanë të kenë kushte edhe më të mira të udhëtimit për të marrë shërbime shëndetësore në shtetet e rajonit e tutje, sepse në vendin e tyre nuk i kanë kushtet për t'i marrë shërbimet e duhura shëndetësore. Por, të

mos harrojë kjo Qeveri se në rastet tejet kërcënuese, kur minutat janë vendimtare, pacientët nuk mund të arrijnë as në vendet e rajonit për t'i marrë shërbimet e duhuara shëndetësore.

Gjithashtu duke analizuar pashë se në këtë projektbuxhet vërehet ulja e buxhetit për disa vija buxhetore për disa komuna. Po e marr shembull Prishtinën, ku e kemi një ulje në vijën buxhetore 'paga dhe mëditje' për 297 400, që do të thotë 49 vende pune më pak; 'mallra dhe shërbime' kemi ulje për 90 000, ose 6,48%; ulja e subvencioneve 100%, ulja e shpenzimeve kapitale për 299%, që i bie 10,66%.

Pra, marrë në përgjithësi, buxheti për shëndetësi është më i ulët për këtë qytet për 8,96%, që i bie përafërsisht 9%.

A thua hartuesi i këtij projektbuxheti është bazuar në regjistrimin e fundit të popullatës, që ka qenë një regjistrim politik, meqë me qëllim është bërë ulja e numrit të banorëve të Prishtinës për qëllime politike. Me siguri se përgjigjja do të ishte po.

Me këtë projektbuxhet, në vend që të investohet në zhvillimin ekonomik dhe të bëhet hapja e vendeve të reja të punës, që të ulet papunësia e madhe që ekziston te ne, është ngritur buxheti për asistencë sociale për 24 milionë, sepse kjo Qeveri qysh në start e pranon paaftësinë e vet për të hapur vende të reja të punës dhe është përgatitur për rritjen e numrit të të varfërve, sepse e di mirë se kjo do të ndodhë me këtë politikë, të cilën e udhëheq.

Pacientët tanë lirisht mund të shkojnë në barnatore dhe me recetë të kërkojnë nga një copë asfalt, sepse është treguar se është shumë kurues për shumë sëmundje. Edhe mangësitë tjera janë evidente në këtë projekt-buxhet, si për shembull: pensionistët nuk mund të presin vitet e pensioneve të tyre, e as punëtorët e arsimit nuk mund të presin rritje të pagave 100%, ashtu siç u është premtuar gjatë fushatës elektorale, sepse këto kanë qenë vetëm premtime se ky buxhet kështu si është nuk mund t'ua sigurojë këtë rritje.

Po të kisha mundësi që këtë Qeveri ta dërgoj në një institucion shëndetësor që të punojë vetëm 24 orë, ku do të ballafaqoheshin me probleme nga më të ndryshmet, duke filluar me sulmet fizike nga pacientët, ballafaqimi me fluksin e madh të pacientëve me patologji të ndryshme, atëherë me siguri se ky projektligj nuk do të ishte ashtu siç është tani para nesh. Faleminderit!

**KRYETARI:** Lirije Kajtazi e ka fjalën.

**LIRIJE KAJTAZI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Ne që jemi kah fundi, jo nga lodhja, por nga mirëkuptimi për të mos i përsëritur gjërat, sigurisht se do të flasim më shkurt, por megjithatë do t'i shprehim ato që janë interesimet tona për të korrigjuar atë që prezantohet në Ligjin për buxhetin.

Ajo që e kemi vërejt ne, me gjithë lavdet e një pjese të pozitës, megjithatë nuk mund të kënaqemi, edhe përkundrazi është shqetësuese ndarja e buxhetit, por interesimi për pjesën e rinisë, e cila vazhdon nga viti në vit të injorohet në mënyrën më të keqe dhe, si rrjedhojë, shihet edhe migrimi i saj. Megjithatë po them duhet më shumë kujdes që rinia të mbahet këtu me investimet që do të përqendroheshin.

Pak mund të flitet edhe për kulturën identitare, ani se u tha këtu, ne e dimë që ka shumë botime, monografi të ndryshme për përvetësimin e trashëgimisë kulturore nga shtetet fqinja dhe ne nuk investojmë në atë drejtim që me argumentin shkencor t'i përkrahim botimet, të cilat i rrinë karshi këtij dezinformimi, apo përvetësimit të trashëgimisë aonë kulturore.

Unë kam dy propozime konkrete. Duke i analizuar problemet që u dalin komunave rreth punësimit në arsim, del nevoja e ndryshimit të formulës nacionale për arsimin. Ndoshta më mirë do të ishte financimi me normën e punës sesa me numrin e nxënësve, ngase kjo ka krijuar shumë vështirësi te komunat për mbajtjen e klasave në zonat të cilat janë më pak të banuara, apo fshatrat më të thella. E dimë që formula për minoritete dallon, ndoshta do të ishte mirë që këto zona të trajtohen edhe me atë formulë, por do të ishte mirë që shikohet edhe punësimi me normën e plotë të punës dhe po ashtu ministër Buja e di që patët durimin të jeni bashkë me ne që nga fillimi, do t'ju bënte nder juve, Qeverisë juaj, krejt neve, që borxhin për dy pagat të vitit 2011 t'ua kthejmë mësimdhënësve, se ata e dinë që individualisht është nënshkruar secili, dhe meqenëse janë nënshkruar, është mirë që edhe paratë të shkojnë tek ata.

Propozimi tjetër është, meqë po ashtu e vërejt nga defektet të cilat raportohen gjatë shpenzimit të parasë nga projektet e bashkëfinancimit, qoftë edhe ajo që u përmend më parë edhe nga shkelja e Ligjit për menaxhim të financave publike dhe të vetëqeverisjes lokale. Financimi i ministri dhe pushtet lokal, vërehet një centralizim i pushtetit në ministri dhe kjo ua lë mundësinë ministrive apo ministrave që ta bëjnë atë ndarjen politike që veç është evidente nga raportimet që shihen, por edhe gjëja tjetër se ka projekt, i cili raportohet nga komuna si projekt totalisht i kryer prej saj, ndërkohë që mjetet janë bartur edhe nga ministria, dhe e lë mundësinë të manovrohet me shpenzimin e parasë. Ajo, jo vetëm për t'u mburrur që është bërë një projekt, por edhe e lë mundësinë e keqpërdorimit të asaj paraje dhe bashkëfinancimit me donatorë.

Kjo është më shumë shqetësuese me faktin se këtu kemi të bëjmë me miliona. Bashkëfinancimet me donatorë janë miliona të tërë, për të cilët asnjëherë nuk saktësohet edhe mënyra se si bëhen. Prandaj, do të ishte mirë që qoftë me ndonjë formulë të caktuar, apo me një raportim më të hollësishëm të shihet se si bëhet ky shpenzim dhe po ashtu do të ishte me rëndësi që tek investimet kapitale të bëhet edhe bartja e parasë për shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, ngase kemi objekte të cilat kanë përfunduar së ndërtuari dhe në mungesë të parasë për mirëmbajtje ato nuk mund të jenë edhe funksionale.

Këto ishin disa nga plotësimet e mia që besoj i ndihmojnë buxhetit të shtetit, i cili na takon të gjithëve njësoj. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqë jam kah fundi që flas, do të mundohem që të jem sa më i përmbledhur në pikat që mendoj që nuk janë tanguar nga kolegët. Unë do t'i përkushtohem aspektit teknik që u tha këtu se mirë është i strukturuar. Ai strukturës sektoriale të këtij buxheti, sa sektorë, çfarë sektori i është dhënë prioritet, cila është arsyeja e atyre prioriteteve dhe qëllimi final se sa është ky buxhet, ky projeksion na jep një buxhet zhvillimor, apo nuk na jep.

Nëse ndalemi te pika e parë, pra te aspektit teknik, kujtoj se ka shumë mangësi që ky buxhet do të duhet korrigjohet. Po fillojmë nga neni 4 i Ligjit të buxhetit, i cili flet për komunat. Edhe më herët nga disa kolegë u tangua te performansa e komunave në raport me buxhetet ekzistuese. T'u përkujtoj të gjithë kolegëve se komunat e kanë vetëm një tatim, ai është tatimi në pronë dhe ajo është baza e financimit të tyre. Ai tatim kur është aplikuar, unë kam qenë ministër dhe i di synimet, qëllimet dhe metodat që e ka përcjellë.

Në atë kohë, ne i kemi përcjellë komunat se si e kanë shtruar atë çështje, si i kanë realizuar ato tatime dhe po t'i shikoni buxhetet e viteve 2002-2003, do të shikoni se janë stimuluar po aq sa ato kanë bërë mbledhjen nga ky tatim, që është i vetmi tatim për komuna, në kuptimin që t'i stimulojmë, jo për kah masa, se masën nuk mund t'i përcaktosh, se fuqia ekonomike është e një komune, dallon nga tjetra, por nga përqindja e realizimit, që ai e ka parashtruar dhe vërtet ka pasur një garim mandej të komunave në përmbushjen e këtij buxheti.

Po t'i shikoni këto sot, ose buxhetin e vitit 2013, apo edhe 2012, flas tash ka prizma e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, e kam vërejtur se është në shpërputhje të plotë. Komunat të cilat nuk kanë inkasuar, realisht u janë dhënë më shumë grande prej pushtetit qendror. Kjo e vë Komunën në një pozitë jo të drejtë. Unë nuk e lë edhe aspektin historik, por dua t'i përmbledh agregatat ekzistues në shfrytëzimin e tyre.

Kur jemi te komunat e reja, që po ashtu është objekt diskutimi, do të doja t'jua vë në dije çdonjërit që ka procedura dhe kalimi i procedurave të sjellë në një pozitë të keqe. Lexojeni nenin 4 dhe do të shihni se lihet në mundësinë e ministrit, përkatësisht të Qeverisë të ndajë buxhetin për komunat e posaformuara.

Ju lutem, aty ka një procedurë. Në radhë të parë Qeveria duhet të nxjerrë një vendim për themelimin e një komune, ta ngarkojë Ministrinë e Pushtetit Lokal që ta nxjerrë një ligj të territorit, të hapësirës, e cila do ta përfshijë ajo komunë, dhe në të ajo do të ketë një rekomandim të Ministrisë së Financave se sa është implikimi buxhetor i asaj komune dhe tek mandej mund të bisedosh për buxhetin e tij.

Ne këtu sot, në këtë projeksion e kemi të kundërtën. Fillimisht, prejudikon se po ndahet, po formohet një komunë, dhe si do t'i merret buxheti Komunës amë. Po ju lutem, aty ka

edhe investime kapitale, ka edhe investime në personel shitesë, ka edhe shumëçka tjetër, dhe, në fund të fundit, pse nuk definohet?

Të shkojmë më tutje me radhë. Pozicioni i pagave është i prezantuar në një pozicion 45 milionë. A nuk është kjo Qeveri, që është krekosur se po e përmbush një standard të kërkuar shumë herë nga faktori ndërkombëtar, edhe vendor, dhe është trajtimi i Administratës Publike, nivelimi i tyre, gradimi i tyre. Sa e sa herë Qeveria ka thënë se i ka kryer këto çështje dhe nëse këto kanë ndodhur pse të mbetet një pozicion i paqartësuar, i paspecifikuar? 45 milionë?

Pse nuk thuhet arsimit do t'i shkojnë kaq dhe përqindja do të jetë kjo, ose shëndetësisë, ose tjetrit? Por, lihet si një diçka e paqartësuar dhe lihet në kompetencën e ministrit dhe të Qeverisë mandej të alokohet atje ku dhe si të dojë.

Nuk është në rregull kjo çështje. Pastaj, unë i kam hulumtuar edhe nenet tjera. Ta zëmë, neni 13 flet për shkurtimet buxhetore, të cilat nuk janë të vogla. Unë nuk i preferoj ministrisë që të mos e zbatojë atë proces. Me krejt këtë, çfarë dua të them? Por, unë i preferoj ministrisë, edhe Qeverisë, se është i obliguar domosdoshmërisht ta respektojë Ligjin e menaxhimit të financave publike, se nëse e le kështu siç e ka lënë nenin 13, pikën 2, edhe pikën 5, ku e anashkalon tërë procesin në kompetencë të ministrit, përkatësisht Qeverisë, po i lë 75 milionë vetëm gjatë këtij viti t'i shkurtojë, t'i rialokojë ku të dojë.

Kjo nuk është në rregull. E pyes çdonjërin, pse të përjashtohet? Lexojeni pikën 5! Përjashtimisht thotë pika 2, se pika 2 e ka këtë vëllim. Pastaj te investimet kapitale, unë kam vërejtur edhe në disa sektorë, ku nuk janë qartësuar, ta zëmë në infrastrukturë për investime kapitale janë 2,2 milionë të paspecifikuara. Pse të specifikuar? Pse nuk thuhet: në këtë komunë, për këtë projekt.

Shpenzimet e paparashikuara, një pozicion e keni atje, zoti ministër, 7,5 milionë euro. Shumë tepër e madhe për investimet kapitale të paparashikuara. Sikur po i ndillni një kob Kosovës! Pse të jenë kështu? Pse nuk janë të specifikuara? Ky projekt, për këtë, për atë etj., etj.

Pastaj, në Ministrinë e Kthimit i keni 5 milionë e 600 mijë për investime kapitale, po ashtu të paspecifikuara. Pse? Nga prizmi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike kemi pasur rast kur janë bartur investimet kapitale nga një komunë në komunën tjetër pa asnjë vendim, por vetëm me vendim të ministrit. Këto janë shkelje dhe ato raporte shkojnë në Bruksel, prandaj nuk mund ta presim një raport të mirë.

Ne mund t'i mbyllim këtu dhe t'i komentojmë në stilin tonë, por bota i trajton sipas rregullave për ç'gjë i ka vendosur.

Po ashtu, e ke edhe te Pushteti Lokal një pozicion 3,5 milionë investime kapitale të paspecifikuara.

Të ndalemi te elementi që gjithsej bëjnë 18,7, e kur ia shtojmë edhe ato 75 milionë del se 93 milionë e 700 mijë, Qeveria mund t'i riallokojë ku të dojë. Unë pyes: ku është kuptimi i kësaj që na po i thyejmë dhëmbët, prej kësaj që ne do të votojmë, prej kësaj që opinioni do ta marrë mesazhin se çdo gjë, çdo euro është diskutuar, është ndarë dhe do të zbatohet sipas këtyre rregullave? Jo, s'po e ndajmë sipas këtyre rregullave, s'e kemi ndarë as vitin e kaluar.

Prandaj, nëse e lëmë ventilin përjashtim pikës 2, atje te pika 5 do ta kemi këtë rezultat. Te aspekti strukturor unë mendoj se do të kishte qenë shumë mirë, sikur ministri të na kishte treguar proceset në trajtimin e hartimit të këtij projeksi buxhetor, qarkoret buxhetore. Sa ka pasur suficit buxhetor, sa i ka pasur kërkesat për projektet e caktuara? Cilat janë ato? Pse janë shkurtuar ato? Cilat janë arsye që këtyre projekteve u është dhënë prioritet?

Dhe, në momentin kur shkurtohen, po të vijnë në Kuvend, ato duhet të diskutohen. E ke kërkuar në fillim të vitit, nuk e ke realizuar. Pse nuk e ke realizuar? Cilat janë qëllimet? A e ke sjellë projektin pa projekt? Cila është arsyeja? Do të thotë, te ne ndodh shumëçka. Ne diskutojmë. Po i shkurojmë në filan vend dhe po i çojmë këtu, dhe fokusohemi atje ku po i çojmë. Por, unë e dua një analizë pse nuk është realizuar ajo? Pse ai prioritet që ia ke dhënë fillim të vitit, gjatë vitit, nuk ka vlejtur? Vetë e ke shkruar, ti e ke një arsye.

Pa një diçka të tillë, unë frikohem se buxhetin edhe më tutje do ta kemi diçka që nuk do të jetë drejt qëllimit dhe krejt në finale e kanë thënë shumë kolegë, zoti ministër ,po ta përsëris: 58 milionë i ke investime të reja,...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Hamza Balje.

HAMZA BALJE: Zahvaljujem predsedniče!

Ja ću svoje izlaganje u pismenoj formi predati predsedništvu. Zahvaljujem!

#### Diskutim i dorëzuar me shkrim

Evidentno je da je budžet preslikan iz 2013. godine jer su lokalne vlasti naročito u sredinama gde su manjine (Bošnjaci i Goranci) ciljane u opštinama Prizren i Dragaš, smanjene su investicije, a i one koje su uvrštene u budžetu nemaju nikakvog značaja za mesno stanovništvo.

To je prvo u vrednosti koja je ista kao i prošle godine, drugo nisu razjašnjeni u nacrtu gde i kako će se investirati.

Primera radi, kada se radi OS Restelici primetno je da su iz vladinih granta izdvojene sredstva u vrednosti od 220 000 evra za neki glavni put, koji se ne zna gde. A zna se da mes. stanovnika traži upravo već 2 godine da se u budžet uvrste sredstva od 450 000 evra za izgradnju kuća srušenih u katastrofalnoj nesreći koja je zadesila ovo selo.

Takođe od vitalnog značaja je otvaranje puta ka Makedoniji (Strezomir) koji bi doprineo za ekonomski razvoj ovog kraja.

Dakle, budžet se treba menjati u pojedinim tačkama i kao takvog ga možemo prihvatiti. Da ne govorim o drugim stvarima koje su unapred predodređene. U nekim selima je sve pokockano, pa se opet uvrstavaju pokockavanje ulica bez prave adrese.

Bitno je da se ubace u budžet, pa ćemo ih lako menjati za druge stvari koje nam trebaju, i to ne u jednom projektu nego u skoro svim.

Ovo se dešava u jednom podužem periodu, umesto da se te investicije daju ljudima koji će pravilno iskoristiti, one završavaju kao slepo crevna, ili u nekom ćošku.

Što se tiče Prizrena, isti je slučaj a možda i gori, jer u odnosu na broj stanovništva koji datira u opštini, očigledno je da nisu izdvojena sredstva pravilno, onoliko koliko je potrebno za meno stanovništvo u Župi i Podgori. Znači, evidentno je da su politizovana sredstva odnosno ciljano se daju sredstva određenim grupacijama a nikako građanima koji plaćaju porez i koji zaslužuju.

Zdravstvo i obrazovanje je na samoj crti odnosno malo iznad nule, i time smatram da smo svi zdravi i pismeni i da nam ne trebaju sredstva za knjige, ambulante, laboratorije pa mora da šaljemo pacijente van Kosova na lečenje, ili da nam učenici svake godine fotokopiraju knjige da bi mogli da savladaju gradivo.

*(Hamza Balje, d.v.)*

KRYETARI: Bahri Thaçi e ka fjalën.

BAHRI THAÇI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Shumica prej atyre që i kisha ndërmend t'i them, veç u thanë sot, dhe me të vetmin qëllim që ta ruajmë edhe shtyllën e kurrizit, shtyllë e cila mund të shtrembërohet edhe si deputetë duke ndenjur gjatë ulur, posaçërisht duhet pasur kujdes për të mos ndenjur shtrembër.

Do të ndalem kryesisht te transferet sociale dhe te shëndetësia, për të mos ju lodhur.

Transferet sociale në vete përmbajnë një rritje prej 24 milionë, kështu që kur dëgjohet kjo mendohet që vërtet është bërë një diçka e madhe për t'i ndihmuar kësaj kategorie. Por, nga kjo rritje, pjesa më e madhe shkon për mbulimin e kategorive të reja, siç janë: të burgosurit politikë dhe veteranët e luftës, përderisa as që mendohet për rritje të përkrahjes së skemave sociale dhe kategorive tjera në nevojë.

Buxheti për skemat sociale nuk është rritur më shumë se 6 vjet. Kjo tregon për qasjen jo të barabartë në shpërndarjen e buxhetit. As që pritet të kemi të rritje të pensioneve dhe kategorive tjera.



Sa i përket buxhetit për shëndetësi, vazhdon të mbetet i njëjtë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

Kjo tregon që shëndetësia ende nuk është prioritet. Nuk kemi rritje të numrit të stafit për këtë ministri, përderisa Ligji për shëndetësi është miratuar në Parlament dhe një pjesë e madhe e këtij ligji nënkupton rritje të stafit për implementimin e reformave të parapara me ligj.

Do të jem shumë konkret, do t'ua citoj vetëm një nen të këtij ligji, i cili thotë: “Në të gjitha barnatoret, qofshin ato publike apo private, barnat duhet t'i jepen pacientit nga farmacisti, ose së paku në prani të farmacistit”, e ne sot në Kosovë, në sektorin publik... *(Ndërprerje nga regjia)*... të barnatoreve nuk kemi farmacistë.

Andaj, kërkoj nga Komisioni për Buxhet dhe Financa që për Ministrinë e Shëndetësisë, përkatësisht për shëndetësinë të jetë pak më dorëlibër në mënyrë që të mund të rritet stafi dhe reformat që kanë filluar të shkojnë edhe më tutje. Faleminderit!

#### Diskutim i dorëzuar me shkrim

ELMI REÇICA: I nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2014 vazhdon me trendin e rritjes të zhvillimit ekonomik, trend ky që është më i larti në rajon (ky konstatim nuk është vetëm vlerësim yni, por edhe i institucioneve financiare ndërkombëtare).

Sa buxheti i vitit 2014 është buxhet zhvillimor tregon edhe fakti se politikat e Qeverisë përkrahin sektorët, të cilët janë bartës për zhvillimin ekonomik. Kjo pasqyrohet nëpërmjet ndarjeve buxhetore ku shihet se 531 milionë euro janë mjetet të ndara për investime kapitale. Kjo kategori përfaqëson 33% të buxhetit të përgjithshëm për vitin 2014, apo përafërsisht 10% të bruto-produktit vendor.

Sektori i infrastrukturës vazhdon ta ketë pjesëmarrjen më të madhe në ndarjen buxhetore për investimet kapitale. Përkundër që projekti më madhor i financuar ndonjëherë përfundon në vitin 2013, projekti i autostradës “Ibrahim Rugova”, me buxhetin e vitit 2014 dhe vitet vijuese do të financohen projekte tjera të rëndësisë nacionale, si: Rruga 6 - Prishtinë - Hani i Elezit, rruga M2 Prishtinë - Mitrovicë, rruga M9 Prishtinë - Pejë, si dhe një varg projektesh tjera, të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e infrastrukturës rrugore në përgjithësi.

Sektori i bujqësisë vazhdon edhe më tutje të ketë rritje të ndarjeve buxhetore. Për këtë sektor në vitin 2014 do të kemi rreth 4 milionë euro më shumë ndarje buxhetore se në vitin 2013. Kjo do të ndikojë në rritjen e granteve për fermerë dhe subvencionimin e prodhimeve vendore, rritje të të ardhurave të fermerëve, përmirësimin e aftësive

konkurruese të ndërmarrjeve bujqësore dhe agropërpunuese, zëvendësim të importit me produkte vendore etj.

Po ashtu, në këtë sektor vazhdohet të financohen investimet kapitale në shumën prej rreth 10 milionë në projektet e sistemeve të ujitjes dhe disa projekte tjera të pylltarisë, të cilat drejtpërdrejt ndikojnë në zhvillimin e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural.

Subvencionet për ndërmarrje publike kanë shënuar rënie krahasuar me ndarjet buxhetore për vitin 2013, krejt kjo në përkrahje të politikave qeveritare që kanë për qëllim ngritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të punës së ndërmarrjeve publike, pra rritjes së inkasimit të të hyrave vetjake për këto ndërmarrje publike.

Sekretit privat vazhdon të mbështetet nëpërmjet promovimit të investimeve dhe potencialit eksportues, promovimit të turizmit, avancimit të infrastrukturës së cilësisë, mbikëqyrjes së tregut dhe mbrojtjes së konsumatorit, si dhe zhvillimi i mëtejshëm i politikave tregtare, mbështetje e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme etj.

Sa i përket mbrojtjes së mjedisit do të vazhdohet me projektet që kanë të bëjnë me rregullimin e shtratit të lumenjve, krijimin e kushteve për menaxhimin e mbeturinave, si dhe financimin në ngritjen e rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit.

*(Elmi Reçica, d.v.)*

#### Diskutim i dorëzuar me shkrim

FADIL DEMAKU:

Buxheti i vitit 2014 tregon edhe njëherë përkushtimin institucional për një disiplinë fiskale dhe për një stabilitet makroekonomik të garantuar nga menaxhimi i rregullt dhe harmonizimi i nevojave për likuiditet financiar.

Buxheti i vitit 2014 është vazhdimësi e rritjes së vazhdueshme ekonomike, duke iu kthyer taksapaguesve në një proporcion të drejtë me atë se çfarë ata paguajnë.

Për më tepër, ky buxhet mundëson rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve nëpërmjet rrugëve më të mira, shkollave, ujit dhe shërbimeve tjera publike.

Ne e konsiderojmë si një mundësi serioze për të vazhduar me rritjen e buxhetit dhe e inkurajojmë vazhdimin e luftës kundër informalitetit në ekonomi dhe evazionit fiskal, ku me gjithë vlerësimet pozitive për punën e mirë të tyre, dihet se niveli i synuar ende nuk është arritur edhe në këtë pikë ky buxhet paraqet një vazhdimësi të mirë për rritjen e kapaciteteve të institucioneve të vendit në realizimin e synimeve tona afatgjate, për një rritje të qëndrueshme dhe për një model të zhvillimit ekonomik, i bazuar në shfrytëzimin sa më të drejtë të resurseve.

Ndikimi i buxhetit 2014 do të jetë i rëndësishëm në mbajtjen e kërkesës agregate të lartë dhe në rritjen e kërkesës për produkte vendore, duke vazhduar me përkrahjen e sektorit privat që ai të forcohet edhe më tej dhe të jetë partneri kyç në ndërtimin e vendit nëpërmjet kontributit që jep në buxhetin e shtetit.

Tani do të fokusohem më tepër te sektori i rendit dhe sigurisë.

Qeveria e Kosovës nëpërmjet buxhetit për vitin 2014 ka vazhduar përkushtimin e saj në përkrahje të këtij sektori shumë të rëndësishëm në ngritjen e kapaciteteve të institucioneve të rendit dhe sigurisë.

Rëndësi të veçantë në këtë drejtim ka zbatimi i marrëveshjes me institucionet dhe vendet tjera në fushën e sigurisë, gjyqësisë dhe prokurorisë. Buxheti për vitin 2014 reflekton rritje të numrit të stafit dhe buxhetit për këto fusha të rendit dhe sigurisë.

Për periudhën 2014, buxheti i MPB-së ka rritje të konsideruar gjithashtu edhe me numër. Policia e Kosovës do të vazhdojë të pajiset me mjetet teknike të nevojshme me qëllim të forcimit të mëtutjeshëm të kapaciteteve të policisë, në veçanti fushat që kanë të bëjnë me hetimin, luftimin dhe zbulimin e krimit të organizuar, luftimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit si bartëse kryesore të sistemit gjyqësor dhe prokurorial janë duke shënuar rritje të vazhdueshme të buxhetit nga viti në vit.

Në fushën e sigurisë, Qeveria do të vazhdojë ta mbështesë fuqishëm transformimin e FSK-së në një forcë të re me mision dhe detyra shtesë në pajtim me standardet më të larta të NATO-s, që do t'i përmbushë kërkesat në lëmin e sigurisë sipas rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë.

Buxheti për vitin 2014, i paraparë për Agjencinë e Inteligjencës së Kosovës është solid dhe që garanton përmbushjen e misionit të këtij institucioni të rëndësishëm së veçantë në fushën e sigurisë së vendit tonë.

Ne do ta mbështetim këtë buxhet. Faleminderit!

*(Fadil Demaku, d.v.)*

KRYETARI: Dhe, diskutuesi i fundit, deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqë u tha shumë dhe krijuam mjaft argumente, unë do ta shkurtoj diskutimin tim dhe do të kaloj drejtpërdrejt në disa konstatime që i kam. Pra, tani derisa po diskutohet ky buxhet prej afro 1 miliard e 500 milionë, shihet se është një buxhet shumë i vogël për një shtet dhe për një popullatë afro 2 milionë banorë, prandaj janë gjitha këto arsye të diskutimeve se çka përpara.

Të ishte për dëshirat dhe premtimet elektorale, kishim për t'i zgjidhur të gjitha problemet dhe sigurisht s'kishim pasur më shumë se 3 diskutues, por kur e kemi buxhetin përpara

dhe biem në një realitet, tash fillojmë të djersitemi dhe themi çka përpara. Kudo që do të shkonte ky buxhet, diçka rregullon, por shtrohet pyetja cilat janë prioritetet?

Por, ajo që unë do të diskutoj tash, do të diskutoj më tepër për dy qasje që i ka ky buxhet. E para, për qëllim që të rritet ky buxhet dhe pastaj do të kishim zgjidhur probleme, unë shoh, sikur edhe vitin e kaluar, edhe këtë vit, një ambicie të vogël të Qeverisë dhe të ministrisë në vjeljen nga ekonomia informale, de facto zvogëlimin e ekonomisë informale dhe rritjen e buxhetit.

Sado që specifikisht nuk po shihet, unë po besoj që diçka është llogaritur në të, por nga vlerësimet e të gjithë ekspertëve, ajo vlerë duhet të jetë diku rreth 200 milionë.

Unë kam pritur që bile këtë vit, Qeveria ta rrisë disiplinën dhe nëpërmjet pikave doganore dhe Administratës Tatimore së paku të fillojë që nga ky vit dhe kthejë diku rreth 100 milionë, që tash do të i zbutnin problemet. Por, nëse ne vazhdojmë kështu ta tolerojmë para syve ekonominë e fshehtë, ndërsa pastaj me mjetet që i kemi fillojmë majtas dhe djathtas. Pra, duhet të merret aty ku ka, sepse krijohet edhe një padrejtësi në treg pastaj.

Ngjashëm është edhe çështja me komunat. Ne i kemi komunat të cilat hyjnë në borxhe dhe po e marrim vetëm për vitin 2013, sipas vlerësimit të institutit GAP, kemi pasur komuna që janë futur në borxhe aq sa ka investime kapitale për vitin e ardhshëm dhe ajo komunë sigurisht s'do të mund të hynte në borxhe nëse dikush nuk do t'i thoshte "hajt ti, se unë t'i jap ty". Dhe, këtu është problemi me gjithë diskutuesit që flasin për ministrinë e linjave.

Sikur ministrinë e linjave të kishin dalë dhe të tregonin se cila është strategjia e asaj ministrie dhe duke financuar në atë fushë cilat janë rezultate, e jo t'i ruajë mjetet dhe pastaj të fillojë t'u ndajë komunave sipas dëshirës, dhe cila është pasoja më e madhe që krijohet. Komunat nuk kanë motiv që t'i rritin të hyrat vetjake, prandaj edhe kjo është arsyeja po të analizoni 'mallra dhe shërbime', ju e shihni se cilat janë komunat e mira dhe cilat janë komunat jo të mira. Sepse, komunat në mënyrë joproporcionale me buxhetin e vet shpenzojnë në reprezentacion, në mëditje, në telefoni, derivate të naftës etj.

Prandaj, derisa nuk e rritim disiplinën financiare dhe nuk presim në autonominë e komunave, në rast se kur ne i japim mjetet nga qendra, duhet edhe të presim që aty të krijohen disa standarde të shpenzimit nëpër komuna.

Pra, duhet duke krijuar disiplinë financiare, t'u krijomë komunave motiv për t'i rritur të hyrat. Kjo është dy.

Çështja e tretë është befasuese se pse së paku të kemi një hyrje-dalje të mjeteve nga pika doganore 1 dhe 31 nëpër buxhet që qytetari ta kuptojë se çfarë po ndodh me atë çështje dhe meqenëse s'kemi kjo është një e metë dhe, e fundit, unë vërtet jam optimist në diskutimin që e tha kryeministri. Më vjen mirë që ... ka dhënë shumë përgjigje, nuk e di në cilën e pati, dhe në shumicën e atyre përgjigjeve unë besoj se ka vend për optimizëm. Së paku për mua ka vend për optimizëm dhe unë besoj që stadiumet është mirë që

riparohen, veç të bëhet “Uembly” me buxhet të Kosovës jo, sepse në Mitrovicë janë 93 milionë, por 62 janë nga Komisioni Evropian, e nëse dikush në këtë sallë do të jetë zëdhënës i donacionit të bashkësisë ndërkombëtare është çështje tjetër, por nga Buxheti i Kosovë të bëjmë “Uembly” është çështje tjetër.

Dhe, pika e fundit që do të them, një komunitet shumë i fuqishëm në Kosovë që janë të papunët, me këtë buxhet Zoti u ndihmoftë. Faleminderit!

KRYETARI: Diskutimet kanë përfunduar dhe së fundi është fjala për ministrin Besim Beqaj.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit i nderuar kryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Unë me vëmendje e kam dëgjuar secilin diskutim të secilit deputetë, veç e veç, për të marrë sugjerimet tuaja, shpjegimet, për t’i dhënë edhe ato orientimet të cilat ne i kemi dhënë për një buxhet, i cili është buxhet i rritjes ekonomike, buxhet, i cili nëse krahasohet me vendet e rajonit, është shumë më mirë.

Jemi në situatën kur përderisa në rajon buxhetet bëhen, rishikohen për t’i reduktuar shpenzimet, për t’i reduktuar pagat, ne edhe në shikim, edhe në këtë buxhet, kemi rritje të investimeve, kemi rregullim fiskal, i cili na mundëson që ne të kemi disiplinë të jashtëzakonshme financiare dhe njëkohësisht një buxhet, i cili mundëson edhe rritje ekonomike, e cila është më e mira në rajon.

Ne në Ministrinë e Financave, së bashku me Komisionin për Buxhet dhe Financa, do ta analizojmë secilën veç e veç dhe do ta bëjmë së bashku një buxhet, i cili do t’u përgjigjet interesave të qytetarëve të Kosovës.

Ky është misioni i Qeverisë, ky është misioni i Ministrisë së Financave dhe i Kuvendit gjithashtu. Faleminderit të gjithëve për vërejtjet dhe do të punojmë ndërmjet dy leximeve së bashku. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit edhe për kohën e shkurtër. Sipas pranisë elektronike, të pranishëm janë 93 deputetë. Ministri e ka kryer fjalën dhe nuk ka më diskutime. As replikë, as asgjë! 91 është prania fizike. Atëherë lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 59 vota për, 31 kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 04/L-233 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojmë Projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë, pasi i kemi dy ligje në lexim të dytë, konsideroj që shkojnë shpejt dhe kemi rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për kërkesën e Fondit të Kursimeve Profesionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2014.

## **5. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2014**

Fjalën ia kisha kaluar deputetes, kryetares së Komisionit FunkSIONAL, deputetes Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 12.11.2013, e ka shqyrtuar kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksës vjetore për vitin 2014 dhe ka vendosur që t'i rekomandojë Kuvendit që të miratohet kërkesa e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksës investive prej 0,40% dhe taksës operacionale prej 0,13% për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2014.

Në bazë të nenit 4, paragrafi 7 të Ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, aktivitetet e fondit të financohen nëpërmjet pagesave të arsyeshme të bazuara në shpenzimet e llogarive individuale. Kuvendi i Kosovës e cakton taksën investive dhe operacionale në bazë të kërkesës së fondit për çdo vit kalendarik, e cila kërkesë duhet të jetë e specifikuar në të gjitha shpenzimet e përlllogaritura për periudhën për të cilën paraqitet kërkesa në pajtim me nenin 2, paragrafi 1 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Fondin Pensional dhe Ligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit nr. 04/LK-101 për Fondin Pensional të Kosovës.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 12 nëntor e ka shqyrtuar kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale për miratimin e taksës vjetore për vitin 2014 dhe e ka analizuar edhe buxhetin e fondit të miratuar nga Bordi udhëheqës dhe i ka rekomanduar Kuvendit ta miratojë taksën operacionale prej 0,13 dhe taksën investive prej 0,40%, që përfshin periudhën 1 janar - 31 dhjetor.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit të kësaj takse investuese dhe taksës operacionale kanë qenë edhe përfaqësuesit e Fondit të Kursimeve Pensionale, të cilët u janë përgjigjur të gjitha shqetësimeve, të cilat i ka ngrëhur Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe në fund unanimisht është përkrahur kjo taksë investive dhe operacionale për Fondin Pensional. Faleminderit!

KRYETARI: Shkojmë në votim menjëherë. Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 76 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi e miratoi rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Fondit të Kursimeve Profesionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2014.

## 6. Shqyrtim i dytë i Projektligjit për fshatin Zym i Hasit

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për fshatin Zym i Hasit dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, deputetin Nait Hasani që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni e ka shqyrtuar Projektligjin për fshatin Zym dhe ka nxjerrë amendamentet, si dhe i propozon Kuvendit që të miratohet ky projektligj për shkak se fshati Zym është një fshat me një kulturë dhe një histori shumë të lashtë të trashëgimisë sonë kulturore, prandaj kërkohet që ky projektligj të miratohet dhe të ndihmohet në mbrojtjen e këtyre vlerave të trashëgimisë sonë të lashtë dhe historike qindravjeçare.

Komisioni ka pasur parasysh këtë dhe trashëgiminë atje dhe ka vendosur në mënyrë unanime që t'i dërgohet Kuvendit, seancës plenare, që ta miratojë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 8 amendamente. Në amendamentin e parë ka një vërejtje nënkryetari dhe deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit, Krasniqi!

Unë e kam lexuar në dy variante këtë ligj, edhe variantin e parë. Ky që e kemi sot në dorë, mund t'ju them gati është i rishkruar, sepse ligji edhe ashtu nuk ka shumë nene, me një provë që të bëhet më i saktë dhe më preciz.

Megjithatë, unë propozoj që neni i parë i këtij ligji, që është gjithmonë themelori, të duket kështu: neni i parë - qëllimi. Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore e fshatit Zym i Hasit dhe promovimi i tij si fshat me vlera kulmore të rëndësisë lokale, shtetërore e ndërkombëtare, si dhe zhvillimi i qëndrueshëm dhe harmonizimi i tij.

Po e përsëris edhe një herë, nëse e keni tekstin përpara, ju lutem përcillen. Unë kam parasysh edhe ekipin sponsorues. Jam konsultuar edhe me ata që e kanë nënshkruar iniciativën dhe ata më kanë thënë se kjo është ideja. Po e përsëris, edhe një herë:

Neni 1, qëllimi i këtij ligji është mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore e fshatit Zym i Hasit dhe promovimi i tij si fshat me vlera kulturore të rëndësisë lokale, shtetërore e ndërkombëtare, si dhe zhvillimi i qëndrueshëm dhe harmonizimi i tij. Ky është neni themelor. Ky nen sintagmën e definon edhe te neni 4 dhe neni 6. Po shpjegoj se me çka ka të bëjë. Ka pasur variant 'trashëgimia historike, kulturore fetare', ka dalë varianti 'fetare kulturore', ka dalë 'varianti kulturore fetare'.

Unë si njohës i asaj që quhet kulturë nacionale tradicionale, them kulturore mbështet brenda edhe fetare, edhe historike, edhe etnografike, edhe shkrimore dhe të tjera, dhe unë

mendoj se ky është formulim i vërtetë për qëllimin që fshati Zym i Hasit ta ketë statusin e zonës të veçantë të mbrojtur.

Unë mendoj që ky formulim është më i saktë. Duhet dhe disa saktësime në nenet tjera, por janë gjuhësore dhe unë kujtoj që konkondarta gjuhësore mund të rregullohet me një lekturë të tekstit. I drejtohem sponsoruesit, i kam konsultuar dhe nënshkruesit e iniciativës. Ky është propozimi im. Faleminderit!

KRYETARI: Ju e dëgjuat propozimin e nënkryetarit dhe deputetit Sabri Hamiti. Konsideroj që e ka të drejtën dhe ne po e hedhim në votim amendamentin e parë, sipas propozimit të deputetit Sabri Hamiti.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Urdhëronim, fjalën e ka kryetari i Komisionit, Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Kërkoj që propozimi i Komisionit të dalë në votim, nëse nuk kalon ai, pastaj është propozimi i Sabri Hamitit.

E votojmë amendamentin e parë sipas variantit të Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Jo nuk e përsëris, se shqip ishim duke folur të gjithë. Mirë! E hedhim edhe variantin e dytë, i propozuar nga Sabri Hamiti.

Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Amendamenti 1

Kaloi varianti i parë, do të thotë ky i dyti është 32, me 33 minus, 8 abstenuan.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Të pranishëm janë 80 deputetë.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.



Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Tani e votojmë ligjin në tërësi. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 56 vota për, 19 kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për fshatin Zym i Hasit. Totali është 75.

## **7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sistemin e lejeve dhe licencave**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për sistemin e lejeve dhe licencave dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputetin Zenun Pajaziti që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar projektligjin për sistemin e lejeve dhe licencave dhe i propozon Kuvendit që ta miratojë në parim.

Më lejoni që ta bëj edhe një sqarim, meqenëse ky është ndër projektligjet që është kthyer dy herë dhe një kohëzgjatje ka qenë më e madhe derisa kemi ardhur këtu në lexim të dytë, megjithatë Komisioni për Legjislacion ka pasur vërejtje dhe ka menduar se në dy pika është i kontestueshëm për shkak se është në kundërshtim edhe me Kushtetutën.

Komisioni, përkatësisht Grupi punues ka punuar dhe i ka bërë dy amendamente shtesë në përputhje me rekomandimet e Komisionit për Legjislacion, në ndërkohë që kemi pas pasur edhe komente, por duhet t'i sqaroj këtu para seancës, edhe nga partnerët që kanë ndihmuar në dizajnimin e këtij projektligji në momentin e fundit, që ta ketë një format tjetër, megjithatë unë kam kërkuar edhe nga Qeveria, edhe nga partnerët e tjerë, që edhe një herë të konsultohemi, megjithatë jam dakorduar që ky format i tashëm mund të shkojë dhe në një kokë krejt tjetër ndoshta mund të gjendet ndonjë variant tjetër.

Pra, mendoj që duke i marrë parasysh edhe rekomandimet e Komisionit për Legjislacion, tash është përmbushur në tërësi ky projektligj dhe ju ftoj ta votoni.

KRYETARI: Mirë, shkojmë në procedurën e votimit. Por, amendamenti që u miratua, i pari, mendoj që në një formë bie ndesh me Kushtetutën, kështu që është mirë të shikohet,

por ai bie ndesh me Kushtetutën. Po, po, bie ndesh me Kushtetutën, lexojeni mirë ligjin dhe lexojeni mirë Kushtetutën se çfarë shteti është Kosova.

*(Reagime nga salla)*

Kosova është shtet laik, por nuk është shtet fetar. Ti miratove diçka që bie ndesh me Kushtetutën. Vazhdojmë me pikën e shtatë. Nuk ka amendamente kundërshtuese.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 27

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 28

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Tani e votojmë Ligjin në tërësi. Të pranishëm janë 82 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 53 vota për, 21 vota kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për sistemin e lejeve dhe të licencave.

Fjalën e ka kërkuar kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Unë i kisha propozuar seancës para se të dalim, meqë jam plotësisht i bindur se disa deputetë kanë votuar gabimisht, prandaj kisha kërkuar edhe një herë që ta hedhim në votim ligjin.

KRYETARI: Ju lutem, uluni në vendet tuaja se na duhet tash një votim formal i deputetëve për këtë çështje.

Atëherë, kush është që amendamenti 1 ose neni 1 i ligjit, seanca mund të marrë vendim, për ta rivotuar edhe një herë?

Shumica është për. A ka kundër? Atëherë, ju lus që amendamentin 1 të Ligjit për fshatin Zym, propozimin e deputetit Sabri Hamiti ta hedhim në votim edhe një herë.

Lus deputetët të votojmë me elektronikë. Pra, nenin 1, ashtu siç e propozoi deputeti Sabri Hamiti. Ju lutem uluni, zërin vendet tuaja!

Ju lutem fillimisht votojmë për praninë. Votojmë tash! Regjia, votojmë për praninë. Me prani elektronike janë 81 deputetë. Tani e votojmë propozimin për nenin 1, të deputetit Sabri Hamiti.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Gjithsej 39 vota dhe një me dorë, pra 40. Tani e votojmë ligjin në tërësi. Votojmë tash!

Konstatohet se me 65 vota për, 9 kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin për fshatin Zym i Hasit.

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*